



**UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I DREJTËSISË
DEPARTAMENTI I TË DREJTËS PENALE**

DISERTACION

PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE

“DOKTOR”

“KRIMET SEKSUALE”

Kandidati:

Deniona KATRO

Udhëheqës shkencor:

Prof. Dr. Vasilika HYSI

Tiranë, Shtator 2016

Një falënderim i veçantë shkon për udhëheqësen time shkencore Prof. Dr. Vasilika Hysi e cila ka qenë pranë meje me këshillat e saj profesionale gjatë realizimit të këtij punimi.

Mirënjohje e thellë për familjen time e cila më mbështeti dhe më ndihmoi gjatë gjithë kohës së studimeve doktorale.

Deniona

Familjes sime!

Parathënie

Shqipëria është një vend në ndryshim dhe qysh nga rënia e diktaturës në vitin 1991, ligjet në vendin tonë kanë pësuar ndryshime rrënjësore për t'i përafuar ato me standardet europiane. Megjithëse me një ritëm më të ngadaltë, këto ndryshime do të vazhdojnë edhe në të ardhmen e afërt. Një shoqëri në tranzicion është një shoqëri shumë delikate dhe vendet në tranzicion, sidomos ata në Ballkan, janë goditur nga krimi i organizuar me të gjitha format e tij.

Në Shqipëri i është kushtuar shumë vëmendje luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Gjithësesi, për të ndërtuar një shoqëri të bazuar në respektimin e ligjit dhe të të drejtave të njeriut nuk është e mjaftueshme vetëm lufta kundër kriminalitetit të nivelit të lartë. Ndërkohë që krimi i organizuar sjell kosto të mëdha shoqërore, ai nuk ndikon në jetën e përditshme të qytetarëve të cilët preken më tepër nga konflikte pronësie dhe konflikte kontraktuale si dhe nga kriminaliteti ordiner siç janë krimet e dhunshme dhe në mënyrë të vecantë krimet seksuale.

Ideja që aktiviteti seksual lidhet me dhunën me mekanizma biologjike të përpunuara gjatë evolucionit është një e vërtetë e provuar. Krimi seksual brenda familjes ekziston sepse ekziston baza biologjike për të: lidhja seks - dhunë. Dhe në një shoqëri si e jona, ku mënyra kryesore e seksit të ligjëruar është familja, dhuna seksuale brenda familjes, është edhe më e madhe. Viktimat në këto lloj veprash penale janë femrat dhe fëmijët.

Në radhë të parë janë normat morale që kufizojnë ose ndalojnë seksin. Shoqëritë që kufizojnë fort marrëdhënien seksuale jashtë martesës, janë shoqëri seksualisht të dhunshme. Restriksioni seksual, e përcakton seksin si diçka të keqe. Kombinimi i restriksionit seksual me idenë se seksi është një e keqe, e bëjnë seksin edhe më violent në ato shoqëri ku zotëron ky kod seksual. Kultura jonë është një kulturë seksualisht restriktive, me shumë tabu në fushën e seksualitetit.

Hapja që bëri shoqëria shqiptare në këto njëzet e pesë vjet, futja e sjelljeve të reja në fushën e seksualitetit, influenca shumë e madhe e medias, e artit dhe muzikës në kushtet e një mentaliteti represiv, janë faktorët që ndihmuan të rritet violenca seksuale në vëndin tonë. Antagonizmi seksual dhe teoria e segregacionit, na mësojnë se sa më i lartë të jetë niveli i antagonizmit midis burrit dhe gruas, aq më e madhe është tendenca për të përdorur violencën në aktin seksual. Në një shoqëri si e jona antagonizmi midis sekseve është shekullor. Nuk duhet të çuditemi që niveli i sotëm i antagonizmit midis sekseve, është po aq i madh sa dhe në kohët e herëshme. Femrat shqiptare në shumë zona të vëndit, vazhdojnë t'i shohin meshkujt si shfrytëzuesit e tyre dhe i edukojnë vajzat me idenë se burrat kanë avantazhe mbi to.

Meshkujt e dhunshëm, ose përdhunues, nuk ndjehen fajtorë dhe nuk preken prej këtij akti. Mekanizmat e tyre mbrojtëse funksionojnë mjaft mirë dhe ata nuk shqetësohen për pasojat fizike.

Krimet seksuale prekin ndjeshëm ndërgjegjen e të gjithë qytetarëve, sepse janë krime që çënojnë rëndë dinjitetin e personit, vecanërisht të femrës, lirinë e tij dhe të drejtën për vetëvendosje në një fushë shumë delikate, individuale e thellësisht personale sic

është sfera seksuale. Karakteristika kryesore që dallon veprat penale që çënojnë sferën seksuale nga veprat e tjera penale është gërshetimi i efekteve juridike me ato psikologjike që rrjedhin nga kryerja e këtyre veprave penale.

Krimet seksuale ndaj të miturve kanë patur përhapje kohët e fundit dhe çënojnë rëndë zhvillimin seksual të të miturit si dhe zhvillimin mendor të tyre. Krimet seksuale lënë pasojë si në anën fizike të subjektit pasiv po ashtu dhe në anën psikologjike si dhe ndikojnë në marrëdhëniet interpersonale.

Në përfundim, dëshiroj të them se seksi është instikt human themelor që influencohet nga shoqëria dhe nga faktorë të tjerë. Shoqëri të ndryshme kanë mënyra të ndryshme të formave dhe drejtimeve që i japin seksualitetit. Sjelljet seksuale dhe traditat që duken barbare në një kulturë, mund të duken normale dhe të pranueshme në një kulturë tjetër. Kultura jonë është seksualisht restriktive, ky është fakt. Ajo është e tillë prej shekujsh. Ajo nuk mund të ndryshohet sforcueshëm brenda pak viteve, edhe pse do t'i quajmë ato tranzicion.

Duhet të nënvizohet se, ky punim nuk pretendohet të shterojë të gjitha problematikat që paraqet tema, por besohet të shërbejë si fillesë për nxitjen e diskutimeve dhe debateve të mëtejshme në literaturën tonë juridike si edhe në praktikën gjyqësore.

TABELA E PËRMBLEDHJES

KAPITULLI I

VËSHTRIM HISTORIK I KRIMEVE SEKSUALE NË SHQIPËRI

1.1	Hyrje.....	2
1.2	Analizë e krimeve seksuale në të drejtën zakonore shqiptare.....	2
1.3	Krimet seksuale sipas Kodit penal të Zogut	4
1.4	Krimet seksuale sipas Kodit Penal të vitit 1952.	9
1.5	Krimet seksuale sipas Kodit Penal të vitit 1977.....	11
1.6	Krimet seksuale sipas ligjit nr.7895 datë 27.01.1995 – Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.....	13

KAPITULLI II

NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KRIMET SEKSUALE SIPAS KODIT PENAL TË VITIT 1995 TË NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8733 DATË 24.01.2001 DHE ME LIGJIN NR. 144 DATË 02.5.2013.

2.1	Hyrje.	22
2.2	Krimet seksuale në Shqipëri.	23
2.3	Koncepti i “aktit seksual”.	25
2.4	Mënyra e realizimit të veprës penale.	27
2.5	Regjimi i ushtrimit të ndjekjes penale në krimet seksuale.	29
2.6	Kryerja e krimeve seksuale në bashkëpunim.	30
2.7	Krimet seksuale të mbetura në tentativë.	32
2.8	Aspekte kriminologjike të krimeve seksuale.	33
2.8.1	<i>Hyrje.</i>	33
2.8.2	<i>Kategoritë e krimeve seksuale.</i>	34
2.8.3	<i>Sjellja kriminale e autorit të veprës penale.</i>	36
2.8.3.1	<i>Strategjia e vetjustifikimit moral të sjelljes kriminale.</i>	37
2.8.4	<i>Një analizë e autorit të krimit seksual.</i>	38

2.8.4.1	C’rregullimet me natyrë seksuale të autorit të krimit seksual.	40
2.8.4.2	Autori i krimit seksual – viktimë e krimit seksual në fëmijëri.	41
2.9	Analizë e disa problemeve që evidentohen në lidhje me krimet seksuale.	42

KAPITULLI III

ANALIZË E DETAJUAR E KRIMEVE SEKSUALE NË SHQIPËRI.

3.1	Hyrje.	49
3.2	Marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale me të mitur.	49
3.3	Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur në moshën 14-18 vjeç.	58
3.4	Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura dhe marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur.	61
3.5	Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur.	66
3.6	Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën.	69
3.7	Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona në gjini apo kujdestari.	70
3.8	Veprat e turpshme me të mitur.	74
3.9	Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në vende publike.	77
3.10	Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës.	77
3.11	Dhuna seksuale.	78
3.12	Ngacmimi seksual.	79

KAPITULLI IV

STANDARTI I PROVËS NË KRIMET SEKSUALE. POZITA E VIKTIMËS NË PROCESIN PENAL. NDIHMA JURIDIKE.

4.1	Hyrje.	82
4.2	Provat tipike (të zakonshme) që ndeshen në krimet seksuale.	84
4.2.1	<i>Njolla sperme, materiali vaginal, pështymë, materiale fece dhe urine.</i>	84
4.2.2	<i>Akti i ekspertimit mjeko - ligjor dhe gjinekologjik.</i>	86
4.2.3	<i>Dëshmia e subjektit të dëmtuar.</i>	88
4.2.4	<i>Provat elektronike në krimet kibernetike me natyrë seksuale.</i>	90
4.3	Vlerësimi i provave tipike të krimeve seksuale.	92
4.4	Parimi in dubio pro reo (dyshimet në favor të të pandehurit).	96
4.5	Aspekte procedurale të trajtimit të viktimave të krimeve seksuale.	100
4.6	Kuadri juridik ndërkombëtar në trajtimin e viktimave.	100
4.7	Aspektet procedurale.	103
4.7.1	<i>Identifikimi i viktimës.</i>	103
4.7.2	<i>Informimi i viktimave.</i>	105
4.7.3	<i>Sigurimi, mbrojtja dhe rehabilitimi.</i>	105
4.7.3.1	<i>Sigurimi, mbrojtja.</i>	105
4.7.3.2	<i>Rehabilitimi i viktimës.</i>	106
4.7.4	<i>Parimi i mosdënimit të viktimave të trafikimit.</i>	109

KAPITULLI V

VËSHTRIM KRAHASUES

5.1	Krimet seksuale sipas kodit penal amerikan.	117
5.1.1	<i>Hyrje.</i>	117
5.1.2	<i>Vështrim historik.</i>	117
5.1.3	<i>5.1.3. Sjellja seksuale kriminale.</i>	118
5.1.4	<i>Historia e përdhunimit.</i>	120
5.1.5	<i>Elementët e përdhunimit</i>	121

5.1.5.1	Actus reus i përdhunimit.	121
5.1.5.2	Mens rea i përdhunimit.	121
5.1.5.3	Mosha për përgjegjësi penale.	122
5.1.5.4	Sjelljet kriminale seksuale me fëmijë.	122
5.1.5.5	Përfundimi i përdhunimit bashkëshortor.	122
5.1.6	<i>Elementët e sjelljes seksuale kriminale.</i>	123
5.1.6.1	Sjellja seksuale kriminale.	123
5.1.6.2	Shkallët e përdhunimit.	124
5.2	Krimet seksuale sipas kodit penal italian.	124
5.2.1	<i>Hyrje.</i>	124
5.2.2	<i>Vështrim historik.</i>	125
5.2.3	<i>Vështrim i përgjithshëm mbi krimet seksuale në Kodin penal italian.</i>	126
5.3	Krimet seksuale në të drejtën penale franceze. 132	
5.3.1	<i>Hyrje.</i>	132
5.3.2	<i>Vështrim historik.</i>	132
5.3.3	<i>Vështrim i përgjithshëm mbi krimet seksuale në Kodin penal francez.</i>	134
5.3.4	<i>Vepra penale e abuzimit seksual në sens të ngushtë.</i>	135
5.3.5	<i>Vepra penale e agresionit seksual.</i>	135
5.3.6	<i>Vepra penale e përdhunimit.</i>	136
6	Përfundime.	138
7	Rekomandime.	153
8	Bibliografi.	155
	Abstrakt. 170	

Metodologjia

Për realizimin e këtij punimi janë ndjekur hapat e mëposhtëm:

Identifikimi i problematikave të studimit. Në dekadat e fundit, ka patur një rritje të numrit të krimeve seksuale. Objekt i këtyre veprave penale në radhë të parë është liria seksuale e çdo personi, qoftë ky i mitur apo i rritur, i gjinisë femërore apo mashkullore. Liria seksuale duhet kuptuar si e drejta e çdo personi për të disponuar lirinë e tij seksuale, për të pretenduar që ajo të respektohet nga të tretët edhe si paprekshmëri e kësaj sfere kaq delikate. Krimet seksuale prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme të drejtën themelore dhe ekskluzive të çdo njeriu për të disponuar lirinë e tij seksuale dhe për të pretenduar paprekshmërinë e saj si dhe në mënyrë të tërthortë prekin moralin dhe ndërgjegjen publike. Interesi i Shtetit është të mbrojë dhe të garantojë lirinë seksuale.

Koncepti i lirisë seksuale si e drejtë autonome e personit përfaqëson pikën e referimit të figurës së krimeve seksuale.

Synimi i këtij punimi është të analizojë krimet seksuale në Shqipëri duke nisur nga e drejta zakonore e duke vijuar deri në rregullimin e sotëm në Kodin Penal. Janë analizuar të gjitha figurat e krimeve seksuale duke ndaluar në problematika të ndryshme që ato paraqesin. Janë analizuar gjithashtu standartet e provës, aspekte krimnologjike të krimeve seksuale si dhe disa mënyrë rregullimi të krimeve seksuale në legjislacione të huaja si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Itali dhe Francë. Për të analizuar krimet seksuale në këtë punim është përzgjedhur një qasje metodologjike mikse, ku përfshihen:

Kërkimi doktrinar (mbledhja dhe përpunimi i literaturës). Ky hap konsiston në rishikimin e literaturës në lidhje me objektin e studimit. Ai përfshin identifikimin, mbledhjen dhe sistemimin e librave, monografive, artikujve shkencorë, kumtesave të konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën ligjore, si dhe përzgjedhjen e praktikës gjyqësore për të ilustruar problematikat e ngritura. Zgjedhja e literaturës është shtrirë mbi një numër relativisht të konsiderueshëm autorësh të huaj si edhe disa autorë vendas.

Metoda e analizës së legjislacionit - metoda e analizës dhe sintezës. Kjo metodë konsiston në formulimin e problemeve ligjore nëpërmjet analizës së legjislacionit. Në rendin tonë juridik, normat ligjore që rregullojnë krimet seksuale gjenden në Kodin penal. Duke qenë se normat rregullojnë situata të përgjithshme, metoda e analizës ligjore shërben për identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të teorisë dhe të praktikës, nëpërmjet interpretimit të këtyre normave. Gjithashtu, kjo metodë shërben për të sqaruar paqartësinë e normave, vendosjen e tyre në një rend logjik dhe koherent dhe për të analizuar ndërveprimin e tyre me normat e tjera. Kjo është dhe metoda e përdorur gjerësisht në këtë punim ku analiza e dispozitave është shoqëruar dhe me analizën e vendimeve gjyqësore të cilat reflektojnë mënyrën si këto dispozita zbatohen nga sistemi gjyqësor.

Metoda e kërkimit ndërdisiplinor. Procesit të interpretimit dhe analizës së legjislacionit, kryesisht në rastet e paqartësisë së normave, i vijnë në ndihmë faktorë të tjerë të jashtëm si analizimi i aspektit historik, kontekstit social dhe krimnologjik.

Aspektet historike janë analizuar në kreun e parë. Konteksti social është analizuar në disa momente të këtij punimi, ndërsa konteksti kriminologjik është analizuar në kreun e dytë.

Metoda krahasuese. Kjo metodë është përdorur në kreun e pestë ku analizohen disa legjislacione të huaja në mënyrën si ato rregullojnë krimet seksuale.

Një vështrim i shkurtër mbi punimin.

Ky punim është strukturuar në 5 krerë.

Kreu i parë nis me analizën e evoluimit normativ të krimeve seksuale ndër vite. Më konkretisht ai nis me rregullimin e krimeve seksuale në të drejtën zakonore, vijon me rregullimet në Kodin Penal të Mbretit Zog (viti 1930), me rregullimet në “Kodin Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë” (1952) dhe përfundon me rregullimet në Kodin Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1977) si dhe me analizën e rregullimit të krimeve seksuale në kodin penal shqiptar të vitit 1995, të ndryshuar.

Kreu i dytë është një vështrim të përgjithshëm mbi krimet seksuale sipas kodit penal të vitit 1995 të ndryshuar me ligjin nr. 8733 datë 24.01.2001 dhe me ligjin nr. 144 datë 02.5.2013.

Në Shqipëri, krimet seksuale, tradicionalisht, janë konsideruar çënime tepër të rënda dhe të papajtueshme me nderin, moralin dhe respektin ndaj gruas.

Legjislacioni penal shqiptar mbron posaçërisht lirinë seksuale dhe shëndetin e njeriut, duke dënua rëndë përdhunimin dhe krime të tjera seksuale. Kodi penal, aktualisht, parashikon disa figura veprash penale, si krime seksuale ose homoseksuale, të cilat konsiderohen krime kundër jetës dhe shëndetit të personit, për të cilat parashikohen dënime të rënda. Krimet seksuale dhe homoseksuale përmbahen në seksionin VI të Kodit penal, “Krimet seksuale”, i cili është një prej 10 seksioneve të kapitullit II të këtij Kodi, “Veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës”.

Krimet seksuale dhe homoseksuale janë parashikuar në të njëjtin seksion. Analiza në këtë kre përqëndrohet mbi konceptin e “aktit seksual”, mënyrën e realizimit të veprës penale, regjimin e ushtrimit të ndjekjes penale në krimet seksuale, kryerjen e krimeve seksuale në bashkëpunim, krimet seksuale të mbetura në tentativë, aspekte krimnologjike të krimeve seksuale si dhe një analizë e disa problemeve që evidentohen në lidhje me krimet seksuale.

Në kreun e tretë analizohen figurat e ndryshme të krimeve seksuale të rregulluara nga legjislatori shqiptar në Seksionin e Krimeve Seksuale në Kodin Penal, nga neni 100 deri në nenin 108 të tij. Analiza bazohet jo vetëm mbi tekstin e dispozitave dhe doktrinën në fushë, por edhe mbi vendime të ndryshme gjyqësore.

Kreu i katërt analizon standartin e provës në krimet seksuale, pozitën e viktimës në procesin penal si dhe ndihmën juridike. Krimet seksuale për shkak të natyrës së tyre si dhe mekanizmit të kryerjes në praktikë paraqesin vështirësi të mëdha në kuadër të provueshmërisë. procesi i të provuarit është fleksibel dhe i kushtezuar nga indikatorët e figurës së veprës penale, e cila futet në kategorinë e krimeve seksuale. Kështu të ndryshëm janë indikatorët që përbëjnë elementet e “Marrëdhënies me dhunë me të rritura”, në krahasim me ata që përbëjnë “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”, duke ndikuar në standartin e provës.

Ky kre përqëndrohet mbi analizën e provave tipike që ndeshen në krimet seksuale si njolla sperme, materiali vaginal, pështymë, materiale fece dhe urine, aktin e ekspertimit mjeko - ligjor dhe gjinekologjik, dëshminë e të dëmtuarës duke vijuar me

vlerësimin e tyre. Analiza vijon me “Parimin in dubio pro reo”, me trajtimin e disa aspekteve procedurale të trajtimit të viktimave të krimeve seksuale, trajtim të kuadrit juridik ndërkombëtar në trajtimin e viktimave si dhe disa çështje të tjera.

Kreu i fundit analizon krimet seksuale në legjislacionin italian, francez dhe amerikan.

Në mbyllje të punimit, parashtrohen përfundimet dhe rekomandimet lidhur me çështjet e trajtuara.

Vijon bibliografia e cila përmbledh zërat e doktrinës më të shquar në fushë si dhe shumë vendime të gjykatave shqiptare mbi krimet seksuale.

KAPITULLI I

VËSHTRIM HISTORIK I KRIMEVE SEKSUALE NË SHQIPËRI

1.1 Hyrje.

Ky punim shkencor analizon krimet seksuale sipas të drejtës penale. Bëhet fjalë për një fushë të së drejtës, mjaft të vjetër, e cila me shumë mundësi lind, sipas doktrinës më në zë, si rrjedhojë e *lex Iulia de adulteriis et de stupro*, dhe *lex Iulia de vi publica*, në shekullin e 17 p.e.s¹. Ky kre, i cili, hap punimin, nis me analizën e evolucionit të të trajtimit të këtyre veprave në të të drejtën zakonore shqiptare e cila përbëhet nga rregullat e pashkruara të krijuara në rrethana të caktuara, shpeshherë specifike dhe që zbatoheshin në krahina të ndryshme të Shqipërisë duke qëndruar në fuqi për kohë mjaft të gjata. Rregullat kanunore janë ruajtur deri më sot edhe pse nuk mund të mohojmë që ato kanë pësuar ndryshime të domosdoshme.

E drejta zakonore përbëhet nga kanune të krahinave të ndryshme të Shqipërisë si Kanuni i Lekë Dukagjinit që zbatohet në krahinat veriore, Kanuni i Labërisë që zbatohet në zonat jugore, Shartri i Idriz Sulit, Kanuni i Skënderbeut etj.

Ligjet e "Kanunit" kanë shërbyer për më shumë se pesë qind vjet duke rregulluar mënyrat e sjelljes shoqërore dhe të vetëqeverisjes për klanet e Shqipërisë. Kanunet janë pjesë përbërëse e kulturës shpirtërore e materiale të kombit shqiptar. Ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e popullit shqiptar, pasi përbëjnë rregullime ligjore me rëndësi për kohën kur kanë ekzistuar. Në ditën e sotme, këto rregullime vazhdojnë ende të ushtrojnë një ndikim të shqiptarë si brenda edhe jashtë kufijve të vendit.

Në këtë të drejtë gjejnë pasqyrim veprat penale në sferën seksuale, por konceptimi i këtyre veprave ka qenë shumë i ndryshëm nga konceptimi i këtyre veprave në legjislacionet moderne.

1.2 Analizë e krimeve seksuale në të drejtën zakonore shqiptare.

Krimet seksuale në të drejtën zakonore shqiptare, pra në kanunet e përdorura dhe të rradhitura më lart, nuk gjejnë një parashikim sistematik². Nga një analizë e teksteve të kanuneve të ndryshme arrijmë në përfundimin se këto vepra penale përbëheshin nga veprime të kryera ndaj grave dhe vajzave të tilla si: prekja e shamisë, prekja me dorë dhe deri tek dhuna seksuale. Këto vepra penale në ato periudha njiheshin si vepra penale të kryera ndaj nderit dhe dinjitetit, kryesisht të babait të vajzës (në rast se vajza ishte e pamartuar) dhe bashkëshortit (në rast se vajza ishte e martuar). Pra, vëmë re, se në të drejtën zakonore këto vepra konceptohen në një mënyrë tejet të ndryshme krahasuar me të drejtën penale në fuqi sot në Republikën e Shqipërisë e cila i konsideron ato si vepra penale ndaj sferës së lirisë seksuale të çdo femre. Rregullat kanunore në veprat penale me sfond seksual kishin si objekt ruajtjen e nderit dhe

¹ Shiko në këtë drejtim Macrì F., *Verso un nuovo diritto penale sessuale. Diritto vivente, diritto comparato e prospettive di riforma della disciplina dei reati sessuali in Italia*, Firenze University Press, 2010.

² Shiko Gjocovi Sh., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Prishtinë 1972 dhe Elezi I., *Kanuni i Labërisë*, Toena, Tiranë, 2002.

dinjitetit të burrit të familjes, pasi femra kuptohej në funksion të mashkullit qoftë ky babai ose bashkëshorti. Femrat, me përjashtim të të drejtës që kishin për t'i kërkuar mashkullit ushqim dhe veshmbathje, nuk gëzonin asnjë të drejtë tjetër, por vetëm detyrime.

Nga ana objektive veprat penale me sfond seksual kryheshin me veprime materiale që konsistonin në prekjen e shamisë së femrës, në prekjen e femrës dhe deri në kryerjen e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të.

Subjekti aktiv i këtyre veprave penale mund të ishte vetëm mashkulli. Ky i fundit duhej të kishte një moshë të caktuar e cila nuk përcaktohej me saktësi, por zakonisht ishte e lidhur dhe e kufizuar me aftësinë e tij për të mbajtur armë. Si rregull djali që fillonte të mbante armë quhej që kishte arritur pjekurinë e duhur dhe si i tillë konsiderohej madhor dhe kishte gjithashtu përgjegjësi penale³ (duhet të nënvizojmë se në çështjet e madhorisë hasen diferenca në krahina të ndryshme).

Në çështje nderi, e drejta zakonore nuk bën shkallëzime të veprimeve të kryera ose të formave të fajësisë. Nderi konsiderohej i shtrenjtë dhe kudo sundonte koncepti tradicional se *“jeta e njeriut nuk vlen asgjë përpara nderit”*⁴.

Në të drejtën zakonore shqiptare nuk konceptohej si vepër penale marrëdhënia seksuale me dhunë e kryer ndaj bashkëshortes, pasi sipas kësaj të drejte bashkëshortja kishte detyrime ndaj bashkëshortit siç ishin ruajtja e nderit të tij, qëndrimi nën sundimin e tij dhe plotësimi i detyrave të kurorës. Në kuadër të këtyre detyrimeve gruaja nuk mund të ankohej për dhunën e ushtruar nga burri i shtëpisë⁵. Siç del qartë në pah gruaja konsiderohej si pronë e burrit të familjes.

Në nenin 601/d të Kanunit të Lekë Dukagjinit përcaktohet se: *“Ndera i mirret burrit..... d) me i dhunue gruen e me ia hikun”*. Pra kuptohet qartë që dhuna e ushtruar ndaj një gruaje ishte dhunim i nderit të mashkullit të familjes. Dhe ky dhunim sipas Kanunit të Lekë Dukagjinit dënohej me vdekje. Kjo duket qartë dhe në përmbajtjen e neneve 922 dhe 929 të këtij kanuni ku në nenin 922 përcaktohet se *“nuk hyn në gjak kush vret personin që i ka dhunue armën a gruan”* dhe gjithashtu në nenin 929 përcaktohet se *“kush dhunon një grua, vajzë a cucë dhe shpëton pa u vrrarë e ikën në dhe të largët janë të lëcitur me flamur”*.

Si konkluzion duhet nënvizuar se, edhe pse në të drejtën zakonore shqiptare gjejnë pasqyrim veprat penale në sferën seksuale, konceptimi i këtyre veprave ka qenë shumë i ndryshëm dhe, përmes sanksionimit të tyre nga kjo e drejtë, nuk mbrohej disponimi i lirë i sferës seksuale, por mbrohej në radhë të parë nderi i burrit të shtëpisë, pronë e të cilit ishte gruaja. Pra nuk ekzistonte dhe ishte i pakonceptueshëm koncepti i barazisë gjinore në të drejtën zakonore shqiptare dhe si rrjedhojë femra dhe gjithçka që kishte të bënte me të konceptohej si një send në pronësi të mashkullit.

³ Gjecovi SH., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, cituar më lart: *“Malësori bëhet madhor-shkruan Joviqeviq - kur merr pushkën, kur mbush 15-16 vjec.”*, *“Babai është i detyruar t'u blejë armë djelëve posa të bëhen për to (KLD-21 e 60)”*, Elezi I., cituar më lart, *“Mosha e përgjegjësisë penale caktohej zakonisht në 14-15 vjec, kur personi bëhej i aftë për të mbajtur armë”*

⁴ Elezi I., , *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, cituar më lart (nenet 91-97), *Kanuni i Skënderbeut* (p.3348-3359). *“Ndera asht ma e madhja, ma e bukura pasuri e shqiptarit”*(p.3349)

⁵ Gjecovi Sh., *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, nenet 32-33, cituar më lart.

1.3 Krimet seksuale sipas Kodit penal të Zogut

Kodi i parë penal në Shqipëri identifikohet me Kodin penal të Mbretërisë (Kodi Penal i Zogut – dekretuar më 28 maj 1927, hyrë në fuqi në 1 Janar 1928) i hartuar mbi modelin e Kodit Penal Italian.

Krimet seksuale në këtë Kod konfiguroheshin nga legjislatori në Titullin VIII, *“Delikte kundra zakonit të mirë dhe rregullit familjar, “Kaptina I” - “Turpnim me violencë, demoralizimi fizik i të vegjëlve, goditja e cipës publike” te Kaptina I përfshinte nenet 364 - 376, nene të cilat nuk kishin “nomen juris”.*

Neni 364 përcaktonte se *“Kushdo që, tue shtrëngue me violencë ose me frikësime një person femën ose mashkull, e turpnon ndëshkohet me burgim të randë nga 3 deri në 10 vjet”.*

Po me këtë ndëshkim dënohet dhe *ay që turpënon një person femën ose mashkull, i cili në kohën e fajit:*

- *nuk ka pasë mbushun moshën 15 vjec;*

- *nuk ka pasë mbushun moshën 18 vjec, në qoftë se fajtori asht i parëlinduni, kujdestari ose mësuesi i personit të turpënuem;*

- *tue qenë i rreshtuem ose i dënuem i ishte besue fajtorit për me e transportue ose me e ruejt;*

- *nga shkaku i një sëmundje mendore ose trupore ose nga një tjetër shkak që nuk mvaret nga vepra e fajtorit ose nga efekti i mjeteve dhelparake të përdoruna prej këtij, nuk ka qenë në gradën që t’i kundërshtonte.”*

Asnjë nga dy dispozitat nuk përcakton se çfarë duhet kuptuar me *“turpnim”*. Nga një lexim i mirëfilltë i dispozitës kuptohet se në kategorinë e *“turpnimit”* mund të përfshiheshin një sërë veprimesh të cilat fyenin nderin e mashkullit ose femrës, veprime të cilat mund të shkojnë nga prekja e shamisë deri tek dhuna seksuale. Në të vërtetë, nga një lexim i kujdesshëm edhe i dispozitave të tjera të kësaj kaptine, dalim në përfundimin që legjislatori me *turpnim* i referohet *“Kryerjes së marrëdhënieve seksuale”*.

Një risi e këtij Kodi, krahasuar me të drejtën zakonore, ishte fakti se në këtë Kod femra nuk konsiderohej më send i mashkullit dhe se viktimë e krimit seksual mundet të ishte edhe një mashkull. Njihej dhe dënohej edhe krimi seksual i kryer nga një person i familjes, ose një person që edhe pse nuk ka lidhje gjaku, ishte person të cilit i është besuar kujdestaria e viktimës ose mësuesi i tij. Në këto raste, viktimja gjendej në një situatë ku është më i manipulueshëm pasi ishte i prirur të besonte në fjalët dhe veprimet e familjarit, kujdestarit ose mësuesit të cilët ishinë pikërisht personat që duhej ta udhëzonin . Kjo dispozitë dënonte dhe rastin kur një person, i ndodhur në kushte të vështira, i besonte pikërisht autorit sigurinë dhe transportin e tij, por ky i fundit abuzonte duke kryer me të një krim të natyrës seksuale. Dispozita mbyllej duke dënuar krimet me natyrë seksuale të kryera nga një autor përmes mashtrimit, ose duke abuzuar me paaftësinë mendore ose fizike të viktimës, të tilla që nuk e lejonin këtë të fundit të kundërshtonte veprimet e autorit.

Kodi penal i Zogut parashikon konceptin e dhunës fizike dhe asaj psikologjike.

Neni 365 i tij përcaktonte se *“Kur ndonjana nga veprat e parapamë në paragrafin I dhe në numrin 1 dhe 4 të nenit të masipërmë, asht ba tue abuzue autoritetin, besimin*

ose marrëdhënjet shtëpiake, fajtori ndëshkohet në rastin e parapamë në paragrafin I me burgim të randë nga 6 deri 12 vjet dhe në rastet e tjera me burgim të randë nga 8 deri në 15 vjet.” Kjo dispozitë parashikon rrethana rënduese dhe dënime më të rënda.

Neni 366 i po këtij Kodi përcaktonte se *“Kushdo që tue përdor mjetet ose tue përfitue nga konditat ose cirkostancat e tregueme në nenin 364 ban mbi një person femën ose mashkull, vepra luksuri të cilat nuk drejtohen për me ba deliktin e parapamë n’atë nen, ndëshkohet me burgim të randë nga 1 deri në 7 vjet.*

Në qoftë se vepra ashtë ba me abuzim t’autoritetit ose të besimit ose të marrëdhënjeve shtëpiake, burgimi i randë, rast që vepra ashtë ba me violencë ose me frikësim fillon nga 2 vjet dhe zgjatet deri në 10 vjet; dhe në rastet e parapame të numrit 1 dhe 4 të nenit 364, nga 4 deri në 12 vjet.” Kjo dispozitë parashikonte kryerjen e veprimeve me sfond seksual por që nuk konsistojnë në turpnim, por janë më të lehta.

Neni 367 rregullon bashkëpunimin në kryerjen e veprës penale si rrethanë rënduese, duke rritur masën e dënimit në këto raste *“Kur ndonjana nga veprat e parapame në nenet e mësipërme ashtë ba me bashkëpunim, po në një kohë, të dy ose më shumë personave, ndëshkimeve të caktume në ato nene i shtohet një e treta.”*

Neni 368 i kodit penal trajton veprat penale ndaj të miturve nga persona që kishin për detyrë të kujdesishin për të. Ky nen përcakton se *“Kushdo që me vepra luksuri demoralizon (corrompe) një person nën 16 vjec ndëshkohet me burgim të randë nga 1 deri në 30 muej dhe me gjobë të randë nga 50 deri në 2000 franga ari.*

Në qoftë se delikti ashtë ba me të gënjer, ose fajtor ashtë i parëlinduni i të voglit ose i ashtë besue kujdesia edukacioni, mësimi, vrejtimi ose ruajtja qoftë dhe përkohësisht, ndëshkimi ashtë me burgim të randë nga 1 deri në 6 vjet dhe me gjobë të randë nga 100 deri në 3000 franga ari.”

Neni 369 përcaktonte se *“Deliktet e parapame në nenet e nalt-tregueme në qoftë se janë ba kundra një femne ndiqen vetëm mbi kërkimin e atij personi që ka të drejtën me ba padije civile, por kërkesa ashtë e pranueshme vetëm brenda 1 viti prej ditës që ashtë ba delikti ose që prej asaj dite në të cilën ka marrë dijen ai që ka të drejtën me ba padi civile në vend të ofenduemit.*

Heqja dorë nga padija civile nuk ka ndonjë efekt në qoftë se kjo bahet pasi të fillojë gjykimi.

Ndjekjet bahen kryesisht kur faji:

1) ashtë ba kundra një mashkulli;

2) ka shkaktue vdekjen e personit të pendueme ose ai faj ashtë ba së bashku me një tjetër delikt për të cilin ashtë caktue një ndëshkim kundra lirisë personale për një kohë jo ma pak se 30 muaj dhe ashtë nga ato delikte që ndiqen kryesisht;

3) ashtë ba në një vend public ose te celun për publikun;

4) ashtë ba tue abuzue fuqiën e atësisë ose autoritetin e tytoriës.”

Neni i mësipërm përmbante një diferencim të pajustificueshëm midis femrës dhe mashkullit, në drejtimin të faktin se ndjekja penale niste kryesisht në rastet kur viktima është mashkull, ndërkohë që në rastet kur viktima ishte femër ndjekja penale do të niste vetëm me kërkesë të personit të legjitimuar dhe për më tepër vendosej një afat parashkrimi relativisht i shkurtër.

Nga rregullimet e mësipërme arrijmë në përfundimin që legjislatori i vitit 1927 e konsideron më të rëndë krimin seksual të kryer kundrejt mashkullit. Të njëjtën rëndësi

i njëjtte këtij krimi në rastet kur krimi kryhej në një vend publik. Në këtë rast legjislatori mbron dukshëm moralin publik. Kryesisht ndiqej dhe rasti kur krimi ishte kryer nga prindi ose kujdestari pikërisht sepse këto krime shkonin kundër rregullit dhe moralit familjar të cilat përbëjnë dhe objektin e mbrojtjes së këtij parashikimi. Dispozita parashikonte se ndiqej kryesisht edhe rasti kur krimi ka sjellë vdekjen e një personi të pendur ose kur krimi seksual ishte shoqëruar me kryerjen e një krimi tjetër i cili ndiqej kryesisht dhe dënohej me heqje ose kufizim të lirisë personale për një kohë të përcaktuar. Në këtë rast krimi ndiqej kryesisht për pasojat e rënda që sillte ose sepse ai nuk ishte një krim i veçuar, por ishte një krim që shoqërohej me një krim tjetër të rëndë.

Neni 370 ndalonte çdo marrëdhënie seksuale në familje (inçest) duke përcaktuar se *“Kushdo që ndodhet në relazione turpënore me ndonjanin nga prindët ose të paslindurit e ligjshëm ose natyrel ose me motrën ose me vllanë, qofshin të një ame e ati, qofshin ose vetëm të një ame ose të një ati, ose me ndonjanën nga krushqitë në vijë direkte, ndëshkohet me burgim të randë nga 8 muaj deri në 3 vjet. Kjo dispozitë mbron familjen, por edhe moralin publik në shoqëri. Nuk nevojitet dhuna për dënimin e inçestit. Dënimi ashpërsohet në rast se vepra penale ka shkaktuar skandal publik “Në qoftë se faji asht ba me një mënyrë që ka shkaktue skandal publik, burgimi i randë asht nga 2 deri në 5 vjet”.*

Legjislatori parashikonte edhe dënim plotësues si largimin nga postet publike pikërisht sepse marrëdhënien e inçestit e konsideronte një cënim i rëndë të moralit publik dhe personi që e kryente atë nuk ishte i denjë të mbulonte një post publik, por ky largim ishte i përkohshëm.

Neni 371 i kodit penal dënonte mashtrimin e ushtruar kundrejt një vajze të virgjër me qëllim kryerjen e marrëdhënies seksuale me të. Nga përmbajtja e kësaj dispozite del e qartë se nuk kërkohet ushtrimi i dhunës, por mjaftonte premtimi i kryer nga autori se ai do të martohej me viktimën pasi konsiderohej se kjo e fundit kishte pranuar të kryente marrëdhënie me autorin për këtë arsye. Legjislatori vendos një moshë kufi, në sensin që ai përcakton se nëse një mashkull i bën këtë premtim një femre nën moshën 20 vjeçare dhe më pas nuk e mban premtimin, atëherë marrëdhënia e kryer do të konsiderohet krim. Ndërsa, në rastin kur premtimi i ishte bërë një femre e cila ishte më e madhe se njëzet vjeçe atëherë legjislatori nuk e quante më krim marrëdhënien e kryer midis tyre. Ky diferencim kishte vetëm një justifikim juridik – faktin që legjislatori e konsideronte femrën e cila kishte mbushur 20 vjeç të aftë për të kuptuar mashtrimin, ndërsa femrën nën 20 vjeç e konsideronte që nuk kishte arritur pjekurinë e duhur për të kuptuar mashtrimin e autorit. Dispozita përcaktonte se *“Kushdo që tue bindun i prish virgjinin një vajze që nuk ka mbush moshën 20 vjec, tu i premute se ka me e marrë për grue, mbi kërkimin e saj ose t’atij që ka të drejtë me ba padinë civile për atë, ndëshkohet me burgim të randë nga 3 muaj deri në 1 vit. Në këtë rast legjislatori mbron moralin publik, por mbron edhe moralin e femrës. Dhe në fakt ai shtynte drejt të ashtëquajturës martesë riparuese midis autorit dhe viktimës përmes përcaktimit se “Në qoftë se martohet me të, pushojnë ndekjet ligjore dhe në qoftë se asht dhanë vendimi pushon ekzekutimi i vendimit dhe efektet penale.*

Por në rast që fajtori brenda 5 vjetve c’prej ditës së martesës e ndan pa që ajo ti japë shkak të justifikueme, rifillojnë ndjekjet dhe aplikohen efektet e tjera ligjore.”

Me qëllim mbrojtjen e moralit publik dhe zakoneve të mira, neni 372 i kodit penal përcaktonte se *“Kushdo që jashtë rasteve të tregueme në nenet e masipërme godet cipën publike ose zakonet e mira me vepra të bamuna në vende publike ose të celuna për publikun, ndëshkohet me burgim të randë nga 3 deri 30 muaj dhe me gjobë të randë nga 50 deri në 500 franga ari.”*

Vijonte neni 373, gjithomë në kuadër të mbrojtjes së moralit publik, me përcaktimin se *“Kushdo që godet cipën publike me shkresa, vizatime ose me të tjera sende të turpshme, të cilat i shpërndan ose i ekspozon ose i shet ose me diskure ose me filma ose lojna në cinemat, theatrot ose në vende të tjera që janë të celuna për publikun ose me pllaka gramafonash që përmbajnë këngë ose fjalë të turpëshme, si dhe ata që bajnë ose mbushin të tilla filme e pllaka ose i importojnë së jashtmi ose i transportojnë nga një vend i republikës në tjatin, ose që përmbajnë e shesin cdo llojë nga sendet e sipërtregueme ndëshkohen me burgim të randë deri në 1 vit dhe me gjobë të randë deri në 1000 franga ari.*

Në qoftë se këto vepra bahen për fitim, burgim i randë asht jo ma pak se 1 muaj dhe gjoba e randë jo ma pak se 100 franga ari.

Sendet që përmbajnë t’atilla pamje të turpëshme konfiskohen dhe cduken.”

Pra, vihet re se nga formulimet e kodit, nuk lejohej as ekspozimi i vizatimeve, shkresave, filmave dhe këngëve që kishin përmbajtje të turpshme.

Neni 374 i kodit penal të Zogut dënonte shfrytëzimin e prostitucionit përmes parashikimit që *“Kushdo që me qëllim përfitimi në vende publike ose të celuna për publikun angazhon cëngina ose të tjera femna për me tërheqë njerëzinë dhe i vë ato në dispozicion të klientave për turpënim ose vetëm për luksur si dhe ato gra që angazhohen ose bajnë veprat e sipërtregueme ndashkohen me burgim nga 1 deri në 6 muaj ose me interim nga 3 deri në 12 muaj dhe në cdo rast me gjobë të randë deri në 1000 franga ari.”*

Legjislatori dënonte edhe ngacmimin seksual të bërë me fjalë ose vepra me si ndaj femrës ashtu edhe ndaj mashkullit. Ligji dënonte gjithashtu edhe rastin kur viktimja e ka provokuar vetë autorin. Ky dënim tregonte se legjislatori përmes këtij përcaktimi mbronte kryesisht moralin publik dhe jo lirinë seksuale të viktimës. Kështu, neni 375 i kodit penal përcaktonte se *“Ata që ngacmojnë me fjalë ose me vepra femra ose djem ndëshkohen me burgim deri në një muaj.*

Në qoftë se ky ngacmim asht provokue nga i ofenduem i ndëshkimi sht me gjobë të randë deri në 200 franga ari.”

Neni 376 i po këtij kodi mbyllte kaptinën I duke përcaktuar se *“Ata që hyjnë me petka grash në vend ku ka gra dhe asht ndalue hyrja për të vetmen këtë vepër ndëshkohen me burgim deri në 1 muaj.”*

Nga studimi i këtij kreu të Kodit Penal të Zogut bie në sy fakti që deri në nenin 372 kemi të bëjmë me vepra penale kundër sferës seksuale, ndërsa në nenet e mëposhtme bëhet fjalë për shpërndarje të materialeve pornografie, shtëpitë publike etj.

Gjithashtu, vihet re ngjashmëria e madhe e rregullimeve të këtyre neneve me ato të Kodit penal Italian të vitit 1889.

Siç mund të kuptohet ky kre parashikonte një shumëllojshmëri veprash penale që kishin një objekt heterogjen dhe të ndryshëm nga njëra - tjetra. Janë figura veprash penale që duken tërësisht të ndryshme nga struktura dhe specifika e objektit juridik.

Siç u përmend dhe më lart, krimet seksuale futeshin në titullin e veprave penale kundër zakonit të mirë dhe rregullit familjar dhe objekti i mbrojtjes juridike ishte pikërisht ky, pasi për kohën zakoni i mirë dhe rregulli familjar ishin të mira juridike thelbësore të çdo shoqërie civile, që plotësonin njëra - tjetrën dhe për këtë arsye gjendeshin së bashku dhe në mbrojtjen që i siguronte ligji penal.

Me termin “zakoni i mirë” kuptoheshin rregullat etiko-juridike që shërbenin për ruajtjen e limiteve të nevojshme për sigurinë, lirinë dhe ndershmërinë e marrëdhënieve seksuale dhe shkelja e tyre dhe pse nuk ndodh brenda familjes godet dhe reflektohet në rregullin familjar.

Me termin “rregull familjar” kuptoheshin rregullat që siguronin ndershmërinë e marrëdhënieve seksuale në familje dhe raportet midis tyre që impononin zbatimin e ligjeve juridiko-natyrale të gjeneratave.

Është pikërisht vendosja si objekt mbrojtjeje të veprave penale seksuale zakonin e mirë dhe rregullin familjar që bën që në të njëjtin kre të gjejmë të klasifikuara lloje të ndryshme veprash penale në disa prej të cilave është më i rëndësishëm rregulli familjar e në disa zakoni i mirë, sepse legjislatori nuk mund të bëjë ndarje në pasojat e tyre.

Pra, objekt kryesor i mbrojtjes penale ishte interesi social dhe publik (zakonin e mirë dhe rregullin familjar), ndërsa mbrojtja e subjektit pasiv ishte objekti dytësor. Kritika kryesore lidhur me mënyrën e rregullimit të krimeve seksuale mund të bëhet nga këndvështrimi që legjislatori në këtë periudhë fillimisht mbronte interesin publik dhe pastaj paprekshmërinë e personit, pra ai përqëndrohej në nevojën për të mbrojtur më shumë një interes social se një interes personal të individit.

Këto nene parashikojnë hipoteza të ndryshme të marrëdhënieve seksuale ose të ngacmimeve seksuale që dënoheshin penalisht pavarësisht ekzistencës apo jo të dhunës e kanosjes dhe që merrnin rëndësi në funksion të moshës së subjektit pasiv apo kushteve të tij mendore e fizike dhe raporteve ndërpersonale që lidhinin subjektin aktiv me atë pasiv.

Ekzistonte bindja që në rrethana të caktuara subjekti pasiv nuk është në gjendje të kuptojë drejt situatën dhe të kundërshtojë atë që po ndodh dhe kush kishte kryer marrëdhënie seksuale ose ngacmime seksuale me subjekte të tillë duhet të mbante përgjegjësi penale pavarësisht faktit në kishte ushtruar apo jo dhunë fizike apo psikologjike. Bëhen dy ndarje të krimeve seksuale: nga njëra anë kryerja e marrëdhënieve seksuale dhe nga ana tjetër ngacmimet seksuale që ndryshojnë kryesisht nga fakti që përta i përket këtyre të fundit qëllimi i subjektit aktiv nuk është kryerja e marrëdhënieve seksuale.

Siç u përmend më lart, legjislatori i asaj kohe pranon se subjekt pasiv mund të jetë si femra po ashtu dhe mashkulli dhe gjithashtu i kushton një rëndësi të veçantë dhe mbrojtjes së fëmijëve si nga kryerja e marrëdhënieve seksuale po ashtu dhe nga veprime që mund të korruptojnë moralin e fëmijës.

Janë parashikuar dhe një sërë rrethanash cilësuese në të cilat mund të ndodhin veprat penale si bashkëpunimi, abuzimi i autoritetit etj, për të cilat parashikohet një dënim më i rëndë.

Në nenet e analizuara më lart gjejnë rregullim pothuajse të gjitha figurat e veprave penale të Kodit Penal të sotëm, por jo të gjitha janë figura veprash penale më vete, por mund të jenë parashikuar si rrethana të cilësuar. Gjejnë rregullimin e tyre në Kodin Penal të vitit 1928 : marrëdhëniet seksuale me dhunë me të mitur e të rritur, ato duke abuzuar me detyrën, ato me persona na gjini, ngacmimet seksuale, veprat penale të turpshme, kryerja e tyre në ambiente publike etj.

Gjithashtu në këtë kre futen dhe disa rregullime procedurale dhe si të tilla janë ushtrimi i ndjekjes penale me ankimin për veprat penale të parashikuara nga neni 364 deri në nenin 368 i kodit penal në rastin kur subjekti pasiv është femër.

1.4 Krimet seksuale sipas Kodit Penal të vitit 1952.

Më datë 01.09.1952 ka hyrë në fuqi Ligji nr.1470 datë 23.05.1952 i titulluar “Kodi Penal i Republikës Popullore të Shqipërisë”.

Në kapitullin IV të këtij kodi me titull “Krimet kundër personit”, në nënkapitullin e IV gjen pasqyrim parashikimi i krimeve seksuale. Nënkapitulli i krimeve seksuale përbëhet nga 4 nene, nenet 165-168⁶, në të cilat gjenin pasqyrim krime të ndryshme të kryera ndaj sferës seksuale. Këto nene nuk kishin tituj (nomen juris).

Neni 165 ndalonte marrëdhëniet seksuale të kryera me dhunë, me kanosje ose duke përfitur nga pazotësia e viktimës për mbrojtje. Dispozita parashikonte një dënim më të rëndë në rastet kur krimi ishte kryer në bashkëpunim apo kishte shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin e viktimës.

Neni 166 dënonte marrëdhëniet seksuale me personat që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale. Edhe në këtë rast dispozita parashikonte një dënim më të rëndë në rastet kur krimi ishte kryer në bashkëpunim apo kishte shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin e viktimës.

Neni 167 dënonte veprat e turpshme me persona që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale dhe neni 168 dënonte marrëdhëniet seksuale në gjini.

⁶ Neni 165-“Mardhëniet seksuale të kryera me dhunë, me kanosje ose duke përfitur nga pazotësia e viktimës për mbrojtje, dënohet: me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Kur veprat e sipërme janë kryer nga një grup personash ose kanë shkaktuar pasoja të tjera të rënda për shëndetin e viktimës dënimi është me burgim: nga dhjetë deri në njëzet vjet.”

Neni 166-“Mardhëniet seksuale me persona që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale, dënohen: me burgim nga tre deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur veprat e sipërme janë kryer me dhunë ose nga një grup personash si dhe kur nga ato kanë ardhur pasoja të rënda për shëndetin e viktimës, dënimi është: me burgim nga dhjetë deri në njëzet e pesë vjet.”

Neni 167-“Korrupsioni me anë të veprave të turpshme i personave që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale, dënohet : me burgim nga një gjer në pesë vjet.”

Neni 168-“Mardhëniet seksuale midis personave që janë gjini në vijë të drejtë, ose midis vëllait dhe motrës, qofshin dhe vetëm prej ati ose mëme, dënohen : me burgim gjer në tre vjet.”

Në këtë Kod Penal gjëja kryesore që bie në sy është klasifikimi i krimeve seksuale në kapitullin e krimeve kundër personit, gjë që flet për faktin se që në ato vite objekt i këtyre veprave penale ishte ruajtja e paprekshmërisë seksuale të gruas. Ky është një fakt shumë i rëndësishëm që flet për një evoluim të mendimit juridik dhe social, për një rëndësi të madhe që i jepej gruas dhe për rëndësinë që kishte për shtetin ruajtja e paprekshmërisë së saj seksuale.

Në këtë Kod Penal këto vepra penale nuk ishin të sistemuara mirë pasi në të njëjtin nen parashikohet vepra penale ndaj femrave që kanë arritur pjekurinë seksuale me marrëdhëniet seksuale me dhunë me personat e pazotë etj. Për frymën komuniste të asaj periudhe që udhëhiqte të gjithë jetën e shtetit, shumë vepra penale në sferën seksuale nuk ishin të parashikuara pasi nuk ishin të pranuar si koncepte nga sistemi politik. Terminologjia juridike ishte e varfër dhe në të njëjtin nen gjenin parashikim situata të ndryshme juridike. Nuk kishte filluar të përdorej ende koncepti “i mitur” dhe të përcaktohej një moshë minimale për viktimën, por parashikimet ligjore bazoheshin në arritjen e pjekurisë seksuale.

Femrat ndaheshin në dy kategori në ato që kishin arritur pjekurinë seksuale dhe në ato që nuk kishin arritur pjekurinë seksuale. Për femrat që kishin arritur pjekurinë seksuale, që të ekzistencete veprapenale e marrëdhënies seksuale të parashikuar nga neni 165 ishte e nevojshme përdorimi i dhunës fizike ose psikologjike (kanosja), ndërsa për cilësimin juridik të veprës penale të kryerjes së marrëdhënieve seksuale duke përfutur nga pazotësia e viktimës nuk kishte rëndësi nëse pazotësia ishte krijuar nga autori i veprës penale me qëllim për të realizuar objektivin e tij apo ishte objektivisht pazotësi e viktimës. Këto rrethana shërbenin vetëm për t’u patur parasysh nga Gjykata në caktimin e masës së dënimit.

Nga ana objektive ky grup veprash penale kryhej me anë të veprimeve të kryera nga autori i veprës penale me qëllim realizimin e aktit seksual, ndërsa nga ana subjektive duhet të ekzistojë faji në formën e dashjes.

Akti seksual quhej i kryer kur arrihej bashkimi i plotë seksual, pavarësisht në kishte ardhur apo jo si pasojë deflorimi i femrës.

Përsa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 166 i K.Penal (v.1952) kryerjes së marrëdhënieve seksuale me vajza që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale objekti në këtë vepër penale është i dyfishtë dhe synon mbrojtjen e sferës seksuale të vajzës si dhe zhvillimin normal seksual të saj. Elementi dhunë në këtë vepër penale ishte rrethanë rënduese, sepse për cilësimin juridik mjaftonte kryerja e marrëdhënieve seksuale, pasi një vajzë që nuk kishte arritur pjekurinë seksuale nuk ishte e aftë dhe nuk kishte arritur zhvillimin e përgjithshëm që të kuptojë rëndësinë e aktit seksual si dhe pasojat që lë ai në shëndetin e saj. Gjithashtu ajo është shumë lehtë e përpunueshme dhe e ndikueshme nga personat madhorë që e rrethonin.

Vepra penale e marrëdhënieve seksuale në gjini e parashikuar nga neni 167 i Kodit Penal konsiderohej si një vepër penale që ndodhte rrallë dhe që ishte një fenomen i rëndë dhe i dënueshëm vecanërisht nga morali shoqëror i asaj kohe. Nuk kërkonte ekzistencën e dhunës, por mjaftonte kryerja e marrëdhënieve seksuale në vijë të drejtë apo midis vëllezërve dhe motrave. Kjo vepër penale konkuronte në çdo rast me krimet e tjera seksuale.

1.5 Krimet seksuale sipas Kodit Penal të vitit 1977.

Më datë 01.10.1977 ka hyrë në fuqi “Kodi Penal i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Në kreun IV të këtij kodi me titull “Krimet kundër personit”, në nënkapitullin “Krimeve kundër shëndetit” gjen pasqyrim parashikimi i krimeve seksuale. Krimet seksuale përbëheshin nga 4 nene, nenet 97 - 100⁷, në të cilat rregulloheshin krimet e kryera ndaj sferës seksuale. Me hyrjen në fuqi të Kodit të ri Penal çdo veprë penale iu vunë tituj (përfshi këtu dhe krimet seksuale), dhe krimet seksuale nuk patën shumë ndryshime thelbësore nga Kodi Penal i mëparshëm duke gjetur pasqyrim në të “Marrëdhëniet seksuale me dhunë” (neni 97), “Marrëdhëniet seksuale me të miturat” (neni 98), “Veprat e turpshme” (neni 99) dhe “Marrëdhëniet seksuale në gjini” (neni 100).

Në këtë Kod Penal u ruajt klasifikimi i krimeve seksuale në kapitullin e krimeve kundër personit dhe vijimësia e të njëjtit objekt të këtyre veprave penale që ishte ruajtja e paprekshmërisë seksuale të gruas dhe e shëndetit të saj.

Në këtë Kod Penal u bë një përpjekje për një sistemim më të mirë të këtyre veprave penale, por sistemimi i tyre ende lë për të dëshiruar pasi në të njëtin nen parashikohet vepra penale e marrëdhënieve seksuale me të rritura krahas veprës penale së marrëdhënieve seksuale me dhunë me personat e pazotë etj.

Gjatë analizës së këtij ligji vëmë re se dhe Kodi Penal i ri i asaj kohe përshkohej nga e njëjta frymë socialiste e marksiste - leniniste duke bërë që edhe në këtë kod të mos parashikoheshin shumë vepra penale në sferën seksuale.

Një nga risitë e këtij kodi ishte se u bë një hap përpara në terminologjinë juridike duke u futur koncepti i bashkëpunimit etj., por, siç u theksua më lart, ende në të njëtin nen gjenin parashikim situata të ndryshme juridike.

Risia tjetër e këtij kodi ishte futja, krahas mos arritjes së pjekurisë seksuale, e kriterit moshë që u përcaktua “mosha 14 vjeç” si dhe e konceptit “të mitur”. Tashmë

⁷ Neni 97- Mardhëniet seksuale me dhunë : “*Marëdhëniet seksuale të kryera me dhunë ose duke përfitur nga pazotësia e viktimës për t’u mbrojur, dënohen: me heqje të lirisë deri në dhjetë vjet. Po këto vepra të kryera në bashkëpunim si dhe kur kanë shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin dënohen : me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet dhe, kur kanë sjellë si pasojë vetëvrasjen ose vdekjen e të dëmtuarës, edhe me vdekje.*”

Neni 98- Mardhëniet seksuale me të miturat : “*Marëdhëniet seksuale me me një vajzë që nuk ka arritur moshën 14 vjeç ose pjekurinë seksuale, dënohen: me heqje të lirisë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Po këto vepra të kryera me dhunë, në bashkëpunim ose kur kanë shkaktuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohen: me heqje të lirisë jo më pak se dhjetë vjet dhe, kur kanë sjellë si pasojë vetëvrasjen ose vdekjen e së dëmtuarës, edhe me vdekje.*”

Neni 99- Vepra të turpshme : “*Kryerja e veprave të turpëshme me persona që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç, dënohet : me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.*”

Neni 100- Mardhëniet seksuale në gjini : “*Mardhëniet seksuale midis personave që janë gjini në vijë të drejtë, ose midis vëllait dhe motrës dënohen : me heqje të lirisë gjer në pesë vjet.*”

parashikimet ligjore bazoheshin në kriterin moshë dhe në kriterin e arritjes së pjekurisë seksuale.

Femrat në këtë Kod ndahen në tre kategori: në ato që kishin mbushur moshën 14 vjeçare dhe që kishin arritur pjekurinë seksuale, në ato që nuk kishin mbushur moshën 14 vjeçare dhe në ato që kishin mbushur moshën 14 vjeçare, por që nuk kishin arritur pjekurinë seksuale. Për femrat që kishin mbushur moshën 14 vjeçare dhe kishin arritur pjekurinë seksuale për ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 97 ishte i nevojshëm përdorimi i dhunës. Nga ky nen u hoqën fjalët dhunë fizike dhe kanosje, por me të njëtin koncept “dhunë” nënkuptoheshin si dhuna fizike dhe ajo psikologjike (kanosja), ndërsa për cilësimin juridik të veprës penale të kryerjes së marrëdhënieve seksuale duke përfutur nga pazotësia e të dëmtuarës nuk kishte rëndësi nëse pazotësia ishte krijuar nga autori i veprës penale me qëllim për të realizuar objektivin e tij apo ishte objektivisht pazotësi e viktimës. Këto rrethana shërbenin vetëm për t’u patur parasysh nga Gjykata në caktimin e masës së dënimit. U ashpërsuan sanksionet penale pasi u shtua një rrethanë tjetër rënduese (kur e dëmtuara vetëvritej ose kur ishte shkaktuar vdekja e të dëmtuarës) e cila parashikonte deri dënimin me vdekje të autorit të veprës penale.

Nga ana objektive ky grup veprash penale kryhej me anë të veprimeve të kryera nga autori i veprës penale me qëllim realizimin e aktit seksual, ndërsa nga ana subjektive duhej të ekzistonte faji në formën e dashjes.

Akti seksual quhej i kryer kur arrihej bashkimi i plotë seksual, pavarësisht në kishte ardhur apo jo si pasojë deflorimi i femrës.

Përsa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 98 i K. Penal, kryerjes së marrëdhënieve seksuale me vajza që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeçare ose që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale, objekti në këtë vepër penale është i dyfishtë dhe synon nga njëra anë mbrojtjen e sferës seksuale të vajzës dhe nga ana tjetër zhvillimin normal seksual të saj. Elementi dhunë në këtë vepër penale është rrethanë rënduese, sepse për cilësimin juridik mjafton kryerja e marrëdhënieve seksuale, pasi një vajzë që nuk ka arritur pjekurinë seksuale nuk është e aftë dhe nuk e ka arritur atë zhvillim të përgjithshëm që të kuptojë rëndësinë e aktit seksual si dhe pasojat që lë ai në shëndetin e saj. Gjithashtu, ajo është shumë lehtë e përpunueshme dhe e ndikueshme nga personat madhorë që e rrethojnë. Sic e thamë dhe më lart kemi një risi të Kodit. Penal që konsistonte në futjen e kriterit moshë. Vepra është njëlloj e dënueshme dhe në rast se është arritur moshë 14 vjeçare, por jo pjekuria seksuale.

Vepra penale e marrëdhënieve seksuale në gjini e parashikuar nga neni 100 i K. Penal konsiderohej si një vepër penale që ndodhte rrallë dhe që ishte një fenomen i rëndë dhe i dënueshëm veçanërisht nga morali shoqëror i asaj kohe. Nuk kërkonte ekzistencën e dhunës, por mjaftonte kryerja e marrëdhënieve seksuale në vijë të drejtë apo midis vëllezërve dhe motrave. Kjo vepër penale konkuronte në cdo rast me krimet e tjera seksuale.

Ndryshimet e pakta në Kodin Penal të vitit 1977 erdhën dhe si pasojë e një rëndësie më të madhe dhe vëmendje të theksuar që po i jepej emancimit të gruas në ato vite në çdo fushë të jetës, situatë që u reflektua edhe në Kodin Penal.

Vlen për t’u theksuar fakti që si Kodi Penal i vitit 1952, po ashtu dhe Kodi Penal i vitit 1977, doktrina dhe jurisprudenca përshkoheshin në mënyrë të dukshme dhe të ndjeshme nga ideologjia marksiste - leniniste, mësimet e partisë së punës si dhe

mësimet e udhëheqësit të partisë shokut Enver Hoxha, fakt tërësisht i kuptueshëm dhe i pranueshëm për sistemin politik, monokratik të asaj kohe.

1.6 Krimet seksuale sipas ligjit nr.7895 datë 27.01.1995 – Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.

Me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri nga ai monokratik - totalitar në një sistem demokratik, pati ndryshime të shumta dhe në të gjithë legjislacionin shqiptar. Ndryshime dhe shtesat e shumta që iu bënë edhe Kodit Penal të vitit 1977 nuk prekën veprat penale në sferën seksuale. Kështu, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 7895 dt. 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”⁸ nenet që parashikonin krimet seksuale mbetën të pandryshuara.

Hartuesit e ligjit në fjalë kanë tentuar të hartojnë një Kod penal që të ishte i zbatueshëm dhe t’i përshtatej kushteve, traditave dhe zhvillimeve demokratike të Shqipërisë. Ky Kod frymëzohej edhe nga legjislacionet e vendeve më me traditë të Evropës dhe në mënyrë të veçantë Kodit penal francez⁹.

Kodi i ri penal ndahet në dy pjesë kryesore: në pjesën e parë që është pjesa e përgjithshme trajtohen dispozitat themelore që rregullojnë institutet e veçanta të së drejtës penale, ndërsa në pjesën e posaçme rregullohen veprat penale. Pjesa e përgjithshme, në versionin origjinar, përbëhet nga tetë krerë dhe përmban 73 dispozita kundrejt 49 dispozitave që përmbante kodi i mëparshëm. Risi përmban dhe pjesa e posaçme e këtij Kodi. Kështu renditja e veprave penale është e ndryshme në krahasim me kodin në fuqi. Është përdorur si model Kodi Penal Francez. Dënimet konkrete janë përcaktuar në harmoni me rrezikshmërinë e veprës penale dhe dënimet rezultojnë gjithashtu në harmoni midis veprave të ndryshme penale. Hartuesit e projekt Kodit theksojnë se në caktimin e dënimeve në vepra konkrete janë nisur edhe nga traditat, kushtet e vendit si dhe nga krahasimi i dënimeve të të njëjtave vepra në Kode penale të vendeve të tjera¹⁰.

Krimet seksuale përfshihen në seksionin VI të këtij kodi me titull “*Krimet seksuale*”, i përfshirë në kreun II të pjesës së posaçme të K. Penal me titull “*Krimet kundër personit*”. Para ndryshimeve të bëra në vitin 2012 dhe 2013 në kodin penal, krimet krimet seksuale parashikoheshin nga 9 nene, nenet 100 - 108, në të cilat gjenin pasqyrim krimet e kryera ndaj sferës seksuale të femrës.

Kodi Penal i vitit 1995 sjell shumë ndryshime thelbësore për krimet seksuale krahasuar me parashikimet e Kodit Penal të mëparshëm. Kështu veprat që gjejnë pasqyrim janë: “*Marrëdhëniet seksuale me të mitura*” (neni 100)¹¹, “*Marrëdhëniet*

⁸ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 2, datë 28 Shkurt 1995, fq. 23.

⁹ Siç pohohet në Relacionin “*Për projektin e Kodit të ri penal të Republikës së Shqipërisë*” të Këshillit të Ministrave, drejtuar Kryesisë së Kuvendit. Arkivi i Parlamentit Shqiptar, nr. 896, datë 02.06.1994.

¹⁰ Shiko relacionin e përmendur në footnote pararendëse.

¹¹ Neni 100 - “*Kryerja e marrëdhënieve seksuale me të miturën që nuk ka arritur moshën 14 vjec ose që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga 5 gjer në 15 vjet. Kur marrëdhënia seksuale*

sesuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç” (neni 101)¹², “Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura” (neni 102)¹³, “Marrëdhëniet seksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur” (neni 103)¹⁴, “Marrëdhëniet seksuale me kërcënim për përdorim të armës” (neni 104)¹⁵, “Marrëdhëniet seksuale duke shpërdoruar detyrën” (neni 105)¹⁶, “Marrëdhëniet seksuale me persona në gjini ose nënkujdestari” (neni 106)¹⁷, “marrëdhëniet seksuale në vende publike” (neni 107)¹⁸, “Vepra të turpshme” (neni 108)¹⁹.

Duhet theksuar se në këtë Kod Penal u ruajt klasifikimi i krimeve seksuale në kapitullin e krimeve kundër personit, dhe vijimësia e të njëjtit objekt të këtyre veprave penale që ishte ruajtja e paprekshmërisë seksuale të gruas, por u bë një sistemim shumë më i avancuar i këtyre veprave penale. Edhe pse në çdo nen të veçantë gjejnë parashikim lloje të ndryshme të veprave penale ndaj lirisë dhe paprekshmërisë seksuale të femrës dhe të të miturave, në të vërtetë ato linin për të dëshiruar pasi dhe në këtë kod shumë vepra penale në sferën seksuale nuk u parashikuan apo vazhduan të dënoheshin marrëdhëniet homoseksuale, kryerja të cilave dhe me konsensus përbënte vepër penale. Duhet vlerësuar edhe fakti se me këtë kod kemi gjithashtu një përmirësim të dukshëm të terminologjisë juridike.

Çfarë përbën risinë e vërtetë të këtij kodi lidhur me krimet seksuale është:

1) parashikimi i veçantë që ju bë çdo veprë penale duke u rritur kështu parashikimi i tyre nga në 4 në 9 nene;

kryhet me dhunë ose kur i janë shkaktuar të dëmtuarës pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 10 gjer në 20 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të miturës, dënohet me burgim jo më pak se 15 vjet.”

¹² Neni 101 - *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të miturën në moshë 14-18 vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga 5 gjer në 10 vjet. Kur të miturës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 10 gjer në 15 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të miturës, dënohet me burgim nga 10 gjer në 20 vjet.”*

¹³ Neni 102 - *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura, dënohet me burgim nga 3 gjer në 10 vjet. Kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 5 gjer në 15 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të miturës, dënohet me burgim nga 10 gjer në 20 vjet.”*

¹⁴ Neni 103 - *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale duke përfutur nga pazotësia fizike ose mendore e të dëmtuarës që ka arritur moshën 14 vjeç dhe pjekurinë seksuale, ose vendosja e saj në gjendje të pandërgjegjshme dënohet me burgim nga 5 gjer në 10 vjet. Kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 5 gjer në 15 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të miturës, dënohet me burgim nga 10 gjer në 20 vjet.”*

¹⁵ Neni 104 - *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale duke kërcënuar të dëmtuarën për përdorim aty për aty të armës, dënohet me burgim nga 5 gjer në 15 vjet.”*

¹⁶ Neni 105 - *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale duke shpërdoruar raportet e vartësisë ose të detyrës, dënohet me burgim gjer në 3 vjet.”*

¹⁷ Neni 106 - *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale midis prindërit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, midis personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë, ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie apo birësimi dënohet me burgim gjer në pesë vjet.”*

¹⁸ Neni 107 - *“Kryerja e marrëdhënieve seksuale në vende publike ose në ambiente të ekspozuara nga vështrimi i njerëzve përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.”*

¹⁹ Neni 108 - *“Kryerja e veprave të turpshme me persona që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç, dënohet me burgim gjer në 5 vjet.”*

- 2) parashikimi i figurave të reja të krimeve seksuale (situatave të reja) si ajo e kryerjes së marrëdhënieve seksuale duke shpërdoruar detyrën, nën kërcënimin e armës etj; si dhe
- 3) kategorizimi i ri që iu bë të miturave duke shtuar dhe të miturat nga moshë 14-18 vjeç etj.

Në lidhje me subjektin pasiv (femër) tashmë ai ndahet në katër kategori si vijon: kategoria e parë ku inkuadrohen ato femra që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe cilësohen si të rritura; kategoria e dytë ku inkuadrohen të miturat e moshës 14 vjeç - 18 vjeç dhe që kanë arritur pjekurinë seksuale; kategoria e tretë përfshin të miturat që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç dhe kategoria e katërt përfshin të miturat që kanë mbushur moshën 14 vjeç, por nuk kanë arritur pjekurinë seksuale. Kategorizimi i mësipërm ishte shumë i nevojshëm pasi nga ai varet cilësimi juridik i veprës penale. Kështu, për të miturat në moshën 14 - 18 vjeç dhe që kanë arritur pjekurinë seksuale për ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 101 është i nevojshëm përdorimi i dhunës.

Një kategori tjetër subjekti pasiv me karakter të veçantë e gjejmë në parashikimin e nenit 103 të K. Penal ku për cilësimin juridik të veprës penale të kryerjes së marrëdhënieve seksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur parashikuar nga neni 103 i K. Penal, në vetë përmbajtjen e nenit përcaktohet se subjekti pasiv duhet të jetë i paaftë fizikisht, mendërisht apo të jetë vendosur në gjendje të pandërgjegjshme nga autori i veprës penale me qëllim për të realizuar objektivin. Sanksionet penale në këtë Kod mbetën përsëri të ashpra, por në ndryshim nga Kodi i mëparshëm nuk parashikohet më dënimi me vdekje. Edhe ky fakt përbën risinë më të rëndësishme lidhur me sistemin e dënimeve.

Nga ana objektive ky grup veprash penale kryhet me anë të veprimeve të kryera nga autori i veprës penale me qëllim realizimin e aktit seksual, ndërsa nga ana subjektive duhet të ekzistojë faji në formën e dashjes.

Akti seksual quhej i kryer kur arrihej bashkimi i plotë seksual, pavarësisht në kishte ardhur apo jo si pasojë deflorimi i femrës.

Përsa i përket veprës penale të parashikuar nga neni 100 i K. Penal (v.1995) kryerjes së marrëdhënieve seksuale me të mitura që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç ose që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale objekti në këtë vepër penale është i dyfishtë dhe synon mbrojtjen e sferës seksuale të vajzës si dhe zhvillimin normal seksual të saj. Elementi dhunë në këtë vepër penale është rrethanë rënduese, sepse për cilësimin juridik mjafton kryerja e marrëdhënieve seksuale, pasi një vajzë që nuk ka arritur pjekurinë seksuale nuk është e aftë dhe nuk e ka arritur atë zhvillim të përgjithshëm që të kuptojë rëndësinë e aktit seksual si dhe pasojat që lë ai në shëndetin e saj. Gjithashtu ajo është shumë lehtë e përpunueshme dhe e ndikueshme nga personat madhorë që e rrethojnë. Sic e thamë dhe më lart kemi një risi të K.Penal që konsiston në futjen e kriterit moshë. Vepra është njësoj e dënueshme dhe në rast se është arritur moshë 14 vjeç, por jo pjekuria seksuale.

Vepra penale e kryerjes së marrëdhënieve seksuale me kërcënim për përdorimin e armës parashikuar nga neni 104 është një figurë e re vepre penale e cila kërkon kërcënimin për përdorim aty për aty të armës.

Vepra penale e kryerjes së marrëdhënieve seksuale duke shpërdoruar detyrën parashikuar nga neni 105, gjithashtu është një figurë e re vepre penale e cila kërkon që midis subjekteve të ketë një raport vartësie apo detyre.

Vepra penale e marrëdhënieve seksuale në gjini e parashikuar nga neni 106 i K. Penal ka pësuar përmirësime nga e njëjta figurë vepre penale e parashikuar në kodin e vjetër. Në të janë shtuar dhe raportet e kujdestarisë dhe birësimit. Kjo vepër penale nuk kërkon ekzistencën e dhunës, por mjafton kryerja e marrëdhënieve seksuale në vijë të drejtë apo midis vëllezërve dhe motrave etj. Kjo vepër penale është një vepër që konkurron në çdo rast me krimet e tjera seksuale.

Gjithashtu është shtuar dhe një vepër e re penale e parashikuar nga neni 107 i K. Penal ajo e kryerjes së marrëdhënieve seksuale në vende publike. Kjo është një kundravajtje penale dhe objekti i saj është i ndryshëm nga objekti i veprave të tjera penale të parashikuara në këtë seksion. Kjo vepër penale ka për objekt ruajtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura për të ruajtur moralin publik dhe rregullat e moralit të shoqërisë sonë. Për këtë arsye mendoj se është bërë një sistemim i gabuar i kësaj figure vepre penale në këtë seksion.

Këto ndryshime që patën krimet seksuale me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të vitit 1995, erdhën kryesisht si pasojë e ndryshimit të sistemeve, nevojës për një përshtatje të legjislacionit penal me atë të vendeve demokratike, me konventat ndërkombëtare dhe me një emancipim të shoqërisë dhe nevojës për të parashikuar dhe vepra penale që më parë ishin të papranueshme për moralin e shoqërisë socialiste.

Vlen për t'u theksuar fakti që tashmë si Kodi Penal po ashtu doktrina dhe jurisprudenca kishin humbur ndikimet e ideologjisë së vjetër që më parë përshkonte të gjithë shtetin dhe institucionet.

Më pas me ligjin nr. 8175 datë.23.12.1996²⁰ seksioni i Krimeve Seksuale pësoi një sërë ndryshimesh të dukshme si në mënyrën e formulimit të neneve, në parashikimin dhe rregullimin e figurave të veprave penale, po ashtu dhe në sanksionet e parashikuara. Ky ligj pati një jetëgjatësi shumë të shkurtër (as 3 muaj)²¹, jetëgjatësi kjo e përcaktuar edhe si rrjedhojë e kritikave të shumta nga ana e doktrinës dhe jurisprudencës. Objekt i kritikave, mes të tjerave ishin dhe sanksionet pasi ato në shumicën e rasteve parashikonin dënime fikse (psh: dënohet me 13 vjet burgim, dënohet me 10 vjet burgim etj.) dhe jo dënime të përcaktuara në minimum e

²⁰ Ligji nr. 8175, date 23.12.1996 "Për disa shtesa e ndryshime në Ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë".

²¹ Ligji nr. 8175, dt.23.12.1996, Fletore Zyrtare nr. 29, dt.7 Janar 1997, fq. 965. Ligji u deklarua antikushtetues me Vendim i GJK, Nr.13, Dt.Aktit:29.05.1997, datë e miratimit 29.05.1997, Fletore Zyrtare Nr.7, Fq.171. Midis të tjerave Gjykata Kushtetuese sqaron në vendimin e saj se Gjykata cmon se parashikimi i sanksioneve (dënimeve) fikse në normat e sipërpërmendura të Ligjit nr.8175, bie ndesh me një sërë parimesh (dispozitash) të Pjesës së Përgjithshme të Kodit Penal, sidomos për mënyrën e caktimit të dënimit, për rrethanat lehtësuese e rënduese (nenet 47-50), të cilat kur konkurrojnë, vlejnjë, pa përjashtim, për cdo vepër penale. Sanksionet fikse eliminonjë mbrojtjen përsa i përket përcaktimit të shkallës së rrezikshmërisë së veprës së kryer e të autorit të saj dhe gjykatës i heqin mundësinë e individualizimit të dënimit, duke cunuar kështu funksionin e saj në dhënien e drejtësisë. Si rrjedhojë, me sanksionet fikse çënohen të drejtat themelore të njeriut, të garantuara me parimet kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe për një gjykim të drejtë (nenet 38 e 40 të Ligjit Kushtetues nr7692, datë 31.3.1993 "Për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut") dhe si të tilla duhet të shfuqizohen.

maksimum apo vetëm në minimum e vetëm në maksimum, gjë që të çonte në dënimin njëloj të të gjithë autorëve të veprave penale pa patur parasysh rrethanat specifike lehtësuese apo rënduese për çdo vepër penale të kryer.

Nga studimi i këtij ligji bie në sy fakti që formulimi i neneve, hartimi i tyre është i ndikuar nga legjislacioni penal italian duke përjashtuar dënimet absurde dhe të pakuptimta që parashikoheshin në këtë ligj.

Ky ligj shumë shpejt u shfuqizua dhe përsëri mbetën në fuqi figurat e veprave penale të parashikuara nga K. Penal i vitit 1995, të cilat do të mbeten të pandryshuara deri me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 8733 datë 24.01.2001. Nevoja e rishikimit në mënyrë të përgjithshme të dispozitave të Kodit penal u diktua nga miratimi i Kushtetutës së re, përvoja e zbatimit të ligjit 7895 në luftën kundër kriminalitetit, nga Vendimi i Gjykatës kushtetuese e cila shpallte antikushtetues dënimin me vdekje si dhe nga procesi i nënshkrimit të Protokollit të gjashtë të Konventës për Mbrotjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore.

Të gjitha ndryshimet e bëra si rezultat i ligjit të mësipërm kishin si synim mbrotjen e të drejtave dhe lirive të personit, forcimin e rendit dhe sigurisë publike në luftë kundër kriminalitetit²².

Nga një analizë e ligjit, pas ndryshimeve të bëra në vitin 2001 në lidhje me krimet seksuale mund të themi, që risitë janë dy:

Risia e parë dhe më e rëndësishme qëndron në faktin se legjislatori pohon se jo vetëm femra mund të jetë subjekt pasiv i një krimi seksual dhe se jo vetëm mashkulli mund të jetë subjekt aktiv i veprës penale. Marrëdhëniet mund të jenë midis subjektit aktiv dhe pasiv të të njëjtit seks apo të sekseve të ndryshme.

Risia e dytë lidhet me parashikimin e rrethanave të cilësuar në kryerjen e krimeve seksuale. Kështu ndryshimin e kemi në nenin 100 i cili në versionin origjinar ndalonte “*marrëdhëniet seksuale me të mitura*”.

Me ligjin nr. 8733 u ndaluan si marrëdhëniet seksuale ashtu dhe ato homoseksuale me të mitur ku termi “*të mitur*” nënkupton të mitur femra dhe të mitur meshkuj. Kjo shtesë përbën një risi të domosdoshme pasi dispozita garanton në të njëjtën mënyrë fëmijën e mitur pavarësisht seksit të tij/saj. Dëmi psikologjik dhe fizik që shkaktohet tek fëmija i mitur nuk zhduket në rastin kur i mituri është i seksit mashkullor. Gjithashtu edhe neni 101 në versionin e tij origjinar ndalonte vetëm “*Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç*”.

Me shtesat e ligjit nr, 8733i vitit 2001 ai ndalon tashmë edhe marrëdhëniet seksuale me dhunë me të mitur (meshkuj) të moshës 14-18 vjeç edhe ato homoseksuale me dhunë me të mitur (meshkuj dhe femra) të moshës 14-18 vjeç.

Objekt ndryshimi ka qenë edhe neni 102 i Kodit Penal, i cili ndalon marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura. Shtohet në këtë dispozitë parashikimi i rrethanave

²² Siç pohohet në Relacionin e Komisionit të Ligjeve, Kuvendi i Shqipërisë, me objekt projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”, Arkiv i Parlamentit Shqiptar.

të cilësuar si kryerja e marrëdhënies seksuale në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin duke parashikuar në këto raste dhe dënime më të rënda.

Shtohet gjithashtu neni 102/a i Kodit Penal, i cili, në frymën e barazisë midis dy sekseve, ndalon marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur.

Ndërsa neni 103 i Kodit Penal, i titulluar në versionin e tij origjinar “*Marrëdhënie seksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur*” pëson dy shtesa. Së pari ndalon krahas marrëdhënieve seksuale edhe ato homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur dhe së dyti parashikon dënime më të rrepta në rastin kur vepra kryhet në rrethana të cilësuar.

Neni 104 i Kodit Penal ndalon përveç marrëdhënieve seksuale edhe ato homoseksuale me kërcënim për përdorim të armës. Subjekt pasiv mund të jetë si mashkulli si femra.

Në të njëjtën frymë edhe neni 105 i Kodit Penal ndalon jo vetëm marrëdhëniet seksuale por edhe ato homoseksuale duke shpërdoruar detyrën.

Ndryshim pëson dhe neni 106 i Kodit Penal, i cili dënon marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari duke konceptuar të tilla marrëdhëniet ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit²³.

Neni 107 i Kodit Penal ndalon kryerjen e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në vende publike.

Krimet seksuale pësojnë ndryshime edhe me ligjin nr. 23/2012 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë"*”, të ndryshuar, por këto ndryshime lidhen vetëm me masën e dënimit në veprat penale të parashikuara në nenet 102/a dhe 108 të këtij kodi të orientuara drejt ashpërsimit të dënimit me burgim.

Së fundmi, ndryshime të rëndësishme Kodi penal ka pësuar edhe si rrjedhojë e miratimit të ligjit nr. 144/2013, datë 02.5.2013. Nevoja e ndryshimit të Kodit penal u konsiderua si thelbësore me qëllim dhënien e një përgjigjeje më të përshtatshme dhe efektive problematikave në rritje ose të reja në fushën penale. Përmes ligjit të ri, këto probleme adresohen nëpërmjet një qasjeje të dyfishtë ku qasja e parë garanton forcimin e luftës ndaj kriminalitetit, duke ashpërsuar dënimet për veprat penale të rënda dhe duke parashikuar rregulla të reja, me qëllim garantimin e vuajtjes së plotë të dënimit nga personat me rrezikshmëri të lartë shoqërore²⁴. Më konkretisht mes

²³ Ndërkohë që në versionin origjinar konceptoheshin si marrëdhënie seksuale me persona në gjini ose nën kujdestari vetëm ato midis prindërit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, midis personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie apo të birësimit.

²⁴ Qasja e dytë garanton reformimin e rregullave për masat alternative të dënimit, të cilat sigurojnë rehabilitimin e personave që kryejnë vepra të lehta penale dhe kanë rrezikshmëri të ulët shoqërore. Për më gjatë shiko: Relacion të Këshillit të Ministrave për Projektligjin “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”*”, bashkalidhur Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 175, datë 20.03.2013.

qëllimeve të këtij ligji është trajtimi më efektiv i problematikës së dhunës në familje²⁵ dhe rritja e dënimeve për ato vepra penale për të cilat është vërejtur një rritje gjatë viteve të fundit.

Kështu, legjislatori ka ndërhyrë duke rritur dënimin në rastet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 100 të kodit penal ku dënimi për kryerjen e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në rrethana rënduese pëson një rritje në sensin që legjislatori fillimisht parashikonte një minimum burgimi prej pesëmbëdhjetë vitesh dhe një maksimum gjer në njëzet e pesë vjet. Me ligjin e ri maksimumi është ndërruar në minimum dhe dispozita tashmë përcakton se kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në rrethana rënduese dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet dhe dënimi maksimal ai i parashikuar në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal.

Legjislatori ka ndërhyrë gjithashtu edhe në paragrafin e tretë të nenit 100 të kodit penal i cili parashikon se: *“Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur”* duke rritur edhe në këtë rast dënimin. Legjislatori përcaktonte se vepra dënohej me burgim jo më pak se njëzet vjet, ndërsa tashmë ajo dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Legjislatori ka ndërhyrë në tekstin e nenit 102 të Kodit Penal duke shtuar ndalimin e kryerjes së marrëdhënieve seksuale midis bashkëshortëve ose bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre dhe duke e dënuar me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Është shtuar një dispozitë e re që është neni 107/a i cili ndalon ushtrimin e dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, duke e dënuar me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Gjithashtu, legjislatori rregullon dhe rastet kur vepra kryhet në rrethana rënduese si bashkëpunimi, kur kryhet kundër disa personave, kur kryhet më shumë se një herë ose kundër fëmijëve të moshës katërmëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç. Në këto raste dënimi ashpërsohet dhe subjekti aktiv dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Në rastet kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Dënim më i ashpër parashikohet në rastet kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit. Subjekti aktiv do të dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

Në nenin 108 të Kodit Penal, legjislatori ndalonte kryerjen e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërmëdhjetë vjeç. Me ndryshimet e ligjit nr. 144/2013 në këtë dispozitë shtohen disa paragrafë. Kështu, në kuadër të luftës së dhunës në familje, legjislatori përcakton se *“kjo vepër, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”*.

Më tej, në kuadër të mbrojtjes së mëtejshme të të miturit përcakton se *“Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur*

²⁵ Në relacion sqarohet se *“problematika e dhunës në familje ka njohur rritje dhe përbën një nga shqetësimet kryesore të Ministrisë së Drejtësisë në fushën penale. Ajo konceptohet si një fenomen i papranueshëm në shoqërinë shqiptare dhe duhet luftuar me shumë ashpërsi dhe vendosmëri”*.

moshën katërmbëdhjetë vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

Legjislatori shkon më tej me mbrojtjen e tij dhe me qëllim shkurajimin e çdo lloj iniciative nga ana e subjekteve aktive për të kryer krime seksuale apo vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit dënon dhe thjesht propozimin²⁶ e bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale.

Gjykoj se përmes kësaj dispozite garantohej një mbrojtje ligjore maksimale e të miturve në lidhje me veprat e mësipërme.

Ndërhyrja e fundit në seksionin e krimeve seksuale lidhet me shtimin e një dispozite të re, neni 108/a i Kodit Penal, i cili ndalon kryerjen e sjelljeve me natyrë seksuale, që çënojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues. Ngacmimet seksuale përbëjnë tashmë një vepër e cila dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Në rastet kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënimi ashpërsohet duke u rritur në tre deri në shtatë vjet. Ngacmimet seksuale përbëjnë një krim seksual, i dënuar në një numër të lartë shtetesh të zhvilluara.

Si përfundim, mund të thuhet se legjislacioni penal shqiptar lidhur me krimet seksuale ka evoluar, jo vetëm në raport me llojet e vepra penale, por edhe në elementët e anës objektive, dënimet penale dhe zbatimin e tyre duke u përafëruar me përkufizimet standarte të këtyre krimeve që mundësojnë matjen dhe krahasimin e tyre me ato në vendet e tjera europiane.

²⁶ Propozim për të kryer krime seksuale apo vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit.

KAPITULLI II

**NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KRIMET
SEKSUALE SIPAS KODIT PENAL TË VITIT 1995 TË
NDRYSHUAR ME LIGJIN NR. 8733 DATË 24.01.2001
DHE ME LIGJIN NR. 144 DATË 02.5.2013.**

2.1 Hyrje.

Me miratimin e ligjit nr. 8733 datë 24.01.2001 dhe ligjit nr.144 datë 20.05.2013 u ndryshuan dhe u plotësuan figurat e veprave penale që parashikonin krimet seksuale ose homoseksuale. Këto ligje luajnë rol ndihmës dhe plotësues të normativës mbi krimet seksuale. Ato janë aktive në luftën kundër krimeve seksuale ose homoseksuale duke parashikuar dhe dënime të rënda për këto vepra penale.

Objekt i këtyre veprave penale në radhë të parë është liria seksuale e çdo personi, qoftë ky i mitur apo i rritur, i gjinisë femërore apo mashkullore. Liria seksuale duhet kuptuar si e drejta e çdo personi për të disponuar lirinë e tij seksuale, për të pretenduar që ajo të respektohet nga të tretët si dhe si paprekshmëri e kësaj sfare kaq delikate²⁷.

Krimet seksuale prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershme të drejtën themelore dhe ekskluzive të çdo njeriu për të disponuar lirinë e tij seksuale dhe për të pretenduar paprekshmërinë e saj²⁸ si dhe në mënyrë të tërthortë prekin moralin dhe ndërgjegjen publike. Interesi i Shtetit është të mbrojë dhe të garantojë lirinë seksuale.

Duhet vënë në dukje se seksualiteti është një “mjet” i shprehjes së personalitetit njerëzor, është një mënyrë “komunikimi” ndërpersonale dhe krimet seksuale mund të interpretohen vetëm si një dëm që i shkaktohet personit në të drejtat e tij themelore. Legjislatori është “xheloz” në mbrojtjen e kësaj të drejte individuale që integron atë marrëdhënie të veçantë juridike që është morali publik, pra në këto vepra penale kemi një përparësi të profilit privat mbi atë publik.

Liria seksuale kuptohet si një disponim i lirë i trupit për qëllime seksuale brenda kufinjve të së drejtës dhe të moralit shoqëror. Edhe sikur të duam të gjejmë në krimet seksuale jo një dëm ndaj lirisë së të dëmtuarës/it, por një kapërcim të lirisë së shprehjes së aktivitetit seksual të subjektit aktiv, nuk do të kishte qenë konseguente të përcaktohej si objekt i mbrojtjes penale liria seksuale e subjektit. Sipas kësaj llogjike hipotetike do të kishim një abuzim të sferës seksuale të subjektit aktiv i cili do të kishte dëmtuar në radhë të parë dhe të drejtpërdrejtë një të mirë juridike publike të vendosur për kufizimin e lirisë seksuale.

E drejta për disponim të lirë dhe të plotë të sferës seksuale duhet të kuptohet në sensin “negativ”, pra në ndalimin që të tjerët të strumentalizojnë trupin e një personi, pa dëshirën e tij, për qëllime seksuale. Aktiviteti seksual i çdo personi është frut i një zgjedhjeje të lirë individuale.

Koncepti i lirisë seksuale si e drejtë autonome e personit përfaqëson pikën e referimit të figurës së krimeve seksuale.

²⁷ Me këtë opinion bashkohet dhe një pjesë e rëndësishme e doktrinës së huaj mbi këtë fushë si: Bertolino M., *Liberta' sessuale e tutela penale* Milano, 1993, fq. 90-91; Sabatini L. P., *Violenza Carnale*, në Enciclopedia Giuridica, Roma, 1994, fq. 2.

²⁸ Gjykata e Tiranës pohon se “liria seksuale” ...është një ndër elementët mjaft thelbësorë të lirisë individuale. Por, më i rëndësishëm sesa “liria për të disponuar trupin tënd” është “liria shpirtërore” e individit, e mbrojtur nga kjo dispozitë. (neni 100 në rastin konkret). Shiko vendimin nr. 1581 datë 19.11.2008.

Deri para hyrjes në fuqi të ligjit të vitit 2001, Kodi Penal mbron vetëm paprekshmërinë e sferës seksuale të femrës, ndërsa homoseksualiteti parashikohej si vepër penale.

Ligji nr. 8733 datë 24.01.2001 ndryshoi mënyrën e të konceptuarit të subjektit pasiv të këtyre veprave penale duke përfshirë si subjekt pasiv edhe mashkullin krahas femrës. Një risi e rëndësishme e këtij ligji, që meriton të nënvizohet, është zgjerimi i mbrojtjes që ai garanton duke përfshirë edhe marrëdhëniet seksuale midis homoseksualëve. Përmes tij sigurohet njëhësi i përgjegjësisë penale për krimet seksuale ose homoseksuale, në të cilin bazohet cilësimi si veprime të kundërligjshme me dashje, që çënojnë lirinë seksuale dhe shëndetin e femrës a të mashkullit²⁹.

Nga një analizë e këtij ligji, përse i përket luftës kundër krimeve seksuale” del në pah se ai përbën një hap përpara dhe në përputhje me Kushtetutën e RSH-së, Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për mbrojtjen e të drejtave të grave. Ky ligj padyshim mund të krahasohet edhe me kodet penale të shteteve të zhvilluara evropiane.

Ndryshimet në kodet penale evropiane përse i përket krimeve seksuale kanë ardhur dhe si pasojë e “luftës” së gjatë që kanë bërë lëvizjet feministe dhe shoqatat për mbrojtjen e grave në këto shtete, gjë që në vendin tonë mungon. Ndryshimet në kodin tonë kryesisht bëhen si nevojë për përshtatje me legjislacionet e shteteve evropiane dhe si pasojë e ndikimit të politikës kriminale.

Me ardhjen e demokracisë, pra ndryshimin e sistemit politik, megjithëse mungojnë statistikat kriminologjike, krimet seksuale patën një rritje të madhe në vitet 1993, 1994 etj, veçanërisht deri në vitin 1997-1998 dhe si pasojë u bë i domosdoshëm parashikimi i figurave të më shumë veprave penale në sferën seksuale.

Kjo situatë solli fillimisht shtimin e figurave të veprave penale në Kodin Penal të vitit 1995 dhe me pas ndryshimin dhe plotësimin e këtyre veprave penale përmes ligjit nr. 8733 të vitit 2001. Së fundmi kuadri ligjor është plotësuar më tej përmes ndryshimeve të bëra nga ligji nr. 144/2013. Këto ndryshime erdhën dhe si pasojë e maturimit të imazhit të pavarur të gruas në shoqëri dhe njohja e të gjitha të drejtave të saj.

Me këtë ligj kemi një klasifikim të ri të krimeve seksuale në hap me kohën dhe pa kontradikta.

2.2 Krimet seksuale në Shqipëri.

Në Shqipëri, krimet seksuale, tradicionalisht, janë konsideruar çënime tepër të rënda dhe të papajtueshme me nderin, moralin dhe respektin ndaj gruas.

Legjislacioni penal shqiptar mbron posaçërisht lirinë seksuale dhe shëndetin e njeriut, duke dënuar rëndë përdhunimin dhe krime të tjera seksuale. Kodi penal, aktualisht (2016), parashikon 12 figura veprash penale, si krime seksuale ose homoseksuale, të cilat konsiderohen krime kundër jetës dhe shëndetit të personit, për të cilat parashikohen dënime të rënda. Krimet seksuale dhe homoseksuale përmbahen në

²⁹ Lexo vendimin e cituar në footnote pararendëse.

seksionin VI të Kodit penal, “Krimet seksuale”, i cili është një prej 10 seksioneve të kapitullit II të këtij Kodi, “Veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës”.

Krimet seksuale dhe homoseksuale janë parashikuar në të njëjtin seksion. Gjithsesi, gjenden disa dispozita të veçanta, siç është rasti i nenit 102 dhe 102/a, i cili përkatësisht parashikon rastet e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura dhe rastet e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur. Ato ndryshojnë vetëm për sa u përket dënimit³⁰.

Me ligjet 8733, datë 24.01.2001 dhe nr.144 datë 20.05.2013, të cilët amenduan Kodin Penal me disa shtesa dhe ndryshime, u plotësua një sistem i tërë i mbrojtjes së marrëdhënieve seksuale.

Në këndvështrimin bashkëkohor, Kodi Penal aktual paraqitet më i plotësuar në goditjen e krimeve seksuale dhe homoseksuale, në raport me të gjitha kodet apo ligjet penale të mëparshme. Të gjitha rrethanat e veçanta në të cilat mund të kryhen marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë, si dhe veprat e turpshme, klasifikohen si figura krimi më vete dhe jo si rrethana të cilësuarat të kryerjes së krimit.

Marrëdhëniet seksuale me dhunë parashikohen si vepër penale më vete në: nenin 101³¹ (Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës(14-18 vjeç), nenin 102³² (Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura), 102/a³³ (Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur) të K. Penal dhe si rrethanë rënduese në nenin 100 (Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me të mitur). Më tej krimet seksuale klasifikohen marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur (neni 103); marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim për përdorim të armës (neni 104); marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën (neni 105); marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (neni 106); marrëdhënie seksuale në vende publike

³⁰ “Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet”. (neni 102, paragrafi 1). “Kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet”. (neni 102/a, paragrafi 1).

³¹ Neni 101 -“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me dhunë me fëmijë të mitur në moshë 14-18 vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga 5 gjer në 15 vjet. Kur marrëdhënia seksuale apo homoseksuale, me dhunë, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 10 gjer në 20 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur, dënohet me burgim jo më pak 20 vjet.”

³² Neni 102 -“Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura, ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga 3 gjer në 10 vjet. Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 5 gjer në 15 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, dënohet me burgim nga 10 gjer në 20 vjet.”

³³ Neni 102/a-“Kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur, dënohet me burgim nga 3 gjer në 7 vjet. Kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 5 gjer në 10 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim nga 10 gjer në 20 vjet.”

(neni 107); dhuna seksuale (neni 107/a); vepra të turpshme (neni 108) dhe ngacmimi seksual (neni 108/a).

Pothuajse të gjitha veprat e klasifikuara si më sipër përbëjnë krim dhe kryerja e çdonjërit prej tyre pasohet nga dënime të rënda. Dënimet janë më të rënda nëse veprat penale kryhen në rrethana cilësuese. Prej këtyre bëjnë përjashtim marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në vende publike pasi kjo vepër përbën një kundravajtje penale.

Këto vepra penale përbëjnë çështje të juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për një periudhë kohe Gjykata e Krimeve të Rënda, e krijuar në vitin 2004, ka patur juridiksion vetëm për rastet e konsideruara mjaft të rënda, të parashikuara në nenet 100 dhe 101 të Kodit Penal, përkatësisht në rastet e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me të miturat dhe të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur, por tanimë dhe këto vepra penale janë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme.

Nga Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë evidentojmë se në vitin 2014 janë përfunduar 55 çështje³⁴ mbi krimet seksuale, në vitin 2013 janë përfunduar 35 çështje³⁵, në vitin 2012 janë përfunduar 23 çështje³⁶, në vitin 2011 janë përfunduar 20 çështje³⁷ dhe në vitin 2010 janë përfunduar 31 çështje³⁸.

2.3 Koncepti i “aktit seksual”.

Siç u përmend dhe më lart sjellja tipike e parashikuar nga nenet 101, 102 dhe 102/a të K. Penal është shtrëngimi i personit me dhunë për të kryer akte seksuale.

Koncepti i “*aktit seksual*” është një term referues që qëndron në thelb të normativës shqiptare.

Në Kodet e vjetra penale me këtë term kuptohej akti heteroseksual, pra akti i penetrimit të organeve seksuale mashkullore në ato seksuale femërore duke arritur një bashkim seksual. Me ndryshimin e sistemeve politike, ka ndryshuar dhe mënyra e konceptimit të aktit seksual nga shoqëria gjë që gjen pasqyrim dhe në legjislacionin penal.

Në një shpjegim në sens të gjerë të konceptit të “aktit seksual” në të futet cdo lloj penetrimi, dhe i pjesshëm, të organeve gjenitale të njërit prej subjekteve në një pjesë të trupit të subjektit tjetër e aftë për ta pranuar, në mënyrë që të arrihet bashkimi, pavarësisht nga seksi i subjektit pasiv. Pra në konceptin e gjerë të termit “akt seksual” në të futen seksi oral, vaginal dhe anal.

³⁴ Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2014, fq. 30. www.drejtësia.gov.al

³⁵ Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2013, fq. 32. www.drejtësia.gov.al

³⁶ Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2012, fq. 32. www.drejtësia.gov.al

³⁷ Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2011, fq. 31. www.drejtësia.gov.al

³⁸ Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2011, fq. 32. www.drejtësia.gov.al

Vetë termi “akt seksual” falë gjerësisë semantiko-kulturore të lë hapësira për një interpretim të tillë.

Në fakt shprehja “Akt seksual” mund të marrë kuptime të ndryshme edhe në varësi të parametrave që përdoret (mjekësor, antropologjik – sociologjik, psikologjik) gjatë zbatimit gjyqësor të normativës. Kështu, nëqoftëse përdorim një parametër psikologjik, të llojit frojdian do të arrijmë në një kuptim të aktit seksual tejet të gjerë, të tillë që përfshin praktikisht çdo veprimtari njerëzor. Kjo mënyrë konceptimi vlerëson gjendjen e brendshme psikike të dëshirës seksuale të subjektit aktiv të veprës penale.

Në të kundërt, në qoftëse përdorim një parametër të pastër mjekësor do të kemi dhunë seksuale vetëm në rastet e akteve që i referohen seksit, referuar vetëm perspektivës të organeve gjenitale. Ndërsa parametri antropologjik – sociologjik përbën një rrugë të mesme krahasuar me dy parametrat e përmendur më lart pasi nga njëra anë eviton subjektivizmat e lidhur me parametrin psikologjik dhe nga ana tjetër kapërcen përfundimet tejet të ngushta të lidhura me parametrin mjekësor. Sipas parametrave që do të zgjidhet të përdoret do të arrihet në një mënyrë konceptimi subjektive apo objektive të aktit seksual³⁹. Parametri i dytë dhe i tretë theksojnë aspektet materiale të aktit seksual.

Sipas teorisë së të drejtës penale shqiptare por edhe asaj ndërkombëtare, si dhe jurisprudencës është arritur në përfundimin se “*me marrëdhënie seksuale kuptohet jo vetëm bashkim formal të dy personave, të sekseve të ndryshëm apo të njëjtë por, edhe çdo lloj akti, i cili edhe pse nuk ka lidhje të drejtëpërdrejtë me kontaktin fizik direkt me subjektin pasiv (viktimën) ka për qëllim dhe është i përshtatëshëm të vërë në rrezik të mirën parësore të individit, atë të lirisë seksuale, nëpërmjet eksitimit ose sadsifksionit të instiktit seksual të personit abuzues.*”

Në nocionin “akt seksual” përfshihen të gjitha ato akte të adresuara drejt zonave erogjene dhe që janë të përshtatshme për të cënuar apo kompromentuar vendosmërinë e lirë të seksualitetit të viktimës dhe që rezultojnë të afta për të hyrë në sferën seksuale të viktimës, me mjete që lidhen me shtrëngim, presion apo abuzim të kushteve të inferioritetit fizik apo psikik.

Në të gjitha këto raste do të përfshihen çdo lloj prekje, kapje, shtypje mbi zonat intime të të dëmtuarve, të ndjeshme dhe të afta për të shkaktuar ndjesi seksuale qoftë edhe në

³⁹ Në këtë drejtim mund të studjohet doktrina italiane ku ekzistojnë dy interpretime të aktit seksual. Kështu interpretimi objektiv mbrohet nga: Cadoppi A., *Commento all'art.3, në. Cadoppi A., Commentario delle norme contro la violenza sessuale e della legge contro la pedofilia*, Padova, 1999, fq. 48. Sipas këtij autori kemi të bëjmë me një akt seksual në rastin e një kontakti fizik midis një pjese çfarëdo të trupit të një personi me një zonë gjenitale (duke përfshirë gjirin e gruas), anale apo orale të partnerit. Në të njëjtin drejtim shiko edhe Mantovani F., *Diritto penale. I delitti contro la libertà e l'intangibilità sessuale, Appendice ai delitti contro la persona*, 1998, fq. 11 e vijuese. Cappai M., *Guida alle norme contro la violenza sessuale*, 1997, fq. 42 e vijues; Damini P., *Sulla nozione di atti sessuali ex art. 609 bis c.p.: nuova legge, vecchia giurisprudenza?*, në Ind.Pen., 1988, fq. 203.

Ndërsa interpretimi subjektiv mbrohet nga Marini G., *Delitti contro la persona*, II, Torino, 1997, fq. 296. Sipas këtij autori përbën një akt seksual çdo akt që ka një kuptim erotik, qoftë edhe vetëm në dimensionin subjektiv të raporteve subjekt aktiv/subjekt pasiv, me të vetmin kufi të domosdoshmërisë së dallimit midis akteve seksuale nga aktet e ngacmimeve seksuale. Mbrojtës të këtij interpretimi është edhe Antolisei F., *Manuale di diritto penale, Parte speciale – I*, nën përkujdesjen e Conti L., 1996, fq.165.

mënyrë jo të plotë dhe/ose për një periudhë kohore të shkurtër, duke qenë i parëndësishëm fakti nëse viktimë e ka arritur këtë kënaqësi erotike.⁴⁰

Megjithatë ekzistojnë doktrina që në termin “akt seksual” kuptojnë dhe veprime në vetvete neutralë që në planin ngushtësisht shkencor dhe objektiv dhe mund dhe nuk mund të futen në sferën e seksualitetit⁴¹. (sipas të cilit nuk është e domosdoshme që akti të ndodhë mes pjesëve të zhveshura të trupit, ose që të ketë lidhje me organet gjenitale ose që të ketë një farë shtrirje në kohë).

Koncepti “akt seksual” të con në mënyrë koherente në pranimin e faktit që përbëjnë marrëdhënie seksuale vetëm ato sjellje që karakterizohen nga një kontakt fizik i një pjesë cfarëdo të trupit të njërit prej partnerëve me një zonë gjenitale të partnerit tjetër (në konceptin bashkëkohor zonë gjenitale kuptohen si mamelet femërore, po ashtu dhe zona orale e anale). Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një objektivizim efektiv i konceptit, i cili bazohet sigurisht në planin seksual të pjesëve të trupit mbi të cilat ndikon sjellja antiligjore e subjektit aktiv.

Në legjislacionin tonë tashmë gjejnë mbrojtje edhe ngacmimet seksuale, të cilat janë të mbrojtura penalisht edhe në pjesën më të madhe të shteteve europiane e më gjerë (Francë, Itali, Zvicër etj.) Po të marrim në konsideratë faktin që një person mund të ngacmohet seksualisht (me puthje, përqafile, prekje etj.), por që qëllimi final i subjektit aktiv nuk është kryerja e marrëdhënieve seksuale me subjektin pasiv. Në rastin konkret nuk ndodhemi para veprave penale të parashikuara nga kodi ynë të mbetura në tentativë, pasi qëllimi i subjektit aktiv është të kryejë veprimet që ka kryer dhe jo të kryejë marrëdhënie seksuale.

2.4 Mënyra e realizimit të veprës penale.

Sfera seksuale nuk është e mirë e përgjithshme që i përket moralit kolektiv, por është një e drejtë personale e çdo individi, i cili e disponon sipas dëshirës së tij. E thënë në fjalë të tjera, sfera seksuale nuk është një vlerë publike, por është një vlerë individuale, e drejtë e personit për të vendosur lirisht në lidhje me seksualitetin e tij fizik, çënimi i të cilës përbën shkelje të të drejtave dhe dinjitetit të personit.

Veprat penale kundër sferës seksuale çenojnë lirinë personale e kuptuar si liri për të vetëvendosur në lidhje me aktivitetin seksual, por duke patur parasysh faktin që liria për vetëvendosje nuk mund të çenojë lirinë e subjektit tjetër për vetëvendosje në kryerjen e aktit seksual.

Në nocionin e aktit seksual nuk mund të futen të gjitha sjelljet që edhe pse manifestojnë instikte seksuale, nuk konkretizohen në një kontakt trupor mes subjektit aktiv dhe atij pasiv, ose e thënë ndryshe nuk prekin trupin e këtij të fundit, sic mund të përmendim aktet e autoerotizmit të bëra para një personi të tretë. Nga ana objektive

⁴⁰ Siç pohon Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë, në vendimin e saj datë 19.01.2010 dhe vendimin nr. 3, datë 12.01. 2010.

⁴¹ Shiko Cadoppi A., *Commentario delle norme contro la violenza sessuale e della legge contro la pedofilia*, cituar më lart.

kemi të bëjmë me akte që sjellin prekjen trupore seksuale të subjektit pasiv, dhe nuk duhet të jenë të limituara vetëm me organet gjenitale, por duhet të përmbledhin dhe pjesët e tjera të trupit të njeriut që në bazë të parametrave objektivë të përcaktuar nga shkencat e mjekësisë, psikologjisë, sociologjisë dhe antropologjisë përbëjnë zona erogjene. Nga ana subjektive veprimet e subjektit aktiv janë akte të motivuara nga qëllimi erotik, pavarësisht nëse subjekti aktiv e ka arritur apo jo kenaqësinë seksuale.

E drejta për vetëvendosje në sferën seksuale dhe mbrojtja e kësaj të drejte nuk është e lidhur drejtpërdrejtë dhe vetëm me mospranimin apo mungesën e konsensusit të subjektit pasiv, duke qenë e nevojshme që për të pasur cënim të të mirës juridike të mbrojtur nga legjislatiioni penal duhet që të kemi si element të domosdoshëm të anës objektive dhunën, qoftë kjo fizike, qoftë psikologjike qoftë dhe abuzimin me autoritetin nga ana e subjektit aktiv. Pra parashikimi ligjor, në rastet e krimeve seksuale, nuk mbron mospranimin ose mungesën e dëshirës së subjektit pasiv. Legjislatiioni shqiptar nuk ka ndjekur shembullin e shumë legjislatiioneve të shteteve evropiane si Franca, Belgjika, Anglia etj., ku për ekzistencën e figurës së veprës penale mjafton mungesa e konsensusit nga ana e subjektit pasiv. (sic et simpliciter). Legjislatiioni në vija të përgjithshme ka ndjekur shembullin e legjislatiionit Italian në hartimin e këtyre figurave të veprave penale.

Hap të rëndësishëm në këtë drejtim ka bërë legjislatiioni duke futur në parashikimet ligjore dhe mungesën e pëlqimit në rastet e marrëdhënieve seksuale mes bashkëshortëve ose bashkëjetuesve.

Mungesa nga ana e legjislatiionit të adoptimit gjerësisht të një modeli inkriminues që bazohet në mungesën e konsensusit nga ana e subjektit pasiv atëherë lind e nevojshme që mos t'i japësh një kuptim shumë të ngushtë konceptit “dhunë” në mënyrë që të mos shkaktohen “deficit” të rrezikshëm në mbrojtjen e subjektit pasiv, të cilit nuk duhet t'i imponohet një rezistencë e sproportionuar e parë kjo në lidhje të ngushtë me forcën fizike dhe situatën konkrete në të cilën ndodhet subjekti pasiv ku dhe si pasojë mund të rëndohet situata e tij dhe të rëndohet rreziku.

Është e qartë që një interpretim i tillë nuk duhet të të çojë në drejtimin që të anullovë tërësisht ekzistencën e dhunës fizike apo psikologjike dhe as të “matet” nëse subjekti pasiv po të këmbëngulte mund të rezistonte dhe ta evitonte.

Në legjislatiionin tonë këto vepra penale mund të kryhen vetëm me anën e shtrëngimit fizik apo psikologjik dhe nuk është e parashikuar sic ndodh në shumë legjislatiione të tjera mundësia e kryerjes së këtyre veprave penale me anë të mashtrimit (që nënkupton zëvendësimin me një person tjetër) apo kryerjen e marrëdhënieve seksuale me anë të befasisë.

2.5 Regjimi i ushtrimit të ndjekjes penale në krimet seksuale.

Në mbështetje të nenit 284/1 të K.Pr.Penale veprat penale të parashikuara nga nenet 102 paragrafi i parë⁴², 105⁴³ dhe 106⁴⁴ të K.Penal ndjekja penale mund të fillojë vetëm mbi ankimin e të dëmtuarit, i cili mund ta tërheqë atë në cdo fazë të procedimit.

Ankimi i të dëmtuarit tregon për një stad evolutiv të të drejtës më të avancuar, sepse nëpërmjet filtrit të ankimit personi i dëmtuar valorizohet dhe respektohet në mundësinë e tij për të vlerësuar peshën e dëmit të shkaktuar në krahasim me peshën e pasojave negative që mund të sillte për të një proces penal.

Por ankimi i të dëmtuarit mund të shihet dhe në një këndvështrim tjetër dhe pikërisht si një dobësim i mbrojtjes së të drejtave të personit⁴⁵. Në qoftë se në mënyrë të drejtë do të pranohet se marrëdhëniet seksuale me dhunë janë krime të rënda kundër personit rrjedh si pasojë dhe nevoja për të ushtruar ndjekjen penale kryesisht dhe jo mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit. Për këtë arsye legjislatori në pjesën më të madhe të këtyre veprave penale ka bërë zgjedhjen për të ushtruar ndjekjen penale kryesisht dhe jo mbi bazën e ankimit dhe kryesisht ushtrohet ndjekja penale për krimet seksuale ndaj të miturve, nën kërcënimin e armës, veprat e turpshme etj. Pra kjo zgjedhje e legjislatorit të bën të mendosh se është më e rëndësishme tutelimi i sferës seksuale dhe zhvillimi seksual të të miturit se mbrojtja e jetës së tij private.

Qëllimi i ushtrimit të ndjekjes penale me ankim në disa raste është ai që të ruajë moralin, nderin dhe gjendjen emocionale të personit të dëmtuar, por në fakt, në mënyrë indirekte, tenton të mbrojë bashkë me nderin e të dëmtuarit dhe dhunuesit; dhe në një farë mënyre i jep atyre “licensën” për të përdhunuar.

Këtu është e nevojshme një ndërhyrje ndëshkuese e Shtetit që është një mjet efikas për luftën kundër kriminalitetit.

Ndodh shumë shpesh që gra të përdhunara të ndodhura në kushte të thella dëshpërimi, humbjeje totale identiteti dhe frikë të vazhdueshme nuk bëjnë ankim. Ndoshta një regjim juridik për ushtrimin e ndjekjes penale kryesisht do të kishte forcuar pozitën e gruas dhe do të ishte një kontribut për kapërcimin e zakonit për të lënë gjithcka në heshtje prej frikës së një skandali. Sipas disa kërkimeve kriminologjike⁴⁶ janë konstante disa reagime psikologjike në viktimat e krimeve seksuale si terrori, ankthi, vetëfajësimi, depresion si dhe shumë pasoja të tjera që ndikojnë në stilin e jetës dhe raportet ndërpersonale të personit të dëmtuar.

Ndjekja penale e bazuar në ankimin e personit të dëmtuar thekson dhe një herë karakterin personal të sferës seksuale dhe që i përket vetëm fushës së lirive të individit

⁴² Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura.

⁴³ Marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale duke shpërdoruar detyrën.

⁴⁴ Marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari.

⁴⁵ Shiko Gazzetta G., “*Colpevole col consentire*”. *Dallo stupro alla violenza sessuale nella penalistica dell’ottocento*, në *Rivista Italiana di diritto e procedura penale*, 1997, fq.424.

⁴⁶ Shiko Menapace, *Dall’iniziativa legislativa popolare alle insufficienti risposte del Parlamento* në *QualeGiustizia*, 1985, fq. 37.

dhe për këtë arsye lihet dhe në dorën e të dëmtuarit të vendosë për ndjekjen apo jo penalisht të personit që i ka cënuar lirinë e tij seksuale.

Opsioni i zgjedhur për të ushtruar ndjekjen penale mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit është pasojë e një vlerësimi të ndryshëm që i bëhet vlerave të të mirës së tuteluar nga norma penale dhe personalitetit dhe lirisë personale të subjektit pasiv. Në këtë mënyrë i kushtohet një vëmendje më e madhe vullnetit të brendshëm të personit të dëmtuar nga vepra penale për të mos përballuar një proces penal dhe sidoqoftë për të mos ndjekur penalisht agresorin dhe nuk sakrifikohet ky vullnet për të patur një luftë sa më efikase ndaj kriminalitetit.

2.6 Kryerja e krimeve seksuale në bashkëpunim.

Bashkëpunimi është një mënyrë veçanërisht e rëndë në kryerjen e krimeve seksuale.

Në fakt kryerja e krimeve seksuale në bashkëpunim dhe përsa i përket subjektit aktiv dhe po të analizohet në lidhje me subjektin pasiv nxjerr në pah me qartësi ngarkesën e madhe ofensive që ka.

Përsa i përket subjekteve aktivë nuk mund të mos konsiderohet rrezikshmëria e veprimeve në bashkëpunim që theksohet nga fakti se bashkëpunimi sjell një zhvillim dhe zgjerim të kapacitetit kriminal të cdo subjekti në vecanti që në këto kushte ndjehen të përkrahur dhe të stimuluar si nga ana psikologjike po ashtu dhe nga ana materiale⁴⁷ dhe kjo vjen si pasojë nga ndërëgjegjësimi që po e kryen veprën penale me të tjerë dhe jo i vetëm dhe duhet të theksohet fakti që në rastet e bashkëpunimit subjektet aktivë nuk janë delinkuentë për seksualitet, por për agresivitet. Ata shpesh veprojnë për kënaqësi, kokëfortësi, aventurë, afirmim i sferës së tyre seksuale, aq sa viktima në shumë raste përfaqëson vetëm një nishan të rastësishëm, të cpersonalizuar dhe tërësisht kalimtar.

Në shumë raste bashkëpunimi i subjekteve aktivë, bashkimi i forcave dhe forcave të tyre është i destinuar të lehtësojë suksesin e veprimtarisë kriminale: forcat e një individi mund të jenë modeste dhe për të arritur një qëllim të caktuar mund të jetë e nevojshme apo thjesht më oportune bashkimi i energjive dhe mbështetjes së më shumë personave.

Nga ana tjetër është e pamohueshme që dëmi që i shkaktohet subjektit pasiv nga bashkëpunimi i subjekteve aktivë është absolutisht më i rëndë dhe ka një ndikim shumë më të madh si në sferën fizike po ashtu dhe në atë psikike të tij.

Bashkëpunimi i subjekteve aktivë jo vetëm që zvogëlon mundësitë e subjektit pasiv për t'u mbrojtur dhe për të rezistuar ndaj dhunës, por rrit dhe rrezikun për një dëm të përsëritur ndaj sferës dhe lirisë seksuale⁴⁸ (pra kryerja e marrëdhënieve seksuale nga më shumë se një person).

⁴⁷ Antolisei, *Manuale di diritto penale*, cituar më lart.

⁴⁸ Donini M., *Art. 9, në Commentario delle norme contro la violenza sessuale*, Padova, 1996.

Kërkimet kriminologjike evidentojnë që në kryerjen e krimeve seksuale në bashkëpunim, ndryshe nga ato individuale, zakonisht ka një “konvergjencë në vendim” dhe jo “përputhje” të “raptusit erotik”. Bashkëpunëtorët në shumicën e rasteve ndjekin një kult të dhunës së ushtruar ndaj subjektit pasiv me një shkallë turpërimi e zhvlerësimi shumë më të lartë për subjektin pasiv.

Veprimi i më shumë se një subjekti aktiv në bashkëpunim me njëri-tjetrin mund të jetë shkak për shkaktimin ndaj subjektit pasiv të më shumë dhimbje dhe dëme fizike nga “quantum” i dhunës që do të ishte i nevojshëm për arritjen e qëllimit të subjektit aktiv.

Dhe pikërisht për t’u mbrojtur specifikisht nga fakte kaq brutalë dhe në përpjekje për të “shëruar” sado pak të jetë e mundur një fenomen kaq të rëndë dhe të trishtueshëm, legjislatori ka parashikuar në pjesën më të madhe të krimeve seksuale në paragrafet e dyta të neneve kryerjen e veprave penale në bashkëpunim ku vendos dhe një sanksion më të rëndë për subjektet aktivë.

Bashkëpunimi nuk nënkupton që bashkëpunëtorët duhet të jenë të gjithë të pranishëm në vendin dhe momentin kur do të kryhet vepra penale. Bashkëpunimi në krimet seksuale konsiston në dhënien ndihmë reciprokisht të më shumë se një personi dhe pse akti seksual kryhet nga një person i vetëm.

Mund të diskutohet për faktin nëse do të quhet bashkëpunim cdo lloj ndihmese e nevojshme për kryerjen e veprës penale, apo cdo lloj ndihmese pa të cilën vepra penale nuk do të ishte kryer apo cdo lloj ndihmese e dhënë pa qenë e rëndësishme nëse ka shërbyer për kryerjen e veprës penale, kontributi “ex ante” i aftë të lehtësojë realizimin e veprës penale dhe pse “ex post” ka rezultuar i panevojshëm, apo cdo lloj ndihme që “ex post” ka rezultuar e nevojshme apo lehtësuese e favorizuese për kryerjen e veprës penale.

Nuk mund të përkrahet ideja e bashkëpunimit vetëm në dhënien e një ndihmese të nevojshme për kryerjen e veprës penale, sepse do të përjashtoheshin nga grupi i bashkëpunëtorëve një numër shumë i madh personash që kanë lehtësuar kryerjen e veprës penale apo favorizuar atë.

Gjithashtu është i dyshimtë disi dhe fakti që të quash bashkëpunëtor këdo person që kryen një veprim pa qenë i rëndësishëm për kryerjen e veprës penale, sepse kjo do të fuste në këtë kategori dhe persona që nuk kanë lidhje me veprën penale.

Duket versioni më i preferuar që të futen në kategorinë e bashkëpunëtorëve subjektet aktivë që janë të pranishëm në vendin dhe momentin e kryerjes së veprës penale, që japin ndihmesën e tyre ose në fazën parapërgatitore apo ekzekutive që sipas një gjykimi “ex post” konkretizohet me një kontribut të nevojshëm apo lehtësues e favorizues si në nivelin e pjesëmarrjes materiale po ashtu edhe morale.

Pra nuk është e rëndësishme që të gjithë bashkëpunëtorët të jenë të pranishëm në vendin dhe në momentin e kryerjes së veprës penale.

2.7 Krimet seksuale të mbetura në tentativë.

Neni 22 i Kodit penal përcakton se “*Vepra penale quhet e mbetur në tentativë kur, megjithëse personi ndërmerr veprime të drejtpërdrejta për ta kryer atë, vepra ndërpritet e nuk përfundohet për rrethana të pavarura nga vullneti i tij*”. Kjo dispozitë është një dispozitë e përgjithshme pasi ajo nuk përcakton veprën penale të cilës i referohet. Në këtë drejtim edhe krimet seksuale mund të mbeten në tentativë. Mund të flasim për tentativë kur sjellja e vënë në jetë nga *reo* nuk arrin të prodhojë pasojat e dëshiruara.

Gjykata e Kazacionit në Itali, duke ju referuar dhunës seksuale pohon se “*mund të flasim për dhunë seksuale të mbetur në tentativë kur, edhe pse në mungesë të kontaktit fizik midis të pandehurit dhe personit të fyer, sjellja e mbajtur nga i pari karakterizohet nga elementi subjektiv i qëllimit për të arritur përmbushjen e instikteve të tij seksuale dhe nga elementi objektiv të aftësisë për të dhunuar lirinë e vetëpërcaktimit të viktimës lidhur me sferën e saj seksuale*”⁴⁹.

Të gjitha figurat e krimeve seksuale të rregulluara në Kodin penal mund të mbeten në tentativë, edhe pse gjatë analizës së çështjeve të trajtuara nga gjykatat shqiptare ndeshemi shpesh me veprën e marrëdhënieve seksuale të mbetura në tentativë, kryesisht me të rritura. Fakti që këto çështje janë më të shpeshta nuk do të thotë se me të miturat nuk mund të kemi krim seksual të mbetur në tentativë.

Krimet seksuale të mbetura në tentativë me subjekt pasiv në moshë madhore janë më të shpeshta pasi ky i fundit ka pjekurinë e duhur për të vlerësuar situatën që po ndodh si dhe forcën fizike për të reaguuar. Në disa raste raste është pikërisht reagimi i viktimës që arrin të shmangë kryerjen e marrëdhënieve seksuale. Ndërsa viktimat e mitura nuk kanë as pjekurinë dhe as forcën fizike për të kundërvepruar në një rast ushtrimi dhune fizike. Pavarësisht rëndësisë së kundërveprimit të viktimës duhet të pohojmë se në shumë raste janë edhe faktorë të tjerë të cilët bëjnë që krimi të mbetet në tentativë.

Kështu në një rast të shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës⁵⁰, një zonjë ecën rrugës e qetë kur një person e tërheq nga pas dhe e shtrin në tokë. Ai i heq bluzën dhe më pas pantallonat duke tentuar të realizojë qëllimin e tij për të kryer marrëdhënie me zonjën. Zonja e kupton situatën dhe e tronditur fillon të bërtasë si dhe tenton të vetëmbrohet. Veprimet e kundërligjshme ndërpritën si rrjedhojë e vetëmbrojtjes nga ana e viktimës dhe si rrjedhojë e afrimit në vendngjarje të dy personave me motor të cilët ndjekin autorin. Autori largohet, por rikthehet sërish duke e ndjekur viktimën ditën e nesërme, pasi ai kërkon të realizojë qëllimin e tij. Nuk lejohet nga familjarët e viktimës dhe më konkretisht mamaja e viktimës i gjuan në kokë.

Nga dinamika e mësipërme del qartë në pah se subjekti aktiv, mashkull në moshë madhore, vepron me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar krimin e marrëdhënies seksuale me dhunë me të rritura duke përdorur dhunën fizike. Veprimet janë konkrete, të kundërligjshme dhe të drejtuara për kryerjen e veprës penale në fjalë.

⁴⁹ Gjykata e Kazacionit në Itali, v. penal, seksioni III, 23.5.2006 – 12.10.2006, n. 34128.

⁵⁰ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim nr. 11-2012-2579, datë 04-09-2012.

Në një rast tjetër tre persona hynë në një banesë duke shkelmuar derën e saj⁵¹. Si rrjedhojë e zhurmës zgjohet i zoti i shtëpisë bashkë me djalin dhe përballen me autorët e ngjarjes. Këta i fundit i godasin me binarë druri dhe më pas drejtohen nga dhoma e gjumit dhe tentojnë të kryejnë marrdhënie seksuale me dhunë më nënën dhe vajzën, (në moshë madhore). Njëri kap prej flokësh vajzën, hipën mbi trupin e saj, e godet, tenton ti shkyejë rrobat dhe të kryejë aktin seksual. Tjetri kryen veprime të ngjashme me nënën e vajzës. Të dyja femrat reagojnë duke i goditur autorët me grushta dhe shkelma, por këta të fundit prapësohen vetëm kur në ndihmë vinë i zoti i shtëpisë dhe djali i tij të cilët i kundërpërgjigjen dhunës me grushta dhe shkelma. Autorët largohen, por kërcënojnë të zotin e shtëpisë se po folën ata do i vrasin. Në këtë rast krimi seksual tentohet të kryhet në bashkëpunim. Situata paraqitet e rëndë pasi shoqërohet edhe me dhunimin e banesës dhe rrezikimin e shëndetit të banorëve të tjerë. Autorët janë në moshë madhore. Veprimet e tyre janë konkrete, të drejtuara për realizimin e veprës penale dhe të shoqëruara me dhunë fizike dhe psikologjike. Dhuna fizike evidentohet në të gjitha veprimet e kryera nga autorët dhe drejtohet ndaj të gjithë banorëve të familjes. Dhuna psikologjike lidhet me moskallzimin e krimin. Dashja është e drejtpërdrejtë.

Në një rast të shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Korçë⁵² subjekti pasiv është femër në moshë madhore e cila ishte e punësuar si kamarierë në një lokal i cili frekuentohej edhe nga subjekti aktiv i veprës penale që është mashkull në moshë madhore. Ky i fundit e ka pritur viktimën jashtë lokalit duke e futur me dhunë në makinë (i ndihmuar nga një shok i tij i cili ngiste makinën) dhe duke kryer veprime të dhunshme ndaj saj me qëllim shmangien e refuzimit për kryerjen e marrëdhënieve seksuale. E dëmtuara ka arritur të hapë derën e makinës në lëvizje dhe të hidhet në një kanal buzë rrugës, por subjekti aktiv e ka hipur sërish në sediljen e prapme të makinës duke e dërguar në një hotel dhe duke ushtruar sërish dhunë me qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale jashtë dëshirës së saj. E dëmtuara e ka qëlluar atë me një tavëll duhani dhe është larguar. Subjekti aktiv ka rënë në tokë dhe nuk është ngritur. Në rast se e dëmtuara nuk do të ishte kundërpërgjigjur përmes goditjes me tavull, subjekti aktiv do të kishte realizuar qëllimin e tij i cili del qartë në pah nga e gjithë dinamika e mësipërme. Dashja e përdorur është e drejtpërdrejtë për të kryer krimin e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura. Nga ana objektive vepra është kryer me veprime aktive, të kundërligjshme dhe të drejtuara për të kryer krimin, siç u përshkruan më lart.

2.8 Aspekte krimnologjike të krimeve seksuale.

2.8.1 Hyrje.

Krimet seksuale përbëjnë një fenomen aq të vjetër sa dhe vetë shoqëria. Ato ekzistojnë pothuajse në të gjitha shoqëritë e zhvilluara dhe jo, duke përfshirë subjekte të moshave dhe gjinive të ndryshme. Në shoqëritë më pak të zhvilluara ky fenomen

⁵¹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim nr. 11-2012-7928, datë 16-04-2012.

⁵² Për më gjatë shiko: Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, Nr.00-2010-1200 i Vendimit (842), datë 22.09.2010 i cili le në fuqi vendimin nr.81, datë 06.06.2008, Gjykata e Apelit Korçë (ky i fundit vendos lënien në fuqi të vendimit nr.55, datë 13.02.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.)

është më pak publik si rrjedhojë e mentalitetit shoqëror që atë e shoqëron dhe përcmimit të femrës viktimë të veprës seksuale.

Mund të pohojnë se veprat penale seksuale në një farë mënyre përbëjnë një sëmundje sociale. Pavarësisht faktit se ekzistojnë dallime dhe se shtete të ndryshme i kanë dhënë zgjidhje të ndryshme ligjore këtyre fenomeneve, duhet të pohojmë se në përgjithësi krimet seksuale dënohen në të gjitha vendet e zhvilluara.

Rregullimi ligjor i krimeve seksuale bën të mundur vendosjen e rregullit në shoqëri, dënimin e fajtorëve dhe parandalimin e këtyre figurave krimi. Më lart u analizua mënyra e rregullimit të krimeve seksuale në Shqipëri duke nisur nga e drejta zakonore e duke përfunduar me ndryshimet e fundit në Kodin Penal shqiptar.

Ndërsa, në paragrafet vijuese, do të analizohen disa aspekte kriminologjike të krimeve seksuale. Analiza bëhet dhe duke patur parasysh faktin se Shqipëria ka shënuar edhe një prirje progresive të këtyre veprave në dekadat e fundit. Dhe kjo përbën një aspekt jo pak shqetësues për çdo qytetar.

Përsa i përket nënfushës së veçantë të krimeve seksuale analiza duhet nisur nga autori i krimit seksual pasi krimi seksual ndodh vetëm si pasojë e sjelljes së këtij të fundit. Në këndvështrimin kriminologjik, pyetjet e para që na vinë ndër mendje janë disa si: Cilat janë karakteristikat e autorit të një krimi seksual? Një njeri lind kriminel apo është ambjenti social që e shndërron në të tillë? Nëse po, cilët janë faktorët që shtojnë një rrezik të tillë? Autori i një veprë penale vuan nga probleme mendore dhe nëse po, cilat janë ato?

2.8.2 Kategoritë e krimeve seksuale.

Bazuar në parashikimet e Kodit Penal shqiptar mund të themi se krimet seksuale mund t'i kategorizojmë në katër kategori. Në kategorinë e parë do të mbështetemi mbi gjininë e autorit dhe atë të viktimës dhe në këtë drejtim vëmë re që mund të kemi: krime seksuale të kryer nga femra mbi viktima meshkuj, krime seksuale të kryer nga meshkuj mbi viktima meshkuj; krime seksuale të kryer nga meshkuj mbi viktima femra dhe krime seksuale të kryer nga femra mbi viktima femra.

Duhet të theksohet se pjesa dërrmuese e krimeve seksuale në praktikë, siç evidentohet dhe nga rastet e analizuara në këtë punim, ka të bëjë me autorë meshkuj dhe viktima femra. Statistika të sakta janë të vështira, pasi një pjesë e konsiderueshme e krimeve seksuale nuk kallzohen.

Sipas Studimit ndërkombëtar të Viktimave të Krimin të kryer në Shqipëri në vitin 1997⁵³ niveli i raportit të krimeve seksuale ishte shumë i ulët në Shqipëri (17.1% e viktimave raportin krimin në polici). Vrojtimet kombëtare të mëvonshme të kryera nga në rajon, përfshirë edhe Shqipërinë⁵⁴ si dhe studimet kombëtare për dhunën në familje dhe ndaj grave të kryera në 2009⁵⁵ dhe 2013⁵⁶ tregojnë se niveli i raportit të krimeve

⁵³ Hysi, V.,: *International Crime Victims Survey in Tirana, Albania, 1996*, botuar në "The International Crime Victims Survey in Countries in Transition, national reports", UNICRI, Publication no.62, Romë 1998, f. 1-39.

⁵⁴ Nikolić-Ristanović, V., & Dokmanović, M.,: *International Standards on Domestic Violence and Their Implementation in Western Balkans*, Belgrade, HOM, 2006.

⁵⁵ Dr. Robin N. Haarr, *Dhuna në familje në Shqipëri, raport kombëtar mbi bazë popullatën, 2009*, UNDP. Ky raport gjenden në faqen zyrtare të UNDP me adresë:

seksuale vazhdon të jetë i ulët. Studimi European për statistikat e krimit dhe sistemin e drejtësisë penale (2014)⁵⁷ tregon se tendencat e krimeve të raportuara në polici janë në nivele të ulta, krahasuar me shumë vende europiane, ndërkohë që raportimi e veprave penale në sferën seksuale është problem shqetësues edhe në vende të tjera të Europës.

Në kategorinë e dytë do të mbështetemi mbi marrëdhënien midis autorit dhe viktimës dhe në këtë drejtim do të ndajmë në krime seksuale brenda familjes dhe jashtë saj, në varësi të faktit nëse autori është anëtar i familjes apo kujdestar i viktimës. Nëse autori është anëtar i familjes atëherë do kemi të bëjmë me “inçestin” ku rasti më i shpeshtë është inçesti midis atit dhe bijës. Autori mund të jetë dhe nëna, vëllai, motra apo një i afërm më i largët. Autori mund të jetë edhe kujdestari i fëmijës. Ky i fundit mund të mos ketë lidhje gjaku me viktimën, por legjislatori e konsideron po aq të rëndë këtë rast sa dhe inçestin pasi kujdestari është personi që kujdeset, mëson, edukon, rrit viktimën dhe si i tillë është personi që duhet të shërbejë si shembull për të. Përsa i takon krimeve seksuale jashtë familjes ato janë të shumëllojshme duke inkuadruar situata të ndryshme dhe autorë të ndryshëm për të cilat do të flasim më tej gjatë këtij studimi.

Në kategorinë e tretë do të mbështetemi mbi moshën dhe gjendjen psiko - fizike të viktimës dhe në këtë drejtim do të ndajmë në: krime seksuale me të rritur, krime seksuale me të mitur dhe krime seksuale me persona të paafte nga ana psiko – fizike. Krimet seksuale me persona madhorë marrin disa forma të cilat do të analizohen më tej. Të një problematike të veçantë shfaqen marrëdhëniet seksuale me të mitur nën moshën 14 vjeçare apo të pazotë fizikisht ose mendërisht apo të pandërgjegjshëm për aktin që kryhet. Këto lloj krimesh janë problematike edhe për vetë rëndësinë që merr viktima pasi në të gjitha rastet bëhet fjalë për një subjekt që nuk është në gjendje për të kuptuar atë që po i ndodh si dhe i paafte të mbrohet nga autori.

Në lidhje me krimet seksuale me të miturit duhet theksuar se rreziku i të qënurit viktimë ka varësi nga raca, kultura dhe statusi social-ekonomik. Fëmijët e abuzuar kanë një mungesë themelore të besimit të tjerët dhe një tendencë për të kuptuar sjelljen e të tjerëve si armiqtë dhe kërcënues. Reagimet tipike të tyre moshatarëve dhe të rriturve që u afrojnë me abuzuesit.

Fjala Pedofili si term rrjedh nga greqishtja *παις*, *παιδός* (fëmijës) dhe *φιλία* (miqësi, dhembshuri), dhe tregon pasionin erotik në lidhje me fëmijët dhe të miturit. Në psikiatri Pedofilia është e kategorizuar në grupin e paraphilias, ose si çrregullim i dëshirës seksuale, që konsiston në preferenca erotike nga ana e një subjekti që ka

<http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Domestic%20Violence%20in%20Albania%20-%20National%20Survey.pdf>

⁵⁶ Dr. Robin N. Haarr, Dhuna në familje në Shqipëri, raport kombëtar mbi bazë popullatën, 2013. raport gjenden në faqen zyrtare të INSTAT me adresë. http://www.instat.gov.al/media/225812/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf

⁵⁷ Marcelo F. Aebi, Galma Akdeniz, Gordon Barclay, Claudia Campistol, Stefano Caneppele, Beata Gruszczynska, Stefan Harrendorf, Markku Heiskanen, Vasilika Hysi, Jörg-Martin Jehle, Anniina Jokinen, Annie Kensey, Martin Killias, Chris G. Lewis, Ernesto Savona, Paul Smit, Rannveig Þórisdóttir: *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics 2014*, Fifth edition, HEUNI, 2014, f.40-43. Botimi gjendet në internet në adresën:

http://www.heuni.fi/material/attachments/heuni/reports/qrmEoCVTF/HEUNI_report_80_European_Soourcebook.pdf

arritur pjekurinë seksuale me një tjetër që nuk nuk e ka arritur ende atë dhe është në moshën pre - puberale.

2.8.3 Sjellja kriminale e autorit të veprës penale.

Veprimtaritë seksuale midis njerëzve kanë të bëjnë me mënyrën sesi qeniet njerëzore përjetojnë dhe shprehin seksualitetin e tyre. Njerëzit janë të lindur me një potencial të caktuar për shprehjen seksuale, por ky potencial mund të realizohet në një larmi mënyrash. Në të vërtetë, në shoqëritë seksualisht represive ai mund të mbetet pjesërisht ose plotësisht i perealizuar.

Njerëzit angazhohen në një shumëllojshmëri të akteve seksuale kohë pas kohe. Veprimtaria seksuale përfshin sjelljen dhe aktivitetet të cilat kanë për qëllim që të ngjallin interesin seksual të një individi tjetër, të tilla si strategjitë për të gjetur apo për të tërhequr partnerët. Këto veprimtari takohen me interesin seksual ose jo të palës tjetër. Ky interes shprehet përmes vullnetit apo dakortësimit të palës tjetër për të kryer veprimtaritë seksuale në të cilat e fton pala e parë. Në disa raste ky interes mungon apo nuk është i njëjtë me atë të palës që e fton. Nëse pavarësisht mungesës së vullnetit të palës së dytë, pala e parë vazhdon në qëllimin e saj, përmes përdorimit të dhunës fizike apo psikike, atëherë realizohet një krim me natyrë seksuale.

Në disa raste legjislatori nuk e kërkon shprehjen e konsensusit nga pala e dytë dhe krimi seksual realizohet edhe në prani të këtij konsensusi. Kështu në rastin e fëmijëve në moshën nën 14 – vjeçare. Në lidhje me sjelljen kriminale në fjalë, një fakt i pakontestueshëm është që sjellja e autorit është gjithmonë e qëllimshme⁵⁸.

Një pyetje a parë që vjen në mendje është: Përse një individ kryen një krim seksual? A ka faktorë që ndikojnë në shkaktimin e këtij krimi?

Shkaqet se pse një individ kryen një krim të tillë janë të shumta dhe disa prej tyre do i analizojmë më tej. Ndërsa në lidhje me faktorët që ndikojnë në shkaktimin e krimit mund të themi që, edhe pse nuk janë faktorë determinues, ekzistojnë disa faktorë që janë më të favorshëm për të çuar një individ të kryejë një krim sesa faktorë të tjerë. Këta faktorë janë: ambjenti social, një defekt fizik i autorit, një defekt mendor, pasiguria emocionale e autorit, një mjedis social që atë e rrethon si një lagje e varfër, arsimimi i dobët i tij, varfëria ekstreme, përpjekje për të kënaqur nevojën për të kryer marrëdhënie seksuale apo për të kënaqur nevojën për t'u ndjerë dominues apo sepse dikush tjetër e ka shtyrë të kryejë krimin kundrejt shpërblimit apo sepse dëshiron ta bëjë viktimën që të vuajë si dhe arsye të tjera si dhe të tjera.

Duhet theksuar se shpesh shkaku identifikohet në dëshirën e autorit për të kënaqur dëshirat seksuale. Kjo mund të identifikohet edhe si arsyeja që i ka shtyrë të gjithë autorët, në rastet e trajtuara nga Gjykatat Shqiptare dhe të analizuara në këtë punim. Vetëm në rastin e të fejuarit të cilin e fejuara kërkon ta lërë dhe si rrjedhojë ky i fundit e rrëmben dhe më pas kryen marrëdhënie me të mund të identifikojmë një motivacion tjetër. Në këtë rast autori nuk do të lërë të fejuarën që të largohet nga ai. Evidentohet dëshira e autorit për ta pasur të tijën viktimën.

Të gjithë faktorët që u përmendëm, siç vihet re, i referohen autorit të veprës penale duke evidentuar faktin që shkaktar i një krimi seksual është vetëm ky i fundit.

Më lart u përmend termi “sjellje kriminale e autorit”. Me këtë term do të kuptojmë mënyrën në të cilën një individ kryen krimin seksual. Duhet të kemi parasysh se krimi

⁵⁸ Shiko Cornish, D., and Clarke, R., *The Reasoning Criminal. Rational Choice Perspectives on Offending*. New York, NY: Springer-Verlag, 1986.

mund t'i drejtohet një apo më shumë subjekteve të mitur ose një apo më shumë subjekteve në moshë madhore. Kështu në lidhje me rastin kur kjo sjellje drejtohet ndaj të miturve Kaufman, Hilliker dhe Daleiden e përcaktojnë *modus operandi të autorit/autorëve* si "modelin e sjelljeve që ky/këta shfaqin në periudhat para, gjatë dhe pas kontaktit seksual"⁵⁹.

Mënyra e kryerjes së krimit seksual ndryshon në çdo vepër penale. Ajo është e kushtëzuar nga faktorë të ndryshëm ku ndër të parët rradhitet inteligjenca dhe aftësitë e autorit. Sjellja kriminale kushtëzohet edhe nga viktimja, mosha e saj, aftësia e saj për t'i bërë ballë dhunës së ushtruar nga autori. Rezistenca e viktimës influencon vendimet e autorit dhe ndërveprimin autor – viktimë e veprës penale⁶⁰.

Sipas një studimi kërkimor⁶¹ mbi sjelljet e autorëve gjatë kryerjes së një krimi me natyrë seksuale ndaj fëmijëve, një autor para kryerjes së krimit gjendet para një seri zgjedhjesh.

Së pari, ai duhet të zgjedhë vendin ku do të kryejë krimin, që do të jetë një vend ku, ai ka të ngjarë të hasi në një viktimë potenciale.

Së dyti, ai duhet të zgjedhë kohën më të përshtatshme për të kryer krimin.

Pas këtyre vendimeve, vjen zgjedhja e viktimës. Kjo zgjedhje ndikohet nga shumë faktorë si mosha, gjinia dhe karakteristikat fizike apo dhe njohja e autorit me viktimë si dhe të tjera.

Së fundi, shkelësi duhet të vendosë mënyrën si ai do të afrohet viktimës. Por më e rëndësishmja, ky studim sugjeron se strategjitë e zbatuara nga autorët janë të ndikuara shpesh dhe nga faktorë të situatës.

Gjithashtu është vënë re se sa më e lartë distanca që autorët përshkojnë për të gjetur një viktimë të mundshme, aq më i lartë ka qenë dhe niveli i dhunës së përdorur për të kryer krimin.

2.8.3.1 Strategjia e vetjustifikimit moral të sjelljes kriminale.

Krimi seksual nuk është një fakt që lë të paprekur nga ana psikologjike edhe vetë autorin. Nuk mund të lëmë pa përmendur faktin se çdo krim seksual dënohet nga ambjenti social dhe në këtë drejtim autori nuk mundet mos ta njohë këtë opinion dhe të mos përballet me të. Sipas studjuesve kjo përballje nuk është e lehtë.

Autori për të kryer krimin seksual duhet të krijojë kushtet psikologjike që e lejojnë të veprojnë në kundërshtim me kodin e tij moral, por në të njëjtën kohë ai nuk abdikon totalisht nga ky i fundit.

Në studimin e përmendur më lart, i cili i referohet autorëve të krimit seksual të marrëdhënive seksuale me të mitur, por që natyrisht i përshtatet edhe autorëve të tjerë, theksohet se autori arrin të prodhojë në nivel konjitiv një lloj leve të moralit e cila i lejon të neutralizojë senset e fajit dhe turpit nga shoqëria në nivelin e duhur për të mbajtur të paprekur vetëvlerësimin e tij.

⁵⁹ Kaufman, K. L., Hilliker, D. R. and Daleiden, E. L. (1996). *Subgroup differences in the modus operandi of adolescent sexual offenders*. *Child Maltreatment*, 1, fq.18.

⁶⁰ Në këtë drejtim shiko Tedeschi T. J., Felson R. B., *Violence, Aggression, and Coercive Actions Hardcover* në *Journal of contemporary criminal justice*, Volume 12, no.3, 1996

⁶¹ Shiko Proulx, J., Ouimet, M. and Lachaine, N. *Criminologie de l'acte et pédophilie* në *Revue Internationale de Criminologie et de Police Technique*, 1995.

Studimi i referohet disa mekanizmave psikologjikë të cilët janë në gjendje të çaktivizojnë në mënyrë selektive kontrollin moral dhe të favorizojnë apo lejojnë kryerjen e veprimeve me matricë antisociale⁶².

Mekanizmat kryesorë janë:

1. Mohimi i pasojave të veprimit/ sjelljes duke i justifikuar ato si psh: “*unë i mësoj fëmijëve seksualitetin dhe në thelb nuk bëj asgjë të keqe*”;
2. Shpërndarja e përgjegjësisë si psh: “*janë shumë dhe nuk jam unë i vetmi që bëj këto gjëra*”.
3. Veshja e fajit viktimës si psh: “*fajin e ka viktimja pasi kishte veshur një fund aq të shkurtër duke më shtyrë të ngacmoja seksualisht*”.
4. Përkufizimi i fakteve me fjalë të ëmbla të cilat i ndryshojnë kuptimin si psh: “*unë i dhuroj fëmijëve dashuri, nuk abuzoj me to*”. Ky mekanizëm është i pranishëm në rastin e marrëdhënieve seksuale me të mitur të kryera nga shtetasit anglezë në fondacionin “Fëmijët e tij” dhe të analizuar në kreun vijues.
5. Autori mendon se fëmijët kanë aftësinë për të kuptuar rëndësinë e një raporti seksual njëlloj sikur të ishin të rritur. (ky mekanizëm i zbatohet vetëm autorëve të krimeve seksuale me fëmijë të moshës nën 14 vjeçare)

Kuptohet lehtësisht se prania e këtyre mekanizmave është një faktor që dëshmon për rrezikshmërinë e autorit⁶³.

2.8.4 Një analizë e autorit të krimit seksual.

Sigmund Freud pohon *se njeriu ka instikte agresive dhe pasione primitive që çojnë tek përdhunimi, tek inçesti, tek vrasja... këto instikte frenohen, shpesh në mënyrë jo perfekte nga Institucionet shtetërore*⁶⁴ dhe nga *senset e fajit*.

Studimi i autorëve të krimeve seksuale do të ishte shumë i lehtë nëse do të ekzistonin përgjigje gjithpërfshirëse për pyetjet e që u bënë me lart apo pyetje të tjera të ngjashme.

E vërteta qëndron që nuk mundemi të grupojmë autorët në kategori të caktuara. Kjo sepse secili autor është i ndryshëm në natyrën dhe *modus operandi*⁶⁵. Kjo konfirmohet edhe nga analiza e vendimeve të gjykatave shqiptare të trajtuara në këtë punim. Vëmë re që autorët kanë moshë të ndryshme dhe mënyra të ndryshme të kryerjes së veprës penale.

⁶² Në këtë drejtim shiko dhe Bandura A. (1986): *Social foundations of thought and action: A social cognitive theory*. Prentice - Hall, Englewood Cliffs, NJ.

⁶³ Bruzzone R., *Il profilo criminologico del pedofilo..* Artikull i botuar në numrin 3 të Revistës ALTEREGO – Maj 2007, www.accademiascienzefforensi.it

⁶⁴ Freud S.), *Tre saggi sulla teoria sessuale*, Boringhieri, Torino, 1905.

⁶⁵ Siç u përmend dhe më lart *modus operandi* është e ndryshme në vepra të ndryshme penale. Për më gjatë shiko dhe Kröber, H.L. (2009), *Sexualstraftäter – Klinisches Erscheinungsbild*. Në Kröber H.L., Dölling D., Leygraf, N., Sass H. (Hrsg.), *Kriminologie und forensische Psychiatrie*, Band 4, Steinkopff Verlag, Darmstadt, fq. 420-457.

Një studim me karakter psikologjik mbi autorët e krimeve seksuale tregon se për autorin opinion dominues është që ai është një njeri pa ndërgjegje, i cili nuk shqetësohet për mirëqenien e të tjerëve dhe se nga ana tjetër ai është shumë i shqetësuar që të realizojë dëshirat dhe nevojat e tij, pavarësisht nga pasojat.

Ky lloj përshkrimi është i vërtetë nëse i referohemi momentit në të cilën ai kryen krimin e tij, por dhe do të ishte një gabim i madh nëse mendojmë që ky përshkrim i përket të gjithë personalitetit të autorit.

Autori shpesh fsheh një sërë ngjarjesh të përjetuara, (të cilat na ndihmojnë të kuptojmë përshkrimin e mësipërm) një sërë dyshimesh mbi vlerat që ai si individ përfaqëson, dështime në fusha të rëndësishme, tentativa për të mohuar vetveten si dhe tension të brendshëm siuate që e çojnë të shpërthejë në aktin kriminal.

Studimi pohon se është e vështirë për t'u gjetur një grup njerzish më të ndjeshëm ndaj mendimeve të të tjerëve. Edhe pse tingëllon paradoksale, është e vërtetë, se këta njerëz edhe gjatë kryerjes së krimeve në fjalë, po përpiqen të jetojnë ideale të larta dhe të largojnë sa më shumë bindjen e dëshpëruar se ata kurrë nuk vlejnë si meshkuj. Për ta të gjitha kanalet e zakonshme për fitimin e respektit për vetëvehten duken të mbyllyra ndërkohë që kryerja e krimin seksual paraqitet për ta si një rrugë e mundur.

Analiza psikike e autorëve të krimeve seksuale gjithmonë tregon me qartësi një tipar të përbashkët të personalitetit për ta. Ata kanë një përbuzje të madhe për veten e tyre si burra. Në të gjitha fushat e rëndësishme të jetës, në veprimtari shoqërore, në dashuri, në punë, ata e shohin veten të dështuar apo në mënyrë të pashmangshme të destinuar për të dështuar. Është pikërisht përpjekja për të treguar se ata nuk janë as inferiorë dhe as të neveritshëm, që i bën të vënë në jetë krimin seksual. Nëse ato dështojnë, ky dështim nuk bën gjë tjetër përveçse shton bindjen e brendshme të paafësisë. Këta individë kanë një nevojë të madhe për vlerësim, respekt dhe dashuri nga ana e të tjerëve, sepse përmes këtyre ata mundin deri diku bindjen e brendshme që ata nuk vlejnë për asgjë.

Studimi pohon se autori është njeri psiqikisht i sëmurë⁶⁶ dhe se e vetmja metodë për të ulur numrin e krimeve seksuale është të kuptuarit e motiveve psikiatrike që qëndrojnë prapa veprës penale.

Një tjetër doktrinë në fushë⁶⁷ identifikon katër lloje autorësh të marrëdhënieve seksuale me dhunë. Lloji i parë identifikohet me autorin që e kryen krimin për arsye kompensimi. Bëhet fjalë për një subjekt agresiv, me pak kompetenca sociale, me një nivel të ulët vetëvlerësimi. Ka një sërë deviancash seksuale. Ky subjekt përmes marrëdhënies seksuale me dhunë tenton të zgjidhë problemet e vetëvlerësimit. Ai e njeh veten si një nulitet dhe dominimi i një personi e bën të ndjehet i rëndësishëm. Niveli i dhunës së përdorur nga ai është i ulët dhe koïncidon me dhunën që i nevojitet për të nënshtruar viktimën.

Lloji i dytë identifikohet si autori prej inatit.

⁶⁶ Kjo lloj analize i referohet Roth N., *Factors in the Motivation of Sexual Offenders*, në *Journal of Criminal Law and Criminology*, Volumi 42, Numri 5 janar – shkurt, Neni 5, Winter 1952.

⁶⁷ Shiko Holmes R., and Holmes S., *Profiling violent criminals*, Thousands Oaks, CA, Sage, 1996.

Autori i dytë ndryshon nga i pari pasi bëhet fjalë për një subjekt me shumë kompetenca sociale dhe i dhunshëm. Dhuna e ushtruar nis me forma të lehta, por mund të shkojë deri të vrasja, bazuar në sasinë e inatit që subjekti mban brenda dhe që do të nxjerrë jashtë. Pra dhuna seksuale vjen si nevojë e manifestimit të inatit të subjektit.

Lloji i tretë është një subjekt që përmes dhunës shpreh pushtetin e tij. Ky subjekt ndjehet superior dhe ushqen bindjen se dhuna seksuale është një e drejtë natyrore e mashkullit kundrejt femrës.

Ndërsa lloji i katërt paraqet subjektin më të rrezikshëm dhe identifikohet me dhunuesin sadist. Ai përmes dhunës bën reletet fantazitë e tij seksuale. Ky subjekt dëshiron që të ushtrojë dhunë mbi viktimën dhe ta shohë atë të vuajtë. Zakonisht këto subjekte vuajnë nga probleme personaliteti dhe nuk janë sociale.

2.8.4.1 C'rregullimet me natyrë seksuale të autorit të krimit seksual.

“Orientimi seksual” është një term që shpesh përdoret për të përshkruar tërheqjen romantike, emocionale apo seksuale të një personi ndaj një personi tjetër. Orientimi seksual është një koncept relativisht i ri.

Orientimi seksual është i ndryshëm nga identiteti gjinor, i cili i referohet ndjesive të brendshme që tregojnë se dikush është mashkull apo femër. Individët që tërhiqen nga persona të seksit të kundërt kanë orientim heteroseksual. Dikush që tërhiqet nga dikush tjetër i të njëjtit seks ka orientim homoseksual dhe individët që tërhiqen nga persona të të dy seksve kanë orientim biseksual.

Qëniet njerëzore nuk mund të zgjedhin për të qenë homoseksualë, heteroseksualë apo biseksualë. Orientimi seksual ka shumë gjasa të jetë rezultat i bashkëveprimit të një kompleksiteti faktorësh rrethues, njohës dhe biologjikë, gjenetikë ose hormonal të lindur. Asnjë shkak psikosocial ose prej dinamikave familjare nuk mund të identifikohet, duke përfshirë këtu historitë e abuzimeve seksuale në fëmijëri si shkak formues i orientimit seksual.

Një pyetje e cila lind shpesh kur bëhet fjalë për autorët e krimeve seksuale është nëse ata janë të sëmurë nga ana mendore?

A kanë ata ç'rregullime me natyrë seksuale?

Këto pyetje i lindin edhe qytetarit të thjeshtë pasi përmes saj ai tregon çudinë sesi mund të ketë njerëz të shëndoshë nga ana mendore të cilët janë në gjendje të kryejnë krime të kësaj natyre.

Përgjigja në shumë raste është: Po. Tek autori i krimit seksual mund të shfaqen shqetësime psikike të cilat njihen me emrin “parafili” apo “perversitete seksuale”. Këto e shtyjnë autorin të kryejë krimin në fjalë.

Sjellja jo normale që vë në jetë autori mund të konsiderohet përmes tre parametrave⁶⁸:

- 1) kriteri mjekësor – biologjik i cili konsideron çrregullimet si parafilite;
- 2) kriteri sociologjik që konsideron devijuese sjelljet që bien në kundërshtim me kostumin social dhe kulturor;
- 3) kriteri juridik që konsideron si krime sjelljet seksuale të përcaktuara nga ligji penal dhe të analizuar më tej në këtë punim.

Duke ju referuar kriterit mjekësor theksojmë se parafilia në mënyrë që të cilësohet si perversitet seksual duhet të zgjasë për të paktën gjashtë muaj, të shfaqet si formë e vetme apo dominuese e seksualitetit dhe të shkaktojë vuajtje klinike domethënëse apo dëmtim në fushat sociale e profesionale. Ajo mund të shfaqet në tetë forma kryesore si më poshtë:

- Eksibicionizmi - mani për t'u dukur;
- Fetishizmi - mani për t'u eksituar nga përdorimi i objekteve të pajetë;
- Frotteurizmi - mania për t'u prekur apo fërkuar kundër dëshirës me të tjerët;
- Pedofili - Impulse dhe aktivitete seksuale ndaj fëmijëve;
- Mazohizmi – marrje e kënaqësisë seksuale nëpërmjet dhimbjes e poshtërimit;
- Sadizmi - marrje e kënaqësisë seksuale nëpërmjet dhimbjes e poshtërimit të tjerëve;
- Fetishizmi tranvestit - marrje kënaqësie duke veshur rroba të seksit tjetër;
- Vuajerizmi- marrin kënaqësi duke parë aktet seksuale të të tjerëve;

Sipas kërkimeve klinike sjellja jo normale mund të vlerësohet nga një papjekuri afektive dhe nga një identifikim deficiantar si dhe nga një paaftësi e autorit për të instauruar marrëdhënie ndërpersonale në mënyrë normale.

Midis shqetësimeve mendore që mund të çojnë në krime seksuale, shumë studime tregojnë se përveç shqetësimeve të lidhura me psikopatinë dhe pamjaftueshmërinë mendore, ka një përbërës të rëndësishëm skizofrenie.

Pikërisht ky është dhe shqetësimi i konsideruar më i rëndi dhe i karakterizuar nga ç'organizimi i mendimit dhe i sjelljes, me humor jo të përshtatshëm, i cili mund të prodhojë një alterim të sferës afektive të subjektit dhe mund të çojë atë të kryejë akte të dhunshme dhe agresive⁶⁹.

2.8.4.2 Autori i krimit seksual – viktimë e krimit seksual në fëmijëri.

Një numër i madh fëmijësh gjatë fëmijërisë së tyre janë viktima të krimeve seksuale. Një studim i vit 2012⁷⁰ pohon se ky numër arrin deri në 30%, përqindje kjo tepër e lartë dhe shqetësuese.

⁶⁸ Pajardi D., , *Oltre a sorvegliare e punire*, collana di: Prospettive di psicologia giuridica, 2008, Giuffrè Editore, fq. 210..

⁶⁹ Shiko po aty.

⁷⁰ Ogloff J. RP., Cutajar M. C., Mann E., and Mullen P., *Child sexual abuse and subsequent offending and victimisation: A 45 year follow-up study, Trends & issues in crime and criminal justice*, No. 440 June 2012, Australia.

Edhe pse studimi i referohet krimeve seksuale në Australi, ai paraqet interes për ne, për vetë rezultatet në të cilat arrin. Ky studim analizon faktin që shumë nga autorët e krimeve seksuale janë viktime të krimeve me natyrë seksuale në fëmijëri.

Kështu duke patur si kampion një numër prej 2,759⁷¹ viktimash të krimeve seksuale, me të cilët është abuzuar seksualisht në vitet 1964 - 1995, rezultati në të cilin arrihet është fakti që ekziston një probabilitet që këto viktime më pas në jetë të kthehen në autorë të krimeve seksuale. Ky probabilitet është pesë herë më i lartë sesa në rastin e fëmijëve të cilët nuk janë abuzuar seksualisht asnjëherë. Të gjitha rastet e marra në analizë lidheshin me kontakte të tipit seksual ku 63 % përmbanin raste penetrimi të viktimave, ku 64.9% të viktimave janë të gjinisë femërore dhe 35.1% janë të gjinisë mashkullore.

Studimi i referohet të dhënave të mbledhura për një periudhë që varion nga 13.97 deri në 44.77 vite. Pikërisht numri i lartë i rasteve të analizuara dhe periudha e gjatë kohore e bëjnë këtë studim mjaft interesant.

Studimi vë në dukje se një numër i lartë femrash të cilat janë autore të krimeve seksuale (75 %) në të vërtetë kanë përjetuar krime seksuale në fëmijëri (viktime).

Rezulton gjithashtu se autorët e krimeve seksuale të gjinisë femërore rezultojnë të jenë viktime të krimeve seksuale, në një përqindje më të lartë krahasuar me autorët femra të veprave të tjera penale apo autorëve meshkuj të krimeve seksuale⁷². Të paktën ¼ e atyre që janë viktime të krimeve seksuale janë autorë veprash të ndryshme penale, ku spikasin krimet seksuale. Midis tyre ka patur dhe katër të dënuar për vrasje. Pra, duket se është një hipotezë me e besueshme ajo e "abuzuesit të abuzuar". Sipas saj viktime, një herë i rritur, riprodhon dhunën në të njëjtën mënyrë me atë që ka vuajtur.

Duket në një farë mënyre sikur këta individë janë duke vepruar seksualisht dhe në mënyrë agresive për të reduktuar efektet post-traumatike (si impotencë, mungesës së stimës për veten, mungesën e besimit të tjeret, frikën e vazhdueshme nga ndonje rrezik etj) të shkaktuar nga abuzimi seksual që kanë pësuar në fëmijëri.

2.9 Analizë e disa problemeve që evidentohen në lidhje me krimet seksuale.

Disa nga krimet seksuale janë më të përhapura dhe më problematike se të tjerat. Kështu, marrëdhënia seksuale me dhunë me të rriturat/rriturit apo dhe me të miturit⁷³. Këto lloj marrëdhënies njihen ndryshe dhe me fjalën "përdhunime" dhe të tilla ka praktikisht në të gjitha shoqëritë e sotme, edhe në shtetet ku nuk ekzistojnë shifra zyrtare.

⁷¹ Ky kampion përbëhet nga 2,201 femra (79.8%) dhe 558 meshkuj (20.2%).

⁷² Për më gjatë në këtë drejtim shiko dhe Fromuth M & Conn V., *Hidden perpetrators. Sexual molestation in a nonclinical sample of college Women në. Journal of Interpersonal Violence* 12,1997; Kaplan M. and Green A., *Incarcerated female sexual offenders: A comparison of sexual histories with eleven female nonsexual offenders. Sexual Abuse: A Journal of Research and Treatment* 7: 1995; Mathews R., Hunter J. and Vuz J. *Juvenile female sexual offenders: Clinical characteristics and treatment issues. Sexual Abuse: A Journal of Research and Treatment* 9: 1997.

⁷³ Neni 102 i Kodit penal.

Në bazë të raporteve të Kombeve të Bashkuara, përdhunimet janë më të shpeshta në vendet e mëposhtme: Afganistan, Guyana, Kamboxhia, Kolombi, Mozambik, Nepal, Pakistan, Peru, Filipine, Sllovaki, Svaziland, Tajvan, Trinidad dhe Tobago, Uganda dhe në Zaire. Në Gjermani, El Salvador, Mikronezi, Irlandë, Kenia, Peru, Cejlon, Suedi dhe Taxhikistan vërehet një rritje e numrit të përdhunimeve kohët e fundit. Vetëm në Mauritani, Laos, Gjeorgji dhe Tunizi, përdhunimet duket se janë më të rralla. Përmasat e vërteta të përdhunimit nuk kuptohen, sepse shifrat e fshehura janë shumë të larta.

Në shumë vende, frika nga përdhunimi përcakton jetën e përditshme të shumë njerëzve, vecanërisht të grave. Ato e kufizojnë hapësirën e tyre të veprimit dhe të lëvizjes dhe kërkojnë mbrojtjen e një burri.

Përdhunimi është një formë e seksualizuar e ushtrimit të pushtetit dhe kontrollit dhe jo vetëm kënaqje e instiktit seksual. Ai është i rrënjësor në shoqëritë patriarkale. Kështu, skena përdhunimesh gjenden qysh në mitet e krijimit dhe legendat. Përdhunimi shërben për t'i përrulur apo për t'i trembur gratë. Në shumicën e rasteve, autorët nuk vuajnë nga çrregullime psikike abnormale. Qëllimi është depersonalizimi i viktimës, duke e reduktuar atë vetëm në seksin e saj. Për këtë arsye, përdhunimet janë psikikisht shumë më të rënda se sjelljet e tjera agresive.

Lidhur me konceptin e dhunës së ushtruar i cili përbën elementin kryesor të veprës penale dhe, kur viktima nuk mund të tregojë prova të shenjave të dhunës, krimi, në fjalë, nuk mund të provohet.

Dhuna është elementi kryesor i figurës së veprës penale dhe kërkon medoemos kundërshtimin e të dëmtuarës. Dhuna fizike përbën formën më të rëndë të dhunës. Ajo shprehet nëpërmjet rrahjes ose plagosjes duke shkaktuar çenime anatomike ose funksionale të organizmit të të dëmtuarës, si: mavijosje, plagë, ndjenjë dhimjeje, humbje të vetëdijes etj. Karakteristikat e dëmtimeve dhe lokalizimi i tyre ndryshon në lidhje me marrëdhëniet seksuale të kryera nga një i pandehur nga ato me një grup të pandehurish. Në rastin e parë ka dëmtime brerëse të zakonshme (plagë, mavijosje, gërvishtje etj). Kur është fjala për një marrëdhënie seksuale në grup të kryer nga dy të pandehur ose më shumë, dëmtimet shkaktohen sidomos nga mbajtja e katër gjymtyrëve. Dhunimet fizike, si shenja karakteristike të veprimit të dhunës seksuale, konstatohen në $\frac{3}{4}$ e rasteve të përdhunimeve.

Përveç dhunës fizike jurisprudenca pranon edhe dhunën psikologjike. Gjithsesi, dhuna psikologjike është pranuar si provë vetëm në rastet kur ka kanosje serioze për vrasje ose plagosje të rëndë. Dhuna psikologjike që shprehet me anën e kanosjes, zakonisht i paraprin dhunës fizike. Në rrethanat e këtij krimi në pjesën më të madhe të viktimave në plan të parë qëndrojnë trauma akute psikike (veçanërisht gjendja e stresit para traumës) e shoqëruar me një ndjenjë ankthi e frike, si dhe rënie emocionale. Në rastet kur dhuna psikologjike paraprin dhunën fizike, kjo e fundit do të shfaqet si një dhunë fizike minimale⁷⁴. Kanosja nuk përfshin përdorimin e armëve të zjarrit, që përbën një

⁷⁴ Intervistë mbi Krimet seksuale, një tjetër plagë e shoqërisë sonë, nga eksperti mjeko-ligjor Admir Sinamati <http://shendeti.com.al/krimet-seksuale-nje-tjeter-plage-e-shoqerise-sone/>. Eksperti tregon se në një rast një vajzë 20-vjeçare, në orët e mesditës u takua rastësisht me një të njohurin e saj dhe me propozimin e tij shkuan te shtëpia e këtij të fundit për të marrë një libër që ai ia kishte premtuar. Në mirëbesim vajza pranoi të futet brenda në shtëpi, ku i pandehuri e tërhoqi me forcë në një dhomë, e

figurë tjetër krimi (neni 104). Dhuna psikologjike është tepër e vështirë të provohet dhe shpesh i lë autorët të pandëshkuar.

Sic u përmend më lart, vepra penale konsiderohet e mbetur në tentativë, nëse subjekti i veprës nuk e mposht viktimën.

Problematike paraqiten dhe pasojat e përdhunimit. Mund të përmendim faktin se shumë e rëndë për viktimën është jeta me përdhunimin. Në shumë raste gratë nuk mund të presin as ndihmën e familjes, miqve apo të njohurve, sepse shpesh te viktima kërkohet bashkëfajësia, ndërsa autori lehtësohet. Këto mendime nuk janë të përhapura jo vetëm në shoqëri, por shumë shpesh dhe në rradhët e policisë e më gjerë. Nëse përdhunimet denoncohen, iu kushtohet pak vëmendje. Nëse jepet dënimi, autorët marrin dënime të lehta. Madje vetë procesi gjyqësor është shpesh një tjetër traumatizim për viktimën. Nëse gruaja jeton në një ambient social, në të cilin virgjëria e vajzës së pamartuar është shumë e rëndësishme, viktima mund edhe të keqtrajtohet apo të vritet.

Një problem tjetër me karakter social lidhet me mënyrën e konceptimit të krimeve seksuale nga shoqëria shqiptare. Kështu, përdhunimi megjithëse nga ana ligjore shihet gjithnjë si cënim i integritetit seksual dhe personal të të dëmtuarës/it, nga shoqëria shihet si sulm ndaj zakoneve dhe moralit. Dhe e vërteta është që i kushtohet më shumë vëmendje marrjes nëpër gojë të viktimës, sesa sjelljes së keqbërësit.

Referuar përdhunimit, mund të përmendim tre teori psikologjike mbi sjelljen e autorit.

E para është e ashtëquajtura *teori feministe*⁷⁵, sipas së cilës përdhunimi nuk motivohet thjesht nga një dëshirë erotike, por nga një dëshirë për të kontrolluar, dominuar dhe përrulur viktimën karshi autorit mashkull. Kjo teori i referohet rasteve kur autori është i gjinisë mashkullore ndërsa viktima është e gjinisë femërore. Ndërkohë nuk pohon asgjë për rastet e tjera dhe si e tillë konsiderohet e paplotë.

Teoria e dytë që përmendim është ajo e nxënies sociale⁷⁶ sipas së cilës përdhunimi konsiderohet që i ka rrënjët në një traditë represive karshi femrës. Autori ka mësuar të silllet sipas një modeli që e bën atë më pak të ndjeshëm ndaj pasojave të dëmshme dhe që e lidh dhunën me kënaqësinë seksuale. Ky është një model i cili i përket shoqërive patriarkale të së shkuarës dhe që me evoluimin e shoqërisë njerëzore nuk mund të konsiderohet më si aktual.

shtriu në një divan dhe pas një përleshje me vajzën që kundërshtonte, arriti të kryente bashkimin seksual. Pas denoncimit të bërë, policia ndaloi të pandehurin dhe prokuroria filloi hetimin e rastit. Gjatë ekzaminimit të të dëmtuarës u konstatuan disa ekimoza të rrumbullakta në krahun e majtë si dhe shumë gërvishtje dhe dërmishtje në pjesët e brendshme të kofshëve dhe gjunjëve. Nga ana tjetër, u bë edhe ekzaminimi i të pandehurit, ku në faqen e majtë të fytyrës u dalluan dy gërvishtje. I ndodhur përpara këtyre provave, i pandehuri pranoi fajësinë e tij.

⁷⁵ Kjo teori mbrohet nga Brownmiller S., *Against our will. Men, women dhe rape*. Ballantine Publishing group, 1975.

⁷⁶ Mbrohet nga Malamuth M., *Rape proclivity among males*, në *Journal of social issues*, volume 57, no. 4, 1981.

Teoria e tretë ajo e evolucionit⁷⁷, që është dhe më e reja në terma kohore, referon që dhuna seksuale është një faktor thuajse gjenetik, një impuls mashkullor për të fekunduar sa më shumë gra. Edhe kjo teori i referohet rasteve të autorit të gjinisë mashkullore dhe viktimës së gjinisë femërore⁷⁸.

Edhe pse nuk i referohet në mënyrë direkte përdhunimit, në mbrojtjen e grave dhe të vajzave (të rritura), ndihmon edhe dispozita 105 e Kodit Penal, e cila ndalon marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën. Kjo figurë karakterizohet nga subjekte që kanë cilësi të posaçme, marrëdhënien e varësisë ose të detyrës me viktimën. Dënimi i parashikuar për këtë veprë shkon deri në tre vjet burgim. Ky nen përbën një dispozitë tipike që parashikon dhe dënon abuzimet seksuale të personave që përdorin dhe shpërdorjnë detyrën. Raportet e varësisë presupozohen në marrëdhëniet e punëdhënësit me punëmarrësin, por edhe lidhje të tipit të tillë, si mësues - nxënës. Viktima e këtij krimi mund të jetë edhe person i mitur, mjaft që ka mbushur moshën 14 vjeç dhe ka arritur pjekurinë seksuale. Edhe pse duket një dispozitë mjaft efikase, në praktikë përdoret rrallë, pasi në këto raste denoncimet kanë qenë të pakta. Më të pakta kanë qenë rastet e paraqitura si çështje në gjykata⁷⁹.

Gratë përbëjnë shumicën e viktimave të dhunës seksuale. Ato kanë barrën e provës në rastin kur abuzimi seksual ndodh. Gjithsesi, provat mblidhen përmes një raporti mjekësor dhe shpesh nuk bëhen hetime të menjëhershme tërësore. Ekspertimi mjeko - ligjor duhet bërë sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse vonesa në këtë drejtim e vështirëson shumë hetimin e çështjes.

Lidhur me këtë figurë krimi duhet të evidentojmë se abuzimet seksuale për shkak të shpërdorimit të varësisë ose të detyrës mbeten shpesh të heshtura dhe të padenoncuar. Ndërkohë, pozita zyrtare shpërdorohet edhe në rastet kur nuk ka ndonjë varësi të drejtpërdrejtë.

Një problematikë tjetër që duhet vënë në dukje është çështja e dëmshpërblimit përmes padisë civile në procesin penal përgjithësisht vazhdon të mos ketë vëmendjen e duhur. Kjo kërkon angazhim të madh, mjete financiare për të paguar një avokat, pasi edhe pse legjislacioni procedural e parashikon diçka të tillë, gjyqtarët nuk pranojnë shqyrtimin e padisë civile brenda procesit penal.

Duhet nënvizuar se krimi seksual ndryshe nga ngjarjet e tjera traumatike, ka karakteristika të veçanta pasi është një ngjarje që përfshin anën e seksualitetit të personave në fjalë, pra anën më intime të tyre. Këto lloj krimesh kur kryhen brenda familjes, përbëjnë një traumë që përmbys tabute socio-morale të familjes .

⁷⁷ Mbrohet nga Symons D., *The evolution of human sexuality*, Oxford University Press, 1979

⁷⁸ Proietti G., *Lo stupratore*, www.psicolinea.it; "La componente aggressiva insita nella che caratterizzano lo stupro", në Rivista. Sess, Cic. N. 28.

⁷⁹ Nga vjetari statistikor i vitit 2003 rezulton se janë denoncuar 19 vepra penale për marrëdhënie seksuale me dhunë me të rritura. Janë shqyrtuar nga gjykata 12 çështje gjyqësore me këtë objekt dhe janë dënuar gjithsej 20 persona si subjekte të kësaj veprë. Nuk ka asnjë denoncim, asnjë çështje dhe asnjë të dënuar për veprën penale të parashikuar nga neni 105 i KP, marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën.

Dhe së fundmi nuk mund të lëmë pa analizuar disa probleme psikologjike që i shkaktohen viktimës. Në këtë drejtim është e lehtë të pohohet se të gjitha krimet seksuale mund të krijojnë shumë probleme psikologjike dhe për këtë arsye themi se krimi seksual është një "faktor me rrisht jo të specifikuar" ndaj çrregullimeve të ndryshme psikologjike.

Në çdo rast, ajo që duket e sigurtë është se krijimi i këtyre problemeve varet nga disa faktorë të tillë si: moshë në kohën e abuzimit, kohëzgjatja e abuzimit, prania ose mungesa e depërimit, përdorimi i qartë i dhunës, karakteristikat e personalitetit të personit të abuzuar, prania në kohën e abuzimit e problemeve të tjera psikologjike, aftësia për të ndarë problemin me dikë, mbështetja psikologjike e sociale e marre më vonë, etj.

Krimi seksual duhet të konsiderohet kryesisht si një përvojë traumatike. Kjo pasi ai mund të gjenerojë simptoma të tilla si një çrregullim i vërtetë i stresit posttraumatik. Në këtë mënyrë, përvojat e vuajtura, në formën e imazheve, emocioneve, ndjenjave fizike, fjalëve, tingujve, aromave, shijeve, ankthit, mund të kthehen shpesh në mendjen e personit të abuzuar, së bashku me emocione të forta shqetësuese, të tilla si depresioni, ankthi, frika, nervozizmi, panik apo inati. Tek fëmijët kujtimet e atyre çfarë kanë ndodhur përsëriten në format më të këqija të tyre.

Zakonisht personi i cili ka qenë i abuzuar seksualisht përpiqet për të mbajtur distancë ndaj kujtimeve traumatike. Në disa raste, madje, është e mundur që, të paktën në moment të caktuar të jetës, personi i abuzuar ka amnezi të pjesshme për ngjarjet apo kujtimet apo edhe të ngatërruara. Në raste të konsiderueshme, kujtimet e abuzimit gradualisht humbasin pjesërisht pamjen dramatike që i dallon ato, duke u bërë më lehtësisht të menaxhueshme nga individi. Nëse kjo është sigurisht një avantazh, nga ana tjetër ajo mund të jetë edhe një rrezik potencial, pasi që personi i abuzuar mund të ambientohet duke jetuar me problemet e shkaktuara nga abuzimi, për të mos ndarë me askënd problemin dhe për të mos e luftuar atë. Në disa raste, kjo gjendje mund të marrë plotësisht formën e një çrregullimi të stresit posttraumatik.

Në lidhjet më pasojat e krimit seksual tek viktimë shpesh kjo e fundit mund të humbasë besimin tek njerëzit. Kur abuzimi seksual është kryer brenda ambientit të familjes dhe sidomos, kur abuzimi është kryer nga prindërit apo personat të cilët duhet të kryejnë këtë funksion, personi i abuzuar zakonisht e përjeton këtë si një plagë të thellë për shkak se ka pësuar abuzimin nga personi i cili ka për detyrë krejtësisht të kundërtën. Shpesh ata mund të mendojnë se, nëse janë tradhëtuar nga familjarët më të afërt atëherë nuk mund të besojnë më tek askush tjetër.

Gjithashtu, në lidhje me vlerësimin për veten, nënvizojmë se një person rritet edhe ndihet mirë në një mjedis të shëndetshëm, kur ai mendon se ai ka një vlerë. Në rastin e viktimës së abuzimit seksual ka zakonisht një prani të një vetëbesimi të ulët, të ndjerit për të mos qenë i denjë për arsye të asaj që i ka ndodhur.

Në lidhje me seksualitetin e viktimës, krimet seksuale shpesh prodhojnë probleme seksuale të natyrave të ndryshme. Kështu, përveç problemeve më tipike seksuale si vështirësi ose paaftësi për të kryer marrëdhënie seksuale, mungesë të ndjesive të pëlqyeshme e të këndshme, viktimë mund të vuajë edhe nga ndjesia e fajit dhe e të qenit i padenjë apo mungesa e pjesshme ose totale e dëshirës etj mund të çojnë gjithashtu në imoralitet seksual të viktimës.

Viktima mund të vuajë nga probleme psikosomatike si çrregullime me të ushqyerit, abuzim me alkoolin, ilacet dhe narkotikët, mosbesim, vështirësi në menaxhimin e zemërimit dhe distanca ndaj njerëzve etj. Problemet e ankthit dhe depresionit janë të zakonshme dhe mund të lindin qe nga fëmijëria, duke u bërë pjesë e individit, i cili tashmë beson se nuk mund të bëhet ndryshe.

KAPITULLI III

ANALIZË E DETAJUAR E KRIMEVE SEKSUALE NË SHQIPËRI.

3.1 Hyrje.

Në këtë kre do të analizohen figurat e ndryshme të krimeve seksuale të rregulluara nga legjislatori shqiptar në Seksionin e Krimeve Seksuale në Kodin Penal, nga neni 100 deri në nenin 108/a të tij.

Analiza do të bazohet jo vetëm mbi tekstin e dispozitave dhe doktrinën në fushë, por edhe mbi vendime të ndryshme gjyqësore.

3.2 Marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale me të mitur.

Seksioni i Krimeve Seksuale në Kodin Penal hapet me nenin 100⁸⁰, i cili dënon marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale të kryera me fëmijë të mitur nën moshën 14 vjeçare apo me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale.

Kjo dispozitë parashikon një figurë krimi që paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe që ka një përhapje mjaft të gjerë. Normativa shqiptare gjen mbështetje në Konventën e OKB-së për të drejtat e fëmijëve⁸¹.

Në Kodin Penal kjo figurë krimi ka pësuar ndryshime me ligjin nr. 8377/2001⁸². Aktualisht, Kodi Penal parashikon si vepër penale marrëdhëniet seksuale, homoseksuale, si dhe çdo akt tjetër seksual me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën 14 vjeç, ose me fëmijën e mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, vepër për të cilën kur kryhet me dhunë, ose sjell si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur, zbatohet një dënim më i rëndë se në paragrafin e parë të nenin 100.

Praktika gjyqësore tregon se dënimet e dhëna fillimisht kanë qenë tepër të ulta dhe vetëm kur përmasat e këtij krimi u bënë shqetësuese për shoqërinë, gjykata rriti në mënyrë të ndjeshme masën e dënimit.

⁸⁰Neni 100 -“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur që nuk kanë arritur moshën 14 vjeç, ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale dënohet me burgim nga 7 gjer në 15 vjet. Kur marrëdhënia seksuale apo homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se 25 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur, dënohet me burgim jo më pak se 30 vjet ose me burgim të përjetshëm.”

⁸¹ Konventa është miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara më datë 20.11.1989. Kjo Konventë mjaft e rëndësishme është nënshkruar nga të gjitha vendet e Europës Perëndimore, mes tyre edhe Shqipëria, që në vitin 1992.

⁸² www.qpz.gov.al

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë seksuale, jetën dhe shëndetin si dhe zhvillimin normal seksual të fëmijës së mitur apo të të miturës që nuk ka arritur pjekurinë seksuale⁸³.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive me kryerjen e marrëdhënieve seksuale midis sekseve të ndryshme apo homoseksuale midis të njëjtit seks, por subjektet pasivë janë fëmijë të mitur nën moshën 14 vjeç apo që nuk kanë arritur pjekurinë seksuale.

Subjekt aktiv mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndërsa subjekti pasiv është çdo fëmijë i mitur nën moshën 14 vjeç apo që nuk ka arritur pjekurinë seksuale.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim. Në këto raste elementi subjektiv i dashjes identifikohet edhe në të paturit dijeni të faktit se, e dëmtuara është nën moshën 14 vjeç dhe pavarësisht këtij fakti autori kryen marrëdhënie me viktimën. Por, edhe nëse zhvillimi fizik i të dëmtuarës, i analizuar në harmoni me rrethanat e tjera në të cilat ka lindur dhe është zhvilluar njohja mes autorit të veprës penale dhe të dëmtuarës, mund të ngrejë dyshimin se, e dëmtuara nuk e ka mbushur moshën 14 vjeç, autori i veprës penale është i detyruar të informohet për moshën e të dëmtuarës. Marrja e informacionit mund të bëhet me mjete dhe nga persona të ndryshëm por, së paku autori i vepës penale është i detyruar të pyesë vetë të dëmtuarën (ose të dëmtuarin) për moshën e kësaj të fundit. Ky detyrim buron nga neni 4 në lidhje me nenin 100/1 të KP, sipas të cilëve shtetasit nuk mund të pretendojnë përjashtimin nga përgjegjësia penale pasi, nuk janë njohur me ligjin, përveç kur mosnjohja është për shkaqe objektive⁸⁴. Motivet subjektive dhe qëllimi i kësaj vepre penale nuk kanë rëndësi për kualifikimin ligjor të veprës por, mbahen parasysh nga Gjykata në individualizimin e masës dhe llojit të dënimit.

Gjithashtu në të njëjtën dispozitë, në paragrafin e dytë dhe të tretë, parashikohen dhe rrethanat e cilësuar në të cilat kryhet vepra penale sic janë bashkëpunimi, kryerja e krimit më shumë se një herë, kryerja e krimit duke përdorur dhunën, pasojat e rënda për shëndetin dhe kur vjen si pasojë vdekja apo vetëvrasja e personit të paaftë gjë që sjell dhe një masë dënimi më të rëndë për autorin e kësaj vepre penale.

Në Shqipëri problemi i marrëdhënieve seksuale me fëmijë të mitur ka marrë përmasa shqetësuese, sidomos vitet e fundit. Megjithëse është bërë një problem shoqëror, nuk është arritur të përcaktohet se cila është gjendja reale, numri i fëmijëve të dëmtuar, ndërkohë që ka të dhëna që ky fenomen është jo pak i përhapur.

Dua të nënvizoj se zgjedhja ligjore e bërë nga legjislatori përsa i përket mënyrës së rregullimit të marrëdhënieve seksuale apo homoseksuale me të mitur përbën padyshim formën më të mirë të tutelës së të miturit.

⁸³ Në vendimin e Gjykatës së Tiranës nr. 922, datë 18.06.2010 “për kryerjen e veprës penale të “Marrëdhënies seksuale me të mitura”, parashikuar nga neni 100/1 i K.Penal pohohet se “Ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të fëmijëve të mitur të moshës nën katërmëdhjetë vjeç. Cënimi i kësaj marrëdhënieje nga shtetasit, përbën krim dhe passjell përgjegjësi penale”.

⁸⁴ Për këtë analizë referoju vendimit të Gjykatës së Tiranës, nr.922, date 06.2010.

Hy pohim vjen bazuar në faktin se një i mitur nën moshën 14 vjeçare nuk e ka vetëdijen dhe kapacitetin e nevojshëm për të menaxhuar seksualitetin e tij. Pikërisht nga kjo mungesë vetëdijeje lind për legjislatorin nevoja për mbrojtje të sferës seksuale të të miturit dhe në rastet kur marrëdhëniet seksuale janë kryer me konsensusin e tij⁸⁵.

Duhet nënvizuar që, tanimë me zhvillimet e shoqërisë, jo vetëm asaj shqiptare, të miturit janë “emancipuar” në të gjitha fushat e jetës dhe si rrjedhojë dhe në fushën e marrëdhënieve seksuale. Megjithatë duhen patur parasysh dy rrethana të rëndësishme :

- a) që i mituri, në një moshë kaq të vogël, nuk është në gjendje të kuptojë drejt pasojat pozitive dhe negative të një marrëdhënie seksuale (qofshin këto fizike apo psikike);
- b) që, në anën tjetër, kjo është një zgjedhje legjislative e cila vjen si rezultat i një konsensusi të personave madhorë i finalizuar për mbrojtjen e vetë të miturve.

Të miturit nga vetë ineksperiencia e tyre natyrale janë lehtësisht të influencueshëm nga të rriturit që në disa raste përfundojnë duke i përdorur ato sipas dëshirave të tyre. Për këtë arsye ligji dënon subjektin aktiv, i cili dhe pse me konsensusin e subjektit pasiv, kryen marrëdhënie seksuale apo homoseksuale me një të mitur. Në këtë mënyrë amplifikohen mundësitë për të arritur finalizimin e mbrojtjes absolute të të miturit ndaj çdo lloj ndërhyrjeje në sferën e tij seksuale.

Kjo normë ligjore garanton pozicionin e të miturit dhe pozicionohet në mbrojtje të zhvillimit të personalitetit seksual të tij⁸⁶. Nëse e pranojmë këtë fakt atëherë jemi duke njohur edhe “seksualitetin” si një e drejtë dhe liri individuale e çdo subjekti⁸⁷. Kryerja e marrëdhënieve seksuale me të mitur konsiderohet “tabu” për këdo dhe të miturit nuk i njihet asnjë e drejtë “për shprehjen e lirisë dhe cilësive të tij seksuale”.

Siç konfirmohet nga kërkesa e dhunës si element i nevojshëm në marrëdhëniet me të mitur të moshës 14 – 18 vjeçare, të rregulluara nga neni 101 i KP, legjislatori përcakton mbushjen e moshës 14 vjeçare si kufiri penal midis ligjshmërisë dhe paligjshmërisë në kryerjen e marrëdhënieve seksuale me apo midis të miturve.

Kjo ndodh pasi nuk mundet që ligji të ndërhyjë në mënyrë të pandërprerë në jetën dhe personalitetin seksual të të miturit. Në këtë mënyrë do të mohohet normaliteti i seksualitetit dhe do të ndërfaqej një formë traumatizimi.

Kjo formë vepre penale (marrëdhëniet seksuale me të mitur deri në moshën 14 vjeçare) paraqet një model rreziku abstrakt në sensin që gjykimi mbi ekzistencën e

⁸⁵ Ky orientim bazohet dhe në faktin e paaftësisë së plotë të të miturit për të dhënë një konsensus të vlefshëm.

⁸⁶ Për një orientim të afërt mund të shikohet dhe neni 176 i Kodit penal gjerman mbi abuzimin seksual me të mitur. Objekti i mbrojtjes së dispozitës identifikohet me mbrojtjen e zhvillimit normal seksual në mënyrë që të evitohen shtrembërime të tij. Për më gjatë të shikohet: Lenckner T., në Schonke A., – Schroder H., *Strafgesetzbuch Kommentar*, XXII ediz., Munchen, 1985, fq.1138.

⁸⁷ Mbi këtë argument të shikohet: Fiandaca G., “*Buon costume. III) Moralita’ pubblica e buon costume*” – *diritto. Pen.*, në Enciclopedia giuridica, Roma, 1988. Fq. 3; Padovani T., *Violenza carnale e tutela della liberta’*, në Rivista italiana di dir. Proc.pen., 1989, fq. 1307.

rrezikshmërisë formulohet *a priori* nga ana e legjislatorit. Kjo është një veprë penale që bazohet mbi një supozim absolut paprekshmërie të të miturit nën moshën 14 vjeçare. Nga kjo paprekshmëri i mituri del në momentin që mbush moshën 14 vjeçare dhe pikërisht në këtë moment ai bëhet titullar i të drejtës për lirinë seksuale⁸⁸.

Për këtë arsye ligji nuk ndalon marrëdhëniet seksuale të të miturit mbi moshën 14 vjeç dhe që kanë arritur pjekurinë seksuale, mjafton që të jenë eksperiencia seksuale normale dhe formative. Marrëdhënie seksuale normale dhe formative mund të quhen ato marrëdhënie seksuale që kryhen në një moshë të caktuar midis bashkëmoshatarëve.

Paprekshmëria e të miturit nën moshën 14 vjeçare është mbrojtur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në vendimin e saj nr. 922/2010. Në rastin konkret bëhej fjalë për një vajzë të mitur të moshës 13 vjeçare e cila ishte larguar nga shtëpia pasi kishte probleme me nënën. Në një nga ditët e largimit ajo ka fjetur me autorin duke kryer me të marrëdhënie seksuale. Pas kthimit në shtëpi ajo e ka kallzuar krimin. Fillimisht ajo ka pohur se autori, subjekt aktiv në moshë madhore dhe i shëndoshë mendërisht, ka kryer me viktimën marrëdhënie seksuale me dhunë. Më pas, para Gjykatës viktima e ka ndryshuar versionin e saj duke pohuar se marrëdhëniet midis tyre janë kryer pa dhunë nga ana e autorit. Nga ana objektive, krimi në rastin në fjalë, është kryer nga autori me veprime aktive, të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme. Nga ana subjektive këto veprime janë kryer me dashje edhe pse autori ka deklaruar se ai nuk ishte në dijeni të moshës së viktimit. Edhe vetë viktima ka pohuar se autori nuk kishte dijeni për moshën e saj.

Përse e deklaroi autori këtë fakt? Autori është në dijeni të faktit se nëse viktima është mbi moshën 14 vjeçare marrëdhënia seksuale e kryer midis tyre me konsensus do të ishte e ligjshme. Por në rastin konkret, bazuar në aktin e ekspertimit, ka rezultuar se të dhënat fiziko - biologjike të viktimit përputhen me moshën e saj. Pra, pamja fizike e viktimit nuk mund ta linte autorin të dyshonte se ajo është më e madhe se 14 vjeç, moshë kjo, që, siç u tha më lart, përbën kufirin e paligjshmërisë në kryerjen e marrëdhënieve seksuale.

Subjekti aktiv i kësaj veprë penale është mbi 14 vjeç dhe si i tillë mban përgjegjësi para ligjit për veprimet e tij⁸⁹.

Neni 100 përmban dhe dy paragrafë të tjerë në të cilët legjislatori ka parashikuar rrethanat e cilësuar, rënduese, në të cilat mund të kryhet marrëdhënia seksuale me të miturin. Këto rrethana janë: bashkëpunimi; kryerja e veprës penale më shumë se një herë; përdorimi i dhunës; pasojat e rënda për shëndetin dhe vdekja apo vetëvrasja e të miturit.

Vepra penale e kryer në kushtet e këtyre rrethanave të cilësuar tregon për një agresivitet të subjektit aktiv. Kjo situatë passjell dhe pasoja më të rënda si në

⁸⁸ Mbi një interpretim të ngjashëm për dispozita analoghe italiane të shikohet dhe doktrina italiane dhe më konkretisht: Bertolino M., etj. “*Commentario delle “Norme contro la violenza sessuale”* (Legge 15 febbraio 1996, nr.66), Cedam, Padova, 1996.

⁸⁹ Për më gjatë shiko vendimin nr. 922/2010 të Gjykatës e Rrethit Gjyqësor Tiranë, cituar më lart.

shëndetin fizik po ashtu dhe në atë mendor të të miturit⁹⁰. Kjo është dhe arsyeja që legjislatori përcakton sanksione më të ashpra sesa ato të përcaktuara në paragrafin e parë.

Kështu agresivitetet të subjektit aktiv dallojmë në rastin e shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier⁹¹ ku me një të mitur të moshës 8 vjeçare kryhen marrëdhënie homoseksuale, me përdorim të dhunës nga ana e një personi në moshë madhore. Më konkretisht, bëhet fjalë për një fëmijë që ecte i vetëm përgjatë shinave të trenit kur është thirrur nga një person i panjohur prej tij. Ky i fundit e ka urdhëruar që t'i afrohej dhe mbasi e ka kapur kundër dëshirës së tij e ka zhveshur fëmijën në pjesën e poshtme të trupit duke kryer më pas marrëdhënie homoseksuale me të. Mbasi ka përfunduar aktin subjekti aktiv i ka urinuar në fytyrë fëmijës dhe e ka kërcënuar atë që të mos tregonte për ngjarjen.

Edhe në këtë rast, nga ana objektive, kemi të bëjmë me një krim “*Marrëdhënie seksuale me të mitur*” të kryer nga autori me veprime aktive, të kundraligjshme, shoqërisht të rrezikshme.

Subjekti pasiv është një fëmijë i mitur në një moshë të tillë që nuk është në gjendje të kuptojë pasojat e aktit të dhunshëm, ndërsa subjekti aktiv është një person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe i njohur për prirjet e tij homoseksuale.

Nga ana subjektive krimi është kryer me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim. Krimi është kryer duke përdorur dhunën, në mungesë së vullnetit të të miturit.

Duke ndaluar tek agresiviteti - dhuna e përdorur nga autori, duhet theksuar se atë e hasim në pjesën më të madhe të rasteve të shqyrtuara nga Gjykatat shqiptare⁹². Kështu, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁹³, ka shqyrtuar një rast ku subjekti aktiv është mashkull i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë nën moshën 18 vjeç, por më shumë se 14 vjeç. Ndërsa subjekti pasiv në kohën e kryerjes së veprës penale është femër e cila ka qenë nën 14 vjeç. Viktima dhe autori kanë qenë në marrëdhënie familjare me njëri tjetrin. Ky i fundit, pikërisht duke përfituar nga këto

⁹⁰ Shiko Nr.00-2012-1209 i Vendimit (245), Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 26.09.2012.

⁹¹ Me vendimin nr.261, datë 01.12.2006. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.173, datë 18.05.2007, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr.261, datë 01.12.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Ndërkohë vendimi i Gjykatës së Apelit është prishur duke u kthyer çështja për rigjykim në po atë gjykatë, me tjetër trup gjykues: Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 26.09.2012. Nr.00-2012-1209 i Vendimit (245).

⁹² Përmendim një rast tjetër konkret, ku veprimet objektive të pretenduara nga subjekti pasiv, e mitur nën moshën 14 vjeçare, konsistojnë në kryerje marrëdhëniesh intime kundrejt një shpërblimi në para. Veprimet kanë qenë të përsëritura. E mitura e ka kundërshtuar, por autori e ka kërcënuar se nëse tregonte ai do ta rrihte. Subjekti aktiv është person madhor. Veprimet e autorit janë aktive, të kundraligjshme, shoqërisht të rrezikshme dhe të shoqëruara nga elementi subjektiv i dashjes së drejtpërdrejtë për të kryer marrëdhëniet seksuale me të miturën. Për më gjatë shiko: Vendim nr.136, datë 21.09.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.108, datë 15.02.2008, ka vendosur Lënien në fuqi të vendimit nr.136, datë 21.09.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor. Vendimi i Gjykatës së Apelit është prishur nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 441/1, germa “ç” të Kodit të Procedurës Penale, dhe çështja është kthyer për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

⁹³ Me vendimin nr.203, datë 20.06.2008.

marrëdhënie familjare, ka shkuar në dhomën e gjumit ku ndodhej e shtrirë vajza dhe duke përdorur forcën fizike e ka zhveshur atë, e ka qëlluar me grushta dhe ka kryer marrëdhënie seksuale me vajzën e cila e ka kundërshtuar duke bërtitur dhe duke tentuar ta shmangte përmes kundërshtimit me duar, por nuk ka mundur ta ndalojë atë. Ky rast është shqyrtuar nga Gjykata e Shkallës së parë Vlorë dhe Gjykata e Apelit Vlorë.

Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se“*nuk provohet se i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale për të cilën akuzohet nga ana e organit të akuzës “Marrëdhënie seksuale me dhunë me të mitura nën moshën 14 vjeç”, parashikuar nga neni 100/2 i Kodit Penal, pasi nuk ka prova të mjaftueshme në këtë drejtim. Gjykata thekson se e vetmja prove direkte mbi të cilën bazohet akuza janë thëniet e të dëmtuarës , por gjykata çmon se në thëniet e kësaj dëshmitareje para gjykatës dhe ato të dhëna në momentin e kallëzimit ka ndryshime, sikurse është pretendimi i saj se i pandehuri e ka lidhur me litar. Ndërkohë, Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr.374, datë 26.06.2009, ka vendosur: “Ndryshimin e vendimit nr. 203, datë 20.06.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë⁹⁴ duke e ricilësuar veprën penale si “*marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur*” dhe duke dënuar autorin në bazë të nenit 100/2 të Kodit Penal. Sipas kësaj Gjykate në rastin konkret evidentohet dhuna në kryerjen e marrëdhënies seksuale. Ky orientim përqafohet dhe nga Gjykata e Lartë⁹⁵. Duam të evidentojmë se argumentimi i ekzistencës së dhunës në vendimet e Gjykatave është i vakët.*

Duam të ndalojmë tek një rast tjetër për të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin⁹⁶ ka vendosur deklarin e pafajësisë për të pandehurin i akuzuar për kryerjen e veprës penale të “*Marrëdhënies homoseksuale me të mitur*”, parashikuar nga neni 100/ 1 i Kodit Penal.

Në rastin konkret subjekti pasiv është i mitur nën moshën 14 vjeçare dhe subjekti aktiv është madhor.

Veprimet konkrete nisin me një ftesë drejtuar të miturit për të ndihmuar subjektin aktiv. Ky i ka fundit e ka çuar të miturin në një banesë duke mbyllur derën kryesore me çelës, e ka futur të miturin në dhomën e gjumit, e ka shtrirë në krevat dhe ka ushtruar forcë mbi të. Vetëm pasi i ka lidhur duart dhe këmbët me copa leckash që ndodheshin aty në dhomë ai ka arritur të kryejë marrëdhënie homoseksuale me viktimën.

Prokuroria ka parashtruar se nga provat e administruara në dosje, ndër të cilat akt ekspertimi nr.780, datë 24.07.2006 nga i cili konkludohet se në anusin e të dëmtuarit

⁹⁴ Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në datën 24.07.2009, ka ushtruar rekurs i gjykuari, me anën e të cilit ka kërkuar: Prishjen e vendimit nr.374, datë 26.06.2009 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe rikualifikimin e veprës objekt akuze. Si shkaqe të rekursit veçohen: “*Gjykata nuk ka bërë cilësim të drejtë ligjor të akuzës...Gjykata nuk argumentoi ndryshimin e kualifikimit dhe përpara kujt rasti të nenit 100/2 të Kodit Penal ndodhemi, sepse ka disa raste. Gjykata nuk e shqyrtoi fare ankimin tonë por vetëm ankimin e prokurorit. Gjykata nuk ka pasur parasysh mentalitetin e komunitetit rom, që martohemi në moshë të vogël. E dëmtuara ka mbajtur qëndrime kontradiktore”.*

⁹⁵ Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendim Nr.00-2012-1274 i Vendimit (249) datë 03.10.2012, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁹⁶ Me vendimin nr.121, datë 25.09.2008.

vërehen ekimozë me ngjyrë mavi e lehtë, fisurë segmentare (grisje sipërfaqësore) mukozës, etj, po ashtu në bazë të këtij akt ekspertimi është konkluduar se dëmtimet e përshkruara më lart janë shkaktuar me një mjet të fortë tubular.....⁹⁷.

Ndërkohë Gjykata arsyeton:në qoftë se ndodh një delikt, një fakt apo një ngjarje kriminale sado e sofistikuar dhe e mirëorganizuar qoftë ajo, është gjithsesi e destinuar të lërë pas prova materiale, shenja të ndryshme të dhëna, dëshmi apo indicie, të cilat të çojnë në dyshimin e arsyeshem të bazuar mbi prova duke veshur dikë me autorësinë e akuzës së ngritur. Mbështetur në këtë parim, pasi ka marrë në shqyrtim të gjitha provat e administruara në këtë shqyrtim gjyqësor gjykata ka arritur në përfundimin se organi i akuzës nuk disponon prova për të mbështetur dhe bazuar akuzën e ngritur mbi të pandehurin". Gjykata e Apelit Tiranë⁹⁸ ka vendosur: "Lënien në fuqi të vendimit nr.121, datë 25.09.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin".

Edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se vendimi nr.622 datë 07.07.2009 i Gjykatës së Apelit Tiranë është i bazuar në ligj dhe për rrjedhojë duhet të lihet në fuqi⁹⁹. Ky Kolegj vlerëson se sipas aktit të ekspertimit ".....ka mungesë të shenjave të ushtrimit të dhunës në trupin e personit të dëmtuar, mungesë të shenjave të tjera të kryerjes së aktit seksual, si dhe mospërputhje të tjera.....".

Duhet nënvizuar se një nga rastet më të rënda të shqyrtuara deri tani nga Gjykatat shqiptare është rasti i disa fëmijëve të mitur, të braktisur nga prindërit, me të cilët abuzohej seksualisht në brendësi të një fondacioni nga ana e tre shtetasve të huaj¹⁰⁰.

Fondacioni ishte themeluar nga një shtetas anglez i cili është edhe një nga tre autorët e krimeve të lartpërmendura – autori nr.1. Në ambientet e marra me qera nga fondacioni mbaheshin fëmijë kryesisht të moshës nga 2 - 14 vjeç. Fondacioni funksiononte mbi bazën e ndihmave ekonomike të donatorëve të ndryshëm shqiptar dhe të huaj. Pjesë e personelit të këtij fondacioni u bë edhe autori nr. 2, i cili kujdesej për fëmijët e vegjël, për punët e shtëpisë për gatimin etj. Ndërsa autori nr. 3 është një donator i fondacionit. Të tre autorët janë shtetas anglez dhe krimet për të cilat janë dënuar përbëjnë krime edhe në legjislacionin anglez. Duhet të nënvizojmë se qëllimi i fondacionit ishte përkujdesja për fëmijët e mitur, rritja dhe edukimi i tyre.

⁹⁷ Prokuroria argumenton "se edhe sikur të merret i mirëqenë fakti se akti homoseksual nuk është arritur të kryhet, rrethanat e ngjarjes konkluzionet e aktit të ekspertimit më së paku krijojnë bindjen e plotë se vepra penale duhet të ishte kualifikuar si marrëdhënie seksuale me të mitur, e mbetur në tentativë, sipas nenit 100/1 e 22 të Kodit Penal". Shiko vendimin e Kolegjit penal të Gjykatës së lartë të cituar më lart.

⁹⁸ Me vendimin nr.622 datë 07.07.2009.

⁹⁹ Sipas Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë: "... Siç rezulton edhe nga procesverbalet e seancave, nuk është arritur të përfitohet asnjë provë apo e dhënë tjetër, e cila të mbështeste pretendimet e prokurorisë apo të personit të dëmtuar lidhur me veprën penale. Ky Kolegj vlerëson gjithashtu se edhe nga plotësimet e aktit të ekspertimit, të bëra nga njëri prej ekspertëve që kanë firmosur aktin fillestar, nuk rezultojnë që të jenë nxjerrë konkluzione që mbështesin akuzën. Sipas aktit të ekspertimit ".....ka mungesë të shenjave të ushtrimit të dhunës në trupin e personit të dëmtuar, mungesë të shenjave të tjera të kryerjes së aktit seksual, si dhe mospërputhje të tjera.....".

¹⁰⁰ Gjykata e rrethit gjyqësor, vendim nr. 3, 12.01. 2010, Për kryerjen e veprës penale "Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur", parashikuar nga neni 100/2 i K.Penal. 12.01.2010. Gjykata e Apelit Tirane ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal 3 date 12.01.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tirane. Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve të paraqitura nga të gjykuarit Dino Christodoulou dhe Robin Arnold, kundër vendimit nr 891, date 05.11.2010 të Gjykatës së Apelit Tirane.

Në këtë rast, i cili paraqitet si rast shumë kompleks, nga ana objektive, krimi është kryer me veprime aktive, të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme.

Në lidhje me autorin nr. 1: Ai ka kryer marrëdhënie homoseksuale me dy fëmijë të mitur, respektivisht të moshës 8 dhe 10 vjeçare, duke përdorur dhunën fizike. Në rastet konkrete kjo dhunë është shfaqur përmes shtrëngimit dhe goditjes në zona të trupit me qëllim që fëmijët të mos bërtisin. Autori nr. 1 gjithashtu ka fjetur me këta fëmijë në të njëjtin shtrat duke qenë i zhveshur. Ai ka ekspozuar organin gjenital para tyre, duke arritur të kryejë edhe nevojat personale në shishe para tyre. Në këtë mënyrë fëmijët edukoheshin që nevojat e tyre mund të bëheshin edhe në dhomë. Duhet të kemi parasysh që autori nr.1 ishte figura kryesore në fondacion dhe se disa nga fëmijët e konsideronin apo e thërrisnin atë “baba”. Mund të perceptohet në këtë drejtim dhe dëmi psikologjik i krijuar tek fëmijët e abuzuar pikërisht nga personi që duhet të ishte mbrojtësi dhe edukuesi kryesor për ta¹⁰¹.

Autori nr. 2 është një subjekt që shërbente në këtë fondacion. Gjatë shqyrtimit gjyqësor u theksua se ky i fundit 1) kishte sjellje të dhunshme ndaj të gjithë fëmijëve gjatë veprimtarisë së edukimit dhe përkujdesjes për ta dhe 2) kishte abuzuar seksualisht me një numër të lartë fëmijësh.

Në lidhje me autorin nr. 3 ai ishte një financues i fondacionit i cili kishte ardhur në fondacion vetëm dy herë. Gjatë vizitave të tij, ai ka shfaqur interes vetëm për dy fëmijë të mitur për të cilët themeluesi kishte publikuar në faqen e internetit të fondacionit se ata ishin fëmijë të abuzuar seksualisht. Duke patur parasysh moshën e tyre të mitur, autori tentonte ti manipulonte fëmijët duke u sjellë si shok me ta, duke i nxjerrë shëtitje për pica, duke u blerë lodra dhe të gjitha këto veprime kryheshin me qëllim fitimin e besimit tek të miturit. Por qëllimi i tij final, i konkretizuar më pas, ishte kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me ta.

Lidhur me autorin nr. 1 dhe veçanërisht me autorin nr. 2 duhet të vëmë në dukje se veprimet e tyre janë shoqëruar me përdorimin e dhunës fizike e cila në rastin e autorit nr. 2 paraqitet në shumë forma si shtrëngim për të kryer aktin, lidhje me litar të duarve dhe këmbëve, mbyllje të gojës së viktimave, zhveshje të tyre, rrahje me kamzhik, futje në gojë të leckës së dyshemesë, urinim në gojë, pickim në organet seksuale, kapje nga këmbët dhe varje nga ballkoni, tërheqje me pinca të organit seksual, goditje me shkop. Subjektet pasive janë të mitur të moshës nën 14 vjeç. Dua të theksoj se ka patur edhe viktimitë të moshës 5 vjeçare.

Pra në ambjentet e fondacionit, i cili ishte krijuar si strehë materiale dhe shpirtërore e fëmijëve në nevojë, kanë ndodhur krime shumë të rënda ndaj disa fëmijëve me pasoja të parekuperueshme për tërë jetën.

¹⁰¹ Shiko për më gjatë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimi 1581, datë 19.11.2008 “Për kryerjen e veprës penale “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”, parashikuar nga neni 100/2 i K.Penal. 12.01.2010. Gjykata e Apelit Tirane ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit penal 1581 date, 19.11.2008 te Gjykates se Rrethit Gjyqësor Tirane. Gjykata e Larte ka vendosur : Mospranimin e rekursit te paraqitur nga i gjykuari John David Braën, ndaj vendimit nr 1581, date 19.11.2008, te Gjykates Rrethit Gjyqësor Tirane dhe vendimit nr 858, date 02.10.2009 te Gjykates se Apelit Tirane.

Të gjithë autorët e kanë kryer veprën penale nëpërmjet kryerjes së akteve homoseksuale me të mitur më shumë se një herë. Në rastin e autorit nr. 2 dhuna fizike është gërshetuar edhe me dhunën psikologjike.

Ndërsa autori nr. 3 e ka kryer veprën penale pa përdorimin e dhunës fizike ose psikologjike. Viktimat janë dy fëmijë nën moshën 14 vjeçare. Këta të fundit nuk kanë bërë rezistencë ndaj marrëdhënieve homoseksuale, edhe për faktin që autori kishte vendosur me ta një raport miqësor¹⁰².

Nga ana subjektive, të gjithë autorët kanë vepruar me dashje direkte. Motivet dhe qëllimi nuk janë të rëndësishëm për cilësimin e elementit subjektiv, por mbahen parasysht nga Gjykata në individualizimin e masës dhe llojit të dënimit.

Autorët kanë patur dijeni për moshën e viktimave dhe e kanë patur gjithashtu të qartë se, sjellja e tyre përbënte krim, pasi edhe në shtetin e tyre, veprime të tilla janë të ndëshkueshme moralisht dhe ligjrisht. Kjo dijeni nuk i ka penguar ata nga kryerja e veprimeve kriminale.

Në praktikën e gjykatave shqiptare evidentojmë edhe raste kur marrëdhëniet seksuale janë kryer në mungesë të dhunës dhe me pëlqimin e të miturit/miturës. Kështu, në një rast të shqyrtuar nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Vlorë¹⁰³ një vajzë e mitur nën moshën 14 vjeçare së bashku me të motrën 17 vjeçare i kanë shprehur një miku dëshirën për të shkuar e punuar në Itali. Ky ka njoftuar autorët të cilët pasi janë njohur me vajzat i kanë thënë atyre se do të shkonin së bashku në Itali për të bërë një jetë normale. Po atë natë, ata janë ndarë në çifte dhe me dëshirën e tyre kanë fjetur në dhoma të veçanta dhe kanë kryer marrëdhënie seksuale. Më pas kanë shkuar në Itali ku vajzat, me kërkesën e bashkëjetuesve të tyre kanë filluar të ushtrojnë prostitucion në rrugë.

Në këtë rast kemi të bëjmë me një krim pasi kemi një subjekt aktiv i cili kryen marrëdhënie seksuale me të mitura. Ky subjekt është person në moshë madhore ndërsa subjekti pasiv është e mitur nën moshën 14 vjeçare.

Dashja është e drejtpërdrejtë edhe pse mungon dhuna.

Nga ana objektive krimi është kryer me veprime të kundraligjshme të drejtuara për të kryer marrëdhënien seksuale me të miturën. (konkuron kjo vepër penale dhe me veprën penale të shfrytëzimit të prostitucionit parashikuar nga neni 114/2 i Kodit Penal).

¹⁰² Gjykata në vendimin e saj analizon se, sipas së drejtës angleze me marrëdhënie seksuale me të mitur të moshës nën 13 vjeç do të kuptohet sjellja e një personi kur :

- *Ai qëllimisht penetron me një pjesë të trupit të tij apo cdo gjë tjetër në vaginën, anusin apo gojën e një personi tjetër nën 13 vjeç;*
- *Ai qëllimisht prek një person tjetër;*
- *Prekja është seksuale. ;*

¹⁰³ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr.302, datë 11.12.2002.

3.3 Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur në moshën 14-18 vjeç.

Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur në moshën 14-18 vjeç përbëjnë një figurë krimi që paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të fëmijës së mitur në moshën 14-18 vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale nga veprimet kriminale.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive të shoqëruara me dhunë fizike apo psikike me qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale me fëmijët e mitur 14-18 vjeç.

Pra siç është përmendur dhe më lart, për të patur këtë figurë krimi element thellbësor është përdorimi i dhunës fizike apo psikike.

Subjekt aktiv mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndërsa subjekti pasiv janë fëmijët e moshës 14-18 vjeç dhe që kanë arritur pjekurinë seksuale.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim.

Nga një analizë e Vjetarit statistikor të Ministrisë së Drejtësisë vëmë re që ndër vite kemi një numër të lartë të viktimizimit seksual të të miturve. Në vitin 2014 janë proçeduar 22 raste marrëdhëniesh seksuale me të mitur, ku 14 prej tyre janë vepra penale ex nenit 100, të kryera pa ushtrim të dhunës dhe vetëm 8 janë kryer përmes dhunës ex nenit 101¹⁰⁴. Në vitin 2013 janë proçeduar 18 raste marrëdhëniesh seksuale me të mitur, ku 16 prej tyre janë vepra penale ex nenit 100, të kryera pa ushtrim të dhunës dhe vetëm 2 janë kryer përmes dhunës ex nenit 101¹⁰⁵.

Të dhënat e mësipërme përbëjnë të dhëna shqetësuese.

Arsyet e rritjes së marrëdhënieve seksuale me të mitur, mund të gjenden në faktorë të ndryshëm. Midis tyre nënvizojmë faktin që përdorimi i dhunës fizike është më i lehtë kundrejt kësaj kategorie subjektësh pasi ata janë fizikisht më të dobët. Edhe përdorimi i dhunës psikologjike është më i lehtë për t'u ushtruar ndaj këtyre subjekteve, si pasojë e mos arritjes së pjekurisë së duhur për të gjykuar drejt rrezikun që i kanoset si dhe marrëdhënien seksuale dhe pasojat që sjell ajo mbi shëndetin fizik dhe psikologjik të fëmijës. Është një fakt i pamohueshëm që të miturit janë subjekte që manipulohen më lehtë nga pikëpamja psikologjike.

Problematik shfaqet edhe fakti që krimet seksuale shpesh konstatohet se kryhen në rrethana rënduese, me numër të madh viktimash dhe në forma të rënda bashkëpunimi¹⁰⁶.

¹⁰⁴ Ministria e Drejtësisë, Vjetar statistikor, 2014, fq 37.

¹⁰⁵ Ministria e Drejtësisë, Vjetar statistikor 2013, fq 38.

¹⁰⁶ Në këtë drejtim shiko dhe Aranita Brahaj, Pedofili. Vëllimi i krimeve dhe dinamika e fenomenit. Shiko Gjithashtu: Ministria e Drejtësisë, Vjetar statistikor 2009, fq. 30.

Ndër rastet e shqyrtuara nga Gjykatat shqiptare, përmendim vendimin nr. 1230 datë 18/09/2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Në rastin konkret subjekti pasiv është femër e moshës pesëmbëdhjetë vjeçare e cila largohet nga banesa për të ndenjtur me një djalë të sapo njohur. Gjatë kësaj periudhe, rezulton se me të ka kryer marrëdhënie seksuale me dhunë, një shok i djalit që ajo kishte njohur.

Subjekti aktiv është person në moshë madhore. Veprimet janë kryer në mungesë të vullnetit të viktimës. Përsa i përket formës së dhunës fizike të ushtruar, viktimja deklaroi se autori e ka kapur dhe e ka shtrënguar aq fort atë sa ajo ka humbur ndjenjat gjatë kohës që autori abuzonte me të. Sipas deklarimeve të saj autori ka përdorur gjatë kryerjes së veprës penale mjete si: shiringë me age metalike dhe llastik transparent.

Në lidhje me objektin e kësaj vepre penale, Gjykata pohon se *“veprimet e kundërligjshme të kryera nga i pandehuri kanë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale, shëndetin dhe jetën e fëmijës së mitur të moshës 14-18 vjeç dhe që vajza ka arritur pjekurinë seksuale, nga marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet kriminale. Nga ana objektive kjo vepër penale është konsumuar nga i pandehuri, e veprimet e kundërligjshme janë manifestuar në kryerjen e veprimeve aktive duke përdorur dhunë fizike(shtrëngim), për të kryer marrëdhënie seksuale me të.Nga ana subjektive, vepra penale është kryer nga i pandehuri me faj në formën e dashjes direkte, pasi i pandehuri ka parashikuar kundërligjshmërinë e veprimeve të tij dhe pasojat e veprës”.*

Në një rast tjetër¹⁰⁷ viktimja ka bërë kallëzim penal duke pretenduar se ndaj saj, autori, shitës dyqani e banues në të njëjtin fshat, kishte kryer veprime të turpshme e më pas, në dyqanin e tij, kishte kryer marrëdhënie seksuale duke përdorur dhunën fizike. Sipas saj, ajo e kishte mbajtur të fshehtë faktin për disa muaj për shkak të dhunës psikologjike të ushtruar nga i gjykuari dhe kur konstatoi se mund të kishte mbetur shtatzanë nga ajo marrëdhënie, u tregoi për ngjarjen familjarëve të saj.

Veprimet e kundërligjshme të kryera nga autori, sipas vendimit të Gjykatës së rrethit Gjyqësor Korçë, *kane cënuar marrëdhëniet juridike të vendosurapër të siguruar paprekshmërinë seksuale, të të miturës që ka plotësuar moshën 14-18 vjeç, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal shqiptar nga veprimet ose mosveprimet kriminale.*

Nga ana objektive kjo vepër është konsumuar me veprime të kundërligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme duke përdorur dhunën.

Në rastin konkret Gjykata evidenton një gërshetim të dhunës fizike me atë psikologjike. Dhuna fizike evidentohet në momentin e kryerjes së marrëdhënies seksuale ku autori e godet viktimën në kokë, e tërheq prej krahu, e shtrin në tokë dhe kryen marrëdhënie me të. Dhuna psikologjike evidentohet në presionin psikologjik të

¹⁰⁷ Shiko vendimet: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, vendim nr.225, date 23.06.2008; Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.133, date 14.11.2008, me të cilin vendos lenien ne fuqi te vendimit nr.225, date 23.06.2008 te Gjykeses se Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Vendim i Kolegjit penal i Gjykatës së Lartë, Vendim Nr.00-2010-341, datë 27 e 29.01.2010 i cili lë ne fuqi vendimin nr.133, datë 14.11.2008 të Gjykatës së Apelit Korçë.

ushtruar nga autori mbi viktimën me qëllim mos bërjen publike të krimit seksual të konsumuar. Ai e kërcënon viktimën se do e vrasë apo tenton ta bindë se po u mor vesh ajo vetë do të vrasë veten nga turpi. Dhuna psikologjike bën që e mitura të mbyllet në vetvete. Presioni arrin deri aty sa autori e mëson të miturën të mashtrojë se është padyshim përdhunuar nga dy të huaj me maska. Në lidhje me elementin subjektiv dashja e përdorur është dashje direkte. Subjekti aktiv ka moshën 70-71 vjeçare dhe si i tillë ka përgjegjësi penale të plotë para ligjit penal shqiptar.

Në një rast tjetër viktimja, femër në moshë të mitur¹⁰⁸ ka pretenduar se ndaj saj, autori, kishte kryer marrëdhënie seksuale duke përdorur dhunën fizike. Më konkretisht viktimja dhe autori janë ndeshur në mikrobusin e linjës së fshatit të viktimës. Kjo e fundit ka zbritur për të shkuar në shtëpinë e saj dhe pasi ka ecur rreth 500 metra, i ka dalë përpara autori, duke i prerë rrugën. Viktimja është munduar të largohet, por autori e nuk e ka lejuar. Ai e ka kërcënuar atë se do t'i vriste njerëzit e familjes. Autori e ka kapur për flokësh dhe e ka drejtuar në drejtim të rrugës së pyllit me shkurre ku ka kryer marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën. Edhe pse e dëmtuara i ka kërkuar atij të kthehej në shtëpi, ai nuk e ka lejuar, por e ka detyruar të endet gjithë natën nëpër rrugë. Në mëngjesin e ditës së nesërme kur autori është shkëputur prej viktimës për të gjetur një telefon, ajo ka gjetur mundësinë dhe është larguar. Më pas ka paraqitur kallzim penal.

Veprimet e kundërligjshme të kryera nga autori, kanë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë seksuale, të së miturës që ka mbushur moshën 14 - 18 vjeç, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal shqiptar nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive kjo vepër është konsumuar me veprime të kundërligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme duke përdorur dhunën. Edhe në këtë rast mund të evidentohet një gërshetim i dhunës fizike me atë psikologjike. Dhuna fizike evidentohet me kapjen prej krahu të viktimës, shoqërimin jashtë dëshirës së saj në vendin ku është konsumuar vepra penale si dhe konsumimi me dhunë i marrëdhënies seksuale. Dhuna psikologjike evidentohet në kërcënimin psikologjik të ushtruar nga autori mbi viktimën se do e vrasë atë dhe familjarët e saj. Kërcënimi është shoqëruar me përdorimin e thikës të cilën autori e vendos pranë kokës së vajzës gjatë kohës së konsumimit të aktit seksual. Në lidhje me elementin subjektiv padyshim që edhe në këtë rast dashja e përdorur është dashje direkte.

Subjekti aktiv ka moshë madhore ndërsa subjekti aktiv ka moshën 14 – 18 vjeçare.

Në një rast tjetër¹⁰⁹ subjekti aktiv, mashkull në moshë madhore, me subjektin pasiv femër e mitur e moshës 14 – 18 vjeçare kanë qenë të fejuar, por kjo fejesë ka qenë shumë e vështirë, për arsye nga më të ndryshmet. Autori në shumicën e rasteve nuk ka kursyer jo vetëm fyerjet, por edhe dhunën ndaj të fejuarës së tij. Si rrjedhojë e kësaj marrëdhënieje viktimja ka vendosur të ndahej nga i fejuari. Pas ndarjes, autori i është

¹⁰⁸ Shiko vendimet: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Diber, vendimi nr.28, date 28.02.2008. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.580, date 31.10.2008. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me Vendim nr.00-2010-765, datë 26.05.2010.

¹⁰⁹ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane, vendim nr. 747, datë 11.05.2010.

afruar të fejuarës duke i kapur asaj çantën dhe pasi e ka zenë për krahësh e ka futur me dhunë në një taksì ku ai e ka qëlluar dhe të gjakosur e ka çuar më pas tek banesa e motrës së tij. Autori tenton ti mbushë mendjen për tu ribashkuar me të. Pas refuzimit të saj ai e ka çuar atë në një hotel ku edhe ka kryer mardhënje seksuale kundër dëshirës së saj, me qëllimin për ta lënë shtatzënë.

Veprimet e kundërligjshme të kryera nga autori, kanë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë seksuale, të së miturës që ka mbushur moshën 14-18 vjec, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal shqiptar nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive kjo vepër është konsumuar me veprime të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme duke përdorur dhunën fizike. Dhuna fizike evidentohet me kapjen prej krahu të viktimës, shoqërimin jashtë dëshirës së saj në vendin ku është konsumuar vepra penale, goditja e vazhdueshme e saj me mjete te forta shpuese si dhe konsumimi me dhunë i marrëdhënies seksuale.

Nga ana subjektive vepra është kryer me dashje. Autori ka synuar të detyrojë vajzën për të mos shkëputur marrëdhëniet me të dhe këtë qëllim të tijin ai ka tentuar ta arrijë nëpërmjet formash të cilat kanë cënuar lirinë seksuale dhe integritetin fizik të viktimës.

3.4 Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura dhe marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur.

Kodi penal parashikon në nenin 102 kryerjen e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, duke e sanksionuar me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Në rastet kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Ndërsa në rastet kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarës, vepra penale do të dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Ndërkohë në dispozitën vijuese, nenin 102/a të Kodit Penal, legjislatori ndalon kryerjen e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur duke e sanksionuar me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Në rastet kur marrëdhënia homoseksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Në një vështrim krahasues vëmë re se këto dy dispozita janë diskriminuese për shkak të orientimit seksual dhe gjinor njëkohësisht. Siç lexohet më lart, neni 102 i Kodit Penal ndëshkon “marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura”. Pra bën prezumimin se vetëm gratë e rritura mund të jenë viktima të dhunës seksuale dhe se dhunuesit e tyre mund të jenë vetëm burrat. Ndërkohë neni 102/a ndëshkon “marrëdhëniet

homoseksuale me dhunë me të rritur” duke bërë prezumimin se krimet seksuale mes personave të të njëjtit seks janë gjithmonë të kryera nga një mashkull kundër një mashkulli tjetër. Në fakt dhuna seksuale mbetet dhunë seksuale dhe ajo nuk njihet orientim apo gjini.

Një dallim tjetër i pajustificuar është sanksionimi i ndryshëm.

Kështu kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, sanksionohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet, ndërkohë që kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Në rastet kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Ndërkohë kur bëhet fjalë për marrëdhënie homoseksuale me dhunë në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, vepra dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Sanksioni mbetet i njëjtë vetëm në rastet kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit/dëmtuarës. Në këto raste dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Cila është arsyeja e legjislatorit për të bërë këtë lloj diskriminimi? Mos vallë pasojat e një marrëdhëniejeje seksuale me dhunë mbi një femër janë më të rënda se pasojat e një marrëdhëniejeje homoseksuale me dhunë mbi një mashkull?

Në dispozitat e mësipërme kemi disa lloje krimesh:

- 1) Kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura;
- 2) Kryerja e marrëdhënieve seksuale midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre dhe
- 3) Kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur.

Në rastin e parë dhe të tretë objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të gruas së rritur/mashkullit të rritur nga veprimet kriminale që çënojnë sferën e saj/tij seksuale.

Në rastin e dytë objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të bashkëshortëve apo bashkëjetuesve nga veprimet kriminale që çënojnë sferën e tyre seksuale.

Krimet e mësipërme nga ana objektive kryhen me veprime aktive të shoqëruara me dhunë fizike apo psikike me qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale me të rriturën/bashkëshortin/bashkëshorten/bashkëjetuesen/bashkëjetuesin. Pra siç është përmendur dhe më lart për të patur këtë figurë krimi është element esencial i anës objektive përdorimi i dhunës fizike apo psikike.

Në rastin e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura subjekt aktiv mund të jetë çdo person i gjinisë mashkullore që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndërsa subjekti pasiv janë femrat e rritura.

Në rastin e marrëdhënieve seksuale me dhunë midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve subjekt aktiv mund të jetë secili prej bashkëshortëve apo

bashkëjetuesve. Ajo ç'ka bie në sy është fakti se në këtë rast legjislatori e pranon që në këtë marrëdhënie subjekt aktiv mund të jetë edhe femra dhe subjekt pasiv mashkulli. Në këtë figurë krimi qëllimi i ndalimit shkon përtej mbrojtjes së lirisë seksuale të bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, duke dashur legjislatori të mbrojë martesën dhe përmes saj familjen si dhe bashkëjetesën, konceptuar kjo e fundit shpesh si një hallkë para martesës.

Në rastin e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur subjekt aktiv mund të jetë çdo person i gjinisë mashkullore që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndërsa subjekti pasiv janë meshkujt e rritur.

Nga ana subjektive krimet më lart kryhen me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këto veprime.

Siç u përmend më lart, dispozitat parashikojnë dhe rrethanat e cilësuar në të cilat kryhet vepra penale siç janë bashkëpunimi, kryerja e krimit më shumë se një herë, pasojat e rënda për shëndetin dhe kur vjen si pasojë vdekja apo vetëvrasja e viktimës.

Sipas vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2014 janë proçeduar 5 raste marrëdhëniesh seksuale me të rritura¹¹⁰. Në vitin 2013 është proçeduar vetëm një rast¹¹¹. Pra në nenet 101, 102 dhe 102/a dhuna është element thelbësor për ekzistencën e këtyre figurave të veprës penale, ndërsa në nenin 100 ekzistenca e dhunës shërben si rrethanë rënduese dhe për rrjedhojë ka një dënim më të rëndë.

Duhet përmendur se risi e kodit penal, përbën rregullimi që i bëhet marrëdhënieve homoseksuale dhe për rrjedhojë pranimi që subjekt pasiv mund të jenë dhe meshkujt¹¹².

Në krimet nr.1 dhe nr.3 kemi të bëjmë me modele inkriminuese të bazuara në “shtrëngimin” e të dëmtuarës/it. Këto vepra penale nuk bazohen në mungesën e konsensusit të të dëmtuarës/dëmtuarit duke valorizuar llojet e “shtrëngimit” si dhuna fizike dhe psikologjike.

Do doja të nënvizoj se do të ishte interesante ideja që të dënohej penalisht dhe subjekti aktiv që nuk ushtron dhunë, por që thjesht vepron në kundërshtim me dëshirën e të dëmtuarës/it, sepse në këtë mënyrë valorizohet tema e vetëvendosjes së lirë individuale përballë çdo lloj “shtrëngimi” edhe jo të dhunshëm për të mospranuar kryerjen e akteve seksuale.

Aktiviteti seksual ka të bëjë ngushtësisht me personin dhe duhet të mbrohet si aspekt veçanërisht delikat i autonomisë individuale, që mund të sjellë një rimodulim të mbrojtjes efektivisht më garantiste të së drejtës për vetëvendosje seksuale, të tillë që kush manifeston vullnetin personal kundër kryerjes së një akti seksual ka të drejtën të mbrohet në kundërshtimin e tij pavarësisht sjelljeve personale kundrejt iniciativave të

¹¹⁰ Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, viti 2014, fq.37.

¹¹¹ Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë, 2013, fq. 38.

¹¹² Dispozita është shtuar me ligjin nr.8733, datë 24.1.2001, neni 18 dhe është ndryshuar me ligjin nr.23/2012, datë 1.3.2012, neni 10. www.qpz.gov.al.

subjektit aktiv. Kjo lloj tutele është zbatuar në shtete të ndryshme vecanërisht ato me prejardhje anglosaksone¹¹³.

Kjo lloj tutele penale do të kishte vështirësitë e veta në planin proçedural dhe pikërisht lidhur me provueshmërinë e veprës penale. Kjo do t'i linte vend dhe fshehjes së të vërtetës si dhe simulimit të një vepre penale dhe strumentalizimit të denoncimit të bërë.

Në praktikën tonë gjyqësore janë dënuar penalisht subjektet aktivë të cilët nuk kanë ushtruar dhunë, por kanë kryer marrëdhënie seksuale me subjektin pasiv në kundërshtim me dëshirën e saj. Në praktikën gjyqësore kryerja e marrëdhënieve seksuale pa dëshirën e subjektit pasiv është konsideruar si vepër penale e kryer në kushtet e dhunës psikike. Pra, praktikisht jurisprudenca i bën një interpretim shumë të gjerë dhunës sa fut në këtë kategori sjellje që mund të quhen shtrënguese vetëm në një mënyrë krejtësisht indirekte.

Në optikën “progresiste” trupi (dhe veçanërisht ai femëror) nuk mund të parcelizohet dhe të dhunohet dhe nuk mund të tutelohet në mënyrë sektoriale. Tutela duhet të jetë unitare, pavarësisht llojeve të ndryshme të “shtrëngimit”.

Nuk mund të vihet në dyshim karakteri personal i lirisë për vetëvendosje seksuale dhe kjo reflektohet në modalitetet e tutelës penale ku ruhet proporcionaliteti i dëmit të shkaktuar me sanksionin penal.

Në lidhje me kryerjen e marrëdhënieve seksuale midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, duhet të theksojmë se Kodi Penal nuk parashikon dispozitë të veçantë për këto lloj marrëdhëniesh, por ndalimi i mësipërm është shtuar nga legjislatori, në paragrafin e parë të nenit 102, përmes ndryshimeve të fundit të bëra me ligjin nr.144/2013.

Siç u përmend më lart, në fokus të ndryshimeve të Kodit penal kanë qenë dhe çështjet e dhunës në familje e konceptuar kjo si një fenomen i papranueshëm i cili duhet luftuar me vendosmëri dhe ashpërsi¹¹⁴.

Dua të vë në dukje se marrëdhëniet seksuale midis bashkëshortëve pa pëlqimin e tyre apo përmes dhunës përbëjnë një formë të dhunës në familje. Ligji nr. 9669, datë 12.12.2006 “*Per masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare*” e përkufizon dhunën në familje si “*çdo akt dhune (domethënë çdo veprim apo mosveprim i një personi ndaj një tjetri që sjell si pasojë cënimin e integritetit të tij fizik, moral, psikologjik, seksual, social, dhe ekonomik) i ushtruar ndërmjet personave që janë, ose kanë qenë, në marrëdhënie familjare*”.

Dhuna në familje ushtrohet kryesisht ndaj grave dhe nuk përbën një dukuri të re në Shqipëri, por i ka rrënjët thellë në traditat dhe zakonet patriarkale që prej kohësh i kanë dhënë formë shoqërisë shqiptare¹¹⁵.

¹¹³ Bertolino M., *Liberta' sessuale e tutela penale*, Milano, 1993..

¹¹⁴ Shiko për më gjatë: Tekst i shkruar i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, datë 03.04.2013, ora 09.20. Arkivi i Kuvendit të Shqipërisë.

Gjykoj se rregullimi i mësipërm është paksa i vonuar në legjislacionin penal dhe se për vetë rëndësinë kushtetuese që paraqet familja, e konceptuar si vendi ku formohet personaliteti i njeriut, do të ishte e udhës që këto lloj marrëdhëniesh të rregulloheshin në një dispozitë të posaçme.

Dua të vë në dukje se legjislatori ka parashikuar që për ekzistencën e figurës së kësaj veprë penale të kryer mes bashkëshortëve apo bashkëjetuesve mjafton si element i anës objektive mungesa e pëlqimit të njërit prej tyre, pra nuk është i domosdoshëm elementi "dhunë".

Cështja e dhunës ndërmjet bashkëshortëve, përfshirë edhe intimitetin seksual, i cili në rastet kur rrezikohet mund të kthehet në një formë terrorizimi të mirëfilltë, është parashikuar në Konventën e Sidaut, që është Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave¹¹⁶. Në praktikë, nuk ndeshen raste të denoncimit të dhunës seksuale midis bashkëshortëve, ndërkohë që jo rrallë ajo është bërë shkak për divorcet.

Mendoj se është interesante të vihet në dukje se Ministria e Integritimit kishte propozuar që të shtohet paragrafi në nenin 102 ku të parashikohet që "*Kryerja e marrëdhëniesh seksuale me dhunë midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve pa pëlqimin e njërit prej tyre, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.*" Ndërkohë që Ministria e Drejtësisë propozonte variantin që "*Kryerja e marrëdhëniesh seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet*", variant ky i fundit i cili u miratua¹¹⁷.

Nga vjetari statistikor i Ministrisë së drejtësisë për vitin 2014 rezulton se Gjykatat shqiptare kanë gjykuar në vitin 2014 pesë çështje mbi marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura sipas nenit 102 të Kodit Penal.

Nga ana objektive këto vepra penale konsumohen me veprime të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme të cilat mund të marrin forma nga më të ndryshmet. Ajo që i bashkon është përdorimi i dhunës.

Ndër çështjet e shqyrtuara mund të përmendim rastin e një gruaje të martuar, me tre fëmijë të mitur dhe bashkëshortin emigrant¹¹⁸. Ajo punonte si këngëtare në një lokal në periferi të qytetit. Pas pune ajo kthehej në shtëpi kur një person e thërret, e kap për dore, pastaj për fyti, nxjerr një thikë dhe e tërheq fillimisht drejt një rruge pa njerëz e më pas drejt një banese të papërfunduar duke kryer më pas marrëdhënie seksuale me

¹¹⁵ P.sh., rolet dhe identitetet e ngurta gjinore, autoriteti patriarkal, respektimi i kodit të nderit dhe turpiti, dhe kontrolli i disa brezave brenda familjes. Në fakt, burrat dhe gratë në disa zona të Shqipërisë ende i referohen Kanunit për të shpjeguar qëndrimet dhe pikëpamjet për rolet gjinore dhe autoritetin patriarkal, përfshirë të drejtën e burrit për ta ndëshkuar" gruan, e cila konsiderohet si pronë e tij. Shiko për më gjatë "*Dhuna në familje në Shqipëri. Vrojtim kombëtar me bazë popullatën*", 2013, cituar.

¹¹⁶ Për më gjatë shiko procesverbalin e lartpërmendur (footnote 97), faqe 20.

¹¹⁷ Shiko për më gjatë procesverbalin sipas footnote 97, faqe 35 e vijuese. Po në seancën e datës 03.04.2013 u propozua që të lireshin mënjandë bashkëjetuesit, pra ndalimi të përfshinte vetëm bashkëshortët... dhe u ironizua që nqs përfshihen bashkëjetuesit atëherë duhej të përfshiheshin dhe ish – bashkëshortët. Shiko për më gjatë, procesverbalin e seancës, faqe 36.

¹¹⁸ Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim nr. 11-2009-3057, datë 07-07-2009.

të. Gjatë gjithë kohës ai e kërcënon atë se do i gjuajë nëqoftëse ajo do të bërtasë. Pas kryerjes së marrëdhënies i kërkon viktimës të mos flasë dhe duke i premtuar para dhe rroba.

Në këtë rast, kemi një gërshetim të dhunës psikike me atë fizike. Del qartë në pah përdorimi i dhunës fizike që konsiston në kapjen për dorë dhe për fyti si dhe tërheqjen drejt banesës së pabanuar. Ndërsa dhuna psikike konsiston në kërcënimin nga ana e subjektit aktiv se nëse viktimja nuk do të bëjë atë që i kërkon ai, ky i fundit do e godasë duke i marrë jetën apo duke ja rrezikuar atë. Gjykata në vendimin e saj thekson përdorimin e dhunës psikike. Në lidhje me subjektet si ai pasiv si ai aktiv janë të dy subjekte në moshë madhore.

Nga ana objektive, siç del në pah nga përshkrimi më lart, vepra penale është kryer me veprime materiale të drejtpërdrejta për realizimin e veprës dhe duke u shoqëruar nga elementi psikologjik i dashjes së drejtpërdrejtë.

Objekti i këtij krimi seksual, është cënimi i marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale, shëndetin dhe jetën e femrave në moshë madhore.

3.5 Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur.

Në seksionin e Krimeve Seksuale, neni 103¹¹⁹, gjejnë mbrojtje dhe marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale të kryera me persona të pazotë për t'u mbrojtur.

Ligjvënësi ka parashikuar një mbrojtje të posaçme, për një marrëdhënie juridike të rëndësishme, siç është ajo e vendosur nga shteti për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të personave të pazotë fizikisht apo mendërisht si dhe të personave që për shkaqe të ndryshme vendosen në gjendje të pandërgjegjshme.

Cënimi i këtyre marrëdhënieve nga shtetasit, përbën krim dhe passjell përgjegjësi penale". Kjo dispozitë mbron lirinë shpirtërore të individit¹²⁰.

Kjo është një figurë krimi që paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe është një vepër penale që ndeshet dendur në praktikë.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale, jetën dhe shëndetin e personit të paafte nga ana fizike apo mendore për t'u mbrojtur nga veprimet kriminale.

¹¹⁹Neni 103 -"Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke përfutuar nga pazotësia fizike ose mendore e të dëmtuarës që ka arritur moshën 14 vjeç dhe pjekurinë seksuale, ose vendosja në gjendje të pandërgjegjshme dënohet me burgim nga 5 gjer në 10 vjet. Kur marrëdhënia seksuale apo homoseksuale kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo kur personit të dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga 5 gjer në 15 vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e personit të dëmtuar, dënohet me burgim nga 10 gjer në 20 vjet."

¹²⁰ Për më gjatë shiko vendimin e Gjykatës së Rrethit gjyqësor Tiranë nr 1856, datë 19.12.2011.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive me kryerjen e marrëdhënieve seksuale midis sekseve të ndryshme apo homoseksuale midis të njëjtit seks.

Për të patur këtë figurë krimi është esenciale që subjekti pasiv të jetë i paaftë fizikisht apo mendërisht.

Subjekt aktiv mund të jetë cdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndërsa subjekti pasiv është cdo person i paaftë fizikisht apo mendërisht.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim.

Gjithashtu në këtë nen në paragrafin e dytë dhe të tretë parashikohen dhe rrethanat e cilësuar në të cilat kryhet vepra penale sic janë bashkëpunimi, kryerja e krimit më shumë se një herë, pasojat e rënda për shëndetin dhe kur vjen si pasojë vdekja apo vetëvrasja e personit të paaftë.

Parashikimi i kësaj vepre penale synon të koordinojë më së miri nevojën për mbrojtje të lirisë seksuale të personave të paaftë për t'u mbrojtur, në kufijtë e kapacitetit objektiv të tyre për të vetëvendosur për një jetë normale seksuale, pa patur frikë që personi me të cilin ata kanë një marrëdhënie seksuale konsensuale po kryen një vepër penale.

Për këtë arsye legjislatori ka përdorur në këtë nen fjalën “përfiton”, pasi ndryshe nga tutela ligjore që i bën jetës seksuale të të miturit ku mjafton kryerja e marrëdhënieve seksuale me to, në këtë nen kërkohet që subjekti aktiv të përfitojë nga kjo pazotësi, pra të shfrytëzojë këtë paaftësi të subjektit pasiv për t'u mbrojtur duke abuzuar me të.

Duhet të bëhet dallim midis subjekteve pasivë, pasi në rast se personi është i paaftë fizikisht për t'u mbrojtur ai mund të jetë i aftë për të dhënë pëlqimin e tij për këtë marrëdhënie seksuale dhe do të kemi ekzistencën e kësaj vepre penale në rast se personi i paaftë nuk ka dhënë pëlqimin për kryerjen e marrëdhënies seksuale.

Edhe përsa i përket paaftësisë mendore duhet të përcaktohet shkalla e kësaj paaftësie. Në rast se paaftësia mendore e personit është e tillë sa atij i është hequr zotësia për të vepruar ose plotëson kushtet për t'u hequr kjo zotësi atëherë ai barazohet me fëmijën e mitur nën moshën 14 vjeç dhe për ekzistencën e kësaj vepre penale do të mjaftojë thjesht kryerja e marrëdhënies seksuale. Në rast se paaftësia mendore e personit është e tillë sa atij i është kufizuar zotësia për të vepruar ose plotëson kushtet për t'iu kufizuar kjo zotësi atëherë ai barazohet me fëmijën e mitur nga mosha 14 - 18 vjeç dhe për ekzistencën e kësaj vepre penale mendoj se do të ishte e nevojshme që personi i paaftë të jetë mashtruar duke përfutur nga paaftësia e tij për t'i konceptuar faktet dhe ngjarjen ashtu siç duhet.

Me kategoritë e lartpërmendura barazohet dhe një person i aftë mendërisht dhe fizikisht, por që vendoset në gjendje të pandërgjegjshme, për të llogjikuar dhe për të kuptuar rëndësinë e faktit, nga ana e subjektit aktiv me qëllim kryerjen e marrëdhënies seksuale.

Normativa ligjore siguron një kompromis midis faktit që paaftësia mendore e njërit partner nuk passjell pavlefshmërinë e pëlqimit për kryerjen e një marrëdhënie

seksuale dhe midis faktit që kjo normativë mbron të paaftët mendërisht nga veprimet abuzive për të përfituar nga pazotësia e subjektit pasiv.

Megjithatë është detyrë e organeve të drejtësisë për të verifikuar nëse në çdo rast konkret kemi abuzim nga ana e subjektit aktiv, manipulim të procesit të formimit të vullnetit të subjektit pasiv apo kemi të bëjmë me një zgjedhje dhe vendosje autonome e të pavarur.

Kjo sjell nevojën për vlerësimin e të gjitha veçorive të rastit konkret duke i kushtuar vëmendje të veçantë si kontekstit të jashtëm në të cilin ka ndodhur fakti (me qëllim analizimin sa më të saktë të zhvillimit të personalitetit të subjektit pasiv në relacion me ambjentin e jashtëm) po ashtu dhe subjektit aktiv (me qëllim për të verifikuar nëse ai është i vetëdijshëm për kushtet në të cilat ndodhet subjekti pasiv dhe për paaftësinë e tij për të bërë rezistencë).

Megjithatë është e rëndësishme të kuptohet fakti që çdo person ka të drejtën e tij për të patur një jetë seksuale të lirë dhe autonome, prandaj aplikimi i këtij neni nuk mund të kuptohet në një sens të gjerë pasi do të kufizonte për të mos thënë që do të bënte të pamundur jetën private personale të personave të paaftë për t'u mbrojtur.

Sipas vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2014 është proceduar 1 rast marrëdhëniesh seksuale ose homoseksuale me dhunë me persona të pazotë për t'u mbrojtur¹²¹. Në vitin 2013 janë proceduar 2 raste¹²².

Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë¹²³ analizon këtë vepër penale në mënyrë të qartë në një nga rastet e shqyrtuara prej saj ku subjekti aktiv është femër e paralizuar dhe me zhvillim të vonuar mendor. Ajo lëviz me karrocë invalidi. Ajo lyp në rrugë ku edhe i është afruar autori i cili është mashkull në moshë madhorë dhe si i tillë përmbush kushtet për përgjegjësi penale para ligjit shqiptar. Ai e ka mashtruar viktimën duke i thënë se kishte nënën të sëmurë të shtruar në spital dhe i ka kërkuar asaj që të hipte në taksì për ta çuar në spital. Ajo e ka besuar, por ai e ka dërguar në një vend të panjohur për të ku më pas ka kryer marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj. Viktima ka bërë titur, por nuk e ka dëgjuar njeri.

Nga ana objektive, krimi i “Marrëdhënies seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t'u mbrojtur” kryhet nga autori me veprime aktive, të kundraligjshme, shoqërisht të rrezikshme të përshkruara më lart.

Gjykata thekson në vendimin e saj “*se nga ana subjektive i pandehuri duhet të veprojë me dashje, d.m.th. që i autori i veprës penale të jetë në dijeni të faktit sei dëmtuari/a është i/e pazotë fizikisht apo mendërisht ose e di që është në gjendje të pandërgjegjshme dhe pavarësisht këtij fakti autori kryen marrëdhënie me të dëmtuarën/in. Por, edhe nëse zhvillimi fizik apo psikik i të dëmtuarit, i analizuar në harmoni me rrethanat e tjera në të cilat ka lindur dhe është zhvilluar njohja mes autorit të veprës penale dhe të dëmtuarit, mund të ngrejë dyshimin se, personi i dëmtuar është i pazotë fizikisht apo mendërisht apo është në gjendje të*

¹²¹ Ibid.

¹²² Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2013, fq.38, cituar.

¹²³ Vendim nr. 1856, datë 19.12.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

pandërgjegjshme, autori i veprës penale është i detyruar të informohet për këtë gjendje të personit të dëmtuar. Marrja e informacionit mund të bëhet me mjete dhe nga persona të ndryshëm. Ky detyrim buron nga neni 4 në lidhje me nenin 103/1 të KP, sipas të cilëve shtetasit nuk mund të pretendojnë përjashtimin nga përgjegjësia penale pasi, nuk janë njohur me ligjin, përveç kur mosnjohja është për shkaqe objektive.

Motivet dhe qëllimi i kësaj vepre penale nuk kanë rëndësi për kualifikimin ligjor të veprës por, mbahen parasysh nga Gjykata në individualizimin e masës dhe llojit të dënimit”.

Nisur nga rrethanat e ngjarjes, Gjykata është e bindur se autori e ka ditur plotësisht se, në momentin e kryerjes së marrëdhënieve seksuale (për pasojë edhe krimit në fjalë) viktima ka qenë person i pazot për tu mbrojtur.

Gjithashtu Gjykata vëren se: *edhe nëse ky fakt mund të linte dyshime tek i pandehuri... .., për shkak të zhvillimit fizik apo psikik të të dëmtuarës ...ky i fundit nuk ka bërë as edhe një përpjekje për t’u siguruar se e dëmtuara, me të cilën po kryente marrëdhënie seksuale kishte ose jo probleme të tilla shëndetësore”.*

3.6 Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën.

Në seksionin e Krimeve Seksuale, neni 105¹²⁴, gjejnë mbrojtje dhe marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale të kryera duke shpërdoruar detyrën.

Kjo është një figurë krimi që paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore dhe pse nuk ndeshet dendur në praktikë.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të çdo personi si dhe autoritetin e organit shtetëror ose publik nga veprimet kriminale.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive me kryerjen e marrëdhënieve seksuale midis sekseve të ndryshme apo homoseksuale midis të njëjtit seks.

Për të patur këtë figurë krimi është esenciale që subjekti pasiv të ketë një marrëdhënie vartësie në detyrë nga subjekti aktiv, i cili shpërdoron detyrën apo përfiton nga marrëdhënia e varësisë me qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale.

Subjekti aktiv është i posaçëm dhe mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe që ka një raport epërsie në detyrë me subjektin pasiv.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim.

Në këtë vepër penale megjithëse mungon elementi dhunë apo kërcënim në kuptimin e ngushtë nga ana e subjektit aktiv, kërkohet ekzistenca e një pozicioni hierarkik,

¹²⁴Neni 105 -“Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar marrëdhëniet e varësisë ose të detyrës dënohet me burgim deri në tre vjet.”

superior apo dominant (si në kuptimin e të drejtës publike po ashtu dhe në atë private) ndaj subjektit pasiv.

Me pozicionin superior që ka subjekti aktiv, megjithëse nuk ushtron dhunë, prezumohet që konsensusi i subjektit pasiv është i vesuar në sensin që vullneti nuk formohet në mënyrën e duhur për shkak të varësisë së tij ndaj subjektit aktiv dhe frikës nga roli që vesh subjekti aktiv. Subjekti pasiv ka frikë se refuzimi i tij mund të passjellë pasoja negative.

Autori i veprës penale përdor detyrën e tij si dhe frikën që ngjall për pasoja negative (heqje nga puna, ulje në detyrë etj.) për t'i siguruar vetvetës favore seksuale nga ana e vartësit të tij.

Sipas disa autorëve koncepti i pozicionit të epërsisë të subjektit aktiv duhet interpretuar gjerësisht, duke mos konsideruar të rëndësishme natyrën juridike apo të faktit të subjektit epror apo të qënurit subjekt që vesh një funksion publik apo privat.

Skema e veprimit të shpërdorimit të detyrës e gjen sigurisht sektorin e aplikimit në fushën e të gjithë atyre raporteve ku njëri subjekt, aktivi, ka një pozicion epror përballë subjektit pasiv ndaj të cilit ka pushtet drejtimi, kontrolli, sanksioni etj. Edhe studentët mund të jenë viktimë të vëmendjes së padëshiruar seksuale nga mësuesit dhe profesorët. Kjo pasi procesi i mësimdhënies ka një shkallë të konsiderueshme të autoritetit dhe pushtetit.

Kjo është një vepër penale që ka rrezikshmëri shoqërore për faktin se subjekti aktiv me veprimet e tij jo vetëm që çënon të drejtën e individit për vetëvendosje të lirë në sferën seksuale, por ndikon në mënyrë negative në autoritetin e institucionit të cilin ai përfaqëson.

Sipas vjetarit të Ministrisë së Drejtësisë në vitin 2013, 2014 nuk është proceduar asnjë rast marrëdhëniesh seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën¹²⁵.

3.7 Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona në gjini apo kujdestari.

Në seksionin e Krimeve Seksuale, neni 106¹²⁶, gjejnë mbrojtje dhe marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale të kryera midis personave në gjini apo në kujdestari. Kjo është një figurë krimi që paraqet rrezikshmëri të madhe shoqërore, por që për vetë moralin e shoqërisë sonë nuk ka përhapje shumë të gjerë.

¹²⁵ Vjetari statistikor i Ministrisë së Drejtësisë për vitet 2014, 2013, cituar.ëë

¹²⁶Neni 106 - "Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë në gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimi, dënohet me burgim gjer në 7 vjet."

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të personave¹²⁷ që janë në gjini me njëri – tjetrin (babait dhe nënës me fëmijët, vëllait me motrën etj.) të atyre që janë në raporte kujdestarie apo birësimi.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive me kryerjen e marrëdhënieve seksuale midis sekseve të ndryshme apo homoseksuale (midis të njëtit seks).

Subjekti është i posaçëm, pra persona që kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale por që kanë një raport gjinie, kujdestarie apo birësimi me njëri-tjetrin.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim.

Marrëdhënia seksuale në gjini quhet ndryshe dhe “inçest”. Mund të kemi a) inçest midis atit dhe bijës (ky është rasti më i shpeshtë); b) inçest midis babait dhe të birit (E përzier me tendenca pedofilie dhe homoseksualiteti); c) inçest midis nënës dhe djalit. (Kjo është një ngjarje që zakonisht ndodh shumë rrallë); d) inçest midis nënës dhe vajzës (është një ngjarje që zakonisht ndodh shumë rrallë); e) inçest midis vëllezërve dhe motrave (kjo është një ngjarje e shpeshtë dhe shumë shpesh e ndikuar dhe nga kurioziteti seksual i fëmijëve ende në moshë të mitur) dhe f) llojet e tjera të inçestit (nga të afërmit e tjerë, që jetojnë së bashku ose jo, si gjyshërit ose xhaxhallarët, etj.)

Ka studiues që fillimet e farës njerëzore i gjejnë te inçesti. Kësaj ideje, ndoshta me një bërthamë të vërtetë, i është larguar shumica dërrmuese e kritikëve dhe e mbarë njerëzimit sepse është fakt që shfaqjet e inçestit në jetën njerëzore, janë luftuar me rreptësi deri në zhdukjen e aktorëve përkatës, që nga fiset e egra deri në shoqërinë e sotme.

Lufta ndaj këtij akti anormal e ka bazën jo vetëm në moral e fe, të cilat kanë shtrënguar masat kanunore për martesën dhe familjen, por edhe se, tashmë të provuar shkencërisht, fëmijët produkt inçesti, kanë rezultuar fizikisht e mendërisht me devijime dhe me gjymtime të rënda.

Megjithë këtë, rastet e inçestit, të kryerjes së marrëdhënieve seksuale me nënën, motrën, babain, vëllain, janë sporadikisht të vërteta. Ajo që ka tronditur vetëdijen e njeriut, është mendimi i shprehur nga psikoanalistët se njeriu qenka i paracaktuar që në foshnjëri, që impulsin e parë seksual, ta provojë me nënën e vet e bashkë me të edhe urretjen ndaj babait. Ëndrrat edhe te të rriturit e fokusojnë këtë fazë të fëmijërisë duke ndjerë një ndjenjë tmerri ndaj vetvetes.

Reflekset e thellësive të ndërgjegjes, impulset e ndrydhura, megjithatë shfaqen në gjumë. Dhe xhungla e pavetëdijes është akoma e paeksploruar.

Me anë të kësaj norme legjislatori, sipas mendimit tim, nuk është se ka dashur të mbrojë vetëm personalitetin seksual të subjekteve, sepse ata janë madhorë dhe të përgjegjshëm për veprimet e tyre. Me anë të kësaj norme legjislatori ka dashur të ruajë vlerat dhe kuptimin e familjes dhe të marrëdhënieve të familjarëve midis tyre.

¹²⁷ Shiko Elezi I., – *E drejta penale*, Tiranë 2015.

Gjithashtu sic e përmenda dhe më lart, është e provuar shkencërisht se nga bashkimi i personave të lidhur në gjini mund të lindin fëmijë me probleme të ndryshme gjenetike, fizike dhe mendore.

Dhe në parashikimin si vepër penale të marrëdhënieve seksuale midis personave në raporte kujdestarie ka dashur të mbrojë vlera të shoqërisë dhe të moralit tonë shoqëror, sepse këto janë raporte që deri diku përafrojnë me raportet në familje.

Megjithatë duhet patur parasysh dhe fakti që kërkohet të evitohet që një marrëdhënie dashurie prindër - fëmijë etj. të kalohet në një lloj tjetër dashurie dhe marrëdhënie. Por edhe konsensusi i subjekteve për kryerjen e marrëdhënieve seksuale mund të quhet se nuk është tërësisht i konceptuar dhe i llogjikuar, pasi në shumë raste (shkak ndoshta dhe niveli i ulët shoqëror, intelektual dhe kulturor) për shkak të marrëdhënieve shumë të ngushta, tërësisht të një natyre tjetër, që këto marrëdhënie mund të keqkuptohen. Pra mendoj se kemi të bëjmë me një “metus psichico”.

Ka autorë që abuzimin seksual në brendësi të familjes e konsiderojnë si formën më të rëndë të dhunës seksuale, pikërisht sepse në këtë rast koncepti i dhunës identifikohet me konceptin e “mungesës së vullnetit”. Unë bashkohem me këtë mënyrë konceptimi. Në fakt raporti i besimit që lidh një fëmijë me prindin, sjell, në pjesën më të madhe të rasteve, nevojën e një doze shtrëngimi për të kryer dhunën, më të vogël sesa ajo që do të nevojitej për një autor të huaj. Fakti që propozimi për të kryer aktin vjen nga personi i cili si rregull ka detyrën për t’i mësuar viktimës dallimin midis të mirës dhe të keqes e bën shpesh të panevojshëm ushtrimin e dhunës konkrete. Në këtë drejtim moshë e viktimës bëhet një faktor shumë i rëndësishëm. Sa më e lartë diferenca e moshës midis autorit dhe viktimës aq më e lartë dhe shkalla e varësisë së viktimës nga autori i veprës penale¹²⁸.

Në vitin 2014 Prokuroria ka rregjistruar vetëm një rast të kësaj vepre penale, për të cilin janë dënuar dy persona si autorë në gjini apo kujdestari. Në vitin 2015 është rregjistruar vetëm një rast i cili është ende në shqyrtim¹²⁹.

Nga vjetari i Ministrisë së Drejtësisë evidentohet që në vitin 2014 është proceduar një rast vepre penale mbi marrëdhëniet seksuale apo homoseksuale me persona në gjini apo kujdestari¹³⁰.

Në lidhje me pasojat që një krim i tillë krijon tek viktimë duhet theksuar se ky krim seksual i kryer në mesin e "katër mureve", prodhon më shumë dëme të rënda psikologjike se dhuna "jashtë", sidomos kur ka disa karakteristika:

- sa më e ngushtë marrëdhënia me personin që bën abuzimin aq më të rënda pasojat;

¹²⁸ Cadoppi A. (a cura di) *La violenza sessuale a cinque anni dalla legge n.66/96. Profili giuridici e criminologici*. Padova, Cedam, 2001, fq.198. Sot është gjithnjë e në rritje numri i familjeve të formuara nga një prind dhe bashkëshorti/ja e prindit. Kryerja e abuzimit të këtij të fundit mbi fëmijën e bashkëshortit/tes do të inkuadrohet në këtë vepër penale vetëm në rast se autori rezulton prind birësues apo kujdestar i viktimës. Në fakt, edhe kur autori është thjesht bashkëjetues/se e prindit shpesh herë ai gëzon mbi viktimën të njëjtin autoritet që gëzon dhe prindi i tij dhe në këtë drejtim pasojat e abuzimit janë të njëjtat që përmendëm më lart.

¹²⁹ Statistika të Prokurorisë së Përgjithshme Shqiptare.

¹³⁰ Vjetari 2014, fq. 37.

- sa më e përsëritur marrëdhënia në kohë aq më të rënda pasojat;
- nëse personi i abuzuar është ende i mitur.

Mund të dallojmë tri forma themelore klinike nëpërmjet të cilave mund të manifestohet krimi seksual brenda familjes:

- 1) Abuzime seksuale të shfaqura : përfshijnë sjellje të ndryshme me kontakt, nga forma të buta të joshjes (puthjet, përkëdheljet, lakuriqësi) deri tek më të rëndat (masturbim reciprok, seks oral, raporte gjithëpërfshirëse etj);
- 2) Abuzime seksuale të maskuara: Konsiderohen praktika të tilla të pazakonta, si larja e organeve gjenitale, inspektimet e përsëritura (anale, vaginale), aplikimi i kremit, etj. Në këtë grup janë përfshirë si abuzime seksual edhe asistimi i fëmijëve në aktet seksuale të prindërve të tyre, me kërkesë specifike të vetë prindërve. Në situata të tjera më komplekse, kur fëmija është thirrur për të asistuar në abuzim seksual që një prind është duke bërë me një vëlla ose motër.
- 3) Pseudo Abuzimet: janë “abuzime” që nuk janë konsumuar në të vërtetë, por janë deklaruar si të tilla si rezultat i delireve apo perceptimeve të gabuara të një prindi apo pjestari tjetër të familjes apo me qëllim për të diskredituar një anëtar të familjes¹³¹.

Për shkak të burimit të ngacmimit, abuzimi seksual brenda familjes prodhon, në parim, efektet më të rënda se ato të shkaktuara nga abuzimi që ka ndodhur jashtë familjes.

Krimet seksuale, në përgjithësi, dhe, veçanërisht brenda familjes, mund të çojnë në shumë probleme psikologjike me afat të gjatë dhe të vështira për t'u zgjidhur spontanisht gjatë jetës. Kështu, krimet seksuale brenda familjes kanë pasoja të tilla si:

- Çrregullim i stresit post - traumatik;
- Çrregullim patologjik të personalitetit (çrregullim borderline)
- Gjendje ankthi.

Duhet theksuar se fëmijët, e abuzuar brenda familjes, kanë një mungesë themelore të besimit të tjerët dhe një tendencë për të kuptuar sjelljen e tjerëve si armiqësore dhe kërcënuese. Reagimet tipike të të abuzuarit janë: vështirësi në marrëdhëniet ndërpersonale dhe sjellje agresive ndaj moshatarëve dhe të rriturve që u afrojnë me abuzuesit. Sic është analizuar në kreun e mëparshëm, edhe pse një pjesë e viktimave e harrojnë krimin e pësuar ata përsëri janë më shumë në rrezik për t'u përfshirë në akte kriminale apo në pasojat e një sëmundje mendore.

Në lidhje me autorin, dispozita e analizuar më lart, merr në konsideratë që ata që kryejnë abuzimin janë zakonisht anëtarë të familjes ose, në çdo rast tjetër, njerëzit të cilëve fëmija i njeh dhe u beson shpesh sic është kujdestari. Legjislatori e dënon marrëdhënien me këtë të fundit edhe pse ky mund të mos ketë lidhje gjaku me pjesëmarrësin në marrëdhënien seksuale.

¹³¹ Montecchi F., *Le varie forme di abuso sessuale, në I abusi all'infanzia. Dalla ricerca all'intervento clinico*, La nuova Italia scientifica, Roma, 1994.

3.8 Veprat e turpshme me të mitur.

Në seksionin e Krimeve Seksuale, neni 108¹³², gjen mbrojtje dhe kryerja e veprave të turpshme me të mitur.

Objekt i mbrojtjes ligjore është zhvillimi normal seksual i të miturit që nuk ka mbushur moshën 14 vjec.

Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive të turpshme fizike ose amorale ndaj të miturve. Me veprime të turpshme kuptojmë ato mënyra të të kënaqurit të epshit seksual që nuk përbëjnë vepër tjetër penale. (prekje, fërkimet etj.)

Subjekti është i përgjithshëm, pra persona që kanë mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe janë të përgjegjshëm.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim. Ana subjektive është elementi kryesor për të bërë dallimin e kësaj vepre penale nga ajo e parashikuar nga neni 100 i K.Penal të mbetur në tentativë, pasi për cilësimin juridik të kësaj vepre penale kërkohet që qëllimi i autorit të veprës penale të jetë vetëm kryerja e veprimeve të turpshme dhe jo kryerja e marrëdhënieve seksuale.

Kjo është një vepër penale që rrezikon të mirën e mbrojtur nga ky nen, që sic e thamë më lart është zhvillimi normal seksual i të miturit dhe formimi i personalitetit të tij seksual.

Veprimet e turpshme konsistojnë në çfarëdo lloj akti objektivisht të referueshëm jetës seksuale dhe që perceptohet në rast se do të vëzhgohej si shprehje e një impulsi erotik që nuk ka si qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale, por thjesht kënaqjen e epsheve të subjektit aktiv me këto veprime që nuk përbëjnë “akt seksual”.

Këto veprime të turpshme dhe pse nuk manifestohen me veprime të dhunshme apo kërcënime, për modalitetin e tyre mund të provokojnë shqetësime dhe kushtëzime të dëmshme të zhvillimit të qetë e normal të personalitetit seksual të të miturit dhe vlerat e tij si njeri reduktohen në send (ndoshta dhe pa vetëdijen e të miturit) nga ekzibicionizmi i sëmurë i subjektit aktiv.

Normativa legjislativë mbron zhvillimin normal seksual të të miturit nën 14 vjec që mund të turbullohet nga këto veprime dhe ndoshta kjo ka qenë arsyeja që një vepër e tillë nuk parashikohet për të miturit 14-18 vjec, pasi i mituri në këtë moshë mendohet se e ka arritur një shkallë të tillë koshience në fushën seksuale sa nuk mund të turbullohet më nga asistimi i vullnetshëm në kryerjen e veprimeve të tilla.

Me parashikimin e kësaj vepre penale për mendimin tim legjislatori mbron jo vetëm personalitetin seksual të të miturit, por edhe vlerat e njeriut që mbarten dhe do të zhvillohen në të ardhmen brenda të miturit.

¹³²Neni 108 -“Kryerja e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën 14 vjec, dënohet me burgim në 5 vjet.”

I mituri instrumentalizohet dhe pse nuk mund të jetë i vetëdijshëm për atë që po ndodh dhe ndoshta nuk e kupton që ndaj tij po kryhen veprime të turpshme dhe ai po përdoret për kënaqësitë seksuale të subjektit aktiv dhe për këtë legjislatori nuk e kushtëzon ekzistencën e kësaj vepre penale me pëlqimin e të miturit apo me dhunë të ushtruar ndaj tij.

Ai mbrohet pavarësisht shkallës së koshiencës dhe eksperiencës në fushën seksuale dhe duhet të vazhdohet të mbrohet dhe pse mund të ketë pjekuri të mjaftueshme seksuale, sepse veprat e turpshme mund ta cojnë në mbylljen në vetvete të të miturit si dhe në krijimin e një bote të tij të gabuar në fushën seksuale.

Nga vjetari i Ministrisë së Drejtësisë evidentohet që në vitin 2014 janë proceduar 26 raste vepre penale “akte të turpshme”¹³³. Në vitin 2013 janë proceduar 14 raste¹³⁴.

Midis rasteve të analizuara nga Gjykatat shqiptare përmendim rastin e një autori shqiptar, mashkull në moshë madhore i cili, përmes ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike, ka ngacmuar seksualisht tre vajza të mitura, motra midis tyre, njëra e moshës 14 vjeç, tjetra 10 vjeç si dhe e treta 6 vjeç. Ai ka kryer me to veprime të turpshme si zhveshja e tyre¹³⁵.

Nga ana objektive vepra penale konsumohet me veprime të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme. Vepra penale është kryer me veprime materiale të drejtpërdrejta për realizimin e veprës dhe duke u shoqëruar nga elementi psikologjik i dashjes së drejtpërdrejtë. Objekti i këtij krimi seksual, është cënimi i marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale, shëndetin dhe jetën e të miturave. Autori ka patur dijeni për moshën e viktimave, por kjo dijeni nuk e ka ndaluar atë së vepruari.

Në një rast tjetër¹³⁶ një i moshuar i moshës 72 vjec kryen me një të mitur veprime të turpshme të përsëritura si “prekje me duar në gjoks dhe në organin gjenital si dhe puthje në buzë”. Këto veprime janë kryer nga i gjykuari para se e dëmtuara të arrinte moshën 14 vjeç, duke konsumuar kështu veprën penale të kryerjes së veprimeve të turpshme, parashikuar nga neni 108 i Kodit Penal. Po kështu më pas në kohë, ai ka kryer marrëdhënie seksuale me të miturën duke e lënë atë shtatzanë¹³⁷.

¹³³ Vjetari statistikor i Ministrisë së drejtësisë për vitin 2014, cituar, fq. 37.

¹³⁴ Vjetari statistikor i Ministrisë së drejtësisë për vitin 2013, cituar, fq.38.

¹³⁵ Shiko për më gjatë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.1099, datë 17.07.2008, Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.254, datë 23.04.2009 dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendim nr.00-2012-1255.

¹³⁶ Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr.133, date 14.11.2008, ka vendosur: Lenien ne fuqi te vendimit nr.225, date 23.06.2008 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe dhe Gjykata e Lartë, me vendim nr.00-2010-341 (59), datë 29.01.2010 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të apelit.

¹³⁷ Shiko për më gjatë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.1099, datë 17.07.2008, Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.254, datë 23.04.2009 dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendim nr.00-2012-1255.

Në lidhje me krimin e veprimeve të turpshme, nga ana objektive vepra penale konsumohet me veprime të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme, të përmendura më lart.

Edhe në këtë rast objekti i këtij krimi seksual, është cënimi i marrëdhënieve juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale, shëndetin dhe jetën e të miturave. Autori ka vepruar me dashje të drejtpërdrejtë.

Në një rast tjetër¹³⁸ bëhet fjalë për një burrë të moshës 60 vjec i cili kryen veprime të turpshme me një të mitur. Më konkretisht autori takon rastësisht viktimën dhe nis të flasë me të, duke “e bërë atë shok”. Ai më pas me dashje e shoqëron viktimën në një vend larg vëmendjes së familjarëve të tij. Veprimet e turpshme konsistojnë në puthje nga ana e të pandehurit në vende intime, si buzët e viktimës. Këto veprime, sic pohon dhe Gjykata, kanë patur si qëllim të vetëm krijimin e kënaqësive trupore për të pandehurin. Gjykata pohon se cdo arsyetim mesatar normal do të konsideronte si veprim të turpshmëm puthjen në buzë të një të mituri nga një burrë mbi 60 vjec, pa lidhje gjaku apo farefisnore me të dhe në një ambient publik.

Nga ana objektive autori me veprimet e tij të kundraligjshme dhe shoqërisht të rrezikshme ka cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të mbrojtur moralin shoqëror në përgjithësi dhe vecanërisht mënyrën e jetesës dhe mirërritjen e fëmijëve nën 14 vjec. Autori është madhor dhe si rrjedhojë ai është në gjendje të kuptojë dhe të kontrollojë veprimet e tij si dhe pasojat që vijnë prej tyre. Nga ana subjektive ai ka vepruar me dashje duke e patur të qartë se po shoqërohej me një të mitur dhe se po kryente veprime epshndjellëse me të.

Gjithashtu legjislatori ka parashikuar në paragrafin e dytë të këtij neni kryerjen e kësaj vepre penale nga subjekte me të cilët i mituri ka marrëdhënie familjare, duke ashpërsuar në këtë rast dhe masën e dënimit. Pa rënë në përsëritje për sa është thënë më lart legjislatori në këtë rast përveç objektit kryesor të kësaj vepre penale ka dashur të mbrojë dhe të ruajë një marrëdhënie të shëndetshme familjare dhe të ruajë ambientin familjar në të cilin i mituri rritet dhe edukohet.

Dhe thjesht fakti që një person i rritur përfshin qëllimisht si dëshmitar në veprime me natyrë seksuale një të mitur përbën vepër penale, duke dashur kështu legjislatori të mbrojë zhvillimin normal si të sferës seksuale të të miturit po ashtu dhe formimin dhe qëndrimin psikologjik të të miturit ndaj seksit, me qëllim një formim sa më të përshtatshëm dhe në përputhje me normat e etikës dhe të shoqërisë, me qëllim ndalimin e deformimeve të sferës perceptivë dhe konceptuale të të miturit.

Me qëllim mbrojtjen totale të të miturit nga cdo veprim që mund të cënojë atë në cdo lloj forme që mund të ketë ndikim si në formimin seksual, po ashtu dhe në atë shëndetësor, moral dhe mendor legjislatori parashikon në paragrafin e katërt të këtij neni si krim propozimin, me cdo mjet ose formë, që mund të bëhet nga një i rritur për të takuar një të mitur nën moshën 14 vjec apo që nuk arritur pjekurinë seksuale me qëllim kryerjen e ndonjë nga veprat penale të këtij seksioni (pra veprat penale në sferën seksuale) apo të seksionit të VIII kreu II (vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit si prostitucioni, pornografia etj).

¹³⁸ Shiko për më gjatë: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 2011, datë 26.12.2012.

3.9 Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në vende publike.

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në vende publike ose në ambiente të ekspozuara nga vështrimi i njerëzve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

Ky parashikim përmbahet në nenin 107, në brendësi të seksionit të krimeve seksuale.

Në të vërtetë gjendemi para një figure kriminale e cila nuk ka si qëllim mbrojtjen e lirisë seksuale të subjekteve, por mbrojtjen e moralit publik.

Subjekti aktiv dhe ai pasiv veprojnë me konsensus duke qënë dakort për kryerjen e marrëdhënieve seksuale/homoseksuale midis tyre. Subjektet aktive dhe pasive mund të jenë si meshkuj ashtu dhe femra në moshën mbi 14 vjeçare.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të ruajtur dhe mbrojtur moralin publik.

Nga ana objektive kjo vepër vihet në jetë përmes kryerjes së marrëdhënies seksuale/homoseksuale në një hapësirë të destinuar për publikun edhe pse në momentin e kryerjes së marrëdhënies në fjalë në atë hapësirë mund të mos kenë qenë të pranishëm individë të tjerë. Pra legjislatori nuk dënon marrëdhënien midis subjekteve si të tillë, por i ndalon ata që të ekspozojnë këtë marrëdhënie në vende publike. Dashja është e drejtpërdrejtë për të kryer marrëdhënien në vendin publik. Mendoj se kjo figurë kriminale mund të mos rregullohet në këtë seksion, por midis veprave penale që mbrojnë moralin dhe dinjitetin (seksioni VIII i kreut II)

3.10 Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim me përdorimin e armës.

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke kërcënuar personin e dëmtuar për përdorim aty për aty të armës, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lirinë dhe paprekshmërinë seksuale të femrës/mashkullit nga veprimet kriminale që çenojnë sferën e saj/tij seksuale. Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive të shoqëruara me dhunë psikike me qëllim kryerjen e marrëdhënieve seksuale me viktimën. Gjendemi para një figure kriminale e cila ka si element esencial të anës objektive ushtrimin e dhunës psikologjike se nëse personi nuk do të kryejë marrëdhënie seksuale/homoseksuale me autorin atëherë ky i fundit do të përdorë armën aty për aty mbi të duke i marrë jetën apo duke i shkaktuar dëmtime në trup. Pra rreziku që i kanoset viktimës është i mënjëhershëm, real, serioz dhe joimagjinar. Kemi të bëjmë me një vepër penale mjaft të rëndë. Kërcënimi që i bëhet viktimës është i tillë që kjo e fundit nuk ka asnjë mundësi që ti shmangët kryerjes së krimit seksual.

Legjislatori nuk përcakton një moshë për subjektet pasive të cilat mund të jenë meshkuj apo dhe femra. Subjekt aktiv mund të jetë çdo person i gjinisë mashkullore apo femërore që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale,

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim kriminal. Edhe pse praktika shqiptare gjyqësore nuk dëshmon për shumë raste të këtij krimi seksual, nuk mundemi të pohojmë se kemi të bëjmë me një krim që shfaqet rrallë në praktikë. Është më e mundur që si pasojë e kërcënimit real që i bëhet viktimës kjo e fundit të jetë e shtyrë që të mos e denoncojë krimin në fjalë.

Kërcënimi për përdorim të armës në vetvete përbën një formë dhune. Pra, ky krim mundej edhe të mos rregullohej nga autori si figurë krimi më vete, por do të ishte e udhës që kërcënimi për përdorim arme të cilësohej si rrethanë rënduese dhe si e tillë të parashikohej dhe në dispozita të tjera të lidhura me krime të tjera seksuale.

3.11 Dhuna seksuale.

Dhuna seksuale si figurë vepre penale më vete përbën një risi për legjislacionin shqiptar. Dispozita që rregullon këtë veper penale është shtuar përmes ligjit 144/2013, datë 2.5.2013.

Neni 107/a i Kodit Penal përcakton se *“Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën veper penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.”*

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë seksuale, jetën dhe shëndetin të të rriturve e të miturve 14-18 vjec si dhe zhvillimin normal seksual të të fëmijës së mitur apo të të miturës që nuk ka arritur pjekurinë seksuale. Element që shoqëron këtë veper penale është përdorimi i dhunës si në formën e dhunës fizike ashtu dhe në formën e dhunës psikologjike.

Ku qëndron e veçanta e kësaj figure krimi?

Sigurisht në mënyrën dhe mjetet e kryerjes së saj. Nga ana objektive krimi kryhet përmes veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër duke përdorur objekte të ndryshme. Legjislatori nuk e specifikon natyrën e objekteve duke e zgjeruar në këtë mënyrë fushën e veprimit të dispozitës.

Në lidhje me subjektet, subjekt aktiv mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndërsa subjekti pasiv është çdo person madhor dhe çdo fëmijë i mitur. Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim.

Kur kjo veper kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo veper kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Kur kjo veper ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

Mendoj që miratimi i dispozitës ishte i domosdoshëm pasi në mungesë të saj sjelljet me natyrë seksuale, devijante, të cilat kryhen përmes objekteve nuk do të ishin të pa ndëshkueshme, por, sipas specifikave të rasteve konkrete, ato do të inkuadroheshin në figura të tjera të veprave penale të parashikuara nga legjislatori shqiptar si rrahje, plagosje të lehta apo të rënda dhe vrasje. Por objekti do të ishte i gabuar pasi në këto grup veprash penale legjislatori mbron jetën dhe shëndetin e subjektit pasiv, ndërsa me ndryshimet e bëra objekti kryesor është ai i mbrojtjes së sferës seksuale, por njëkohësisht dhe shëndeti e jeta e personit.

3.12 Ngacmimi seksual.

Ngacmimi seksual si vepër penale përbën një risi në legjislacionin penal shqiptar. Dispozita që ndalon ngacmimet seksuale është neni 108/a i cili mbyll edhe seksionin e krimeve seksuale. Kjo dispozitë është shtuar me ndryshimet e ligjit nr. 144/2013, datë 2.5.2013.

Legjislatori pohon se “Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që cenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”.

Kemi të bëjmë me një vepër penale më të lehtë sesa veprat penale të analizuara më lart, me përjashtim të veprës së marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në vende publike.

Legjislatori duhet përgëzuar për iniciativën e miratimit të kësaj vepre të re penale. Duhet nënvizuar se përmes saj plotësohet një boshllëk ekzistues në normativën e krimeve seksuale. Ky parashikim bën të mundur që në sferën e veprimit të dispozitës së mësipërme të inkuadrohen disa sjellje më të lehta, por ndoshta edhe më të shpeshta, të cënimit të lirisë seksuale. Në mungesë të kësaj figure kriminale sjellje të tilla do të konsideroheshin si kundravajtje penale parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal “Fyerja”. Në rastet për të cilat flasim bëhet fjalë për prekje, përçafime, ngacmime të ndryshme apo puthje të dhëna në zona të tilla të trupit që nuk inkuadrohen si akt seksual.

Për kryerjen e ngacmimeve seksuale nuk kërkohet elementi i dhunës në asnjërën prej formave të saj.

Objekt i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar paprekshmërinë seksuale dhe dinjitetin e çdo personi. Nga ana objektive krimi kryhet me veprime aktive që identifikohen me sjellje me natyrë seksuale.

Legjislatori pranon se këto sjellje mund të zhvillohen përmes çdo mjeti apo formë. Përmes këtij pohimi ai e ka zgjeruar shumë sferën e veprimit të dispozitës. Nga ana tjetër sfera e veprimit ngushtohet disi kur legjislatori kërkon që si rrjedhojë e këtyre sjelljeve të krijohet një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues për viktimën, gjë që nënkupton vazhdueshmëri në veprimet e subjektit aktiv. Subjekt aktiv mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën për përgjegjësi penale, ndërsa subjekti pasiv mund të jetë si person që ka mbushur moshën për përgjegjësi

penale ashtu dhe çdo fëmijë i mitur. Një risi tjetër e gjejmë në parashikimin e mundësisë që subjekti aktiv mund të jetë edhe një femër e cila ngacmon seksualisht një mashkull apo një femër tjetër.

Nga ana subjektive krimi kryhet me dashje të drejtpërdrejtë për të realizuar këtë veprim. Siç u përmend më lart kjo dispozitë përfshin të gjitha ato sjellje të cilat çenojnë dinjitetin e personit, lirinë e tij seksuale, por që nuk mund të inkuadrohen si raste dhune seksuale. Pra është një figurë më e lehtë kriminale dhe si e tillë shoqërohet me një sanksion më të lehtë se ato që shoqërojnë krimet ku inkuadrohet një marrëdhënie seksuale. Kjo veprë penale *dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet*.

Dispozita përmban edhe një paragraf të dytë ku përcaktohet se në rastet kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, apo kundër disa personave, apo më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Pra këto janë të gjitha rrethanat të cilësuarat të kryerjes së veprës penale.

Nuk mund të lëmë pa përmendur faktin se legjislatori moshën e viktimës (faktin që bëhet fjalë për një subjekt të mitur) e konsideron si rrethanë të cilësuar duke e shoqëruar veprën me një sanksion më të rëndë. Ky sanksion është i njëjti me atë që legjislatori parashikon në rastet kur kryhen vepra të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërbëdhjetë vjeç¹³⁹.

Duhet nënvizuar se ngacmimet seksuale janë të shpeshta edhe në vendin e punës. Kështu, mund të konsiderohen të tilla insinuatat dhe komentet për pamjen e të punësuarve, vërejtjet rreth karakteristikave dhe sjelljes e orientimit seksual, kontaktet e padëshiruara fizike, ekspozimi i materialeve pornografike. Ndërsa detyrimi për të kryer aktin seksual nga eprori do të konsiderohet si marrëdhënie seksuale e kryer në shpërdorim të detyrës.

Në studime të ndryshme në botë rezulton se më shumë se gjysma e grave të moshës 14-59 vjeç ka pësuar të paktën një ngacmim seksual, shantazh seksual në punë ose dhunë seksuale apo tentativë. Viktimat e përdhunimit ose tentativave të përdhunimit dhe ngacmimi seksual në punë përfaqësojnë një pjesë minimale të viktimave të krimeve seksuale gati 2.9 për qind e viktimave të dhunuara ose që janë tentuar për t'u dhunuar. Format më shpesh të hasura në kërkimin e favoreve seksuale në punë janë ngacmimet, telefonatat e pahijshme, kërcënimet për pushim nga puna etj. Gjithashtu të zakonshme janë edhe rastet e përndjekjes apo dhe aktet e ekzibicionizmit me gati 23 për qind. Të dhënat tregojnë se vetëm 18.3 për qind e viktimave të dhunës seksuale të kryer apo mbetur në tentativë e ka pësuar atë nga të huajt. Më shpesh, autorët janë njerëz të njohur dhe të afërt me viktimat si bashkëshorti apo bashkëjetuesi, miqtë e vet apo miqtë e shoqërisë, punëdhënësit, kolegët, mësuesit apo shokët e klasës.

Por fakti me shqetësues është që më shumë se 43 për qind e grave kanë pësuar përdhunimin apo tentativë përdhunimi në familje kundër 21.1 për qind që e kanë pësuar atë të themi “në rrugë”.

¹³⁹ Shiko nenin 108.

KAPITULLI IV

STANDARTI I PROVËS NË KRIMET SEKSUALE. POZITA E VIKTIMËS NË PROCESIN PENAL. NDIHMA JURIDIKE.

4.1 Hyrje.

Dhuna seksuale është një nga fenomenet më të tmerrshme të jetës njerëzore. Ajo është në antitezë të fortë me civilizimin, me interesin e rregullit juridik jo vetëm për të ruajtur paprekshmërinë fizike të njeriut, por edhe moralin dhe etikën bashkëkohore.

Lind e nevojshme të vendosësh përballë sjelljes njerëzore që dhunon seksualitetin e personave në forma dhe mënyra nga më të ndryshmet një mur të përbërë nga norma juridike, të sjelljes e kulturës, të parandalimit, të shtypjes dhe ndëshkimit. Në këta dhunues jeton i fshehur pas falsitetit dhe maskës imoraliteti fizik, shpirtëror dhe mendor.

Njeriu i rrugës vepron duke injoruar cdo lloj vije demarkacioni mes civilizimit dhe të vepruarit kafshëror. Mjekët përpiqen të gjejnë tek pedofili, dhunuesi profile te patologjive genetike të cilat duhet ndjekur dhe kuruar; psikologu dhe sociologu studiojnë pëpiqen të gjejnë shkaqet që kanë ndikuar në personalitetin e tyre dhe i kanë bërë këta persona seksualisht të dhunshëm.

Ndërsa juristi vëzhgon faktin e ndodhur, e vendos para një norme juridike abstrakte dhe shpreh mendimin e tij. Nëse fakti përputhet me normën atëherë do të ndodhemi para një vepre penale në sferën seksuale.

Përballë këtyre dhunuesve vendosen personat ndaj të cilëve kryhen këto veprime, që zakonisht janë gra, fëmijë dhe persona me paaftësi fizike apo mendore, pra të gjithë subjekte që karakterizohen nga një brishtësi. Është detyrë e shtetit t'u garantojë atyre sigurinë maksimale të një vlere kaq të shtrenjtë dhe të fshehtë, sic është sfera seksuale, siguri e cila duhet të jetë në fuqinë e saj maksimale pikërisht për shkak të aftësive minimale që kanë këto subjekte për t'u vetëmbrojtur.

Juristi duhet të jetë dhe cinik, i ftohtë dhe deri diku i pandjeshëm, sepse vetëm këto karakteristika mund ta lejojnë atë ta vëzhgojë faktin me ekuilibrin maksimal të mundshëm, duke i dhënë nga njëra anë viktimave vëmendjen dhe kujdesin e duhur, ndërsa nga ana tjetër t'i sigurojë autorëve të njëjtën shkallë maksimale drejtësie.

Personi që akuzohet për kryerjen e një vepre penale ndaj sferës seksuale etiketohet si pervers dhe nëse pas hetimesh të shumta do të rezultojë pafajësia e tij do të jetë shumë e vështirë t'i hiqet etiketa e vënë, do të jetë shumë e vështirë të fshish mendimin e mjedisit rrethues dhe kujtimet e tyre. Në mendimet e tyre do të mbetesh po me të njëjtën nofkë.

Juristi ka detyrimin të mbrojë të drejtat e të gjithë palëve në proces dhe të zgjedhë rrugën e duhur për të evituar dramën dhe padrejtësitë si ndaj personave të dëmtuar nga këto vepra penale po ashtu dhe ndaj personave të akuzuar për kryerjen e këtyre veprave penale.

Gjyqtari, prokurori, avokati duhet të jenë shumë të kujdesshëm të mos bëjnë gabime. Ata duhet të përfaqësojnë njëkohësisht profesionalizmin, intuitën, kapacitetin deduktiv, argumentin, llogjikën dhe pasionin. Asnjëherë nuk duhet të harrojnë parimin e të drejtës "Më mirë një i fajshëm në liri, sesa një i pafajshëm në burg".

Në veprat penale kundër sferës seksuale këto tipare duhet të jenë më të theksuara, sepse janë vepra penale të rënda dhe shumë delikate që sjellin pasoja të mëdha si për subjektet pasivë, po ashtu dhe për subjektet aktivë. Dhe kur flasim për vepra penale të rënda nuk marrim në konsideratë vetëm masën e dënimit të parashikuar nga normat penale, por marrim në konsideratë ndikimin që kanë në ndërgjegjen qytetare, por mbi të gjitha ndikimin që kanë në vetë personat e përfshirë. Një vepër penale në fushën e drogës, trafikim qoftë, ka shumë më pak ndikim dhe për kohë shumë më të shkurtër në ndërgjegjen e njerëzve, ndërsa dhunimi i një fëmije apo i një gruaje që është njëkohësisht nënë, motër, bijë jeton gjatë në mendjen dhe shpirtin e shoqërisë, duke mos lënë mënjane faktin që nuk do të shlyhet kurrë nga memoria e viktimës.

Po kështu dhe subjekti aktiv dhe pasi të vuante dënimin do të mbetet i etiketuar si përdhunues dhe i tillë do të mbetet po të deklarohej i pafajshëm.

Vrasja është një vepër penale shumë e rëndë, që e privon njeriun nga gjëja më e shtrenjtë jeta, por mos harrojmë që njeriu i përdhunuar privohet tërë jetën nga dinjiteti i tij njerëzor, shkatërrohen siguritë që ka tek vetja. Krimet ndaj sferës seksuale janë veprat penale më të ulëta dhe të egra që shkatërrojnë tërësisht subjektin pasiv, por jo më pak dhe subjektin aktiv.

Prandaj juristi që heton apo gjykon këto vepra penale duhet të jetë i ndërgjegjshëm për detyrën e tij, duhet të jetë i mbushur me shkencë dhe ndërgjegje, kurrë të mos kufizohet në atë që duket dhe të jetë gjithmonë në kërkim të të vërtetës absolute. Duhet të mos lihet mënjane asnjë provë, të shqyrtohet cdo gjë me thellësi, cdo dëshmi, cdo akt ekspertimi, cdo provë sado e parëndësishme të duket me qëllim që të provohet që fakti ka ndodhur në një mënyrë të caktuar dhe është kryer nga personi i akuzuar. Gjyqtari, nëpërmjet cmuarjes së provave, bindjes së brendshme, përtej cdo dyshimi duhet të vendosë mbi fajësinë apo pafajësinë e personit të akuzuar.

Dua të theksoj që krimet seksuale për shkak të natyrës së tyre si dhe mekanizmit të kryerjes në praktikë paraqesin vështirësi të mëdha në kuadër të provueshmërisë. Shpeshherë e gjithë akuza bazohet vetëm në thëniet e të dëmtuarës, në mungesë të shenjave të dhunës, në mungesë të gjurmëve biologjike.

Në këtë aspekt vlerë të veçantë merr teoria e provave dhe procesi i të provuarit, të cilat përbëjnë një nga elementet thelbësore të procesit penal. Përballë nevojës për ndëshkimin e krimit është parimi i pandëshkueshmerisë së personit që nuk e ka kryer veprën penale. Prandaj në këto kushte është e nevojshme përcaktimi i standartit të provës për këto vepra.

Varësisht nga sistemi i zgjedhur peshorja e drejtësisë mund të anojë në drejtim të efektivitetit të zbatimit të ligjit penal ose në anën e kundërt – në drejtim të garantimit më të mirë të të drejtave dhe lirive të njeriut. Sistemet e përziera, sikundër është dhe sistemi ynë i procedurës penale, synojnë të gjejnë drejtpeshimin e duhur të interesave në lojë. Ndër vite, në procedurën penale janë vendosur dhe pranuar nivele të caktuara të të provuarit për të deklaruar një person fajtor për shkeljen e ligjit penal, ose ndryshe standarde të caktuara. Këtij procesi i ka paraprirë bota anglosaksone, më e ndjeshme ndaj interesave të individit dhe më larg arsyes shtetërore *à la française*. Por, dora -

dorës vlerat e procesit anglosakson po fitojnë të drejtën e qytetarisë edhe në vendet e traditës së civil laë.

Duhet të theksohet se procesi i të provuarit është fleksibel dhe i kushtezuar nga indikatorët e figurës së vepres penale, e cila futet në kategorinë e krimeve seksuale. Kështu të ndryshëm janë indikatorët që përbëjnë elementet e “Marrëdhënies me dhunë me të rritura”, në krahasim me ata që përbëjnë “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”, duke ndikuar në standartin e provës.

4.2 Provat tipike (të zakonshme) që ndeshen në krimet seksuale.

4.2.1 Njolla sperme, materiali vaginal, pështymë, materiale fece dhe urine.

Këto prova paraqesin rëndësi të veçantë në krimet seksuale për vërtetimin e aktit seksual të kryer dhe për zbulimin e autorit të krimit. Grupi hetimor gjatë kqyrjes së vendit të ngjarjes, të kqyrjes së personit, ndaj të cilit është ushtruar dhunë seksuale, duhet të tregohet i vëmendshëm në gjetjen dhe fiksimin e këtyre provave.

- Sperma, e cila mund të klasifikohet në dy kategori:

a) Spermë me spermatozoidë, spermë e përfituar nga një mashkull me shëndet normal, që përmban spermatozoidë që janë të pasur me ADN. Metoda e përdorur e ekstraktimit e veçon spermën nga materiali tjetër qelizor, si për shembull qelizat vaginale¹⁴⁰.

b) Spermë pa spermatozoidë, spermë që përmban shumë pak ose aspak spermatozoidë dhe që prodhohet nga meshkuj, të cilët kanë kryer një vazektomi (operacion për heqjen e kanalit të spermës), që prodhojnë një sasi të vogël sperme ose që janë joprodhues. ADN-ja mund të sigurohet nga qelizat që bien gjatë derdhjes së spermës. Natyra e këtyre kampioneve është e tillë që nuk mund të kryhet ekstraktimi i favorizuar i komponentit të farës. Si rrjedhim, në ato raste kur ka një komponent të madh femëror, psh. material vaginal, mund të mos jetë e mundur që rezultatet t'i atribuohen spermës.

Sperma kur bie në tesha thithëse krijon njolla në ngjyre hiri të cilat e forcojnë (e kollarisin) teshën kurse në lëkurën e trupit, në objekte jo thithëse sperma duke u tharë formon një shtresë sipërfaqësore si luspa të shndritshme.

Identifikimi i spermës në mostrat vaginale dhe/ose në rrobat e viktimës mund të ndihmojnë në vërtetimin e pretendimeve të viktimës. Analiza e AND- së mundëson identifikimin e burimit të spermës. Në rast se ADN-ja është e pasuksesshme, analizat e grupit të gjakut na japin informacion për grupin e gjakut të depozituesit.

¹⁴⁰Shih Gaxha A., “Gjurmët Biologjike dhe roli e rëndësia e tyre në procesin penal” Temë Doktorature, Dhjetor 2014. Fq 25.

Duhet bërë kujdes nga organet proceduese që në të gjitha rastet që përfshijnë krime seksuale, është e rëndësishme që kampionët e kontrollit të merren si nga viktimat ashtu edhe nga personi që akuzohet apo çdo person tjetër i dyshuar. Kampionë kontrolli duhet të merren nga çdo mashkull tjetër që ka kryer marrëdhënie seksuale me viktimën brenda një periudhe dhjetë ditore përpara veprës penale që pretendohet.

Rëndësia që paraqet kjo provë gjatë shqyrtimit gjyqësor pasqyrohet edhe në vendimin nr 537 datë 28.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë¹⁴¹, në të cilin theksohet se: “...Në arritjen e përfundimeve të tyre, gjykatat kanë analizuar, krahas provave të tjera, proces verbalin e kqyrjes së personit datë 08.06.2006, ku eksperti mjeko-ligjor ka konstatuar dëmtime në bark e në këmbë të të dëmtuarit, konkluzionet në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr.124, date 06.06.2006, ku përshkruhen dëmtimet dhe theksohet se në anus i dëmtuari nuk ka dëmtime, si dhe aktin e ekspertimit biologjik të objekteve (teshave të të dëmtuarit) N-4606, datë 25.08.2006, ku janë konstatuar njolla **gjaku e sperme...**”. Megjithatë në rastin konkret nuk janë sqaruar disa aspekte si prania e spermës në rrobat e të demtuarit, apo qëndrimi i shtetasit X pasi ka konstatuar të dy personat në haur. Prania e materialit biologjik sperme në rrobat e të demtuarit tregon që i gjykuari e ka realizuar epshin seksual. Mungesa e dëmtimeve në anus nuk duhet të anashkalojë provën e mësipërme.

- Pështyma: ADN-ja në pështymë mund të analizohet nga një shumëllojshmëri substraktesh, për shembull mund të jetë tek trupi i të dëmtuarës, në buzë, qafë, fytyrë etj. ADN-ja nuk është e pranishme në lëngun e pështymës, por në qelizat e gojës (pjesës së brendshme të faqeve), të cilat bien në pështymë¹⁴². Duke qënë se ADN-ja gjendet në qelizat e pjesës së brendshme të gojës, në mukozën e gojës, shkalla e suksesit për nxjerrjen e profilit të ADN-së nga pështyma është shumë e ndryshme sepse është pothuajse jashtë çdo parashikueshmërie që të përcaktohet sasia e qelizave të gojës që gjenden në kampionët ose njollat e pështymës. Prania e pështymës mund të vërtetojë deklarin e viktimës ose dëshmitarit. Pështyma nga burimi i dyshimtë mund të sigurojë informacion për tipin e ADN-së dhe/ose të grupit të gjakut. Mostrat e pështymës duhet të merren si nga subjekti ashtu dhe viktimat në të gjitha rastet e sulmeve seksuale si dhe në raste të tjera kur ato kanë vlerë

- Sekretionet Vaginale: ose lëngu vaginal përmban qeliza nga shtresa e brendshme e vaginës dhe si rrjedhim përbën një kampion të përshtatshëm për analizë ADN-je. Kjo mund të gjendet në rastet e krimeve seksuale, në pjesën e jashtme të prezervativit ose në sende që janë përdorur për të sulmuar seksualisht një viktimë, në veshje apo në trupin e autorit të veprës penale apo në materiale të përdorura prej tij¹⁴³.

Qelizat vaginale mund të jenë të pranishme gjithashtu në një njollë sperme. Kjo mund të jetë e dobishme në hetimin e marrëdhënieve të inçestit (*marrëdhënie seksuale ndërmjet personave me lidhje gjaku*) etj.

- Urina: Praktika ka treguar se subjekti aktiv, dhunuesi seksual pas realizimit të aktit seksual urinin mbi trupin e të dëmtuarit. Nga qelizat e urinës mund të nxirret ADN-ja,

¹⁴¹ Shih vendimin nr 537 datë 28.10.2009 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

¹⁴² Po aty, fq 26.

¹⁴³ Shih Gaxha A., “Gjurmët Biologjike dhe roli e rëndësia e tyre në procesin penal” Temë Doktorature, Dhjetor 2014. fq 27.

por njollat e urinës zakonisht nuk dërgohen për të nxjerrë profilin e AND-së duke qenë se ka pak mundësi që të ketë material të mjaftueshëm qelizor të veçuar nga shtresa e brendshme e uretrës. Lidhur me këtë provë në vendimin nr 245 datë 26.09.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë¹⁴⁴, në të cilin përcaktohen rrethanat e faktit si më poshtë: “...Ky person i ka kërkuar atij që ta ndihmonte të ngrinte një send të rëndë, por që është refuzuar prej tij sepse nuk kishte dalluar asnjë send. Atëherë agresori i tij e ka urdhëruar që t’i afrohej dhe mbasi e ka kapur kundër dëshirës së tij e ka zhveshur në pjesën e poshtme të trupit dhe më pas ka kryer marrëdhënie homoseksuale me të. Mbasi ka përfunduar aktin i ka **urinuuar në fytyrë** dhe e ka kërcënuar që të mos tregonte për ngjarjen dhe është larguar...”

- Flokë dhe qime. Janë prova materiale që takohen shpesh në praktikë në ngjarje të ndryshme si, marrëdhënie seksuale me dhunë, etj. Ato janë mjaft rezistente ndaj agjentëve të shkatërrimit, prandaj gjenden në vendin e ngjarjes edhe pas një kohe të gjatë.

Flokët dhe qimet mund të gjenden në trupin e teshat e viktimës ose të të dyshuarit; në mjetet, veglat ose armët me të cilat është kryer krimi, etj.

4.2.2 Akti i ekspertimit mjeko - ligjor dhe gjinekologjik.

Gjykata gjatë fazës së hetimit gjygjësor, ose organi i prokurorisë, gjatë fazës së hetimeve paraprake, ndeshet në shumë raste me probleme për zgjidhjen e të cilave kërkohen njohuri të posacme ose përvojë e caktuar në fushën e shkencës, teknikës, artit.

Këto probleme kanë të bëjnë me konstatimin ose sqarimin e fakteve që kanë lidhje me çështjen në gjykim ose hetim. Kur organet procedurale nuk i zotërojnë këto njohuri atëherë ato i shfrytëzojnë ekspertët.

Në lidhje me definicionin “ekspert”, teoricienët kanë dhënë një definicion pothuaj të njëjtë. Kështu, eksperti është një person që zotëron njohuri të posaçme ose përvojë të caktuar në fushat e shkencës, teknikës, artit dhe që në bazë të kësaj njohurie, kanë mundësi që para gjykatës, ose prokurorisë të bëjnë përshkrimin e vërtete të një gjëndje të fakteve ose të nxjerrin përfundimin e saktë që pasojat derivojnë nga një gjëndje e caktuar e fakteve.

Organi procedues e thërret ekspertin për të dhënë mendimin e tij profesional lidhur me ndonjë fakt që ka ekzistuar në të kaluarën ose që ekziston në të tashmen. Fakti i tillë mund të jetë pjesë përbërëse e ndonjë ngjarje, e një veprimi të kryer, ose të jetë e lidhur me cilësinë ose gjëndjen e njerëzve apo të sendeve.

Ekspertiza është procesi i studimit nga ekspertët i objekteve që i janë vënë në dispozicion të tyre për të dhënë mendimin lidhur me probleme që kërkojnë njohuri të veçantë, sipas detyrës së caktuar nga gjykata.

Ekspertimet janë të shumëllojshme, dhe një kriter të përgjithshëm që mund të marrim për të bërë klasifikimin është dega e shkencës, e teknikës, e artit, njohuritë e së cilës

¹⁴⁴Shih vendimin nr 245 datë 26.09.2012 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

përdoren për të bërë konstatimin ose sqarimin e faktit. Në praktikën gjyqësore përdoren këto lloje ekspertimesh:

- 1) ekspertimi mjeko-ligjor,
- 2) ekspertimi psikiatrik,
- 3) ekspertimi kimik,
- 4) ekspertimi teknik ,
- 5) ekspertimi i dokumentave,
- 6) ekspertimi gjinekologjik etj.

Lloji i ekspertimit është i kushtëzuar nga natyra e veprës penale dhe pasqyrimi i elementit objektiv të saj në realitetin material.

Në krimet seksuale aktet e ekspertimit mjeko-ligjor dhe gjinekologjik janë të rëndësishëm për të provuar ekzistencën e aktit seksual. Janë pikërisht këto që përcaktojnë nëse bashkimi seksual ka ndodhur.

Lidhur me këtë në vendimin nr 821 datë 25.04.2007 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁴⁵ ka theksuar se “...Më datë 31.01.2007, rreth orës 13.30, në vendin e quajtur Kombinat, tek ish reparti Tekstil, në ambientet e banesës së tij, i pandehuri X, ka kryer marrëdhënie seksuale me shtetasen Y, e cila nuk ka mbushur moshën 14 vjeç. Sipas aktit të ekspertimit mjeko – ligjor nr. 167, datë 31.01.2007, rezulton se shtetësja Y është e defloruar e freskët dhe ka arritur pjekurinë seksuale. Vetë e dëmtuara ka deklaruar gjatë hetimeve paraprake se e ka kryer marrëdhënien seksuale me dëshirën e saj dhe ky fakt provohet dhe nga pohimi i të pandehurit X....”.

Pasojat që shkakton akti seksual duhet që t’i nënshtrohen dhe të analizohen nga akti i ekspertimit. Gjykata e Lartë në vendimin e datës 24.04.1974¹⁴⁶ ka mbajtur qëndrimin se: “Nga materialet e ceshtjes del që kjo e dëmtuar është e datëlindjes 1960 dmth në kohën e kryerjes së krimit nuk kishte mbushur moshën 14 vjec. Gjykatës në këto rrethana i binte barrë të verifikonte këtë fakt dhe ta dërgonte për ekspertim gjinekologjik. Nëse ekspertimi do të vertetonte se ajo nuk ka arritur pjekurinë seksuale dhe se vec kësaj këtë e tregon edhe paraqitja e saj, gjykata ishte e detyruar që të bënte cilësimin ligjor të veprës nga paragrafi 2 i nenit 160 i kodit penal në paragrafin 2 të nenit 161 të Kodit Penal”.

Gjithashtu me anë të aktit të ekspertimit mjeko - ligjor përcaktojmë nëse akti seksual është kryer më dhunë. Por duhet theksuar se mungesa e shënjave të dhunës fizike nuk duhet të interpretohet si pëlqim nga ana e të dëmtuarit. Në vendimin nr.170 datë 08.10.1966 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁴⁷ ka arsyetuar se: “I gjykuari nuk ka përdorur dhunë ndaj të dëmtuarës përderisa në trupin e saj nuk janë konstatuar shenja dhune, qofshin këto edhe të vogla. Gjykata më e ulët nuk ka pasur parasysh se përdorimi i dhunës nuk shoqërohet kurdoherë me leziona në trupin e të dëmtuarës, prandaj moskonstatimi i gërvishtjeve ose i shenjave të tjera në trupin e të dëmtuarës nuk mund tëkonsiderohen si provë që të vërtetojë së kundër saj nuk është përdorur dhunë. Në qoftë se e dëmtuara është bashkuar seksualisht me dëshirë me të gjykuarin atëherë nuk ka pasur arsye pse ai ta lidhte atë pikërisht në kohën kur do të kryente bashkimin seksual me të”.

¹⁴⁵ Shih vendimin nr 821 datë 25.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

¹⁴⁶ Shih vendimin e datës 24.04.1974 të Gjykatës së Lartë.

¹⁴⁷ Shih vendimin nr.170 datë 08.10.1966 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë

4.2.3 Dëshmia e subjektit të dëmtuar.

Pothuajse në të gjitha procedimet penale një nga mjetet provuese më të pranishëm janë provat me dëshmitarë, kjo sepse mundësia që një ngjarje të njihet nga persona të tretë përveç protagonistëve të kësaj ngjarjeje është shumë e madhe.

Në jetën e përditshme dëshmia nuk është gjë tjetër veçse një rrëfim ose tregim që bën një person për fakte, që njeh, në mënyrë që t'ju transmetojë personave të tretë njohuri për to. Ndërsa prova me dëshmitarë në procesin penal është pohimi i bërë nga një person i tretë, ose i dëmtuari nga vepra penale që thirret nga gjykata për të dëshmuar mbi vërtetësinë e fakteve të së shkuarës që janë të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes.

Dëshmia është shumë e rëndësishme në procesin penal, pasi është instrumenti thelbësor për rindërtimin historik të fakteve, të rëndësishme, për gjykimin. Duke qënë se ngjarja ka karakter historik detyra e procesit gjyqësor (palëve, e trupit gjykues) është që ta rindërtojë këtë ngjarje dhe një herë, ashtu siç ka ndodhur me të vërtetë duke krijuar mundësinë e marrjes së njohurive të nevojshme për zgjidhjen e çështjes. E gjithë kjo ndodh pasi nga vetë karakteri historik i ngjarjes, trupi gjykues nuk ka qënë protagonist në momentin e konsumimit të kësaj ngjarjeje.

Thëniet e të dëmtuarës/dëmtuarit gjatë hetimit të krimeve seksuale përbëjnë provën kryesore në proces, por kjo provë duhet të jetë në harmoni me provat e tjera.

Në vendimin nr 189 datë 15.04.2009 të Kolegjit Penal Gjkata e Lartë ka theksuar se: “ *Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë vlerëson se akuza e ngritur dhe konkluzionet e paraqitura nga organi i Prokurorisë nuk mbështeten në materialet e çështjes e për rrjedhojë të dyja vendimet e gjykatave që konfirmojnë këtë akuzë janë të gabuara. Gjykatat, në kundërshtim me nenin 152 të K.Pr.Penale, i kanë dhënë vlerë të paracaktuar deklarimeve të X, si dhe kanë interpretuar jo drejt deklaratimet e Y, apo të pandehurit Z.*

Vetë Gjykata e Apelit Durrës ka konstatuar kontradikta midis deklarimeve të tre të dëmtuarave në gjykimin në shkallë të parë, e për këtë arsye ka vendosur riçeljen e hetimit gjyqësor, duke i thirrur sërish të dëmtuarat për të dëshmuar, por në fakt ka pyetur vetëm X, duke mos sqaruar në arsyetimin e vendimit se si i ka sheshuar, apo sqaruar këto kontradikta në deklarime.

Ndryshe nga sa pranojnë të dyja gjykatat, apo nuk konfirmojnë në vendimet e tyre, është provuar se janë të dëmtuarat X dhe Y që kanë marrë në telefon të pandehurin Z për të dalë shëtitje (fakt i pranuar në deklaratimet e të tre vajzave dhe të pandehurit); se me të vërtetë arsyeja e shkuarjes në Durrës ishte marrja e makinës së Z që e kishte lënë për ta rregulluar në një oficinë në plazh (konstatuar dhe deklaruar nga vetë të dëmtuarat); se të dëmtuarat kanë ndërruar me vullnetin e tyre disa lokale deri në orën 05.00 të mëngjesit të ditës tjetër (konkluzionet përfundimtare të prokurorit në gjyq “të dëmtuarat duke u ndjerë në faj kanë pranuar të shkojnë për kafe në lokal tjetër pas darke”); se asnjëra nga të dëmtuarat nuk ka shenja dhune, pasi ato i janë shmangur apo neglizhuar kryerjen e aktit mjeko-ligjor; se kallëzim penal ka bërë vetëm Y dhe asnjëra prej dy të dëmtuarave të tjera; se Y ka shkuar vetë të bëjë xhiro me makinën e të pandehurit Z; se pantallonat e pretenduara nga e dëmtuara Y se i janë shqyer nga i pandehuri Z, janë hedhur nga e dëmtuara duke bërë të pamundur kqyrjen e tyre dhe

verifikimin e këtij pretendimi; se nuk ka asnjë shpjegim bindës pse kallëzimi është bërë vetëm pas 8 ditësh (pretendimi ka qenë se po ndërronim banesë dhe po lyenim banesën e re); se nuk ka vendngjarje dhe kqyrje të saj, se nuk ka kqyrje të mjetit ku pretendohet të jetë kryer marrëdhënie seksuale me dhunë nga i pandehuri Z, megjithëse mjete është sekuestruar; nuk ka dëshmitarë okulare, të identifikuar dhe pyetur, personel shërbimi apo klientë të të tre lokaleve ku kanë qenë atë natë të dëmtuarat dhe të pandehurit, madje nuk është identifikuar asnjëri prej tre lokaleve; se nuk ka një shpjegim se përse nuk i është kërkuar ndihmë policisë kur në vendngjarje ka kaluar ngadalë një furgon policie; se nuk ka asnjë shpjegim nga e dëmtuara Y pse ka reagu duke u ndjerë e ofenduar, vetëm pasi i pandehuri Z kishte kryer marrëdhënie seksuale me Y; se i pandehuri ZH për asnjë moment nuk ka bashkëpunuar për kryerje të marrëdhënieve seksuale me dhunë ndaj të dëmtuarës Y dhe se askush nuk e pretendon një gjë të tillë nga të dëmtuarat, veç faktit që i pandehuri ZH është bërë pjesë e ngacmimeve me fjalë që Z i bënte Y pasi u kthyen në tavolinën e lokalit me të tjerët; se përkundrazi i pandehuri ZH u ka kërkuar të pandehurve Z dhe XH që të heqin dorë nga dëshira për të kryer marrëdhënie seksuale respektivisht me B dhe X; se si do të kryente marrëdhënie seksuale me dhunë në makinë i pandehuri XH kur makina ishte në lëvizje dhe në të ishin pesë vetë; se i pandehuri XH megjithëse e shmangu të pandehurin ZH (siç shpjegojnë të dëmtuarat “e shtyu jashtë makinës”) nuk vazhdoi të kërkonte të kryente marrëdhënie seksuale me të dëmtuarën X, por u largua për tek makina tjetër ku ishte Z; se si mund të konsiderohet dhunë për të kryer marrëdhënie seksuale tërheqja e X nga pjesa e pasme e brezit të pantallonave nga XH dhe gjuajtja me pandofël në distance ndaj të dëmtuarës B nga i pandehuri Z....”.

Sic vihet re gjykata nuk u ka dhënë deklarimeve të demtuarave vlerë të vecante, por theniet e tyre janë cmuar në harmoni me provat e tjera.

Në vendimin nr 463 datë 12.05.2010 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se: “Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se të gjykuarit A dhe B, pasi e kanë njohur të gjykuarën X, e kanë marrë atë dhe strehuar në objektin e përdorur si baxho të familjes së tyre dhe pasi e kanë mbajtur në këtë vend për disa kohë e kanë bindur ta çonin në Itali, ku e ka shoqëruar i gjykuari Y. Në Itali janë vendosur në Bergamo, ku e gjykuara ka punuar si prostitutë dhe të ardhurat i përfitonte Y.

Po nga materialet e dosjes, nga thëniet e të gjykuarës të datës 22.01.2002 dhe 27.02.2002, ka rezultuar se ajo ka njohur të dy vëllezërit pas largimit nga shtëpia e bashkëshortit të saj dhe ka qëndruar në baxhon e dy vëllezërve, ku ndodhej edhe një vajzë tjetër. E dëmtuara ka deklaruar në deklaratimet e saj të datës 27.02.2002: “Në Levan u njoha me Y dhe u dashurova me atë. Fillimisht u njoha me vëllain e tij. Vendosa të largohesha nga burri dhe kam shkuar tek baxhua e Y. Aty kam qëndruar rreth një muaj. Aty qëndrova sepse rashë dakord me Y për të shkuar në Itali për të punuar ...”.

Këto thënie të vlerësuara nga gjykata së bashku me deklaratimet e X në seancën e marrjes së provës, si dhe së bashku me provat e tjera, si deklaratimet e dëshmitarëve (nëna e kallëzueses), e cila ka deklaruar përpara oficerit të policisë gjyqësore, thënie të administruara si prova në bazë të nenit 369/3 të K.Pr.Penale, për shkak se nuk është bërë e mundur gjetja e dëshmitares, pra, ajo ka deklaruar se kur e kishte pyetur vajzën në rastin e vetëm që ajo e kishte marrë në telefon i ishte përgjigjur se ndodhej në Itali dhe punonte si gjithë të tjerat si prostitutë, (babai i kallëzueses), ku ky i fundit përpara gjykatës ka deklaruar se vajza e tij kishte shkuar në Itali me një djalë nga

Levani, kanë bindur gjykatën, se të gjykuarit kanë dërguar jashtë shtetit dhe shfrytëzuar si prostitutë të miturën.

4.2.4 Provat elektronike në krimet kibernetike me natyrë seksuale.

Për shkak të rolit të madh që luan interneti në shpërndarjen e pornografisë së fëmijëve, zbatuesit e ligjit kanë bërë shumë përpjekjet për të targetuar dhe identifikuar personat që merren me shpërndarje, blerje, posedim dhe që shikojnë pornografinë e fëmijëve online. Për të kryer në mënyrë efektive hetimet në këto raste, ata rregullisht kanë nevojë për qasje në të dhënat e përdoruesit në internet, por shpesh e gjejnë atë të fshirë, duke e bërë më të vështirë apo edhe të pamundur gjurmimin dhe gjetjen e autorit.

Udhëzimet e standardizuara për ruajtjen e të dhënave janë të rralla dhe ndryshojnë shumë nga vendi, industria dhe lloji i të dhënave. Për fat të mirë, ISP-të individuale në përgjithësi kanë aftësinë dhe kapacitetin teknologjik për të mbajtur dhe për të ruajtur të dhënat e përdoruesve të tyre, në mënyrë për ta vënë më pas atë në dispozicion për qëllimet e ndjekjes penale.

Në këtë kontekst, ka dy lloje të të dhënave: përmbajtje të bazuara (content-based) dhe përmbajtje jo të bazuara (non-content based).

Të dhënat e përmbajtjes së bazuar (content-based data) përfshin informacion të tillë si tekstin e-mail të përdoruesve - "mesazhet" që janë dërguar nga një komunikimi, ose përmbajtjen e një *file* të tilla si një imazh ose film.¹⁴⁸

Të dhënat e përmbajtjes së bazuar (content-based data) përjashtohet shpesh nga mbajtja dhe ruajtja e politikave për të mbrojtur privatësinë e përdoruesit, edhe pse kjo mund të tejkalohej nga mbrojtësit¹⁴⁹.

Të dhënat e përmbajtjes jo të bazuar (non-content based data), nga ana tjetër, përfshijnë informacion përshkrues (të dhëna që ndihmojnë në identifikimin e përdoruesit), si dhe të dhënat e trafikut në rrugë, kohën, datën, kohëzgjatjen, destinacion dhe burimin e një komunikimi.¹⁵⁰

Aksesi në të dhënat e përmbajtjes jo të bazuar (non-content based data) është kritik për shkak se mund të sigurojë zbatimin e ligjit me informacionin e nevojshëm për të përcaktuar identitetin e atyre që kanë pasur akses në mënyrë të paligjshme në këto faqe (site) pa mbledhur të dhënat e panevojshme, ose pushtimin e privatësinë të të dhënave të përdoruesve.¹⁵¹

¹⁴⁸ Kerr O., *Applying the Fourth Amendment to the Internet: A General Approach*, 62 Stan. L. Rev. 1005, 1030 (2010) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children)

¹⁴⁹ *Applying the Fourth Amendment to the Internet: A General Approach*, cituar.

¹⁵⁰ European Commission Directorate General for Home Affairs, *Evidence of Potential Impacts of Options for Revising the Data Retention Directive: Current approaches to data preservation in the EU and in third countries* 4 (Nov. 2012) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).

¹⁵¹ Shiko Parsons Ch., *Lawful Access and Data Preservation/Retention: Present Practices, Ongoing Harm, and Future Canadian Policies*, 21 (2012) (describing the increasingly blurred distinction

Të dhëna të memorizuara (Data retention) i referohen mbajtjes së të dhënave të caktuara për të gjithë përdoruesit (dmth adresa IP, data, koha dhe zonës së kohës së thirrjes, e-mail e dërguara, adresën e plotë të postës elektronike, etj) për një periudhë të caktuar kohe.

Ndërsa ruajtja e të dhënave nga shkatërrimi (data preservation) i referohet ruajtjes së të dhënave specifike të një përdoruesi i cili është aktualisht nën hetim, për të parandaluar humbjen ose modifikimin e të dhënave që për një periudhë të caktuar kohore.¹⁵² Në mënyrë që të dhënat të ruhen për qëllime të ndjekjes penale, ato duhet të mbahen fillimisht nga shoqata që të mundëson shërbimin e internetit (ISP). Të dhënat e mjaftueshme të mbajtjes prej ISP-ve përbën një nga pengesat më të mëdha për identifikimin dhe gjetjen e të dyshuarit në rastet e pornografisë së fëmijëve në internet.¹⁵³

Konventa e Këshillit të Evropës “Mbi krimin kibernetik”, e miratuar në vitin 2001, përfshin rekomandime për ruajtjen e të dhënave.¹⁵⁴

Në vitin 2006, Parlamenti Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian ka miratuar një direktivë e fokusuar në ruajtjen e non-content based data. Direktiva kërkon që të gjitha shtetet anëtare të miratojë një sërë standardesh të politikave të mbajtjes së të dhënave. Ajo është hartuar me qëllim për të siguruar që të dhënat do të jenë në dispozicion për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit dhe ndjekjen penale të krimeve të rënda, kur të jetë e nevojshme.¹⁵⁵

Direktiva përcakton rekomandime për praktikën më të mira në zhvillimin e një fushe rregulluese për mbajtjen e të dhënave. Komisioni Evropian ka kryer një vlerësim të Direktivës në 2011 dhe ka raportuar rezultatet në Parlamentin Evropian dhe Këshillin e Bashkimit Evropian.¹⁵⁶

Raporti identifikon raste të shumta në të cilat (retained data) ruajtja e të dhënave ka qenë e dobishme në hetimet penale dhe ndjekjet penale dhe theksoi nevojën për ruajtjen e të dhënave në periudha mjaft të gjata. Studimi tregoi se për vitet 2008-2009, 20 vendet anëtare të BE-së kishin marrë një mesatare prej 148,000 kërkesa në vit për

between content based and non-content based data) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children)

¹⁵² Department of Justice of Canada, Lawful Access FAQ 4 (2005) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children)

¹⁵³ Weinstein J., *Data Retention as a Tool for Investigating Internet Child Pornography and other Internet Crimes 3* (Jan. 25, 2011) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).

¹⁵⁴Konventa mbi krimin kibernetik.

¹⁵⁵ EU Directive on the retention of data generated or processed in connection with the provision of publicly available electronic communication services or of public communications networks, Article 1 (Mar. 15, 2006), at <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32006L0024:en:HTML>

¹⁵⁶ Report from the European Commission to the Council and the European Parliament: Evaluation report on the Data Retention Directive (Directive 2006/24/EC) 22 (Apr. 18, 2011), at <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2011:0225:FIN:en:PDF>

të pasur akses në të dhënat e telekomunikacionit të ruajtura - 90% e këtyre të dhënave kishin më pak se 6 muaj që ishin ruajtur në kohën kur është paraqitur kërkesa nga autoritetet e zbatimit të ligjit - duke sugjeruar se edhe një periudhë të kufizuar e mbajtjes do të jetë e dobishme për zbatimin e ligjit.¹⁵⁷

Llojet e imazheve apo mediave që konsiderohen pornografike kanë ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme me kalimin e kohës. Për qëllimet e këtij artikulli, pornografia është përcaktuar si çdo media me aktivitet seksual ose lakuriqësi që është e qartë dhe ka si qëllim kryesor zgjimin seksual.

Në Shtetet e Bashkuara nuk ka rregulla të qarta në lidhje se cilat do të konsiderohen media pornografike; standardet ndryshojnë nga juridiksioni në juridiksion dhe udhëzimet janë në përgjithësi të paqarta. Pornografia që përfshin fëmijët, megjithatë, është emërtuar në mënyrë të vazhdueshme si e turpshme, dhe posedimi i këtij lloji të pornografisë është kriminale.

Disa praktika gjyqësore kanë vendosur udhëzime të përgjithshme mbi ato që konsiderohen materiale të turpshme. Për shembull, Roth v. United States (1957) vendosi që materiali i turpshëm, kur ai konsiderohet i dënueshëm nga secili person, duke përdorur standardet morale të shoqërisë, dhe ku media e ka vetëm rol epshor jo artistike.

4.3 Vlerësimi i provave tipike të krimeve seksuale.

Praktika ka treguar që hetimi dhe ngritja e akuzës për krimet seksuale nuk ka qënë e lehtë për shkak natyrës së veprave penale, e cila në shumë raste shoqërohet me mungesë të provave. Situata është me e ndërlikuar kur ekziston një provë e vetme, si vetëm theniet e të dëmtuarës, duke munguar shenjat e dhunës, materialet biologjike etj. Në raste të tilla standarti i provës është i “ulët”.

Termi standardi i të provuarit apo siç njihet ndryshe “standardi i provës”, i referohet masës ose shkallës së përmbushjes së barrës së provës. Është sistemi matës i shkallës së sigurisë ose probabilitetit që provat i ofrojnë gjykatës për të pranuar si të vërteta fakte të caktuara, standardi me të cilin duhet bindur gjykata nëpërmjet provave të ofruara nga pala që mbart barrën e provës në proces. Prandaj, standardi është një sistem matës i cilësisë dhe i forcës bindëse të provave të paraqitura për të përmbushur barrën e provës. Standardi i kërkuar i provës në disa raste ndryshon në varësi të natyrës së çështjes që duhet provuar, por dallimet më themelore janë midis çështjeve penale dhe civile.¹⁵⁸

Nëse prokurori nuk është i bindur për fajësinë e të pandehurit apo ka dyshime në lidhje me të, konform neneve 327/2 dhe 328 të Kodit të Procedurës Penale prokurori

¹⁵⁷ Malmström C., Member of the European Commission responsible for Home Affairs, Taking on the Data Retention Directive, SPEECH/10/723 European Commission conference in Brussels (Dec. 3, 2010), at http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-10-723_en.htm

¹⁵⁸ Shih Murphy P., “*Murphy për provën*”, Oxford University Press, 2005, përkth. Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 163.

duhet të vendosë pushimin e çështjes. Kemi të bëjmë këtu më një çmim apo vlerësim të prokurorit, i cili për sa i përket atij, konsiderohet çmim përfundimtar, megjithatë, kjo nuk ndikon gjykatën në vlerësimin e saj përfundimtar mbi çështjen, të cilin e arrin pas zhvillimit të debatit kontradiktor ndërmjet palëve në proces. Fajësia vendoset në gjykim dhe prokurori ka barrën e të provuarit të saj para gjykatës.

Standardi i kërkuar për dërgimin e çështjes në gjyq është i ndryshëm nga ai i të dhënave të mjaftueshme për marrjen si të pandehur, pasi midis momentit të vendimit për marrjen e një personi si i pandehur, me atë të dërgimit në gjyq, në pikëpamje të masës së provave ka një ndryshim. Ligji parashikon ekzistencën e provave të plota për dërgimin në gjyq të çështjes. Ndërkohë, në rastin e marrjes së personit me cilësinë e të pandehurit, ligji nuk kërkon një standard të një niveli kaq të lartë. Nga interpretimi i nenit 331/1 të KPrP, prokurori dërgon çështjen për gjykim kur e ka sqaruar përfundimisht sipas bindjes së tij:

- * Kryerjen ose jo të veprës penale me të gjithë përbërësit e saj (kohën, vendin, mënyrat e rrethanat e tjera) që kanë ndjekur kryerjen e veprës penale.
- * Fajësinë ose pafajësinë e personit lidhur me veprën që është akuzuar ose që do të akuzohet.
- * Shkallën e përgjegjësisë dhe personalitetin e tij.
- * Pasojat e ardhura nga vepra penale.

Vërtetimi i këtyre rrethanave është i domosdoshëm për të krijuar një përfundim të saktë e bindës. Natyrisht, kjo nuk është një punë e thjeshtë dhe e menjëhershme; ajo zgjat nga momenti i fillimit të çështjes penale e deri në përfundim të saj.

Prokurori duhet të ketë sjellë në gjykim prova të mjaftueshme për të vërtetuar akuzën kundër personit të akuzuar. Puna e tij në drejtim të kërkimit dhe mbledhjes së të dhënave me qëllim për t'i paraqitur ato më pas në gjykim, aty ku ato në kuptimin e plotë të fjalës marrin vlerën e provës, duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese për këtë qëllim. Sipas Kushtetutës askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në Opinionin e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë kjo gjë është e shprehur në mënyrë eksplicite. Prokurori duhet të sigurojë që provat janë mbledhur dhe procedurat kanë nisur dhe vazhduar në përputhje me ligjin. Duke vepruar kështu, prokurori duhet të respektojë parimet e përcaktuara nga KEDNJ dhe instrumente të tjera ligjore ndërkombëtare, sidomos respektimin e prezumimit të pafajësisë, të drejtat e mbrojtjes dhe një gjykim të drejtë.¹⁵⁹ Prokurori duhet të ketë parasysh se, pavarësisht se mund të ketë krijuar bindjen e plotë mbi fajësinë e të pandehurit për dërgimin e tij në gjyq, ai duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë së të pandehurit, në kuptimin që duhet t'i garantojë të pandehurit të gjitha të drejtat që i njeh ligji dhe Kushtetuta, pa paragjykimin e fajësisë së tij.

Duke qenë se në fazën e gjykimit janë potencialisht në rrezik të drejta dhe interesa të rëndësishme të të pandehurit, si liria e tij, pasuria apo të drejta të tjera, kërkohet që niveli i sigurisë dhe vërtetësisë së vendimit gjyqësor të jetë i një shkalle sipërore,

¹⁵⁹Opinionin e Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë nr. 12 (2009) “Për marrëdhëniet e gjyqtarëve dhe prokurorëve në një shoqëri demokratike”.

krahasuar me nivelin që kërkohet në vendimet që mund të marrë organi procedues gjatë fazave të mëparshme të procesit.

Standardi i të provuarit përtej çdo dyshimi të arsyeshëm është instrumenti parësor për reduktimin e dënimeve të padrejta.¹⁶⁰ Ai përcakton kufirin e gabimit, që duhet të jetë objekt i vëzhgimit prej gjykatave.¹⁶¹ Dënimi mund të jepet vetëm atëherë kur të jetë e qartë *siguria gjyqësore* për përgjegjësinë e të pandehurit.¹⁶² Ky standard është pjesë thelbësore e prezumimit të pafajësisë. Në procesin penal të pandehurit i rrezikohen interesa të rëndësishme, sepse ai jo vetëm mund të humbasë lirinë e tij si rezultat i dënimit, por, në të njëjtën kohë do të stigmatizohet prej këtij dënimi. Në këto kushte, një shoqëri që vlerëson emrin e mirë dhe lirinë e çdo individi, nuk duhet të dënojë një njeri për kryerjen e një krimi, nëse ekziston një dyshim i arsyeshëm rreth fajësisë së tij.¹⁶³ Përveç kësaj, aplikimi i këtij standardi i shërben krijimit të respektit dhe besimit të publikut në zbatimin e ligjit penal.¹⁶⁴ Është e rëndësishme që forca morale e së drejtës penale të mos vihet në diskutim nga një standard i të provuarit që i lë njerëzit me dyshimin se individët e pafajshëm dënohen.¹⁶⁵

Standardi i të provuarit përtej dyshimit të arsyeshëm nuk ka kuptimin që në vlerësimin e fajësisë së të pandehurit të përjashtohet çdo lloj dyshimi. Literatura e huaj¹⁶⁶ thekson se provë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm nuk do të thotë provë përtej çdo lloj dyshimi. Drejtësia nuk do të arrinte të mbronte komunitetin, nëse lejonte që opsione imagjinare ta shmangnin nga udha e saj.¹⁶⁷ Të vlerësosh provat në një çështje penale do të thotë të përcaktosh nëse provat në ngarkim të fajësisë së të pandehurit, të paraqitura nga akuza në gjykim, janë aq bindëse, saqë akuza e prokurorit përbën të vetmin shpjegim të arsyeshëm të fakteve të çështjes. E thënë më thjesht, kjo do të thotë që provat janë aq bindëse, saqë fajësia e të pandehurit është e sigurt. Skepticizmi personal, subjektiv dhe emocional i gjyqtarit që gjykon çështjen, për të mos e shpallur të pandehurin fajtor, nuk janë të mjaftueshme për të rrëzuar tezën e prokurorit.¹⁶⁸ Por, nëse në anën tjetër, ka një dyshim të arsyeshëm në lidhje me fajësinë e të pandehurit, atëherë ai duhet të shpallet i pafajshëm nga gjykata.

¹⁶⁰ Kadish S. H., Schulhofer S. J., “*Criminal Law and its Processes. Cases and materials*”, Fifth Edition, Little, Brown and Company, Boston Toronto, London, fq. 39.

¹⁶¹ Diesen Ch, “*Beyond reasonable doubt. Standard of proof and evaluation of evidence in criminal cases*”, Stockholm Institute for Scandianvian Laë 1957-2009, fq. 170. Cit. prej <http://www.scandinavianlaw.se/pdf/40-7.pdf>. klikuar për herë të fundit me datë 21.05.2013.

¹⁶² Conso G., Grevi V., “*Commentario breve al Codice di Procedura Penale. Complemento Giurisprudenziale*”. Cedam, 2011, fq. 2165.

¹⁶³ Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, In re Winship, 393 U.S. 358, 364 (1970), cit. prej http://scholar.google.com/scholar_case?case=14966781063535213924&q=in+re+Winship&hl=en&as_sdt=2003, klikuar më datë 21.05.2013.

¹⁶⁴ Po aty.

¹⁶⁵ Po aty.

¹⁶⁶ Murphy P., “*Murphy për provën*”, Oxford University Press, 2005, përkth. Erjon Shehi, UET Press, 2010, fq. 164.

¹⁶⁷ Po aty.

¹⁶⁸ Diesen Ch., “*Beyond reasonable doubt. Standard of proof and evaluation of evidence in criminal cases*”, Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2009, fq. 170. Cit. prej <http://www.scandinavianlaw.se/pdf/40-7.pdf>. klikuar për herë të fundit me datë 21.05.2013

Në procesin penal, organit të akuzës i kërkohet të provojë përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, çdo element që përbën veprën penale, për të cilën akuzohet i pandehuri.¹⁶⁹ Nga ana e tij, i pandehuri nuk ka asnjë detyrim që të provojë pafajësinë e tij, megjithatë, ai gëzon të drejtën të mbrohet në procesin penal, në përputhje me procesin e rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ.

Në përcaktimin e një akuze penale, gjykata duhet të zbatojë standardet e një procesi të rregullt ligjor. Ky detyrim buron nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNJ. Edhe GjEDNJ, ka zhvilluar standardin e të provuarit të akuzës penale në ngarkim të një personi, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Një person nuk mund të deklarohet fajtor nëse nuk janë provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, të gjithë elementët e veprës penale.

Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. GjEDNJ, në çështjen *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*¹⁷⁰, lidhur me standardin e vlerësimit të provave shprehet, “Për të vlerësuar provat e faktit, Gjykata adopton standardin e të provuarit ‘përtej çdo dyshimi të arsyeshëm’, por shton se prova të tilla duhet të ndiqen nga bashkëekzistenca e deduktimeve përkuese, mjaftueshmërisht të fortë dhe të qartë ose nga prezumime të njëjta e të pakundërshtueshme të faktit.”¹⁷¹ Në doktrinën tonë juridike nuk është trajtuar gjerësisht standardi i të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Në zbatim të standardit të të provuarit tej çdo dyshimi të arsyeshëm, Gjykata e Lartë, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se vendimi i fajësisë së të pandehurit nuk mund të mbështetet në një provë të vetme. Konkretisht në vendimin nr. 291, datë 15.03.2007¹⁷², të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, thuhet: “... një provë e vetme e pashoqeruar me prova të tjera apo indicie, nuk mund të shërbejë në arritjen e përfundimit për fajësinë e të pandehurit...”.¹⁷³

¹⁶⁹Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, In re Winship, 393 U.S. 358, 364 (1970), cit. prej http://scholar.google.com/scholar_case?case=14966781063535213924&q=in+re+winship&hl=en&as_sdt=2003, klikuar më datë 21.05.2013.

¹⁷⁰Çështja *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, GjEDNJ, (Aplikimi nr. 23458/02), 24 mars 2011, parag. 181.

¹⁷¹Po aty.

¹⁷²Në këtë çështje rezultoi se: në vendimin e gjykatës së rrethit përmendet si provë në favor të akuzës dëshmia e dëshmitarit Sh.R, i cili edhe në deklaratimet para oficerit të policisë gjyqësore ishte shprehur se ishte bashkë me Sh.M, duke punuar afër vendit të ngjarjes dhe kishin parë të kalonin në rrugë dy persona para se të dëgjoheshin krismat e armëve, por nuk mund të identifikonte asnjërin prej tyre. Në seancën gjyqësore të datës 09.01.2004, është bërë paraqitja për njohje e të gjykuarit A.R dhe dëshmitari është shprehur se nuk njihje asnjë nga personat që ishin aty dhe asnjërin prej tyre nuk e kishte parë ditën e ngjarjes. Gjykata e rrethit gjyqësor ka deklaruar fajtor të pandehurin. Gjykata e Apelit e ka lënë këtë vendim në fuqi. Gjykata e Lartë e ka prishur vendimin e Apelit dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim. Edhe mbas rishqyrtimit të çështjes, Gjykata e Apelit, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit duke u shprehur se, e gjen të bazuar në prova që, në unitet me njëra tjetrën, krijojnë bindjen në fajësinë e të gjykuarit A.R. Në vendim bëhet një arsyetim më i gjerë në deklaratimet e bëra para oficerit të policisë gjyqësore nga T.D, duke i pranuar të vërteta këto deklarime dhe jo dëshminë para gjykatës.

¹⁷³Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.291, datë 15.03.2007.

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur Gjykata e Lartë edhe në vendimin vijues¹⁷⁴, në të cilin e ka konsideruar të pamjaftueshëm për ta deklaruar të pandehurin fajtor, bazuar në provën shkencore – aktin e ekspertimit daktiloskopik mbi gjurmën e gishtit të të pandehurit. “Problemi i të provuarit të akuzës është themelori për çdo proces dhe kjo kërkon një analizë të plotë e të gjithashme të provave që paraqiten gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke mënjanuar mbivlerësimin e çdo prove, gjë që do të dëmtonte procesin gjyqësor. Nuk mund të pranohet fajësia e një personi të akuzuar për kryerjen e një veprë penale vetëm me një prove çfarëdo qoftë ajo edhe në se është shkencore (sikurse është vepruar me provën e gjurmës së gishtit të të gjykuarit K.B), në se nuk ka prova të tjera që e shoqërojnë atë. Nuk mund të ketë për gjykatën asnjë provë me vlera të paracaktuara e që t'a mbeshtesë vendimin e fajësisë apo pafajësisë vetëm me një provë, pa u harmonizuar ajo me prova të tjera.”¹⁷⁵

4.4 Parimi in dubio pro reo (dyshimet në favor të të pandehurit).

Është evidente se përkundër domosdoshmërisë shoqërore për vërtetimin e plotë të fakteve, për shkak të njohjes njerëzore të kufizuar dhe faktit se burimet e njohjes nuk janë të përkryera, gjyqtari e ka të vështirë të arrijë të vërtetën mbi ekzistencën e faktit.

Jo rrallë, pas vlerësimit të gjithanshëm të materialit provues, te gjyqtari ngrihet dyshimi në lidhje me ekzistencën e ndonjë fakti, krijohet kështu dilema se a do të mund të përcaktohet nëse një fakt do të konsiderohet i vërtetuar apo jo.¹⁷⁶ Në këtë kontekst, një rol të rëndësishëm merr parimi *in dubio pro reo*. Dyshimi në favor të të pandehurit shpreh atë se kur paraqiten shumë zgjidhje të barabarta, preferohet ajo që është më e favorshme për të pandehurin. Ai është aktualizim i parimit të favorizimit të të pandehurit/*favor rei*.¹⁷⁷

Ky parim është i lidhur me standardin e përtej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe prezumimin e pafajësisë. Në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale, së bashku me prezumimin e pafajësisë, është parashikuar edhe parimi *in dubio pro reo*. Duke qenë se prokurori duhet të provojë akuzën tej çdo dyshimi të arsyeshëm, nëse kjo nuk arrihet për shkak se ka dyshime mbi rrethana apo fakte të caktuara, gjyqtari aplikon parimin *in dubio pro reo*.

Ky parim është parë në dy këndvështrime. Në këndvështrimin e ngushtë, aplikimi i këtij parimi lidhet me prezumimin e pafajësisë dhe kufizohet vetëm në çështjen: fajtor – jo fajtor. Në këndvështrimin e gjerë, aplikimi i këtij parimi del jashtë rrethit fajtor - jo fajtor dhe përfshin ekzistencën e dyshimeve për sa i përket të gjitha llojeve dhe kategorive të fakteve juridike në një proces penal, si të atyre që shkojnë në favor të të pandehurit, ashtu edhe ato që nuk janë në favor të tij.¹⁷⁸ Tek ky parim mbështetet

¹⁷⁴Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.876, datë 21.12.2005.

¹⁷⁵Po aty.

¹⁷⁶ Sahiti E., *Argumentimi në procedurën penale*, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë 2006, fq.180, 181.

¹⁷⁷ Lara Dh., *Koment mbi Kodin e Procedurës Penale*, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010, fq. 102.

¹⁷⁸Sahiti E., *vepër e cituar*, fq.180, 181.

formula e pranishme në Kodin e Procedurës Penale për pushimin e akuzës ose çështjes penale, kur “nuk provohet që i pandehuri e ka kryer veprën”, ose në përfundim të hetimeve paraprake (neni 328/1, shkronja ‘dh’), ose në përfundim të gjykimit (neni 388/1, shkronja ‘d’).

Dyshimet çmohen në favor të të pandehurit edhe përsa i përket provueshmërisë së ekzistencës së një kushti procedimi, apo një shkak që shuan veprën penale (neni 387/2), si edhe në rastet e dyshimit për praninë e shkaqeve të përligjura apo të padënueshmërisë, gjatë kryerjes së veprës (neni 388/1, shkronja ‘e’). Pra, dyshimet lidhur me akuzën apo dyshimet për faktet e tjera objekt prove nuk mund të çmohen në mënyrë tjetër, veçse në favor të të pandehurit. Kjo do të thotë që, për të deklaruar një person të pafajshëm, nuk kërkohet që të vërtetohet pafajësia e tij, por mjafton që akuza të mos vërtetohet dot se ai është fajtor.¹⁷⁹

Pavarësisht atyre që sipërcituam praktika gjyqësore ka marrë në konsideratë në formimin e standartit tej cdo dyshimi të arsyeshem natyrën e vepres penale dhe pasojat që sjell për të demtuarin.

Një standart i rëndësishëm për hetimin dhe ndëshkimin e krimeve seksuale ka vendosur GJEDNJ¹⁸⁰ në vendimin M.C. kundër Bullgarisë [39272/98]12 Dhjetor 2003, në të cilin theksoshet se: “*Aplikantja M.C është me shtetësi bullgare. Ajo ka lindur më 1980. Aplikuesja pretendon se ajo ishte përdhunuar nga dy djem, përkatësisht A dhe P, të moshës 20 dhe 21 vjeç, kur ajo ishte vetëm 14 vjeç. Kjo është moshë e lejuar për kryerjen e marrëdhënieve seksuale me pëlqim, në Bullgari. M.C pohoi se, në 31 Korrik 1995, ajo shkoi në një disko me dy djem dhe një shoqe të saj. Ajo, më pas ra dakord të shkonte me dy djemtë në një disko tjetër. Gjatë kthimit, A sugjeroi të ndalonin në një rezervuar për të notuar. M.C qëndroi në makinë. P. u kthye para të tjerëve dhe ai e detyroi M.C të kryente marrëdhënie seksuale me të. M.C pohoi se ajo u shqetësua shumë. Në orët e para të mëngjesit tjetër, ajo u dërgua në një shtëpi private. Ajo pohoi se A. e detyroi atë të kryente marrëdhënie seksuale me të në shtëpi dhe se ajo qau vazhdimisht gjatë dhe pas përdhunimit. Ajo u gjet më vonë nga e ëma dhe u dërgua në spital ku një ekzaminim mjekësor konstatoi se himeni, membrana vagjinale e saj ishte dëmtuar. A dhe P, të dy mohuan ta kishin përdhunuar M.C.*

Hetimet penale konkluduan se nuk kishte prova të mjaftueshme se M.C ishte detyruar të kryente marrëdhënie seksuale me A dhe P. Procedurat ishin ndërprerë më 17 mars 1997 nga Prokurori i Rrethit, i cili pohoi se përdorimi i forcës ose kërcënimeve nuk provohej përtej çdo dyshimi. Në mënyrë të veçantë nuk provohej, se nga ana e aplikantes ishte rezistuar ose ajo ishte përpjekur të kërkonte ndihmë nga të tjerët.

Aplikantja e apeloj këtë vendim pa sukses. Opinionet me shkrim të ekspertëve, paraqitur GjEDNJ identifikuan “frikën e ngrirë” që është një sindromë traumatike psikologjike infantile dhe konsiderohet si një nga pasojat më të zakonshme të përdhunimit, ku viktimat e terrorizuar i nënshtrohet pasivisht ose e veçon veten psikologjikisht nga përdhunimi. Nga 25 raste të përdhunimeve të analizuar përsa i përket femrave në Bullgari, të moshës midis 14 dhe 20 vjeç, 24 nga viktimat i janë përgjigjur agresorit në të njëjtën mënyrë.

¹⁷⁹ Ligorì H., *Provat dhe procedimi provues*, Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012, fq. 4.

¹⁸⁰ Në vendimin M.C. kundër Bullgarisë [39272/98]12 Dhjetor 2003.

M.C u ankua se ligji dhe praktika bullgare nuk siguronte mbrojtje efektive kundër përdhunimit dhe abuzimit seksual, dhe se vetëm çështjet në të cilat viktimat reziston në mënyrë aktive ndiqen penalisht. Ajo pohoi se Bullgaria ka një detyrim pozitiv që buron nga Konventa Europiane mbi të Drejtat e Njeriut të mbrojë integritetin fizik të individit dhe jetën private të tij dhe të sigurojë një mjet efektiv mbrojtje. Ajo gjithashtu u ankua se autoritetet nuk kanë hetuar me efektivitet ngjarjet në fjalë. Ajo u mbështet në nenin 3 (ndalimi i trajtimit degradues), nenin 8 (e drejta për të respektuar jetën private), neni 13 (e drejta për një mjet efektiv) dhe neni 14 (ndalimi i diskriminimit).

Vendimi i Gjykatës lidhur me Nenet 3 dhe 8 të Konventës.

Gjykata përsëriti se sipas nenit 3 dhe 8 të Konventës, shtetet anëtare kishin një obligim pozitiv të dyfishtë: të miratonin një legjislacion penal që efektivisht e ndëshkon përdhunimin dhe ta zbatonin këtë legjislacion përmes hetimit efektiv dhe ndjekjes penale.

Gjykata më pas vuri re se, historikisht, prova e përdorimit të forcës fizike nga dhunuesi dhe rezistenca fizike nga ana e viktimës shpeshherë kërkohej sipas të drejtës vendase dhe praktikës, në çështjet e përdhunimeve në një numër shtetesh. Megjithatë, dukej se kjo nuk po kërkohej më në vendet europiane. Në juridiksionet e të drejtës komunitare, në Europë dhe kudo, çdo referencë ndaj forcës fizike është hequr nga legjislacioni dhe e drejta e precedentit.

Megjithëse në shumicën e vendeve europiane të influencuara nga tradita ligjore kontinentale e civil laë, përkufizimi i përdhunimit përmbante referenca në përdorimin e dhunës ose kërcënimeve për dhunë nga dhunuesi, në të drejtën e precedentit dhe teorinë ligjore ishte mungesa e pëlqimit, jo forca, kritike dhe thelbësore në përkufizimin e përdhunimit.

Gjykata gjithashtu, vuri re se shtetet anëtare të Këshillit të Europës kanë rënë dakord se ndjekja penale e akteve seksuale pa pëlqim, pavarësisht nëse viktimat kishin rezistuar, ishte e nevojshme për mbrojtjen efektive të grave kundër dhunës dhe kishin nxitur zbatimin e reformave të mëtejshme në këtë fushë.

Tribunali Penal Ndërkombëtar, për ish-Jugosllavinë së fundi ka pohuar se, në të drejtën penale ndërkombëtare, çdo penetrim seksual pa pëlqimin e viktimës përbënte përdhunim duke reflektuar një tendencë universale drejt lidhjes së mungesës së pëlqimit si element esencial i përdhunimit dhe abuzimit seksual.

Siç edhe INTERRIGHT (organizata joqeveritare në Londër) kishte paraqitur, viktimat e abuzimit seksual, në mënyrë të veçantë, vajzat nën moshën e pjekurisë, shpesh nuk rezistojnë për një varg arsyesh psikologjike ose për shkak të frikës për dhunë të mëtejshme nga dhunuesi.

Në përgjithësi, ligji dhe praktika ligjore në lidhje me përdhunimin janë zhvilluar me qëllim reflektimin e qëndrimeve të ndryshuara sociale që kërkojnë respekt për autonominë seksuale të individit dhe për barazinë. Bazuar në standardet dhe tendencat bashkëkohore, detyrimi pozitiv i shteteve anëtare sipas nenit 3 dhe 8 të Konventës kërkon ndëshkimin dhe ndjekjen penale efektive të çdo akti seksual pa pëlqim, dhe në rastet kur viktimat nuk ka rezistuar fizikisht.

Aplikantja pretendoi se qëndrimi i autoriteteve në çështjen e saj i ka rrënjët në legjislacionin difektoz dhe reflekton një praktikë të ndëshkimit të dhunuesve e të përdhunimit vetëm kur ka fakte të rezistencës fizike nga ana e viktimës.

Në mungesë të së drejtës së precedentit, që trajton në mënyrë eksplicite çështjen, gjykata e konsideroi të vështirë të arrijë në konkluzione të sigurta, të përgjithshme mbi këtë çështje. Megjithatë, qeveria bullgare nuk ishte e aftë të siguronte kopje të

vendimeve gjyqësore ose të komentareve ligjorë që të kundërshtonte qartë pretendimet e aplikantes për një qasje të kufizuar në ndjekjen penale të përdhunimit. Pohimi i saj ishte kështu i bazuar në argumente të arsyeshme të cilat nuk ishin kundërshtuar.

Prezenca e dy versioneve të papajtueshme të fakteve kërkon qartë një vlerësim të ndjeshëm ndaj besueshmërisë së pohimeve të bëra dhe për verifikimin e të gjitha rrethanave përreth.

Pak, ishte bërë megjithatë, të testohet besueshmëria e versionit të ngjarjeve të sjella nga P dhe A, (madje edhe pohimi që aplikantja e moshës 14 vjeç, kishte filluar të përkëdhelte A, disa minuta pasi kishte kryer marrëdhënie seksuale për herë të parë në jetën e saj me një burrë tjetër - apo të testohet besueshmëria e dëshmitarëve të thirrur nga të akuzuarit ose koha e saktë e ngjarjeve.

As aplikantja, as përfaqësuesit e saj nuk ishin në gjendje të pyesnin dëshmitarët, të cilët ajo i kishte akuzuar për dëshmi të rreme. Autoritetet kishin dështuar të eksploronin mundësitë e vlefshme për të konsideruar të gjitha rrethanat dhe nuk e vlerësonin mjaftueshëm besueshmërinë e pohimeve konfliktuale të bëra.

Shkaku për këtë dështim dukej se ishte se hetuesi dhe prokurori konsideruan që kishte ndodhur një marrëdhënie seksuale e detyruar midis personave që njihen, dhe në mungesë të provës direkte të përdhunimit, të tillë si gjurmët e dhunës dhe rezistencës ose thirrjet për ndihmë që nuk nxorën përfundimin e mungesës së pëlqimit, u konkludua në mungesën e një përdhunimi nga vlerësimi i të gjitha rrethanave.

Ndërsa prokurorët nuk përjashtuan mundësinë që aplikantja mund të mos kishte shprehur pëlqim, ata miratuan pikëpamjen se në kushtet e mungesës së provës së rezistencës fizike, nuk mund të konkludohej se dhunuesit kishin kuptuar se aplikantja nuk kishte dhënë pëlqimin. Ata nuk i vlerësuan provat që P dhe A e kishin futur në një rrugë të gabuar aplikuesen me qëllim që ta çonin atë në një zonë të braktisur, duke krijuar një mjedis detyrues. Gjykata konsideroi se autoritetet bullgare duhet të kishin eksploruar të gjitha faktet dhe duhet të kishin vendosur mbi bazën e vlerësimit të gjitha rrethanave. Hetimi dhe konkluzionet duhet të ishin përqendruar në çështjen e mospëlqimit. Pa shprehur një opinion mbi fajësinë e P dhe A, gjykata pohoi se efektiviteti i hetimit të çështjes së aplikantes dhe në veçanti, qëndrimi i mbajtur nga hetuesi dhe prokurori bie ndesh me detyrimin pozitiv të Bullgarisë sipas nenit 3 dhe 8 të Konventës, e parë në dritën e standardeve përkatëse moderne në të drejtën ndërkombëtare dhe krahasuese-për të vendosur dhe zbatuar efektivisht një sistem të së drejtës penale që ndëshkon të gjitha format e dhunës dhe abuzimit seksual.

Në lidhje me nenet 13 dhe 14 të Konventës, gjykata vendosi se nuk ngrihen çështje të veçanta sipas nenit 13 dhe se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 14. Gjykata vendosi në mënyrë unanime, se në këtë çështje ka pasur:

një dhunim të nenit 3 (ndalimi i trajtimit degradues) dhe nenit 8 (të drejtës për të respektuar jetën private) të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut të shtetit Palë, përgjegjës për dështimin për të qenë në pajtim me detyrimet pozitive që burojnë nga këto dispozita.

nuk ngrihet një çështje e veçantë sipas nenit 13 (të drejtës për një mjet efektiv); nuk është e nevojshme të ekzaminohet ankesa e aplikueses sipas nenit 14 (ndalimit të diskriminimit)

Bazuar në nenin 41 të Konventës, gjykata zhdëmtoi aplikuesen me 8.000 Euro dhe me 4.110 Euro për kostot dhe shpenzimet.....”

4.5 Aspekte procedurale të trajtimit të viktimave të krimeve seksuale.

Drejtësia jonë penale karakterizohet nga tipari diskrecionar pasi tërë sistemi procedural, por dhe ai penal material synojnë në zbulimin dhe ndëshkimin e autorit të veprës penale, pa u marrë në veçanti me pasojat e veprës penale dhe pozitën e të dëmtuarit nga ajo¹⁸¹.

Një qasje e tillë po ndryshon, sepse në të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare vihet re tendenca për t'i kushtuar vëmendje të veçantë viktimës në të drejtën penale në përgjithësi,¹⁸² dhe viktimës së mitur në veçanti¹⁸³. Pavarësisht faktit se vendi ynë ka treguar mbështetje ndaj kësaj tendence, e cila pasqyrohet në ratifikimin e konventave ndërkombëtare, të cilat janë produkt e saj, akoma nuk është adoptuar koncepti i “viktimologjisë”. Kjo ka bërë që gjatë procesit penal, në veçanti në ato raste ku viktima është i mitur, ky i fundit të bëhet subjekt i viktimizimit sekondar, që rezulton të jetë rrezik i shtuar për të¹⁸⁴.

Megjithatë trafikimi i të miturve, i personave, krimet seksuale janë parashikuar nga legjislacioni shqiptar, si vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Krijimi i Gjykatës së Krimeve të Rënda¹⁸⁵, kompetente për gjykimin e veprave penale që lidhen me trafikimin e qënieve njerëzore ka bërë më efikase goditjen e këtij fenomeni me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Gjithashtu, ka patur një angazhim në rritje të të gjitha strukturave shtetërore, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë të shoqërisë në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore, dhunës seksuale përmes masave parandaluese dhe mbrojtëse, si të natyrës ligjore, ashtu edhe të tipit administrativ, social, ekonomik, etj.

4.6 Kuadri juridik ndërkombëtar në trajtimin e viktimave.

Standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e viktimave janë zhvilluar nga Kombet e Bashkuara nëpërmjet Konventës për eliminimin e cdo forme të diskriminimit të femrave të vitit 1979.

Dokumenti i parë ndërkombëtar dhe universal që ka të bëjë në mënyrë specifike me të drejtat e viktimave dhe procedurën e kompensimit të dëmit ndaj tyre është Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit e adoptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara¹⁸⁶.

¹⁸¹Shih Simoni S., *Trajtimi i Viktimave të trafikimit si deshmëtarë gjatë procesit gjyqësor, mundësitë ligjore për kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën gjyqësore*, shkrim në botimin e Shkollës së Magjistraturës “Kuadri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore”, shkurt 2013.

¹⁸²Shih *The responsibilities and the rights of victims of crime*. The Modern Law Review 1992 Jul; 55(4): 482-505

¹⁸³ Shih Sebba L., *The victim's role in the penal process: A theoretical orientation*. The American Journal of Comparative Law 1982; 30(2): 217-240.

¹⁸⁴ Shih Moffetti R. C., *La testimonianza fragile nel processo penale: verso la policromatica valutazione delle dichiarazioni del minore*, in *La giustizia penale*, 2013, fashikuli. 5, fq 300.

¹⁸⁵Krijuar me ligjin nr. 9110, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda”.

¹⁸⁶The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985).

Konventa e Palermos dhe Protokollit i saj shtesë “Mbi parandalimin e trafikut të grave e të fëmijëve” janë instrumenti ndërkombëtar më i plotë që i kushtoi vëmendjen e duhur të drejtës për viktimën.¹⁸⁷

Konventa e Këshillit të Evropës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”¹⁸⁸ nuk rezultoi një normë ndërkombëtare efikase për shkak se ratifikimi i saj nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës zgjati shumë, ndërkohë që Konventa e Këshillit të Evropës “Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” është akti më i plotë juridik ndërkombëtar. Kjo Konventë e Këshillit të Evropës ka veçantitë e saj në krahasim me instrumentet e tjerë ndërkombëtare të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Përsa i përket fushës së zbatimit të kësaj Konvente ajo mbulon të gjitha llojet e trafikimit cilitdo qofshin viktimat: burra, gra, fëmijë duke siguruar në këtë mënyrë barazinë gjinore. Kjo Konventë është instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar që përkufizon termin “viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore” në ndryshim nga instrumentet e tjerë ndërkombëtarë të cilët limitohen duke i lënë secilit Shtet të çmojë se kush do të quhet viktimë dhe për rrjedhojë të përfitojë mbrojtjen e nevojshme.

Konventa Evropiane “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”¹⁸⁹ është një akt tjetër që synon në nxitjen e shteteve për përcaktimin e skemave që garantojnë kompensimin e viktimave. Kjo Konventë synon ndihmën e viktimave në rastet kur ato nuk mund të kompensohen në një mënyrë tjetër. Qëllimi është kompensimi i atyre që kanë pësuar një dëm trupor ose dëmtim të shëndetit. Konventa parashikon se kompensimi mbulon shpenzimet mjekësore, të ardhurat e humbura, shpenzimet për mbajtjen e personave të varur.

Një vend të veçantë në kuadrin juridik ndërkombëtar për trajtimin e të miturve viktime e trafikimit, ose abuzimit seksual zë Konventa Lanzarote.¹⁹⁰ Kjo konventë thekson se masat që kërkon ajo të ndërmerren mund të vihen në jetë në mënyrë më efektive me anë të një instituti të tillë. Kështu sipas saj shteti Shqiptar do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që hetimet dhe procedimet penale të kryhen me interesat më të mira dhe respektimin e të drejtave të fëmijës¹⁹¹; do të adoptojë një trajtim mbrojtës ndaj viktimave, duke siguruar që hetimet dhe procedimet penale të mos përkeqësojnë traumën e përjetuar nga fëmija dhe që përgjigja e drejtësisë penale të pasohet nga asistenca, kur është e mundur¹⁹²; do të sigurojë që hetimet dhe procedimet penale të trajtohen si përparësi dhe të kryhen

¹⁸⁷ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokollit II i saj “Mbi parandalimin, pengimin, dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”.

¹⁸⁸ E hartuar në Strasburg me 24.11.1983 dhe e ratifikuar nga shteti ynë me ligjin nr.9265 datë 29.07.2004.

¹⁸⁹ Konventa e miratuar në Strasburg me 24.11.1983, ratifikuar me ligjin nr. 9265 dt.29.07.2004.

¹⁹⁰ Shih ligjin nr 10071 datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”,

¹⁹¹ Shih nenin 30/1 të ligjit nr 10071 datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”,

¹⁹² Shih nenin 30/2 të ligjit nr 10071 datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”,

pas asnjë vonesë të pajustificuar¹⁹³; do të sigurojë masat e aplikueshme sipas këtij kapitulli nuk paragjykojnë të drejtat e mbrojtjes dhe kërkesat për një gjyq të paanshëm dhe objektiv, në përputhje me nenin 6 të Konventës për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut; do të përpiqet të marrë masat e domosdoshme legjislative ose masa të tjera për të siguruar që të gjitha intervistat me viktimën ose, kur është e përshtatshme, ato me një fëmijë dëshmitar, mund të regjistrohen në video dhe këto intervista të regjistruara mund të pranohen si prova gjatë procedimeve në gjykatë, në përputhje me rregullat që parashikon ligji i brendshëm¹⁹⁴.

Kuadri ligjor që mbështet barazinë gjinore, veprimet kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje përfshin, midis të tjerash, ratifikimin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Protokollet e saj; CEDAW si edhe Protokollin e saj Shtesë.

Shqipëria pranoi Marrëveshjen e Stabilizim dhe Asocimit me BE-në në qershor 2006, që është një hap i suksesshëm drejt arritjes së qëllimit të saj për t'u bërë një ShA i BE-së.

Që nga dhjetori 2006, është në fuqi një Marrëveshje e Përkohshme.

Barazia gjinore është një e drejtë themelore dhe një vlerë e përbashkët e vendeve të BE-së. Me synimin e integritimit eventual në BE, barazia gjinore është një kusht i domosdoshëm për hyrjen e Shqipërisë në të dhe kërkohet për plotësimin e objektivave të MSA-së për punësimin dhe kohezionin social, të cilat janë pjesë e *acquis communautaire*.

Parimet themelore të përdorimit të programeve të drejtësisë restauruese në çështjet penale 2002/12, Udhërrëfyes për drejtësinë në çështjet që përfshijnë viktimat e mitur dhe dëshmitarët e krimit 2005, Drafti i Konventës së Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë dhe asistimin për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit 2006 dhe nga Këshilli European nëpërmjet Rekomandimit (1985) për pozitën e viktimës në fushën penale dhe procedurën penale, Rekomandimi (2006) për asistimin e viktimave të krimit, Udhërrëfyes i vitit 2011 i Komitetit të Ministrave dhe Këshillit European për drejtësinë miqësore për të mitur, Konventa e vitit 2005 për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, Konventa e vitit 2011 për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje etj. Rekomandime të tjera në fushën e mbrojtjes së viktimave janë rekomandimet 87/4, 87/18, 87/21 dhe 06/8.

Për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjes që duhet te kenë viktimat në procesin penal rëndësi themelore paraqet Direktiva 2012/29 e Parlamentit European dhe Këshillit e datës 25.10.2012 e Bashkimit European, që vendosi standartet minimale të të drejtave, mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave të krimit, duke zëvendësuar Vendimin Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA, (publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European në datën 14.11.2012).

Prioriteti i kësaj direktive është përmirësimi i të drejtave, mbështetjes, mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së viktimave në procedimin penal për arsye se roli formal i viktimës në procedimin penal ndryshon në mënyrë domethënëse në shtetet anëtare. Kështu në disa

¹⁹³ Shih nenin 30/3 të ligjit nr 10071 datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”,

¹⁹⁴ Shih nenin 35/2 të ligjit nr 10071 datë 09.02.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual”,

shtete, viktima ka rol si palë civile, dëshmitar ose për ushtrimin e akuzës private, ndërsa në disa shtete nuk ka rol formal.

Roli i viktimës nënkupton vecanërisht të drejtat procedurale të viktimës në procedimin penal, dhe edhe pse shtetet anëtare kanë hapësire të gjerë vlerësimi për përcaktimin e tyre, duhet të sigurohen që të mos çenojnë përmbushjen e qëllimit të Direktivës.

Direktiva ka si qëllim të sigurojë që viktima e krimit të marrë informacionin e përshtatshëm, mbështetjen dhe mbrojtjen dhe të jetë në gjendje që të marrë pjesë në procedimin penal. Për këtë qëllim, shtetet anëtare duhet të marrin masa që të sigurojnë që viktimat të njihen si të tillë dhe të trajtohen në mënyrë profesionale, me respekt dhe jo në mënyrë diskriminuese në çdo kontakt me shërbimet e mbështetjes së viktimave, shërbimet e drejtësisë restauruese apo organet kompetente që kryejnë funksionet e tyre në kuadër të procedimit penal.

4.7 Aspektet procedurale.

4.7.1 Identifikimi i viktimës.

Identifikimi i të viktimës së dhunës seksuale është me rëndësi për sigurimin e të Drejtave të Njeriut, Në mënyrë që të mbrohen dhe të ndihmohen, është e rëndësishme që viktimat të identifikohen menjëherë dhe saktë.

Në praktikën e huaj i kushtohet një vëmendje e madhe përkufizimit të saktë të termit viktimë e krimit sepse në varësi të tij përcaktohet rrethi i personave që përfitojnë mbrojtje dhe gëzojnë të drejtat procedurale për shkak të dëmtimit që kanë pësuar. Prandaj edhe në legjislacionin tonë procedural është e rëndësishme që të përcaktohet qartë rrethi i personave që konsiderohen viktimë për të evituar mundësinë e keqinterpretimit apo zgjerimit/ngushtimit të paarsyeshëm të këtij rrethi personash.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet përkufizimi apo kuptimi i termit të dëmtuar apo viktimë, por është praktika gjyqësore¹⁹⁵ ajo që e ka bërë këtë përcaktim.

Në Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për parimet themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit e vitit 1985, termi viktimë përkufizohet si *personat të cilët, individualisht apo në mënyrë kolektive kanë pësuar dëmtime, duke përfshirë këtu dëmtimet fizike apo mendore, humbjet ekonomike apo përkeqësimin e të drejtave të tyre themelore, nëpërmjet kryerjes së veprimeve apo moskryerjes së tyre, të cilat përbëjnë shkelje të ligjeve penale në fuqi të shteteve anëtare, duke përfshirë edhe ligjet që lidhen me abuzimin e pushtetit.*

¹⁹⁵ Sipas vendimit nr.2 datë 20.06.2013 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, *personi i dëmtuar është titullari i interesit juridik të mbrojtur nga norma penale, në vartësi të llojit të veprës penale, marrëdhënies dhe të mirës juridike që mbrohet nga e drejta penale. Kështu, i dëmtuari është personi fizik i cili është i lënduar në trupin e tij, i dëmtuar në shëndetin e tij, i dëmtuar për shkak të cenimit të së drejtave dhe lirive themelore, prekja dhe kufizimi i të cilave, mbrohet nga norma penale, i cenuar në moralin e tij dhe të familjes, etj. I dëmtuar mund të jetë edhe personi juridik, të cilit vepra penale i ka cenuar interesa pasurore të drejtpërdrejta në raport me veprimtarinë që ai ushtron.*

Ndërsa, sipas përcaktimit në nenin 2 të Direktivës 2012/29 së Bashkimit Europian, termi “viktimë” përkufizohet si *person fizik që ka pësuar dëmtim, fizik apo mendor, vuajtje shpirtërore apo dëm pasuror, të shkaktuar drejtpërdrejtë nga veprime ose mosveprime që janë në shkelje të ligjit penal të vendeve anëtare*. Por, sipas Këshillit Europian, termi viktimë duhet të përfshijë, kur është e përshtatshme, familjarët e afërt ose në ngarkim të viktimitë direkte, subjektit pasiv mbi të cilin ka vepruar vepra penale (Rekomandimi 2006/8).

Ndërkohë që në lidhje me kompensimin e viktimave në Direktivën 2004/80/EC, kuptimi i viktimitë kufizohet vetëm në viktimat e një krimi me dashje dhe me dhunë, në Direktivën 2012/29 nuk bëhet një kufizim i tillë.

Gjykata Europiane e Drejtësisë ka konfirmuar në mënyrë të përsëritur se koncepti i viktimitë për qëllimet e Vendimit Kuadër të Këshillit nuk përfshin personat juridikë që kanë pësuar drejtpërdrejtë dëmtim nga shkeljet e ligjit penal në vendet anëtare.(C-467/05, Dell’Orto, C-205/09, Eredics).

Por, përkufizimi i përcaktuar nga Direktiva nuk ndalon shtetet anëtare që të mund të zgjedhin të aplikojnë të njëjtat standarte edhe për personat juridikë. Mospërfshirja e personit juridik në konceptin e viktimitë është në përputhje me përkufizimin e viktimitë sipas Rekomandimit të Këshillit Europian (2006)8 për asistimin e viktimave të krimit dhe Draftin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për Drejtësinë dhe asistimin për viktimat e krimit dhe abuzimit të pushtetit 2006.

Sipas Dokumentit Udhëzues të Komisionit Europian të muajit dhjetor 2013 lidhur me implementimin e Direktivës 2012/29, viktima është personi që pëson dëmtim të shkaktuar nga vepra penale, pavarësisht faktit nëse autori është identifikuar, proceduar apo dënuar dhe pavarësisht nga lidhja familjare ndërmjet tyre. Viktimë konsiderohet edhe një anëtar i familjes së viktimitë së vdekur, që ka pësuar një dëmtim nga vdekja e personit, e shkaktuar kjo e fundit drejtpërdrejtë nga vepra penale. Në këtë drejtim, kriteri “dëmtim” interpretohet në kontekstin e marrëdhënies shpirtërore individuale dhe/ose varësisë materiale të drejtpërdrejtë ndërmjet viktimitë dhe të afërmit të tij.

Anëtarët e familjes janë bashkëshorti, personi që jeton me viktimitë në një marrëdhënie përkushtimi të ngushtë, në një banesë të përbashkët dhe me baza të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, të afërmit në vijë të drejtë si prindërit dhe fëmijët, vëllezër dhe motra si dhe personat në ngarkim të viktimitë. Kriteri i marrëdhënies së përkushtimit të ngushtë, në një banesë të përbashkët dhe me baza të qëndrueshme dhe të vazhdueshme kërkon një lidhje të ngushtë emocionale dhe ndërvarësi financiare, ashtu sikurse të ishin të martuar. Lidhur me përkufizimin e anëtarëve të familjes, ky koncept duhet të përfshijë përveçse bashkëshortin e viktimitë, ashtu edhe bashkëjetuesin/partnerin, pavarësisht se nuk është lidhur martesë apo legjislacionit të brendshëm për njohjen e cifteve të pamartuara, cifteve të të njëjtit seks dhe martesave të personave të të njëjtit seks. Neni 2 § 2 i Direktivës lejon shtetet anëtare që të kufizojnë numrin e anëtarëve të familjes që mund të përfitojnë nga të drejtat dhe përcaktojnë se cili prej tyre duhet të ketë prioritet me qëllim shmangien e kërkesave kontradiktore drejtuar organeve proceduese, duke qënë se të drejtat e parashikuara në Direktivë aplikohen për të gjithë anëtarët e familjes të viktimitë. Prandaj, autoritetet e vendeve anëtare duhet të përcaktojnë procedurën sic është për shembull emërimi i një personi të vetëm nga familja që do të përfitojë nga të drejtat. Gjithsesi, përcaktimi i

përparësisë është i nevojshëm për të siguruar që bashkëshorti apo partneri dhe fëmijët e viktimës së vdekur të jenë të parët në fokus të kontaktit me autoritetet.

Nocioni “roli i viktimës në sistemin gjyqësor penal” ndryshon në shtete të ndryshme dhe nënkupton në vecanti të drejtat procedurale të viktimës të përcaktuara në Direktivën dhe nuk duhet të ngatërrohet me kuptimin e termit “viktimë” sipas parashikimit në nenin 2.

Viktima sipas nenit 2 të Direktivës është e tillë pavarësisht rolit në sistemin gjyqësor penal kombëtar. Koncepti i Direktivës “roli i viktimës në sistemin gjyqësor penal” nënkupton të drejtat procedurale të viktimës në kontekstin e procesit penal që pavarësisht diskrecionit të shteteve duhet të jetë i tillë që të garantojë mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimës.

4.7.2 Informimi i viktimave.

Që viktimat t’i gëzojnë të drejtat e tyre, ato duhet të dijnë për to. Në rastet e trafikimit, shpeshherë niveli i ulët i arsimimit i shumë viktimave e bën edhe më të rëndësishme që autoritetet në mënyrë aktive t’ua shpjegojnë viktimave të drejtat e tyre. Protokollin e Konventës së Kombeve të Bashkuara, Palermo¹⁹⁶, në nenin 6(2) kërkon nga Shtetet palë të sigurojnë se sistemi i tyre ligjor përmban masa që i pajisin viktimat e trafikimit me “informacionin e duhur për proceset gjyqësore dhe ato administrative” si dhe mbështesin viktimën në shprehjen e shqetësimeve të tyre gjatë procedurave penale.¹⁹⁷

Me qëllim që të rritet pjesëmarrja e viktimave në proceset penale nevojitet jo vetëm njohja me ligj i të drejtave të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, por edhe garantimi në praktikë i këtyre të drejtave.

4.7.3 Sigurimi, mbrojtja dhe rehabilitimi.

4.7.3.1 Sigurimi, mbrojtja.

Nenit 6(5) të Protokollit të Trafikimit të Kombeve të Bashkuara dhe Konventa Evropiane për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Nenin 28 dhe 30 kërkojnë nga Shtetet palë të garantojnë të drejtën e viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për siguri dhe mbrojtje. Mangësitë në garantimin e të drejtës së viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për siguri dhe mbrojtje i dekurajojnë ato në kërkimin e të drejtave të tyre, duke përfshirë të drejtën për kompensim dhe për pasojë rezultojnë në mos gëzimin e të drejtave nga viktimat. Protokollin e Trafikimit të Kombeve të Bashkuara, Neni 6(3)(a)-(d) dhe Konventa Evropiane për Masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Neni 12, kërkojnë nga Shtetet palë garantimin e kësaj të drejte.

¹⁹⁶Neni 6, pika 2, Protokollin e Palermos.

¹⁹⁷ Për më tepër, Deklarata e parimeve themelore të të drejtave të viktimës parasheh që “viktimat duhet informuar për shërbimet mjekësore dhe sociale në dispozicion si dhe për format e tjera relevante të ndihmës dhe në mënyrë të lehtë t’u sigurohet qasja në ato shërbime” (Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit e miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr. 40/34 të datës 29 nëntor 1985, par. 15).

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat të Njeriut, jeta, liria dhe siguria e dëshmitarëve nuk duhet “vënë në rrezik në mënyrë që nuk arsyetohet.”¹⁹⁸ Andaj, autoritetet publike kanë për detyrë t’i mbrojnë dëshmitarët dhe të afërmit e tyre të ngushtë ndaj ndërhyrjeve, kërcënimeve dhe rrezikut, para, gjatë dhe pas gjykimit.¹⁹⁹

Mbrojtja efektive e dëshmitarëve është vendimtare që një sistem ligjor të funksionojë siç duhet. Kjo ka rëndësi të veçantë në rastet e trafikimit, ku të pandehurit mund të jenë pjesëtarë të krimit të organizuar dhe viktima mundet që në të njëjtën kohë të jetë dhe dëshmitare kyçe që e bën atë të ndjeshme ndaj kërcënimeve dhe frikësimit. Në mungesë të mbrojtjes adekuate të viktimës dhe të dëshmitarëve, prokurorët nuk do të mbledhin të gjitha provat e nevojshme që çojnë drejt dënimit të trafikantëve ndërsa viktimat dhe dëshmitarët mund të dëmtohen edhe më tutje. Neni 6(d) i Protokollit të Palermos thotë që “autoritetet publike duhet të bëj përpjekje për të siguruar sigurinë fizike të viktimave të trafikimit me njerëz përderisa ato të gjinden përbrenda territorit të vet.”

Një nga rekomandimet e BE-së është përcaktimi i qartë dhe i saktë i momentit në të cilin konsiderohet se fillon procedimi penal për qëllimet e Direktivës, në mënyrë që të garantohet gëzimi i të drejtave të viktimës në mundësinë më të hershme në kontekstin e sistemit ligjor kombëtar, duke nisur nga e drejta për të kuptuar dhe për të marrë informacion që nga kontakti i parë me organin kompetent.

Neni 3 i Direktivës 2012/29 parashikon që duhet të sigurohet që viktimat, bazuar në karakteristika personale si gjinia, mosha, matura, marrëdhënia apo varësia nga autori i veprës penale, të kuptojnë dhe të kuptohen gjatë procedimit penal dhe autoritetet në mënyrë proaktive të asistojnë viktimat për këtë qëllim. Viktimat kanë të drejtë të kërkojnë praninë e një personi tjetër të zgjedhur prej tyre në kontaktin e parë me autoritetet, në rast se kanë nevojë për asistencë për shkak të impaktit të krimit apo kur kanë vështirësi për të kuptuar procedurën²⁰⁰. Kjo e drejtë nënkupton që organi procedues të pajisë me informacion të konsiderueshëm në mënyrë proaktive dhe kryesisht viktimën, dhe jo të jetë viktima që të ketë barrën për të kërkuar këtë informacion. Viktimës duhet t’i garantohet akses efektiv në informacion.

4.7.3.2 **Rehabilitimi i viktimës.**

Sipas Direktivës 2012/29, e drejta për rimbursimin e shpenzimeve ka si qëllim të

¹⁹⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Van Mechelen e të tjerë v. Holanda , 21363/93, 21364/93, 21427/93, e datës 23 prill 1997, par. 53. Gjithashtu shih Doorson v. Holanda, 20524/92, e datës 26 mars 1996, par. 70 dhe P.S. v. Gjermania, 33900/96, e datës 20 dhjetor 2001, par. 22.

¹⁹⁹ “Duke respektuar të drejtat e mbrojtjes, mbrojtja e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe personave të afërt me ta duhet organizuar, kudo që është e nevojshme, para, gjatë dhe pas gjykimit.” Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare në Këshillin e Evropës, Rekomandimi (2005)9 mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, e datës 20 prill 2005, neni II(2). Për një pasqyrë të çështjeve të përgjithshme në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, ju lusim të shihni grupin punues mbi mbrojtjen e dëshmitarëve brenda sistemit gjyqësor, pranë Zyrës së Kombeve të Bashkuara për drogë dhe krim, Vjenë 22 – 24 shtator 2005.

²⁰⁰Neni 3 § 3 i Direktivës 2012/29.

sigurojë që viktimat të mos pengohen të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin penal për shkak të gjendjes së tyre financiare dhe konsiston në shpenzimet për udhëtim dhe humbjet financiare.

Mënyrat e kompensimit janë të ndryshme në varësi të shtetit, në dhënien e një shume fikse si kompensim për udhëtimin dhe humbjen e fitimit nga puna, detyrimin e punëdhënësit që të paguajë edhe ditën e mosfrimit të shërbimit për shkak të pjesëmarrjes në procedimin penal etj. Neni 7 i vendimit Kuadër parashikon të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve për viktimat që kanë statusin e palës ose dëshmitarit në procesin penal, ndërsa Direktiva njih të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve për viktimat që marrin pjesë aktivisht në procesin penal, pavarësisht rolit që kanë.

Si standart minimal përcaktohet që vetëm shpenzimet e nevojshme duhet të rimbursohen për rastet kur viktimat janë të detyruara ose kërkohet nga organi kompetent që të paraqiten dhe të marrin pjesë aktivisht në procesin penal. Duhet që të përcaktohen qartë shpenzimet e mbuluara, kushtet për përfitimin e rimbursimit të shpenzimeve, kohën e përfitimit (përpara apo në ditën e caktuar për zhvillimin e gjyqit kur viktima është prezent në gjykatë).

Në vendin tonë, lidhur me shpenzimet e viktimave kur thirren dhe marrin pjesë në procesin penal si dëshmitarë apo paditës civil rregullimi bëhet nga Kodi i Procedurës Penale dhe Udhëzimi i Këshillit të Ministrave. Në nenin 485²⁰¹ që rregullon shpenzimet e bëra nga shteti nuk parashikohet si e drejtë e viktimës rimbursimi i shpenzimeve dhe as nuk përmendet shprehimisht lloji i shpenzimeve të viktimave, si shpenzimet për t'u paraqitur në seancë si dëshmitar, shpenzimet për ndihmë ligjore etj për paraqitjen e padisë civile në procesin penal dhe sigurimin e provave.

E drejta për rimbursimin e shpenzimeve dhe masa e rimbursimit është e përcaktuar në Udhëzimin nr.4 datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave "Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor", e që aplikohet vetëm për shpenzimet e bëra nga viktima që thirret në cilësinë e dëshmitarit²⁰².

Sipas pikës 2 të Udhëzimit përfshihen në shpenzimet e rimbursueshme për dëshminë e viktimës shpenzimet e transportit, shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, dieta ditore dhe kur dëshmitari largohet nga vend i punës, shpërblehet në vlerë të barabartë me pagën ditore të ndërprerë, kundrejt dokumentit me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës.

Kthimi i pasurisë: Kushtet dhe rregullat për kthimin e pasurisë viktimës përcaktohen nga ligji i brendshëm. Ligji në këtë rast duhet të jetë i qartë përsa i përket kushteve

²⁰¹"1. Shpenzimet procedurale penale parapaguhën nga shteti, me përjashtim të atyre që lidhen me aktet e kërkua nga palët private. 2. Në shpenzimet procedurale përfshihen shpenzimet e bëra në të gjitha fazat e procedimit për këqyrjet, eksperimentet, ekspertimet, njoftimet, për mbrojtësit e caktuar kryesisht dhe çdo shpenzim tjetër i dokumentuar rregullisht. 3. Në vendimin përfundimtar gjykata cakton detyrimin për pagimin e shpenzimeve të parapaguara nga shteti."

²⁰²Pika I/3 "Dëshmitarët në një proces gjyqësor kanë të drejtën e mbulimit të shpenzimeve për dëshminë e dhënë".

dhe periudhës kohore për kthimin e pasurisë viktimave. Kthimi i pasurisë duhet të jetë pa asnjë shpenzim për viktimën dhe shpenzimet e nevojshme duhet të përballohen nga shteti. Kur është e përshtatshme duhet të parashikohet një procedurë efektive administrative në mënyrë që viktima të kërkojë kthimin e pasurisë sa më shpejt me plotësimin e rrethanave të caktuara. Në mënyrë alternative, organi procedues duhet të pajisë viktimën me dokumentin që vërteton sekuestrimin e pasurisë, cka lejon viktimën që të përfundojë marrëdhëniet e detyrimit me persona të tretë si p.sh ndërprerjen e shërbimeve të telefonisë, internetit etj.

Dëmshpërblimi: Në nenin 16 të Direktivës 2012/29 parashikohet e drejta e viktimës për të marrë vendim për dëmshpërblim prej të pandehurit, brenda një afati të arsyeshëm në procesin penal, me përjashtim kur ligji parashikon që një vendim i tillë merret në një proces tjetër ligjor, si p.sh. në procesin civil.

Në Direktivë përdoret termi “proces tjetër ligjor” ndryshe nga Vendimi Kuadër ku parashikohet si përjashtim që dëmshpërblimi të jepen “në një mënyrë tjetër”. Shtetet duhet të marrin masa për të inkurajuar autorët që të paguajnë dëmshpërblimin për viktimat. Direktiva bën fjalë vetëm për kërkimin e dëmshpërblimit nga autorët dhe jo nga shteti. Në raport edhe me parashikimet e tjera të Direktivës, viktima duhet të marrë informacion për kushtet e kërimit dhe përfitimit të dëmshpërblimit.

Duke qënë se Direktiva nuk mbulon skemat e shtetit për kompensimin e viktimave çështja më e diskutueshme në të gjitha shtetet është ajo e dëmshpërblimit të viktimës në rastin kur personi i dënuar nuk është në gjendje që të paguajë dëmshpërblimin dhe është në pamundësi financiare; si mund të ekzekutohet vendimi gjyqësor për dëmshpërblimin; a duhet shtetet të parashikojnë një rol aktiv të tyre në sistemin e dëmshpërblimit të viktimave; a mundet shteti që të parapaguajë dëmshpërblimin dhe të kërkojë më pas kthimin e shumës nga i dënuari?

Praktikat dhe legjislacionet e vendeve ndryshojnë në mënyrë domethënëse dhe mundësitë për të siguruar të drejtën për dëmshpërblim janë të shumëllojshme. Në Francë, viktimat kanë të drejtë të kërkojnë dëmshpërblimin nga shteti në rast se autori nuk është identifikuar, nuk është ndaluar apo nuk ka aftësi paguese, në bazë të një fondi të posaçëm dhe për vepra penale të caktuara. Viktimat e terrorizmit dëmshpërblehen në bazë të një fondi të vecantë. Në këto raste, shteti kërkon pagimin e shumës së dëmshpërblimit nga autorët pasi e ka paguar atë viktimave.

Edhe në vende të tjera si Holanda, Danimarka është shteti që paguan deri në një masë të caktuar dëmshpërblimin për viktimat e krimit dhe kërkon më pas pagimin e kësaj shume nga autori i veprës penale. Në ligjin nr.9642/2006 Konventën e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore” parashikohet miratimi i masave legjislative ose masave të tjera sipas nevojës, për të garantuar kompensim për viktimat, për shembull nëpërmjet ngritjes së një fondi për kompensim ose masat apo programet e kompensimit, të synuara për asistencë sociale dhe integrimin social të viktimave që mund të financohen nga asetet (që rezultojnë nga zbatimi i masave të parashikuara në nenin 23 të Konventës). Por miratimi i masave të tilla është i nevojshëm edhe për kompensimin e viktimave të veprave të tjera penale, plotësisht apo pjesërisht në varësi të llojit të veprës.

Duke qënë se dëmshpërblimi ndihmon viktimën në procesin e rikuperimit, është e

rëndësishme që të akordohet sa më shpejt të jetë e mundur, prandaj vendimi për dëmshpërblim duhet të jepet brenda një afati të arsyeshëm në procesin penal.

Urdhëri i dëmshpërblimit i vendosur nga gjykata dhe padia civile në procesin penal konsiderohen si mënyra për të përshpejtuar procesin e dëmshpërblimit në vend të vecimit të kërkimit për dëmshpërblim në procesin civil, në të cilin viktimat ka barrën e provës dhe për të paguar shpenzimet gjyqësore. Direktiva inkurajon mekanizmat që i japin të pandehurit një përfitim kundrejt pagimit të dëmshpërblimit të përshtatshëm viktimës, p.sh. pagimi i dëmshpërblimit viktimës mund të merret parasysh si rrethanë lehtësuese për caktimin e masës së sigurimit, llojit dhe masës së dënimit apo lirimit para kohe me kusht. Praktika e mirë e disa vendeve anëtare të BE tregon se në raste të caktuara, shteti i paguan paraprakisht dëmshpërblimin viktimës dhe më pas kërkon kthimin e shumës nga i dënuari. Në mënyrë alternative, mund të aplikohet një shpenzim shtesë që paguhet nga autorët e veprave penale për llogari të shërbimeve të mbështetjes së viktimave.

Problematike mbetet edhe çështja e detyrimit për riparimin e dëmit civil i cili në Kodin tonë Penal parashikohet në nenin 59 dhe 60/3²⁰³, jo si një dënim plotësues, por si një prej detyrimeve të të dënuarve të vënë në provë. Në këtë mënyrë, shmanget mundësia e aplikimit të detyrimit të të pandehurit për riparimin e dëmit civil të shkaktuar në rastin kur nuk aplikohet pezullimi i dënimit me burgim, që përbën pjesën më të madhe të çështjeve të shqyrtuara.

Nga ana tjetër edhe aplikimi i nenit 59 dhe 60/3 të Kodit Penal nuk është në masën e nevojshme të kërkuar për nxitjen e shpërblimit të dëmit viktimave për shkak të problematikës që paraqet: paragjykimin të çështjes në orientimin e shqyrtimit gjyqësor në përcaktimin e vlerës së dëmit civil të shkaktuar, mungesës së hetimit të plotë për përcaktimin e saktë të vlerës së dëmit, mungesës së informimit të viktimave për dëmshpërblimin në procesin penal, paaftësia paguese e të pandehurit etj.

Duke pasur parasysh që praktikën e zbatimit të padisë civile në procesin penal janë të pakta dhe përgjithësisht jofunksionale, riparimi i dëmit civil të shkaktuar mbetet një çështje që kërkon një zgjidhje efektive. Në lidhje me këtë çështje, në Kodin Penal të Kosovës, në nenin 64 të tij është parashikuar si dënim plotësues edhe “Urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit”²⁰⁴.

4.7.4 Parimi i mosdënimit të viktimave të trafikimit.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një dukuri masive e skllavërisë moderne, ku miliona individë janë të privuar nga liria dhe e drejta për të zgjedhur, shfrytëzohen me mjete shtrenguese dhe abuzive, për qëllime nga më të ndryshmet që nga shfrytëzimi

²⁰³ “I dënuari i vënë në provë, mund të detyrohet nga gjykata të plotësojë një apo më tepër prej masave të mëposhtme: ...3. Të riparojë dëmin civil të shkaktuar.”.

²⁰⁴ “1. Kur gjykata dënon personin i cili është shpallur fajtor për çfarëdo veprë penale që përfshin vjedhjen, humbjen, dëmtimin apo shkatërrimin e pasurisë, gjykata do të urdhërojë kryesin që të bëjë dëmshpërblimin e viktimës së veprës penale. 2. Dëmshpërblimi përfshin vlerën e shpenzimeve që janë të barabarta me vlerën e çfarëdo pasurie të vjedhur, humbur, dëmtuar apo shkatërruar. Dëmshpërblimi do të urdhërohet gjithashtu edhe për çfarëdo humbje të të ardhurave të cilat viktimat i përjeton si rezultat i veprës penale dhe procedurave hetimore dhe gjyqësore lidhur me atë veprë”.

seksual apo për punë deri te detyrimi për të kryer veprimtari kriminale dhe heqja e organeve apo formë tjetër shfrytëzimi me përfitime të mëdha.²⁰⁵

Fëmijët pranohen gjerësisht si veçanërisht të cënueshëm nga abuzimi dhe shfrytëzimi, duke përfshirë edhe trafikimin.²⁰⁶

Për shkak qoftë edhe vetëm të moshës së tyre, ata janë veçanërisht të dobët kur bien në kontakt me Shtetin. Ata kanë nevoja dhe të drejta të veçanta, duke përfshirë nevojën dhe të drejtën për t'u mbrojtur nga të tjerët, për kujdes dhe arsimim.

Ndonëse moshë e përgjegjësisë penale mund të variojë ndjeshëm nga një vend në tjetrin, Shtetet kanë prapëseprapë përgjegjësi të posaçme sipas të drejtës ndërkombëtare sa u përket të gjithë personave nën moshën 18 vjeç.

Parimet dhe Udhëzimet që Rekomandojnë Kombet e Bashkuara parashikojnë në Parimin 10 se: *“Fëmijët që janë viktimë të trafikimit duhet të identifikohen si të tillë. Interesi i tyre më i mirë duhet të konsiderohet si jashtëzakonisht i rëndësishëm në çdo kohë. Viktimave fëmijë të trafikimit duhet t'u sigurohet asistencë dhe mbrojtja e duhur. Duhet të merren plotësisht parasysh dobësitë, të drejtat dhe nevojat e tyre.”*

Shumë pak prej tyre marrin ndihmë dhe mbrojtje si viktimë të një krimi të rëndë; më shpesh, ata arrestohen, ndalohen dhe akuzohen për shkelje të rregullave të imigracionit, për prostitucion, apo përfshirje në punë të paligjshme, për deklarime të rreme, apo gjobiten për shkelje të ligjeve dhe rregullave administrative. Në këto situata, ata shpesh vihen në vëmendjen e autoriteteve së pari si shkelës dhe mund të mos dallohen lehtë si viktimë aktuale të një krimi të rëndë. Prandaj, Shtetet duhet të jetë plotësisht të vetëdijshme për këto zhvillime për të mundësuar identifikimin e saktë të viktimës dhe etimi e efektshëm të krimit të trafikimit, si dhe për të siguruar mbrojtje të efektshme të të drejtave të viktimës, përfshirë mosdënimin për ato shkelje të shkaktuara apo të lidhura drejtpërdrejt me faktin që ata janë trafikuar.

Parimi i mosdënimit²⁰⁷ të viktimave vihet re në një numër standardesh ndërkombëtare, përfshirë instrumente me fuqi detyruese ligjore dhe politike. Në rajonin e OSBE-së, Shtetet pjesëmarrëse janë angazhuar të kenë një qasje të veprimeve anti-trafikim të mbështetur në të drejtat e njeriut dhe me viktimat në qendër, qasje kjo që respekton në çdo kohë dinjitetin dhe të drejtat e njeriut për viktimat e trafikimit.

Mosdënimi i viktimave të trafikimit për veprat penale që kanë kryer si pasojë, ose gjatë kohës së trafikimit, është një element thelbësor i kësaj qasjeje që mbështetet te të

²⁰⁵ ILO, Vlerësimi Global i Punës së Detyruar (Gjenevë, 2012): Në vitin 2012, ONP vlerësonte se 20.9 milionë njerëz janë viktimë të punës së detyruar, në shkallë botërore. Ky vlerësim përfshin të gjithë sferën e trafikimit të qënieve njerëzore.

²⁰⁶ European Commission, Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The EU Strategy towards the Eradication of Trafficking in Human Beings 2012-2016

²⁰⁷ OSCE Ministerial Council, Declaration on Trafficking in Human Beings, MC(10). JOUR/2 (Porto, 7 December 2002), Annex 2, Section II, para.6 (Këshilli Ministerial i OSBE-së, Deklarata për Trafikimin e Qënieve Njerëzore).

drejtat e njeriut.²⁰⁸Këto dënime fajësojnë viktimat për krimet e trafikuesve të tyre, për krime që, po të mos ishte për shkak të statusit të tyre si persona të trafikuar, nuk do t'i kishin kryer. Ata e kanë të kufizuar vullnetin e lirë për shkak të masës së kontrollit të ushtruar mbi ta dhe metodat e përdorura nga trafikantët, për rrjedhojë ata nuk janë përgjegjës për kryerjen e shkeljes dhe, për këtë arsye, nuk duhet të konsiderohen të përgjegjshëm për aktin e paligjshëm të kryer.

Të qenit i “detyruar” për të kryer një krim, pra, përfshin një gamë të plotë të rrethanave faktike në të cilat viktimat e trafikimit e humbasin mundësinë për të vepruar me vullnet të lirë; jo vetëm nën kërcënimin e dhunës fizike apo abuzimit emocional, por edhe në skenarët e tmerrshëm ku trafikantët i shfrytëzojnë viktimat duke abuzuar me pozitën e tyre të të qenit të pambrojtur.

Parimi i mosdënimit e merr forcën jo vetëm se Shtetet në nivel ndërkombëtar e kanë njohur qartazi si një normë ligjore me fuqi detyruese, në masat e miratuara nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian, por edhe nëpërmjet zbatimit të ligjit për të drejtat e njeriut në përgjithësi.²⁰⁹

Gjykata e Apelit e Gent (Belgjikë) mori në shqyrtim një çështje ku një person i trafikuar ishte detyruar të deklaronte para zyrës së imigracionit identitetin dhe kombësinë të rreme dhe Gjykata e konsideroi atë si fakt që konfirmonte shfrytëzimin e individit.²¹⁰

Personat e trafikuar për shfrytëzim seksual shpesh detyrohen nga trafikantët të blejnë dokumente identifikuese të rreme apo pasaporta të falsifikuara për t'i përdorur kur ka kontrolle nga policia.

Shtetet duhet të sigurojnë që viktimat të mos dënohen për shkelje të kryera gjatë, apo si pasojë e të qenit të trafikuar. Instrumenti kryesor shumëpalësh që rregullon trafikimin është Protokollin e Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, në veçanti gratë dhe fëmijët, që plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Protokollin e Palermos).²¹¹

Grupi i punës për çështjet e trafikimit të personave, funksioni i të cilit është “të këshillojë dhe ndihmojë Konferencën [e palëve të UNCTOC] për zbatimin e mandatit

²⁰⁸ OSCE Ministerial Council, Decision No. 1 Enhancing the OSCE's Efforts to Combat Trafficking in Human Beings, MC(8).DEC/1 (Vienna, 28 November 2000), para. 9; OSCE Ministerial Council, Ministerial Declaration On Combating All Forms of Human Trafficking, MC.DOC/1/11/Corr.1 (Vilnius, 7 December 2011). Vendime të Këshillit Ministerial të OSBE-së.

²⁰⁹ Këshilli i Evropës, Konventa për veprim kundër trafikimit të qenieve njerëzore, CETS Nr197 (Varshavë, 2005), Neni 26; Bashkimi Evropian, Direktiva 2011/36/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dt. 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe që zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA (5 prill 2011), Neni 8

²¹⁰ Qendra për Shanse të Barabarta dhe Luftë kundër Racizmit, Trafikimit dhe kontrabandimit të qenieve njerëzore (Belgjikë) në lidhje me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit të Gent (Belgjikë), 31 maj 2007.

²¹¹ Kombet e Bashkuara, Op. Cit., <http://treaties.un.org/Pages/ViewDetails.aspx?src=TREATY&mtdsg_no=XVIII-12a&chapter=18&lang=en>.

të saj në lidhje me Protokollin e Trafikimit të Personave”, ka rekomanduar, në vitin 2009: “Për të siguruar mosdënimin dhe përjashtimin nga ndjekja penale të personave të trafikuar, Shtetet palë duhet: (a) të përcaktojnë procedurat e duhura për identifikimin e viktimave të trafikimit të personave dhe mbështetjen ndaj këtyre viktimave; (b) të konsiderojnë, në përputhje me legjislacionin vendas, të mos dënojnë apo ndjekin penalisht personat e trafikuar për vepra të paligjshme të kryera nga ata si pasojë e drejtëpërdrejtë e situatës së tyre si persona të trafikuar apo kur janë të detyruar të kryejnë veprime të tilla të paligjshme [...]”²¹²

Në vitin 2010, Grupi i Punës e ripohon këtë rekomandim dhe shkon më tej duke u kërkuar Shteteve palë të sigurojnë që: “dispozitat për mosdënimin dhe përjashtimin nga ndjekja penale të personave të trafikuar, të shprehen qartësisht në legjislacionin vendas, udhëzuesit, rregulloret, preambulat, apo instrumente të tjera.

Duke vepruar në këtë mënyrë, Shtetet palë inkurajohen të shfrytëzojnë mjete të asistencës teknike si Ligji Model i UNODC kundër Trafikimit të Personave dhe parime dhe udhëzime të tilla si Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara për të drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, si dhe standarde dhe udhëzime të tjera rajonale [...]”²¹³

Më tej, materiali mbështetës për mbledhjen e Grupit të Punës të 2010 përgatitur nga Sekretariati ka shprehur në atë kontekst: “Një element thelbësor i mbrojtjes së viktimave të trafikimit dhe të drejtave të tyre duhet të jetë që shtetet të mos ndjekin penalisht apo të dënojnë personat e trafikuar për shkelje të lidhura me trafikimin, të tilla si mbajtja e një pasaporte false apo mungesa e lejes së punës, edhe nëse kanë dhënë pëlqimin për të mbajtur dokumente false apo të punojnë pa autorizim.

Gjithashtu, argumentohet që shtetet duhet të mos ndjekin penalisht apo të dënojnë personat e trafikuar për krime që mund të kenë kryer gjatë gjendjes së trafikimit.”²¹⁴ Detyrimi për mosdënim njihet e pranohet në disa instrumente që prej Protokollit të Palermos. Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Nenin 26, parashikon: “Secila palë, në përputhje me parimet bazë të sistemit të vet ligjor, duhet të parashikojë mundësinë për të mos dënuar viktimat për

²¹² Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 14 dhe 15 prill 2009, CTOC/COP/WG.4/2009/2 (21 prill 2009), <http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/Final_report_English_TIP.pdf>

²¹³ Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 27-29 janar 2010, CTOC/COP/WG.4/2010/6 (17 shkurt 2010), <http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_WG4/CTOC_COP_WG4_2010_final_report_E.pdf>

²¹⁴ Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave, Mosdënimi dhe mosndjekja penale e viktimave të trafikimit të personave, qasje administrative dhe gjyqësore për shkeljet e kryera gjatë procesit të këtij trafikimi, CTOC/COP/WG.4/2010/4 (9 dhjetor 2009), para. 10, <http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_WG4/WG4_2010_4_E.pdf>.

përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, deri në atë masë që ato kanë qenë të detyruar të veprojnë në këtë mënyrë.”²¹⁵

Ky nen vendos detyrim të qartë për shtetet që të parashikojnë mundësinë e mosdënimit.

Në vitin 2011, prirja drejt njohjes së detyrimit për mosdënim u forcua nga miratimi i Direktivës së Bashkimit Evropian për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij (Directive 2011/36/EU).²¹⁶

Qasja e Direktivës duket të jetë më e gjerë se ajo e Konventës së Këshillit të Evropës; Direktiva përcakton një detyrim të shprehur për të mos proceduar penalisht.²¹⁷

Direktiva e BE-së për trafikimin thekson rëndësinë e saj parësore: “kur bëhet fjalë për një fëmijë, asnjë lloj pëlqimi i mundshëm nuk duhet të konsiderohet asnjëherë i vlefshëm”.²¹⁸ Prandaj, në zbatimin e dispozitave të mosdënimit në rastin e një fëmije, shtetet duhet të bëjnë një interpretim të gjerë, jo fjalë për fjalë, të termit “i detyruar” që shfaqet si në Nenin 26 të Këshillit të Evropës dhe në Nenin 8 të Direktivës së BE-së për trafikimin. Kjo do të përfshinte shqyrtimin nëse vepra penale e kryer nga fëmija është e lidhur me trafikimin apo jo. Në rastet ku kjo lidhje është e pranishme, nuk duhet të ketë ndjekje penale dhe, nëse ndjekja penale ka filluar, ajo duhet të pushohet sa më herët, ose duhet lejuar ankimimi ndaj dënimit.

Parimi i mosdënimit është njohur në instrumente të miratuara në fusha të tjera të së drejtës ndërkombëtare. Përsëri, arsyetimi është që personi në fjalë ishte në një farë mënyre i detyruar nga rrethanat të tilla që liria e tij/ saj e veprimtari ishte e kufizuar dhe se, për këtë arsye, nuk duhet të mbajë përgjegjësi penale.

Prandaj, Konventa e Kombeve të Bashkuara për Statusin e Refugjatëve, parashikon në Nenin 31.1 që Palët: “nuk do të vendosin masa ndëshkimore, në lidhje me hyrjen apo prezencën e paligjshme, ndaj refugjatëve të cilët duke ardhur drejtpërdrejt nga një territor ku jeta ose liria e tyre kërcënohen [në disa mënyra të caktuara], hyjnë apo janë prezent në territorin e tyre pa autorizim, me kusht që të paraqiten pa vonesë pranë autoriteteve dhe të tregojnë shkaqe të mira për hyrjen ose prezencën e tyre”.²¹⁹

²¹⁵ Këshilli i Evropës, Konventa për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, CETS Nr 197 (Varshavë, 2005), <<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/197.htm>>

²¹⁶ Bashkimi Evropian, Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij, dhe zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA (5 prill 2011): të gjitha Shtetet Anëtare të BE-së përveç Danimarkës janë të detyruara prej saj.

²¹⁷ Neni 8, parashikon: “Shtetet Anëtare, në përputhje me parimet bazë të sistemit të tyre ligjor, duhet të ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që autoritetet kompetente kombëtare kanë të drejtë të mos procedojnë penalisht apo të vendosin masa ndëshkimore mbi viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore për përfshirjen e tyre në veprimtari kriminale, të cilat kanë qenë të detyruar t’i kryejnë si pasojë e drejtpërdrejtë e të qenit nënshtruar çdonjërit prej akteve [domethënë, shkelje në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore] të parashikuara te Neni 2”

²¹⁸ Bashkimi Evropian, Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore dhe për mbrojtjen e viktimave, e cila zëvendëson Vendimin Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA (5 prill 2011), Preambula, Kapitulli 11.

²¹⁹ Kombet e Bashkuara, Konventa për Statusin e Refugjatëve, 189 UNTS 150 (Gjenevë, 28 korrik 1951)

UNICEF thekson më tej se fëmijët që janë shfrytëzuar dhe/ose trafikuar, kanë të drejtën e mbrojtjes, duke përfshirë edhe mbrojtjen nga “sanksionet dhe ndjekja penale për vepra penale që kanë kryer si pasojë e situatës së tyre.

Ky parim duhet të zbatohet pavarësisht rolit të tyre në veprën penale dhe vendit ku është kryer ajo, si dhe pavarësisht nisjes dhe rezultatit të ndjekjes penale, apo akuzave të ngritura ndaj autorëve të veprës penale.”²²⁰ Në rastet kur fëmija shfrytëzohet dhe/ose trafikohet dhe përdoret nga një trafikant për një qëllim të paligjshëm, ose kur fëmija kryen një akt kriminal që lidhet me statusin e tij si i trafikuar, zbatimi i dispozitave mosdënuese është vendimtar, jo vetëm nga këndvështrimi i mbrojtjes së fëmijës, por edhe për të parandaluar rrezikun e një traumatizimi të dytë të fëmijës në duart e Shtetit.

Pëlqimi i fëmijës për një aktivitet të paligjshëm në një situatë trafikimi nuk mund të qëndrojë mbi statusin e fëmijës si viktimë.²²¹

Kur rrethanat janë të paqarta dhe ka dyshime për marrëdhënien midis veprës penale dhe situatës së trafikimit të fëmijës, zyrtarët dhe prokurorët duhet t’u japin prioritet veprimeve që inkurajojnë mirëqenien e fëmijës, shmangien e dëmtimit të tij dhe interesin e tij më të mirë.²²²

Sipas standardeve ndërkombëtare²²³ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, “është thelbësore që një fëmijë i akuzuar për një shkelje të trajtohet duke mbajtur parasysh moshën e tij, nivelin e pjekurisë dhe kapacitetin intelektual dhe emocional dhe të merren hapa për të nxitur aftësinë e tij për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në proces.”²²⁴

Për më tepër në të gjitha procedimet ku përfshihen fëmijë, duhet zbatuar parimi i emergjencës për të siguruar një reagim të shpejtë dhe për të mbrojtur interesat më të mira të fëmijës, duke respektuar njëkohësisht shtetin e së drejtës”²²⁵.

Në kontekstin e trafikimit të fëmijës, është shumë e rëndësishme të sigurohet që procesi i identifikimit të fëmijës si viktimë e krimit të kryhet pa vonesë.

²²⁰ Qendra Studimore Innocenti e UNICEF, *Child Trafficking in the Nordic Countries: Rethinking strategies and national responses*. Technical report (May 2012), p. 99

²²¹ Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), *Udhëzime për Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit* (shtator 2006).

²²² UNICEF, *Udhëzues referencë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Evropë* (Gjenevë, 2006), f.104-105

²²³ Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara,

²²⁴ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, *Çështja V kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

²²⁵ Council of Europe, *Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice* (17 November 2010)

Sipas standardeve ndërkombëtare, nëse ka arsye të besohet se viktima është fëmijë, ata duhet të prezumohen se janë fëmijë derisa të verifikohet moshja.²²⁶

Konventa e të Drejtave të Fëmijës shprehet se “fëmijë është çdo njeri nën 18 vjeç, përveçse kur ligji që zbatohet për fëmijën përcakton kufi më të ulët të moshës madhore” (Neni 1).²²⁷

Interesat më të mira të fëmijës duhet të “konsiderohen si parësore” në çdo çështje ku përfshihet Shteti (Neni 3.1).

Në fakt, vulnerabiliteti i fëmijëve ndaj shfrytëzimit është një temë që përshkon gjithë Konventën; kjo ndodh më shpesh në Protokollin Opsional të Konventës për të Drejtat e Fëmijës në lidhje me Shitjen, Prostitucionin dhe Pornografinë me Fëmijët (2000).²²⁸

Secili prej këtyre instrumenteve përmban dispozita që theksojnë nevojën për të vepruar për mirëqenien dhe interesin më të lartë të fëmijës. Në veçanti, Neni 37 (b) i Konventës për të Drejtat e Fëmijës, shpall: “Asnjë fëmijë nuk duhet të privohet nga liria e vet në mënyrë të paligjshme apo arbitrare. Arrestimi, ndalimi apo burgimi i një fëmije duhet të kryhet në pajtim me ligjin dhe të zbatohet vetëm si masë e fundit si dhe për periudhën më të shkurtër kohore të mundshme”.

Fëmijët janë shpesh edhe më pak të zotë se të rriturit që t’i rezistojnë kërkesave të trafikantëve. Është e detyrueshme të respektohet parimi i mosdënimit me përkujdes të veçantë në rastin e fëmijëve, përfshirë edhe moszbatimin e sanksioneve administrative.

²²⁶ Këshilli i Evropës, Op. Cit., Art. 10.3; UNODC, Udhëzime legislative për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollit në zbatim të tij (Nju Jork, 2004), f. 289,

²²⁷ Kombet e Bashkuara, Konventa e të Drejtave të Fëmijës (1989), cituar.

²²⁸ Kombet e Bashkuara, Protokollin Shtesë për Konventën për të Drejtat e Fëmijës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë.

KAPITULLI V

VËSHTRIM KRAHASUES

5.1 Krimet seksuale sipas kodit penal amerikan.

5.1.1 Hyrje.

Kodi Penal amerikan e ka prejardhjen e tij nga një histori e gjatë që rrjedh nga të ashtëquajturat “krimet e common law”, të cilat janë krime që e kanë origjinën në zakonet e lashta të transformuara nga vendimet e gjykatave common law në ligje të shkruajtura. Në shekullin XX Instituti Amerikan i Ligjit përkrahu kodifikimin dhe draftet e para të Kodit Penal Model shfuqizuan krimet common law.

Edhe pse 35 shtete përkrahën dhe kodifikuan të drejtën penale, akoma dhe sot në disa shtete njihet krimi i common law dhe në disa të tjera zbatohet pjesërisht.

Shfuqizimi i common law nuk do të thotë që ajo nuk zbatohet fare, por kjo e drejtë gjen vend në rastet e përjashtimit nga ushtrimi i ndjekjes penale si mbrojtja e nevojshme, papërgjegjshmëria mendore etj.

Përvec Kodit Penal Model që është krijuar dhe vazhdon të rregullohet e përmirësohet nga Instituti Amerikan i Ligjeve, çdo shtet në Amerikë ka kodin e tij penal që mbështetet në Kodin Penal Model si dhe ekziston dhe Kodi Penal Federal.

E Drejta penale seksuale përbën një sektor të së drejtës që ka për objekt mbrojtjen e sferës seksuale të një personi nga ndërhyrje nga ana e të tjerëve me natyrë jo vetëm shtrënguese, por edhe abuzive dhe gjithsesi ndërhyrje që janë jo të dëshiruara nga ana e atij që i pëson.

Përsa i përket trajtimit të krimeve seksuale autorja do t'i trajtojë ato duke u mbështetur në Kodin Penal Model. Trajtimi nis me një analizë të lindjes të së drejtës penale amerikane, vijon me një trajtim të sjelljes kriminale për krimet seksuale dhe më pas përqëndrohet tek vepra penale e përdhunimit e cila është edhe vepra më e rëndë si në aspektin social ashtu dhe në atë ligjor.

5.1.2 Vështrim historik.

Ne jemi të mësuar me idenë që është legjislatori që krijon figurat e veprave penale, por nuk ka ndodhur gjithmonë kështu. Përpara ekzistencës së rregullave të shkruara, rregulli social i nënshtrohej rregullave të pashkruara “lex non scripta” të bazuara në moralin dhe zakonet e komuniteteve lokale, të cilat janë transformuar nga brezi në brez sipas ndryshimit të kushteve shoqërore.

E drejta penale amerikane e ka prejardhjen e saj nga e drejta penale angleze. Në mënyrë periodike dhe të vazhdueshme reformatorët kanë kërkuar shfuqizimin e common law në Amerikë dhe përpjekjet e para datojnë në vitin 1648. Revolucioni amerikan i udhëhoqi reformatorët drejt fuqizimit të kërkesave të tyre për të zëvendësuar sistemin common law me kode të shkruara. Në shekullin XVIII u forcua më tej lëvizja që kërkonte zëvendësimin e vendimeve gjyqësore të shkruajtura me kode penale, kjo dhe për arsyen se vendimet gjyqësore jo vetëm që ishin të çrregullta dhe të paplota, por ishin dhe antidemokratike. Pushteti legjislativ që do të aprovonte kodifikimin ishte i zgjedhur nga populli dhe përfaqësonte dëshirën e tyre dhe nuk i lihej më gjyqtarëve të vendosnin sipas bindjeve të tyre. Në shekullin XX Instituti Amerikan i Ligjit përkrahu kodifikimin dhe draftet e para të Kodit Penal Model

(1962) shfuqizuan krimet common law.

Edhe shtetet kombëtare e kanë kodifikuar të drejtën penale, akoma dhe sot në disa shtete njihet krimi i common law dhe në disa të tjera ai zbatohet pjesërisht²²⁹.

Shfuqizimi i common law nuk do të thotë që ajo nuk zbatohet fare, por kjo e drejtë gjen vend në rastet e përjashtimit nga ushtrimi i ndjekjes penale si mbrojtja e nevojshme, papërgjegjshmëria mendore etj.

Përveç Kodit Penal Model që është krijuar dhe vazhdon të rregullohet e përmirësohet nga Instituti Amerikan i Ligjeve²³⁰, çdo shtet në Amerikë ka kodin e tij penal që mbështetet në Kodin Penal Model si dhe ekziston dhe Kodi Penal Federal.

Nëqoftëse mund të thuhet që ekziston një kod penal amerikan, atëherë ky është pikërisht Kodi Penal Model. Duhet përmendur këtu se, pavarësisht ekzistencës së Kodit Model, vazhdon të ekzistojë një diversitet i madh midis rregullimeve specifike të bëra nga kodet penale kombëtare. Kodi Model ushtron influencën e tij në të gjitha territoret kombëtare, pasi janë vetë gjyqtarët ata që shpesh i referohen atij, për të zgjidhur situata apo mbushur boshllëqe që kodet kombëtare nuk zgjidhin apo rregullojnë²³¹.

Së fundmi Instituti Amerikan i Ligjeve ka publikuar disa drafte të cilat rishikojnë tekstin e nenit 213 të Kodit penal model, që është pikërisht dispozita kyç në rregullimin e krimeve seksuale.²³² Këto drafte ende nuk janë miratuar nga Kongresi amerikan, pavarësisht diskutimeve të shumta dhe të vazhdueshme nga ana e ekspertëve, situatë që dëshmon për rëndësinë dhe seriozitetin e tyre në trajtimin e krimeve seksuale.

5.1.3 5.1.3. Sjellja seksuale kriminale.

Dhuna seksuale është një nga fenomenet më të tmerrshme të jetës njerëzore. Ajo është në antitezë të fortë me civilizimin, me interesin e rregullit juridik jo vetëm për të ruajtur paprekshmërinë fizike të njeriut, por edhe moralin dhe etikën bashkëkohore.

²²⁹ Për një trajtim të detajuar të historikut të zhvillimit të së Drejtës Penale Amerikane shiko: *History of Criminal Law - Then, Now, the Future*, në <http://www.crimesanddefenses.com/History.html>; Friedman L. M., *A history of american law*, third Edition, published by Simon and Schuster, New York, 2005.

²³⁰ Instituti Amerikan i Ligjit (ALI) është një shoqatë private e krijuar në vitin 1923 dhe anëtarët e saj avokatë, gjyqtarë dhe profesorë të njohur në Amerikë. Kjo është një shoqatë që u përkrah dhe u ndihmua shumë nga Fondacioni Rockefeller dhe jep një ndihmesë të madhe në përmirësimin e legjislacionit.

<http://www.icla.up.ac.za/images/un/use-of-force/western-europe-others/UnitedStatesofAmerica/Model%20Penal%20Code%20United%20States%20of%20America%201962.pdf>

²³¹ Për më gjatë shiko trajtimin: *The American Model Penal Code: A Brief Overview*, nga Paul H. Robinson P. H., dhe Dubber M. D., 2007, *New Criminal Law Review*, Vol. 10, f. 319 ose http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=661165

²³² Model Penal Code: Sexual Assault and Related Offenses Tentative Draft No. 1 (April 30, 2014) http://jpp.whs.mil/Public/docs/03_Topic-Areas/02-Article_120/20140807/03_ProposedRevision_MPC213_Excerpt_201405.pdf dhe <https://www.ali.org/projects/show/sexual-assault-and-related-offenses/>

Bëhet e nevojshme të vendosësh përballë sjelljes njerëzore që dhunon seksualitetin e personave në forma dhe mënyra nga më të ndryshmet një mur të përbërë nga norma juridike, të sjelljes e kulturës, të parandalimit, të shtypjes dhe ndëshkimit.

Në këta dhunues jeton i fshehur pas falsitetit dhe maskës imoraliteti fizik, shpirtëror dhe mendor. Krimet seksuale në Amerikë rregullohen në pjesën e dytë të Kodit Model, përkatësisht në kapitullin e “Krimeve kundër personit apo krimeve që paraqesin rrezikshmëri për personin”.

Edhe në Shtetet e Bashkuara, në linjë me të gjitha vendet e zhvilluara këto figura veprash penale trajtohen nga ligji dhe shoqëria si veçanërisht serioze dhe të rënda. Karakteristikë e tyre është fakti që ato dhunojnë intimitetin e individit dhe anën psikologjike të tij në një mënyrë të tillë që dëmtimet e mirëfillta fizike nuk arrijnë ta bëjnë.

Vëmendja e veçantë dhe ashpërsia e legjislatorit del në pah edhe nga fakti, që në këtë legjislacion, sjellja seksuale kriminale kuptohet në një sens shumë të gjërë. Ajo përfshin edhe thjesht prekjet që një individ i bën një tjetri në vende intime, pjesë të trupit të këtij të fundit. Sjellja seksuale kriminale në llojin e saj më të rëndë përfshin rastet e përdhunimit, të cilat, nëse bëjmë një analizë të legjislacionit penal amerikan, shikojmë se në shkallë rëndësie, qëndrojnë menjëherë pas veprave penale të vrasjeve.

Historikisht krimet seksuale kanë qenë përdhunimi dhe ngacmimet seksuale, por kodet penale moderne kanë shtuar llojet e sjelljeve kriminale dhe kanë përfshirë në krimet seksuale një numër të madh marrëdhëniesh seksuale jo konsensuale, kontakte dhe abuzime të tjera që kanë të bëjnë me sferën seksuale. Megjithatë në ditët e sotme vëmendja publike dhe e drejtësisë penale është drejtuar kryesisht mbi dhunimet seksuale ku subjekti aktiv është i huaj për subjektin pasiv, dhe pse një numër i madh dhune seksuale përfshin ato në ambientet e punës, të dashurit, bashkëshortët etj dhe 80% e dhunës seksuale ndodh midis personave që kanë patur njohje të mëparshme me njëri-tjetrin.

Është interesante të nxjerrim në pah disa risi në rregullimet që propozohen në draftet e hartuara nga Instituti Amerikan i ligjeve. Risia e parë lidhet me “nevojën që viktimat të ketë qenë e qartë në shprehjen e po-së ose jo-së në lidhje me kryerjen e aktit seksual”. Mungesa e një “po-je” të qartë sipas ekspertëve të ALI përbën shkak që marrëdhënia e kryer apo kontakti të përbëjë një krim seksual²³³. Në *New York Times*²³⁴ e kritikon këtë qëndrim pasi gjykon se ky orientim është i ashpër dhe shpesh herë mund të çojë në zbatime të gabuara.

Shumë njerëz nuk e kanë për zakon të flasin shumë në momentet që paraprijnë marrëdhënien apo kontaktin midis tyre dhe në këtë drejtim, nëse do të pranohej risia e mësipërme atëherë një riedukim i kësaj kategorie do të ishte i domosdoshëm. Gjithashtu duhet përmendur se jo të gjithë njerëzit kanë aftësi të mira në dëshifrimin e sinjaleve seksuale që përcjell pala tjetër.

²³³ Shiko Draftet e publikuara në faqen zyrtare të ALI.

²³⁴ Shulevitz J.,: *Regulating sex*, *New York Times magazine*, <http://www.nytimes.com/2015/06/28/opinion/sunday/judith-shulevitz-regulating-sex.html>

Risia e dytë lidhet me zgjerimin e termit “kontakti seksual”. Ndoshta kjo do të përbëjë dhe risinë më të rëndësishme pasi ky term propozohet të përfshijë prekjën e çdo pjese të trupit, të veshur ose jo, në të gjitha ato raste kur kjo prekje ka qëllime seksuale. Siç shpjegojnë autorët e drafteve, të përmendura më lart “çdo lloj kontakti është i rëndësishëm. Nuk ka kufizime përsa i përket pjesëve të trupit dhe mënyrës së prekjës”.

5.1.4 Historia e përdhunimit.

Përdhunimi, një krim shumë i vjetër, në Anglinë anglo-sanksone dënohej me vdekje.

Në common law përdhunim quhej akti seksual mes një burri dhe një gruaje, jo bashkëshortja e tij, i kryer forcërisht dhe pa konsensusin e gruas. Këto elementë të përdhunimit sipas common law e kufizonin atë me këto kushte :

- vetëm burrat mund të ishin subjekt aktiv, jo gratë dhe fëmijët;
- përfshinte vetëm penetrimin vaginal dhe jo atë anal apo të ndonjë lloji tjetër;
- burrat mund të përdhunojnë vetëm gratë dhe jo burra të tjerë apo djem;
- burrat nuk mund të përdhunojnë gratë e tyre (përjashtimi për arsye të marrëdhënies bashkëshortore);
- përdhunimi kërkon përdorimin e forcës, është një krim i dhunshëm;
- përdhunimi kryhet kundër dëshirës së gruas ose pa pëlqimin e saj, përveç se kur është e mitur apo e papërgjegjshme.

Common law e bazonte vendimin e gjyqtarit në dëshminë e të dëmtuarës që duhet të ishte e besueshme si dhe në namin e mirë të saj (që nënkuptonte virgjërinë).

Sasia e rezistencës që duhet të bënte një femër ka ndryshuar me kalimin e viteve deri në vitin 1950 “the utmost resistance standard” që nënkuptonte të përdorte të gjithë forcën që mundte për të rezistuar fizikisht.

Ligji nuk kërkon në cdo rast rezistencë fizike. Marrëdhëniet seksuale me gra që ishin të intoksikuara, me deficienca mendore ose të sëmura përbënin përdhunim pavarësisht forcës së ushtruar apo konsensusit të dhënë. Dhe marrëdhëniet seksuale me anë të mashtrimit përbënte përdhunim. Dhe marrëdhëniet seksuale me të mitur me konsensusin e tyre përbënte përdhunim.

Nga viti 1950 u zëvendësua “the utmost resistance standard” me “reasonable resistance standard”, e cila nënkupton sasinë e rezistencës të parë në relacion me të gjitha rrethanat e cdo rasti individual.

5.1.5 Elementët e përdhunimit

Elementët e Përdhunimit		
Actus Reus	Mens Rea	Rrethanat materiale
Penetrim seksual i shtruar me forcë	Qëllim për penetrim seksual	1.pa konsensusin e viktimës 2.dëmtime 3.mosha e viktimës 4.përdorim armësh 5.bashkëpunimi

5.1.5.1 Actus reus i përdhunimit.

Actus Reus i përdhunimit kërkon penetrimin seksual dhe pak forcë të ushtruar për të realizuar penetrimin. Siç u tha dhe më lart përdorimi i forcës dhe rezistenca varet nga rrethanat individuale të çdo rasti konkret. Ai fokusohet në manifestimin objektiv të forcës nga subjekti aktiv që duhet të jetë i tillë që të nënshtrojë subjektin pasiv.

Actus Reus i përdhunimit nuk kërkon ushtrimin e forcës fizike kur kërcënimi është i mjaftueshëm për të nënshtuar subjektin pasiv. Kjo quhet “constructive force” dhe konsiston në kërcënime për vrasje, dëmtime serioze, vjedhje ndaj personit apo të tjerëve dhe zëvendësojnë ushtrimin e forcës fizike.

Nuk kërkohet ushtrim force fizike apo kërcënime kur subjekti pasiv është i mitur, defident mendor, i paafte fizikisht apo konsensusi arrihet me anë të mashtrimit. Në këto raste vetë akti i penetrimit është i mjaftueshëm. Në të gjitha rastet e tjera pranimi është element i rëndësishëm i actus reus²³⁵.

5.1.5.2 Mens rea i përdhunimit.

Actus Rea i përdhunimit kërkon që subjekti aktiv të ketë ndërmend (qëllim) të kryejë marrëdhënie seksuale duke ushtruar forcë apo kërcënim. Përdhunimi kërkon qëllimin specifik të subjektit aktiv për të kryer penetrim seksual me forcë dhe pa konsensusin e subjektit pasiv²³⁶. Subjekti aktiv e kryen këtë krim me dashje të drejtpërdrejtë dhe nuk mund të kuptohet kjo vepër penale e kryer në kushtet e pakujdesisë apo të neglizhencës. Kjo situatë del në pah qartë nga mënyra e formulimit të nenit 213 i cili nuk lë hapësirë për keqinterpretime në këtë drejtim.

²³⁵ Për një analizë më të detajuar: Molan M., Bloy D., Lanser D., *Modern Criminal Law*, fifth edition, Cavendish publishing, USA, 2003.

²³⁶ Shiko edhe *Mens Rea and Rape: Shoul no Mean Yes in the yes of the law*, published by Australian National University, 1989.

5.1.5.3 Mosha për përgjegjësi penale.

Që në kohët e hershme mosha ka qenë një shkak për përjashtimin nga përgjegjësia penale. Një skemë e tillë u vendos në shekullin XVI. Në ato kohë prezumohej që një fëmijë nën moshën 7 vjeç nuk e ka kapacitetin mendor për të kryer një krim, ata nuk mund të formojnë qëllime kriminale në mendjet e tyre, pavarësisht se provat në çështje të caktuara mund të tregonin të kundërtën. Cdo person mbi moshën 14 vjeç është i aftë për të patur mendime kriminale (mens rea). Për ata që kanë moshën nga 7-14 vjeç prezumohej inkapaciteti. Presumimi për inkapacitet ishte i fortë për ata që ishin nën moshën 7 vjeç dhe ai vinte e dobësohej derisa humbiste në moshën 14 vjeç.

Disa shtete adoptuan parashikimet e common law. Së fundmi shtetet të udhëhequra nga Kodi Penal Model ia kanë lënë përcaktimin e moshës për përgjegjësi penale nga ana e Gjykatave për të mitur. Ndërsa në disa shtete hyjnë në juridiksionin e Gjykatave për të mitur procedimet me fëmijë nga mosha 15-16 vjeç. Nga 16-18 vjeç (në raste të rralla) dhe deri në 21 vjeç mund t'ia transferojë çështjet gjykatave për të rritur. Numri i çështjeve që i transferohen Gjykatave për të rritur po shtohet dita-ditës, pasi po shtohet dhe numri i veprave penale të rënda të kryera nga të miturit.

5.1.5.4 Sjelljet kriminale seksuale me fëmijë.

Në vitet e fundit në Amerikë kanë tërhequr shumë vëmendjen abuzimet seksuale me fëmijë. Çështje të ndryshme të njohura, të bëra publike, kanë treguar se njerëz që kanë autoritet ndaj fëmijëve si prindër, mësues, tutorë, përfaqësues fetarë dhe të tjerë kanë abuzuar me autoritetin e tyre duke dhunuar seksualisht fëmijët nën kujdesin e tyre.

Ligji ka sanksionuar dënime të rrepta e të rënda për subjektet pasivë që kryejnë marrëdhënie seksuale me fëmijë, seks të devijuar dhe korrupsion të të miturve. Në këto raste ligji nuk kërkon as ushtrimin e forcës në actus rea dhe as të ekzistojë mens rea. Ligji ka zgjeruar hapësirat e tij dhe mbron të miturit dhe nga prekjat e thjeshta që mund të hyjnë sado pak në sferën seksuale.

5.1.5.5 Përjashtimi i përdhunimit bashkëshortor.

Deri vonë ligji përjashtonte përgjegjësinë penale ndaj bashkëshortit që kryente marrëdhënie seksuale me dhunë me bashkëshorten e tij. Arsyeja e përjashtimit konsistonte :

Kur një grua martohet ajo pranon të kryejë marrëdhënie seksuale kur ia kërkon bashkëshorti;

- të pranojë përdhunimin në martesë inkurajon gratë e palumtura të akuzojnë bashkëshortët për përdhunim pa qenë e vërtetë;
- ndërhyrja e ligjit penal në marrëdhëniet martesore do të ndikonte negativisht në problemet dhe vështirësitë që mund të lindin gjatë martesës.

Lëvizjet feministe i kundërshtuan me forcë këto argumente duke përkrahur idenë se gratë nuk janë sende dhe nuk janë nën pushtetin e bashkëshortëve të tyre. Megjithatë ato martohen, kjo nuk do të thotë që duhet t'i binden seksit me komandë. Në martesë burri dhe gruaja gëzojnë pozitë të barabartë si në të drejta po ashtu dhe në detyrime.

Tanimë është një krim në 25 shtete të Amerikës marrëdhëniet seksuale me dhunë me bashkëshorten.

5.1.6 Elementët e sjelljes seksuale kriminale.

Elementët e Sjelljes seksuale kriminale		
Actus Reus	Mens Rea	Rrethanat materiale
1. penetrim seksual pa patur rëndësi gjinia 2. kontakte me pjesë intime të trupit	qëllim për të përfituar kënaqësi seksuale nga penetrimi apo kontaktet	1. nuk ka rëndësi diferenca e moshës midis subjektit aktiv dhe pasiv

5.1.6.1 Sjellja seksuale kriminale.

Fondacionet për të drejtat civile dhe shoqatat feministe kërkuan midis të tjerave dhe shfuqizimin e neneve që parashikojnë si krime seksuale marrëdhëniet seksuale devijante dhe kërkuan që të krijoheshin figura të reja krimesh për gjini neutrale, pra për të dy sekset.

Disa shtete bënë ndryshime në kodet e tyre penale duke parashikuar figura të reja veprash penale si më poshtë:

- krim i shkallës I: Penetrimi seksual apo i cdo lloji ndërhyrjeje sado e lehtë nga ana e një personi në një pjesë të trupit, ose i një objekti në organet gjentiale apo anale të një personi tjetër. Duhet të ekzistojë një nga rrethanat e mëposhtme:
 - a) subjekti aktiv duhet të ketë qenë i armatosur;
 - b) të jetë ushtruar dhunë apo kërcënim apo subjekti aktiv të jetë ndihmuar nga një person tjetër;
 - c) dhuna e përdorur i ka shaktuar dëmtime subjektit pasiv.
- krim i shkallës II: kontakte seksuale, prekje të brendshme të pjesëve intime të subjektit pasiv nga ana e subjektit aktiv apo prekje të qëllimshme sipër rrobave në pjesët intime me qëllim kënaqjen seksuale. Duhet të ekzistojë një nga rrethanat që kërkohet për krimet e shkallës I.
- krim i shkallës III: penetrim seksual me forcë apo detyrim.
- krim i shkallës IV: kontakte seksuale me forcë apo detyrim.

Sic shikohet legjislacioni i ri mbuloi të gjitha veprat penale në sferën seksuale pa dallim gjinie, qoftë përsa i përket subjektit aktiv qoftë dhe atij pasiv. (një femër mund të përdhunojë një mashkull apo një femër tjetër, një mashkull mund të përdhunojë një femër apo një mashkull tjetër. Ka patur raste në Amerikë kur femrat janë dënuar për përdhunimin e meshkujve.

5.1.6.2 Shkallët e përdhunimit.

Shumica e Kodeve Penale Amerikane e ndajnë përdhunimin në dy shkallë : të thjeshtë apo i shkallës II, dhe i rënduar apo i shkallës I. Përdhunimi i rënduar përfshin të paktën ekzistencën e një nga rrethanave të mëposhtme :

- viktima ka pësuar dëmtime serioze të shëndetit;
- subjekti aktiv është person i panjohur për subjektin pasiv;
- krimi i përdhunimit është i lidhur me një krim tjetër;
- subjekti aktiv është i armatosur;
- subjekti aktiv ka bashkëpunëtorë;
- subjekti pasiv është i mitur dhe subjekti aktiv është disa vite më i madh se ai.

Të gjitha llojet e tjera të përdhunimit janë të thjeshta dhe sanksioni penal për to është më i lehtë.

Sjellja seksuale kriminale ka më shumë shkallë, zakonisht katër, kjo me qëllim për të diferencuar penetrimin seksual nga kontakti seksual:

- shkalla I: penetrim seksual i rënduar;
- shkalla II : kontakte seksuale të rënuara;
- shkalla III : penetrim seksual i thjeshtë;
- shkalla e IV : kontakte seksuale të thjeshta.

Për të patur sjellje seksuale kriminale të rënuara ato duhet të kryhen në praninë e një prej rrethanave rënuese të përdhunimeve.

5.2 Krimet seksuale sipas kodit penal italian.

5.2.1 Hyrje.

Më poshtë do të analizohet shkurtimisht mënyra e analizës së krimeve seksuale në legjislacionin italian. Analiza nis me një vështrim historik duke vijuar më pas me një analizë të dispozitave thelbësore.

5.2.2 Vështrim historik.

Krimet seksuale në Kodin Penal italian aktualisht parashikohen nga neni 609bis deri në nenin 609duodecies.

Ato janë të vendosura në titullin XII të librit II që i dedikohet “Krimeve kundër personit”. Në disa nga këto nene parashikohen figura të ndryshme veprash penale, në disa të tjera parashikohen rrethana rënduese e lehtësuese dhe në disa të tjera parashikohet mënyra e ushtrimit të ndjekjes penale.

Me ligjin nr.66 dt.15.02.1996 u bënë disa ndryshime thelbësore të normativës mbi krimet seksuale. Si fillim u ndryshua vendi që ato zinin në kodin penal të vitit 1930 pasi nga titulli IX “Krimet kundër moralit dhe zakonet të mirë” ato kaluan në titullin XII në “Krimet kundër personit”.

Fillimisht në Kodin Penal të vitit 1889 (Kodi Zanardelli) krimet seksuale ishin të vendosura në titullin VIII “Krimet kundër zakonet të mirë dhe rregullit në familje”.

Në kreun e parë të këtij titulli zinin vend krimet seksuale të përziera këto me krimet në familje, prostitucionin, rrëmbimin etj, dhe në kreun e katërt zinin vend dispozita të përgjithshme për të gjitha figurat e lartpërmendura të veprave penale.

Figurat e veprave penale që parashikonte ky kod penal nga neni 331 deri në nenin 339 ishin: marrëdhëniet seksuale me dhunë, ngacmimet seksuale me dhunë, korrupsioni i të miturve, inçesti, vepra të turpshme në vende publike.

Siç mund të kuptohet ky rregullim ligjor ishte si një “mbajtës i gjerë veprash penale” që për shumë aspekte duken shumë të ndryshme nga njëra-tjetra. Kjo, pasi, në rast se për disa figura veprash penale mund të thuhet që i lidh një fije shumë e hollë e motivit seksual, një gjë e tillë nuk mund të thuhet për vepra të tjera si vepra penale e rrëmbimit.

Legjislatorit të asaj kohe i është dukur e arsyeshme t’i sistemojë së bashku këto vepra penale pasi ishte i bindur se ato dëmtonin rëndë familjet dhe zakonet e mira të shoqërisë. Ndërsa për mendimin tim ato janë shumë të ndryshme nëse i referohemi strukturës dhe objektit juridik.

Nuk mund të lihet pa përmendur, se në shekullin e XIX-të jo vetëm sistemi penal italian, por edhe ai francez mbështeten mbi parimin që “rregulli moral kërkon që çdo vepër penale duhet shoqëruar me një sanksion dhe është pushteti publik ai që duhet të bëhet kujdestar i kësaj nevoje.²³⁷

Në Kodin Penal të vitit 1930 (Kodi Rocco) bëhet një sistemim i ri i krimeve seksuale dhe ato u vendosën në titullin IX “Krimet kundër moralit publik dhe zakonet të mirë”.

Në kreun e parë të këtij titulli zinin vend krimet seksuale, veçanërisht marrëdhëniet seksuale me dhunë dhe ngacmimet seksuale me dhunë të përziera këto me premtimin

²³⁷ Rossi P., *Traité de Droit pénal*, vol. III, Paris, 1829.

për t'u martuar. Ndërsa në kreun e dytë u vendosën figurat e veprave penale kundër nderit seksual si: veprat e turpshme në vende publike, korruptimi i të miturve, shtyrja për prostitucion, shfrytëzimi i prostitucionit dhe në kreun e tretë zinin vend dispozita të përgjithshme për të gjitha figurat e lartpërmendura të veprave penale në rastet kur ato kryheshin ndaj një të mituri nën moshën 14 vjeç, në rastet kur ka marrëdhënie në gjini mes subjektit aktiv dhe pasiv, dispozita mbi rrethanat rënduese e lehtësuese, mbi përjashtimin nga ndjekja penale, mbi ankimin e të dëmtuarit etj.

Sistemi i figurave të veprave penale në këtë kod penal ishte më homogjen, megjithëse ende linte shumë për të dëshiruar. Nëse marrëdhënia juridike, që vihet në bazë të mbrojtjes së këtij titulli, është morali publik dhe zakoni i mirë atëherë është natyrale që të mblidhen në të njëjtin vend vepra penale shumë heterogjene midis tyre duke i lejuar ligjit në fjalë të vazhdojë të jetë “një mbajtjes i gjerë” si për krimet seksuale ashtu dhe për ato të prostitucionit.

Morali publik dhe zakoni i mirë kuptohen në një sens të gjerë dhe korrespondojnë përkatësisht me idenë e koshiencës etike të popullit dhe me zakonet e një bashkëjetese civile.

Por, duhet të nënvizohet se rezulton e vërtetë që, duke u bazuar në një sistemim të tillë, morali publik barazohet kështu me moralin seksual dhe zakoni i mirë me manifestimet seksuale.

Pra, nga objekti i mbrojtjes, del qartë në pah se fillimisht legjislatori italian i ka dhënë rëndësi më të madhe mbrojtjes së shoqërisë nga veprime të tilla të kundraligjshme dhe vetëm me reformën e vitit 1996, pas debateve të shumta juridike dhe parlamentare që kanë zgjatur me vite, të ndikuar dhe nga lëvizjet e shumta feministe, ai vendosi të ndryshonte jo vetëm përmbajtjen e normave juridike, por edhe vendin e tyre në Kodin Penal duke përcaktuar si objekt kryesor të kësaj mbrojtjeje lirinë dhe sferën seksuale të individit.

5.2.3 Vështrim i përgjithshëm mbi krimet seksuale në Kodin penal italian.

Thuajse në fund të shekullit XX, pas gati 7 dekadash zbatimi dhe pas 20 vjet polemikash gjithmonë e më të ashpra, normativa mbi krimet seksuale të Kodit Penal të vitit 1930 u shfuqizua dhe u zëvendësua me krimet e parashikuara nga ligji nr. 66 dt.15.02.1996.

Një nga arsyet që kërkohet ndryshimi i ligjit lidhej me dënimet shumë të ashpra që sanksionoheshin për krimet seksuale si dhe me një kosideratë të munguar ndaj gruas e cila rezultonte dhe viktima më e shpeshtë e këtyre krimeve.

Gjithashtu është denoncuar dhe sistemi anakronik i krimeve seksuale në kapitullin e krimeve ndaj moralit publik dhe zakonisht të mirë dhe në këtë perspektivë është kërkuar klasifikimi i ri i krimeve seksuale në një kapitull të aftë për të ravijëzuar që objekt i tutelës është dinjiteti dhe liria e personit për të vetëvendosur në fushën seksuale.

Gjithashtu është ndalur vëmendja në krijimin e një figure të re vepre penale që është ajo e dhunës seksuale në grup²³⁸.

Legjislatori me ligjin nr.66/1996 bëri një klasifikim të ri të krimeve seksuale duke i vendosur ato në seksionin e “krimeve kundër lirisë personale” që ndodhet në kreun e “krimeve kundër lirisë individuale” i klasifikuar në titullin e “krimeve kundër personit”²³⁹.

Gjithashtu u përmblohdhën në të njëjtin nen marrëdhëniet seksuale me ngacmimet seksuale, por për shkak të dëmit dhe pasojave më të rënda që sjellin marrëdhëniet seksuale u parashikua një dënim më i lehtë kur krimi sillte pasoja të lehta.

Në nenin 609bis me titull “Dhuna Seksuale”, siç u tha dhe më lart, parashikohen si marrëdhëniet seksuale po ashtu dhe ngacmimet seksuale të kryera me dhunë fizike apo psikologjike apo duke abuzuar me autoritetin. Gjithashtu në të njëjtin nen gjejnë rregullim dhe hipotezat e:

- “dhunës së prezumuar” ku subjekti aktiv detyron subjektin pasiv të kryejë apo t’i nënshtrohet akteve seksuale duke abuzuar me kushtet e inferioritetit fizik apo mendor të subjektit pasiv në momentin e kryerjes së aktit seksual;
- “dhunës me mashtrim” ku subjekti aktiv mashtron subjektin pasiv duke u shtirur (hequr) si person tjetër.

Maksimumi i dënimit për këtë veprë penale është 10 vjet. Dua të vë në dukje se legjislatori e ka lënë të pandryshuar dënimin maksimal, ndërkohë që ka rritur dënimin minimal nga 3 vjet në 5 vjet.

Neni 609ter parashikon rrethana rënduese të shumta në raport me dhunën seksuale që normalisht passjellin dhe dënim më të lartë ku dënimi varion nga 6-12 vjet. Rrethanat rënduese janë si vijon:

- kur vepra penale kryhet ndaj të miturve nën moshën 14 vjeç;
- kur vepra penale kryhet nën përdormin e armëve, apo të substancave alkoolike, narkotike, stupefacente ose nën ndikimin e instrumentave e substancave të tjera të rrezikshme për shëndetin²⁴⁰;
- nga një person i veshur ose që shtiret si punonjës publik apo i ngarkuar me punë publike;
- ndaj një personi të cilit i është kufizuar liria personale;
- ndaj një personi nën moshën 18 vjeç kur subjekti aktiv është paraardhësi, prindi natyror apo adoptiv si dhe tutori²⁴¹;
- në brendësi apo në afërsi të një instituti edukimi apo formimi të ndjekur nga subjekti i fyer²⁴²;

²³⁸ Coppi F., *I reati sessuali. I reati di sfruttamento dei minori e di riduzione in schiavitù per fini sessuali*, Giappichelli Editore, 2007.

²³⁹ Shiko në këtë drejtim Squillaci G. F, *I reati sessuali*, <http://www.nuovefrontierediritto.it/i-reati-sessuali/>

²⁴⁰ Shtuar nga neni. 3, paragraf 23, L 15/7/2009, n. 94.

²⁴¹ Parashikim i shtuar nga neni.1, dekret ligj 14/8/2013, n. 93, i konvertuar, në ligjin 15/10/2013, n. 119.

- ndaj një gruaje shtatzanë²⁴³;
- ndaj një personi kur subjekti aktiv është bashkëshorti, edhe në rastet kur janë të ndarë apo të divorcuar, apo kur subjekti aktiv është një person i lidhur aktualisht apo më parë nga një marrëdhënie ndjenje, edhe kur nuk ka bashkëjetesë midis tyre²⁴⁴.
- në rast se vepra penale është kryer nga një person i cili bën pjesë në një shoqatë kriminale me qëllim për të lehtësuar veprimtarinë e saj²⁴⁵;
- në rast se vepra penale është kryer duke përdorur dhunë të rëndë apo kur nga fakti rrjedh për të miturin, si pasojë e sjelljeve, një dëm i rëndë²⁴⁶;
- ndaj një të mituri nën moshën 10 vjeç.

Në rastin e fundit dënimi shkon nga 7 deri në 14 vjet burgim.

Rrethanat rënduese të parashikuara në këtë dispozitë janë pasuruar ndër vite si rrjedhojë e akteve të ndryshme normative që kanë ndryshuar Kodin penal. Ky fakt dëshmon për një vëmendje të vazhduar të legjislatorit lidhur me rrethanat e kryerjes së krimit seksual.

Neni 609quarter sanksionon rastet e marrëdhëniet seksuale me të mitur pa përdorimin e dhunës në rastet kur:

- i mituri nuk ka mbushur moshën 14 vjeç;
- i mituri nuk ka mbushur moshën 16 vjeç kur subjekti aktiv është paraardhësi, prindi natyror apo adoptiv, tutori apo person tjetër që i është lënë i mituri në përkujdesje për arsye kurimi, mbajtje, mësimi, ruajtje apo me të cilin prindi ka marrëdhënie bashkëjetese²⁴⁷;

Neni 4, i Ligjit dt. 1/10/2012, nr. 172 shton dy paragrafë në këtë dispozitë.

Sanksionohet se, jashtë rasteve të parashikuara nga neni 609-bis, dhe të sjellura më lart, dënohet parardhësi, prindi natyror apo adoptiv, apo bashkëjetuesi i prindit, kujdestari apo person tjetër të cilit i është lënë në përkujdesje i mituri, për arsye kurimi, mbajtje, mësimi, ruajtje apo që ka marrëdhënie bashkëjetese me të miturin, në rastet kur subjekti aktiv shpërdoron pushtetin që i rrjedh nga pozita që ai mban dhe kryen akte seksuale me të mitur që nuk ka mbushur moshën 16 vjeçare.

Dënimi në këto raste parashikohet nga një minimum prej tre vjet deri në 6 vjet.

Gjithashtu në këtë nen parashikohen dhe disa raste përjashtimi nga përgjegjësia penale kur subjekti aktiv dhe ai pasiv janë të dy të mitur dhe diferenca mes tyre nuk është më shumë se tre vjet, por subjekti aktiv ka mbushur moshën 13 vjeç.

²⁴² Parashikimi është shtuar nga neni 3, paragraf 23, L 15/7/2009, n. 94.

²⁴³ Parashikim i shtuar nga neni.1, dekret ligj 14/8/2013, n. 93, i konvertuar, në ligjin 15/10/2013, n. 119.

²⁴⁴ Shtuar nga neni.1, dekret ligj 14/8/2013, n. 93, cituar.

²⁴⁵ Shtuar nga neni. 1, dekret legjislativ datë 4/3/2014, n. 39.

²⁴⁶ Shtuar nga neni. 1, dekret legjislativ datë 4/3/2014, n. 39.

²⁴⁷ Shtuar nga neni 6, ligji nr.38, dt. 6/2/2006.

Paragrafi i dytë që shtohet nga ligji i mësipërm i referohet rasteve me rëndësi më të vogël duke parashikuar për to një lehtësim dënimi i cili nuk mund të kalojë 2/3 e dënimit. Mendoj se ky paragraf është i paplotë pasi mbetet pikëpyetje se cilat mund të konsiderohen raste më të lehta. Do të jetë në diskrecionin e gjyqtarit zbatimi i lehtësimit të dënimit si më lart.

Neni 609quinques sanksionon figurën e veprës penale të korrupsionit të të miturit kur subjekti aktiv kryen marrëdhënie seksuale në prani të një të mituri me qëllim që i mituri të asistojë gjatë aktit seksual. Kjo dispozitë e vendosur nga legjislatori përmes ligjit nr. 66, dt 5 shkurt 1996, mbetet e pandryshuar deri në vitin 2014 kur legjislatori shton si rrethanë rënduese rastin kur vepra penale kryhet duke ushtruar dhunë të rëndë apo kur nga fakti të miturit i shkaktohet një dëm rëndë.

Neni 609sexies, i shkruar nga legjislatori i vitit 1996²⁴⁸, thekson dhe një herë një normë të njohur në të drejtën penale: ajo që injoranca e moshës së miturit nuk justifikon autorin për sa i përket kryerjes së veprave penale të marrëdhënieve seksuale me të mitur, korrupsionit të të miturit, dhunës seksuale në grup ndaj të miturve nën moshën 14 vjeç.

Në nenin 609septies, i shkruar dhe ky nga legjislatori i vitit 1996, përcaktohet mënyra e ushtrimit të ndjekjes penale ku alternohet në disa raste ankimi i personit të dëmtuar si për veprat penale të parashikuara në nenet 609bis, 609ter dhe 609 quarter me ndjekjen penale kryesisht në rastet e mëposhtme:

- në rast se vepra penale e parashikuar nga neni 609bis kryhet ndaj të miturve nën moshën 14 vjeç²⁴⁹;
- në rast se vepra penale kryhet nga prindi, bashkëjetuesi i prindit, tutori apo nga ndonjë person tjetër të cilit i është besuar i mituri për kurim, edukim, mësim, ruajtje, kujdesje²⁵⁰;
- në qoftë se vepra penale kryhet nga oficer publik apo person i ngarkuar me funksione publike gjatë ushtrimit të funksioneve të veta;
- në qoftë se kjo vepër penale është e lidhur me një vepër tjetër penale për të cilën ushtrohet ndjekja penale kryesisht;
- në qoftë se vepra penale kryhet ndaj një të mituri nën moshën 10 vjeç.

Mënyra e ushtrimit të ndjekjes penale është një problem i cili meriton diskutim nëse është më e drejtë që një fushë kaq delikate t'ia lesh në dorë ushtrimin e ndjekjes penale personave të dëmtuar apo nëse kjo gjë nuk është e drejtë pasi nuk duhet lënë në dorë të të dëmtuarve përgjegjësia për fillimin e një procedimi penal. Zgjidhja e dytë përforcohet nga ideja se ushtrimi kryesisht i ndjekjes penale është element që forcon efikasitetin e sistemit represiv.

Megjithëse në disa raste është vendosur që ndjekja penale të fillojë mbi bazën e ankimit të personit të dëmtuar është sanksionuar që në këto raste, ndryshe nga veprat e tjera penale, ajo nuk mund të tërhiqet, pra është e parevokueshme.

²⁴⁸ Shtuar nga neni 7, ligji nr. 66, dt. 15/2/1996.

²⁴⁹ Shtuar nga neni 7, ligji nr.38, dt. 6/2/2006.

²⁵⁰ Idem.

Gjithashtu legjislatori ka përcaktuar dhe një afat 6 mujor për të ushtruar të drejtën e ankimit që është dyfishi i afatit që parashikohet për veprat e tjera penale që ndiqen mbi bazën e ankimit, sepse ka dashur ti lërë pak më tepër kohë personit të dëmtuar për të marrë vendimet e veta, nisur nga delikatesa e situatës psikologjike në të cilën gjendet personi i dëmtuar.

Legjislatori ka individualizuar edhe disa raste ku për shkak të moshës së personit të dëmtuar, marrëdhënieve të veçanta mes subjektit aktiv e pasiv, apo cilësisë së subjektit aktiv, nuk është e këshillueshme t'ia besosh personit të dëmtuar të drejtën e ankimit apo legjislatori e ndjen për detyrë që të sanksionojë që në raste të caktuara ushtrimi i ndjekjes penale duhet të bëhet kryesisht.

Neni 609octies, parashikuar nga legjislatori i vitit 1996 dhe i pandryshuar deri në momenti që autorja shkruan, sanksionon dhunën seksuale në grup dhe përcakton se ajo konsiston në pjesëmarrjen nga ana e më shumë se një personi në mënyrë të bashkuar në akte të dhunës seksuale të parashikuara në nenin 609bis e 609ter dhe parashikon raste të rritjes si dhe uljes së dënimit kur ekzistojnë respektivisht rrethana rënduese dhe lehtësuese.

Neni 609nonies parashikon, në vijim të traditës, disa dënime dytësore për autorët që kryejnë veprat penale të parashikuara nga nenet 609bis, 609ter, 609quater, 609quinquies dhe 609octies. Kjo dispozitë, e shtuar nga neni 10, i ligjit nr. 66, datë 15 shkurt 1996, ka qenë subjekte e disa shtesave legjislative²⁵¹. Dënimet dytësore janë:

- humbja e të drejtës prindërore kur kjo e drejtë ka shërbyer si element thelbësor për kryerjen e veprës penale;
- pezullimi i përkohshëm nga detyra për çdo detyrë që ka lidhje me mbrojtjen, kujdesin dhe administrimin e mbështetjes;
- humbjen e të drejtës për ushqim dhe përjashtimin nga trashëgimia e personit të dëmtuar.
- pezullimi i përkohshëm nga detyrat publike;
- pezullimi nga detyra publike për një kohëzgjatje prej pesë vjet si rrjedhojë e një dënimi më heqje lirie prej tre deri në pesë vjet;
- pezullimi nga ushtrimi i një profesioni apo arti.

Kjo dispozitë parashikon gjithashtu zbatimin në disa raste të disa kufizime sigurie personale të autorit të krimit seksual si: kufizimi i lëvizjes dhe qarkullimit të lirë si dhe ndalimi i afrimit në vende të frekuentura zakonisht nga të mitur; 2) ndalim për të kryer punë të cilat kërkojnë një kontakt të zakonshëm me të mitur; 3) detyrimi për të mbajtur të informuar organet e policisë mbi vendbanimin dhe spostimet nga ky i fundit.

Në nenin 609decies parashikohet gjykimi i çështjeve penale nga Gjykata e të miturve kur personi i dëmtuar është i mitur apo autori i veprës penale është i mitur.

²⁵¹ Përmes dekretit legjislativ të datës 28/12/2013, nr. 154, ligjit nr. 38 të datës 6/2/2006, ligjit nr.172 të datës 1/10/2012.

Kjo dispozitë kujdeset gjithashtu të sigurojë asistencë afektive dhe psikologjike të personit të mitur që është fyer nga vepra penale, gjatë çdo shkalle dhe grade të procesit. Kjo asistencë sigurohet përmes pranisë së prindërve apo të personave të tjerë të aftë për këtë qëllim të cilët përcaktohen nga vetë i mituri si dhe grupe, fondacione, organizata joqeveritare me eksperiencë të provuar në sektorin e asistencës dhe mbështetjes ndaj viktimave të krimit si dhe të shërbimeve kundrejt të miturve të administratës së drejtësisë dhe të shërbimeve të enteve vendore.

Në vitin 2012 shtohet një dispozitë e re, neni 609undecies i cili dënon rastet kur një subjekt kryen veprime të ndryshme për të fituar besimin e një të mituri me qëllim shtyrjen e këtij të fundit për të kryer një krim seksual.

Ndërsa në vitin 2014²⁵² shtohet neni 609duodecies i cili përcakton që dënimet për krimet seksuale sipas neneve 609-bis, 609-quater, 609-quinquies, 609-octies e 609undecies rriten në masë jo më të lartë sesa 50% në rastet kur këto krime kryhen përmes përdorimit të mjeteve të tilla që pengojnë identifikimin e të dhënave të hyrjes në rrjetet telematike.

Ndryshimet legislative, të përmendura më lart, patën gjykime entuziaste si dhe kritika.

Lëvizjet feministe vlerësuan shumë pozitiv transferimin e krimeve seksuale në kapitullin e “Krimeve kundër lirisë personale”, sepse nga këto vepra penale nuk dëmtohet morali publik, por e drejta personale e subjektit pasiv për të vetëvendosur në liri të plotë në fushën seksuale.

Jo pak studiozë, dhe pse nuk nënvlerësuan vlerën “pedagogjike” të një klasifikimi të tillë dhe mesazhit që transmeton, theksuan që ajo që është e rëndësishme nuk është një rubrikë, por përmbajtja e normativës dhe disa të tjerë theksuan se do të ishte më e drejtë që krimet seksuale të sistemoheshin në kreun e “Krimeve kundër lirisë morale”²⁵³.

Shumë pozitivisht u prit shfuqizimi i dallimeve mes “dhunës seksuale” dhe “ngacmimeve seksuale” duke argumentuar që në të dyja format e kryerjes së veprës penale objekti që tutelon normativa është gjithmonë i njëjti – dinjiteti dhe liria personale për vetëvendosje në fushën seksuale, pavarësisht nga tipi i agresionit dhe që nuk ka ndryshime cilësore midis tyre dhe figura të ndryshme veprash penale për çdo lloj dhune të ushtruar.

Por, edhe ndaj këtyre vlerësimeve pozitive ka patur kritika të shumta ku theksohej se në shumë shtete ka figura të veçanta veprash penale për marrëdhëniet seksuale me dhunë dhe për ngacmimet seksuale me dhunë dhe justifikimi për këtë zgjedhje

²⁵² Përmes dekretit legjislativ nr.39 të dt 4/3/2014, neni 1, paragrafi i katërt.

²⁵³ Shiko Cadoppi A, *Commento all'art.3, in A. Cadoppi, Commentario delle norme contro la violenza sessuale e della legge contro la pedofilia*, Padova, 1999. Cadoppi A. (nen perkujdesjen e) *La violenza sessuale a cinque anni dalla legge n.66/96. Profili giuridici e criminologici*. Padova, Cedam, 2001; Balbi G., *Violenza Sessuale, në Enciclopedia Giuridica, VII, 1999*; Mantovani – “*I delitti contro la liberta*“, cituar me lart.

legjislative është se i përgjigjet më drejt represionit penal në këtë fushë si dhe i përgjigjet më drejt natyrës së fakteve²⁵⁴.

Dhe përse i përket krimeve seksuale ndaj të miturve duket sikur normativa nuk merr siç duhet në konsideratë seksualitetin dhe të drejtat seksuale ndaj të miturve.

Gjithashtu duket e tepruar dhe figura e veprës penale të korrupsionit të të miturve, i parë si një formë e avancuar e eksibicionizmit. Kjo figurë veprë penale cilësohet si një naivitet i legjislatorit dhe e papërshtatshme për të mbrojtur të miturin që jeton në një botë ku në çdo moment mund të shohë imazhe dhe më të papërshtatshme që përhapen nga mjetet e ndryshme të komunikimit²⁵⁵.

5.3 Krimet seksuale në të drejtën penale franceze.

5.3.1 Hyrje.

Dhuna seksuale është një nga fenomenet më të tmerrshme të jetës njerëzore. Ajo është në antitezë të fortë me civilizimin, me interesin e rregullit juridik jo vetëm për të ruajtur paprekshmërinë fizike të njeriut, por edhe moralin dhe etikën bashkëkohore. Ky trajtim mbi legjislacionin penal në fushën e krimeve seksuale në Francë nis me një vështrim historik, duke ndaluar dhe në trajtimin e fakteve më të rëndësishme. Punimi vijon me analizën e detajuar të krimeve seksuale në kodin penal francez. Veprat penale që analizohen janë: abuzimi seksual në sens të ngushtë (attenite sexuelle nenet 227-25 dhe në vazhdim); agresioni seksual (agression sexuelle, nenet 222-27 e në vazhdim) dhe përdhunimi (viol, nenet 222-23 dhe në vazhdim).

5.3.2 Vështrim historik.

Në sistemin francez analiza nis me rregullimin e krimeve seksuale në Kodin e Napoleonit ku këto vepra penale rregullohen në seksionin e gjashtë që mban titullin “Fyerje ndaj zakonit të mirë”. Ky seksion përmbahet në kreun e parë që titullohet “Krimet dhe veprat penale kundër personave”. Ajo që na bie në sy është situata që në këtë Kod, krimet seksuale klasifikohen si fyerje të zakonit të mirë dhe moralit publik. Veprat penale të rregulluara nga ky Kod ishin fyerja ndaj nderit ku futeshin sipas

²⁵⁴ Për një analizë më të gjatë shiko: Mazza B., *La libertà personale quale elemento centrale delle nuove norme sulla violenza sessuale: prime osservazioni*, në Rivista penale.1996; Venditto M., *La regolamentazione degli atti sessuali alla luce della legge 15 febbraio 1996, n. 66*, ne Rassegna italiana di crim. 1997; Donini M., *Art. 9, ne Commentario delle norme contro la violenza sessuale*, Padova 1996; Tabarelli de Fatis S., *Sulla rilevanza penale del bacio come atto di libidine prima e dopo la riforma dei reati sessuali*, ne Rivista italiana di diritto e procedura penale, Milano 1997; Bertolino M., *I reati sessuali tra codice e riforma*, ne Rivista italiana di diritto e procedura penale, 1983; Catanesi R., Troccoli G., *Il disturbo post-traumatico da violenza sessuale*, ne Rassegna italiana di crim., Milano 1988; Contieri E., *La riforma legislativa in mtema di delitti sessuali. Commento articolo per articolo*, ne Giustizia penale, parte prima; Canepa G., Lagazzi M., *I delitti sessuali*, Padova 1988; Mazzacuva N., *Violenza sessuale*, në *Diritto penale. Lineamenti di parte speciale* nën kujdesin e AA. VV., 1998.

²⁵⁵ Mantovani, cituar më lart.

nenit 330 përdhunimi dhe atentatet e tjera ndaj nderit përmes dhunës parashikuar në nenin 331. Këto vepra penale rregullohen në mënyrë të papërshtatshme, pasi ato reflektojnë një nevojë garancie juridike thellësisht të ndryshme nga të drejtat themelore të njeriut dhe më konkretisht nuk kanë si objekt të tyre lirinë seksuale apo paprekshmërinë fizike të çdo personi. Gjykata e Lartë Franceze me një vendim të vitit 1857²⁵⁶, përcakton për herë të parë se cilët janë elementët që karakterizojnë veprën penale të përdhunimit që është edhe figura kriminale më e rëndë. Sipas saj kjo veprë penale bazohet mbi faktin që një person abuzon me një person tjetër, në mungesë të konsensusit të këtij të fundit. Gjykata nuk bën dallime me bazë gjinore. Siç mund të analizojmë ky vendim, pavarësisht meritës së padiskutueshme që ka si vendimi i parë që nxjerr në pah nevojën e dakortësimit të dy palëve, ai mbart edhe boshllëqe në përkufizim. Mungon në të përcaktimi që dakortësimi duhet t'i referohet kryerjes së një marrëdhënieje seksuale²⁵⁷. Nëse e pranojmë këtë orientim atëherë dalim në përfundimin që përdhunimi është marrëdhënia seksuale midis dy palëve, ku njëra palë nuk shpreh pëlqimin e saj. Nuk mundemi të lëmë mënjanë elementin psikologjik pasi nevojitet që autori i veprës penale të ketë qëllime kriminale²⁵⁸.

Në vitet '70 me qëllim plotësimin e boshllëqeve të legjislacionit penal seksual nisi një debat parlamentar i cili mbyllet me propozime të projektligjeve të ndryshme. Por kjo fazë historike kulmon me miratimin e ligjit nr. 80-1041 të datës 23/12/1980²⁵⁹ i cili konsiderohet si pararendës i i kodifikimit të mëvonshëm të vitit 1994.

Ligji nr. 80-1041 sjell disa risi shumë të rëndësishme në fushën e krimeve seksuale pasi dallon dhe ndan përdhunimin nga atentati ndaj nderit²⁶⁰. Ai përcakton se përdhunimi konsiston në një akt penetrimi seksual, i kryer përmes dhunës, detyrimit fizik apo kanosjes. Atentati ndaj nderit përcaktohet si agresion seksual, i kryer përmes dhunës, detyrimit fizik apo kanosjes²⁶¹. Ky ligj sjell edhe një koncept të ri pasi autori i veprës mund të jetë femër apo mashkull²⁶².

Ligji i mëvonshëm nr. 82-683 datë 4 gusht 1982 përcakton se pjekuria seksuale arrihet në moshën 15 vjeçare. Me këtë ligj u barazuan edhe marrëdhëniet homoseksuale me ato heteroseksuale. "Majorité sexuelle" është moshë që duhet të arrijë një person në mënyrë që ligji ta konsiderojë personin të aftë që të ketë një marrëdhënie seksuale me një partner të zgjedhur në mënyrë të lirë dhe ky i fundit të mos dënohet nga ligji për kryerjen e marrëdhënies së mësipërme²⁶³.

²⁵⁶ Arrêt DUBAS, 25 juin 1857, Bull. crim., n° 240; S. 1857.1.711.

²⁵⁷ Larose et Forcel, *Traité théorique et pratique du droit pénal français*, t. IV, n° 452, 1891.

²⁵⁸ Garçon, *Code pénal annoté (art. 331 à 333)*, n°15, II, nën përkujdesjen e *Rousselet & Patin & Ancel*, 1956, fq. 305; *Goyet Droit Penal special*, Edicioni i tetë, Sirey, 1972, 1952 – 1959.

²⁵⁹ Për një trajtim të normativës para vitit 1980 shiko dhe Garçon, *Code Penal annoté*, cituar më lart, fq. 690 e vijuese.

²⁶⁰ Deri në atë moment mungonte një përcaktim i qartë për të dyja veprat penale.

²⁶¹ Cass. crim., 4 janvier 1985: Bull. crim. n° 10; Gaz. Pal. 1986.1.19 (viol commis par une femme).

²⁶² Në këtë drejtim shiko Macri F., *Verso un nuovo diritto penale sessuale. Diritto vivente, diritto comparato e prospettive di riforme della disciplina dei reati sessuali in Italia*, Firenze University Press, Firenze, fq. 62.

²⁶³ Ky koncept është futur në të drejtën franceze nga ligji i datës 28 prill 1832. Në atë kohë kufiri përcaktohej në moshën 11 vjec. Kufiri u ngrit dhe u cua në 13 vjec nëpërmjet ligjit të datës 13 maj 1863 dhe 15 vjec nëpërmjet udhëzimit të datës 2 korrik 1945. Duhet të nënvizojmë se po flitet për një "Majorité sexuelle" të përkufizuar në mënyrë të ngushtë pasi i referohet vetëm marrëdhënieve heteroseksuale. Majorite sexuelle u fiksua në moshën 21 vjec dhe më pas u ul në 18 vjec në vitin 1974 së bashku me përcaktimin e moshës madhore për qëllime civile.

Duhet të nënvizojmë gjithashtu se në realitetin francez ka patur përplasje të mëdha në vitet 1977-1979 mbi eliminimin e ligjeve mbi "Majorité sexuelle" gjatë kohës kur reforma e kodit penal po diskutohej në parlament.

E drejta penale seksuale reformohet përmes Kodit të ri penal francez, i cili hyn në fuqi më datë 1 mars të vitit 1994. Kjo e drejtë është zhvilluar dhe qëllimi i rregullimit të kësaj fushe identifikohet tashmë tek liria seksuale. Seksioni që u dedikohet këtyre krimeve delikate është seksioni i tretë me titull "Agresionet seksuale", i përmbajtur në Kapitullin e dytë i cili titullohet "Fyerjet ndaj integritetit fizik dhe psikik të personit". Ky kapitull është pjesë e titullit të dytë që emërtohet "Fyerjet ndaj personit". Pra, ndryshimet e reja në të drejtën penale, sjellin një rezultat mjaft të rëndësishëm. Tashmë në qendër të normativës nuk është më zakoni i mirë, por njeriu. Mbrohet ky i fundit jo vetëm nga ana e dëmtimeve fizike, por edhe psikike, pasi është botërisht e ditur tashmë që krimet seksuale çënojnë një pjesë të shenjtë të individit ndaj dhe shpesh arrinë ta dëmtojnë atë edhe nga ana psikologjike. Ky evolucion i të drejtës seksuale franceze është një moment mjaft i rëndësishëm. Ai vetëm nis me Kodin penal të vitit 1994, pasi në të vërtetë e drejta penale seksuale është reformuar ndër vite dhe më konkretisht në vitet 1998, 2003, 2005, 2006, 2007 dhe së fundmi në 2012²⁶⁴.

5.3.3 Vështrim i përgjithshëm mbi krimet seksuale në Kodin penal francez.

Ligji francez parashikon tre forma të abuzimit seksual: 1) abuzimi seksual në sens të ngushtë (attente sexuelle nenet 227-25 dhe në vazhdim); 2) agresioni seksual (agression sexuelle, nenet 222-27 e në vazhdim) dhe 3) përdhunimi (viol, nenet 222-23 dhe në vazhdim). Krimet seksuale rregullohen, me përjashtim të abuzimit seksual në sens të ngushtë, në seksionin e tretë të "Agresionit seksual" të kreut të dytë që emërtohet "Fyerjet ndaj integritetit fizik apo psikik të personit". Ky kre është pjesë e titullit të dytë që emërtohet "Fyerjet ndaj personit", pjesë e librit të dytë që emërtohet "Veprat penale kundër personit". Siç del në pah, në asnjërin prej emërtimeve të lartpërmendura, nuk gjejmë referime të "seksualitet të personit" konsideruar si një e mirë juridike. Ajo që na bie në sy është fakti që mbrojtja franceze përqëndrohet mbi integritetin fizik dhe psikik të personit dhe seksualiteti i këtij të fundit mbetet në sfond. Ai duhet kuptuar si një përbërës i integritetit fizik. Gjithashtu bie në sy numri i ulët i krimeve seksuale të parashikuara nga Kodi penal francez.

Ndryshe vepron legjislatori me veprën e abuzimit seksual e cila inkuadrohet në sektorin e pestë i emërtuar "rreziqet ndaj të miturve", i përmbajtur në kreun e shtatë për "fyerjet ndaj të miturve dhe familjes", pjesë e titullit të dytë për "Fyerjet ndaj personit". Doktrina e kritikon një sistemim të tillë të krimit të abuzimit seksual pasi përmes tij është vlerësuar më shumë moshja e viktimës sesa kategorizimi i veprës penale si krim seksual²⁶⁵.

²⁶⁴ Përmes ligjeve: 1) ligji nr. 98 – 468 të datës 17 qershor 1998; 2) ligji nr. 2003 – 239 të datës 18 mars 2003; 3) ligji nr. 2005 -1549 të datës 12 dhjetor 2005; 4) ligji nr. 2006 – 399, të datës 4 prill 2006; 5) ligji 2007 – 297 të datës 5 mars 2007. Për ndryshimet e vitit 2012 shiko <http://www.ilpost.it/2012/08/01/la-nuova-legge-francese-sulle-molestie-sessuali/>

²⁶⁵ Në këtë drejtim shiko dhe Macri F., Verso un nuovo diritto penale sessuale. Diritto vivente, diritto comparato e prospettive di riforme della disciplina dei reati sessuali in Italia, Firenze University Press, Firenze, fq. 49.

5.3.4 Vepra penale e abuzimit seksual në sens të ngushtë.

Abuzimi seksual në sens të ngushtë (Abuzimi seksual mbi të miturit) i përcaktuar në nenin 227 – 25 i referohet kryerjes së një krimi seksual, por pa përdorur dhunën, pa e detyruar viktimën, kërcënuar atë apo duke e surprizuar atë²⁶⁶. Krimi duhet të kryhet nga një person madhor me një të mitur nën moshën 15 vjeçare dhe dënohet me pesë vite burgim dhe gjobë prej 75 000 eur²⁶⁷. Kur krimi është kryer nga një paraardhës i viktimës apo person që ushtron pushtet mbi të, Kodi penal përcakton sanksione më të ashpra²⁶⁸. Sanksione më të lehta parashikohen kur vepra kryhet mbi një minor me moshë më të madhe se 15 vjeçare.

Në këtë vepër penale elementi që mbron viktimën është mos marrja në konsideratë e konsensusit të viktimës. Ky fakt justifikohet me faktin që në rastin e një fëmije shumë të ri (më pak se 12, 13 vjec) konsensusi konsiderohet zakonisht si i pamundur apo i pavlefshëm. Kjo sepse i mituri ende nuk ka arritur pjekurinë e nevojshme nga pikëpamja mendore për të dhënë një pëlqim të vlefshëm. Një “konsensus në dukje” mund të merret në konsideratë për të vlerësuar mundësinë e ekzistencës së një manipulimi në nivel mendor dhe të konsiderohet si një formë e veçantë kërcënimi psikologjik, situatë kjo që mund të cojë edhe në inkuadrimin e veprës penale të agresionit seksual apo të përdhunimit. Aktet e natyrës seksuale konsistojnë në sjellje që i referohen veprimtarisë seksuale dhe nëqoftëse do të kryhen me dhunë atëherë do të kemi të bëjmë me veprën penale të përdhunimit në rastet kur ekziston një penetrim seksual apo me atë të agresionit seksual kur aktet seksuale janë të ndryshme nga penetrimi seksual.

5.3.5 Vepra penale e agresionit seksual.

Neni 222 – 27 përcakton se agresioni seksual i ndryshëm nga përdhunimi dënohet me pesë vite burgim dhe gjobë prej 75,000 euro. Sanksioni ashpërsohet në rastet kur nga agresioni është shkaktuar një dëmtim si dhe në raste të tjera të parashikuara në mënyrë

²⁶⁶ Kodi penal i vitit 1810 merrte në konsideratë vetëm anën objektive të veprës penale, por vetëm nëqoftëse ishte kryer me dhunë dhe pa e marrë fare në konsideratë moshën e viktimës, ndërsa sot vepra penale e abuzimit seksual dallohet nga agresionet seksuale dhe nga përdhunimi mbi bazën e dy elementëve: 1) mungesa e dhunës, detyrimit, kërcënimit apo të papriturës në realizimin e veprës penale dhe 2) mungesa e rëndësisë së konsensusit të viktimës.

²⁶⁷ Article 227-25 (Act no. 98 - 468 of 17th June 1998 Article 18 Official Journal of 18th June 1998) (Ordinance no. 2000 - 916 of 19 September 2000 Article 3 Official Journal of 22 September 2000 in force 1 January 2002).

²⁶⁸ Neni 227 - 26 parashikon gjithashtu dënime të ashpra kur vepra penale është kryer nga një person në keqpërdorim të autoritetit që ai gëzon si rezultat i pozitës së tij apo kur krimi është kryer nga dy ose më shumë persona që veprojnë si autorë apo bashkëpunëtorë apo kur i mituri është vënë në kontakt me autorët, përmes përdorimit të një rrjeti telekomunikacionesh për përhapjen e mesazheve për një publik të pakufizuar. Act no. 94 - 89 of 1 February 1994 Article 15 Official Journal of 2 February 1994 in force 1 March 1994) (Act no. 95 - 116 of 4 February 1995 Article 121 Official Journal of 5 February 1995) (Act no. 98 - 468 of 17 June 1998 Article 13, Article 19 Official Journal of 18 June 1998) (Ordinance no. 2000 - 916 of 19 September 2000 Article 3 Official Journal of 22 September 2000 in force 1 January 2002) (Act no. 2002 - 305 of 4 March 2002 Article 13 Official Journal of 5 March 2002).

taksative nga neni 222 – 28 e në vijim²⁶⁹. Duhet nënvizuar fakti që dënohet me të njëjtat sanksione si agresioni seksual ashtu edhe tentativa për të kryer veprën penale të agresionit seksual²⁷⁰. Agresioni seksual kërkon ekzistencën e dy elementëve: 1) një kontakt fizik që i imponohet viktimës kundër vullnetit të saj, me dhunë, detyrim, kërcënim apo në mënyrë të papritur (elementë këto që duhen vlerësuar nga gjykatësi) si dhe 2) një akt i natyrës seksuale i çdo lloji duke kuptuar me këtë një akt, vlerësimi i të cilit duhet të mbajë në konsideratë mënyrën e perceptimit të viktimës dhe jo atë të autorit të veprës penale. Akti nuk mund të jetë akt penetrimi seksual, pasi në këtë rast do të kishim të bënim me veprën penale të përdhunimit.

Pra për ekzistencën e kësaj vepre penale nevojitet të vërtetohet mungesa e vullnetit të viktimës (ky i fundit mund të përbëjë një element të vështirë për t'u provuar) dhe ushtrimi i dhunës ndaj viktimës.

5.3.6 Vepra penale e përdhunimit.

Përdhunimi rregullohet nga Kodi penal francez në nenin 222 – 23 dhe përkufizohet si “Çdo akt i penetrimit seksual, i çfarëdo natyre, i kryer ndaj një personi duke përdorur dhunën, duke e detyruar viktimën, kërcënuar atë apo në mënyrë të papritur. Përdhunimi dënohet me pesëmbëdhjetë vjet burgim”. Kjo vepër penale sanksionet në mënyrë më të ashpër në të gjitha rastet kur në kryerjen e saj konkurojnë rrethanat rënduese të parashikuara në mënyrë taksative në nenet 222 – 24, 222 – 25 dhe 222 – 26. Vepra penale e përdhunimit në planin konceptual ngjason me agresionin seksual. Përdhunimi kërkon gjithashtu një kontakt fizik që i imponohet viktimës kundër vullnetit të saj, i kryer me dhunë, detyrim, kërcënim apo në mënyrë të papritur. Dallimi midis dy veprave penale qëndron në natyrën e kontaktit fizik, pasi vepra e dhunës seksuale kërkon penetrimin seksual, të çdo lloji. Ashtu siç u tha më lart për agresionin seksual, mungesa e vullnetit të viktimës duhet të provohet (me të gjitha vështirësitë që krijon për viktimën kjo provë), por duhet gjithashtu që të provohet dhe penetrimi seksual. Përdhunimi përbën krimin seksual më të rëndë si nga pikëpamja e dëmeve fizike dhe psikologjike që mund ti shkaktojë viktimës ashtu dhe nga

²⁶⁹ Sanksioni ashpërsohet në rastet kur vepra është kryer nga një parardhës i viktimës apo person që ushtron pushtet mbi të apo kur vepra penale është kryer nga një person në keqpërdorim të autoritetit që ai gëzon si rezultat i pozitës së tij apo kur krimi është kryer nga dy ose më shumë persona që veprojnë si autorë apo bashkëpunëtorë si dhe kur vepra ajo është kryer me përdorimin e një arme apo është shoqëruar me kërcënimin e përdorimit të një armë. Në këto raste dënohet me heqje lirie për një periudhë shtatë vjeçare dhe gjobë prej 100 000 euro. (Act no. 1998 - 468 of 17 June 1998 Article 13 Official Journal of 18 June 1998) (Ordinance No. 2000 - 916 of 19 September 2000 Article 3 Official Journal of 22 September into force 1 January 2002). Gjithashtu në kuadër të parashikimeve të nenit 222 – 29 nëse vepra penale është kryer kundrejt një të mituri nën moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, apo një personi dobësia e të cilit që vjen si rezultat i moshës, sëmundjes, paaftësisë fizike ose psikologjike, gjendjes së shtatzënisë, është e dukshme ose e njohura për autorin e veprës, atëherë kjo vepër dënohet më shtatë vite heqje lirie dhe gjobë prej 100 000 eur. (Ordinance No. 2000-916 of 19 September 2000 Article 3 Official Journal of 22 September into force 1 January 2002). Agresioni seksual sanksionohet me dhjetë vite heqje lirie dhe një gjobë prej 150,000 € kur në kryerjen e veprës, përveç rrethanave rënduese të rradhitura në nenin 222 – 29 konkurojnë edhe rrethanat rënduese si në rastet kur vepra është kryer nga një parardhës i viktimës apo person që ushtron pushtet mbi të, kur vepra penale është kryer nga një person në keqpërdorim të autoritetit që ai gëzon si rezultat i pozitës së tij apo kur krimi është kryer nga dy ose më shumë persona që veprojnë si autorë apo bashkëpunëtorë si dhe kur vepra ajo është kryer me përdorimin e një arme apo është shoqëruar me kërcënimin e përdorimit të një armë si dhe në rastin kur është kryer si pasojë e orientimit seksual të viktimës.

²⁷⁰ Neni 222 - 31.

sanksionet e ashpra me të cilat shoqërohet kjo vepër penale. Në fakt, ajo çfarë bie në sy, në analizën e kësaj veprë penale është orientimi i ashpër i legjislatorit francez i cili arrin të sanksionojë këtë vepër deri me burgim të përjetshëm në të gjitha ato raste kur kryerja e veprës është shoqëruar me akte torture apo barbarizmi²⁷¹. Një kuriozitet tjetër përbëhet nga fakti që legjislatori e dënon autorin me 30 vjet burgim në rastet kur si pasojë e përdhunimit ka ardhur vdekja e viktimës, ndërkohë që kur viktima është ende gjallë, por mbi të janë kryer akte barbarizmi, autori dënohet me burgim të përjetshëm. Nga ky diferencim mund të nxjerrim vetëm një përfundim që qëllimi i mbrojtjes juridike është i ndryshëm për të dyja parashikimet. Në rastin e akteve të torturës legjislatori përmes ashpërsimit të sanksionit kërkon që të bëjë të mundur eliminimin e praktikave të tilla gjatë kryerjes së përdhunimit. Ky qëllim duhet kuptuar në një sens të gjërë, si një qëllim i shoqërisë franceze e cila tenton të eliminojë ekzistën e praktikave të tilla të cilat janë praktika jo të përputhshme me një qytetërim të zhvilluar.

Në rastet kur viktima vdes përdhunimi konsiderohet si një vepër penale me pasojë vdekjen, në të cilën autori nuk e ka dëshiruar vdekjen e viktimës²⁷², por kjo e fundit ka ardhur si pasojë e rrethanave të kryerjes së aktit, gjendjes shëndetësore të viktimës etj. Në këto raste qëllimi i dispozitës duhet kuptuar në sens më të ngushtë, pasi legjislatori kujdeset që të mbrojë integritetin fizik të viktimës si dhe të drejtën për të jetuar.

Nëse krahasojmë të treja veprat penale vëmë re se abuzimi seksual në sens të ngushtë dallohet si nga agresioni seksual ashtu dhe nga përdhunimi pasi këto dy të fundit kanë një element të përbashkët që është mungesa e konsensusit të viktimës. Një dallim tjetër që nxjerrim në pah është fakti që agresioni seksual dhe dhuna seksuale nuk janë vepra penale që lidhen në mënyrë specifike me të miturit, sic ndodh në rastin e abuzimit seksual. Në veprat penale të agresionit seksual dhe përdhunimit mosha e viktimës dhe cilësia e paraardhësit apo të mbajtësit të pushtetit përbëjnë vetëm rrethana rënduese për efekt të masës së sanksionit.

²⁷¹ Neni 222 – 26.

²⁷² Pasi ndryshe nuk do të flisnim për veprën e përdhunimit, por të vrasjes me dashje apo paramendim, në varësi të rastit konkret.

Përfundime.

Krimet seksuale janë vepra penale të rënda që çënojnë lirinë seksuale të çdo personi, të mitur apo të rritur, dhe në shumë raste sjellin pasoja të rënda e shpeshherë të parikuperueshme në shëndetin e subjekteve pasivë.

Për vetë rëndësinë e tyre ato kanë gjetur një mbrojtje të posacme në legjislacionin tonë, nëpërmjet parashikimit nga legjislatori të një sërë figurash veprash penale.

Figurat e veprave penale të krimeve seksuale kanë patur një evolucion të vazhdueshëm që nga Kodi Penal i Zogut e deri në ditët tona.

Punimi i paraqitur analizoi ndryshimet në rregullimin e krimeve seksuale në të drejtën shqiptare. Përmes tij doli në pah që rregullimi i këtyre veprave penale konceptohej në mënyrë të ndryshme nga akte të ndryshme ligjore. Kështu, në të drejtën zakonore shqiptare konceptimi i këtyre veprave ka qenë shumë i ndryshëm pasi e drejta zakonore nuk mbronte disponimin e lirë të sferës seksuale, por mbronte në radhë të parë nderin e burrit të shtëpisë, pronë e të cilit ishte gruaja, pra femra, dhe gjithçka që kishte të bënte me të konceptohej si një send në pronësi të mashkullit.

Doli në pah sesi në Kodin e mbretit Zog krimet seksuale futeshin në titullin e veprave penale kundër zakonit të mirë dhe rregullit familjar pasi për kohën zakoni i mirë dhe rregulli familjar ishin të mira juridike esenciale të çdo shoqërie civile, që plotësonin njëra - tjetrën dhe për këtë arsye gjendeshin së bashku dhe në mbrojtjen që i siguronte ligji penal. Objekti kryesor i tutelës penale në këtë sistem ishte interesi social dhe publik, ndërsa mbrojtja e e subjektit pasiv ishte objekt dytësor i tutelës. Pikërisht në këtë drejtim, në punim u kritikua legjislatori i asaj kohe pasi ai fillimisht mbron interesin publik dhe pastaj paprekshmërinë e personit. Parashikoheshin hipoteza të ndryshme të marrëdhënieve seksuale apo të ngacmimeve seksuale që dënoheshin penalisht pavarësisht ekzistencës apo jo të dhunës e kanosjes dhe që merrnin rëndësi në funksion të moshës së subjektit pasiv apo kushteve të tij mendore e fizike dhe raporteve ndërpersonale që lidhnin subjektin aktiv me atë pasiv. Legjislatori i asaj kohe pranon se subjekt pasiv mund të jetë si femra po ashtu dhe mashkulli dhe gjithashtu i kushton një rëndësi të vecantë dhe mbrojtjes së fëmijëve si nga kryerja e marrëdhënieve seksuale po ashtu dhe nga veprime që mund të korruptojnë moralin e fëmijës. Gjejnë rregullimin e tyre në Kodin Penal të Zogut pothuajse të gjitha figurat e veprave penale të Kodit Penal të sotëm, por jo të gjitha janë figura veprash penale më vete, por mund të jenë parashikuar si rrethana të cilësuar.

Duke kaluar në Kodin Penal të vitit 1952 gjëja kryesore që bie në sy është klasifikimi i krimeve seksuale në kapitullin e krimeve kundër personit, gjë që flet për faktin se që në ato vite objekt i këtyre veprave penale ishte ruajtja e paprekshmërisë seksuale të gruas. Ky është një fakt shumë i rëndësishëm që flet për një evoluim të mendimit juridik dhe social, për një rëndësi të madhe që i jepej gruas dhe për rëndësinë që kishte për shtetin ruajtja e paprekshmërisë së saj seksuale. Doli në pah në punim sesi në këtë Kod Penal këto vepra penale nuk ishin të sistemuara mirë pasi në të njëjtin nen parashikohet vepra penale ndaj femrave që kanë arritur pjekurinë seksuale me marrëdhëniet seksuale me dhunë me veprën penale ndaj personave të pazotë etj.

Gjithashtu u kritikua fakti që për frymën komuniste të asaj periudhe që udhëhiqte të gjithë jetën e shtetit, shumë vepra penale në sferën seksuale nuk ishin të parashikuara pasi nuk ishin të pranuar si koncepte nga sistemi politik. Terminologjia juridike ishte e varfër dhe në të njëtin nen gjenin parashikim situata të ndryshme juridike. Nuk kishte filluar të përdorej ende koncepti “i mitur” dhe të përcaktohej një moshë minimale për viktimën, por parashikimet ligjore bazoheshin në arritjen e pjekurisë seksuale.

Me kalimin në Kodin Penal të vitit 1977 krimet seksuale nuk patën shumë ndryshime thelbësore nga Kodi Penal i mëparshëm dhe në të gjenin pasqyrim “Marrëdhëniet seksuale me dhunë” (neni 97), “Marrëdhëniet seksuale me të miturat” (neni 98), “Veprat e turpshme” (neni 99) dhe “Marrëdhëniet seksuale në gjini” (neni 100). Në këtë Kod Penal u ruajt klasifikimi i krimeve seksuale në kapitullin e krimeve kundër personit, dhe vijimësia e të njëjtit objekt të këtyre veprave penale që ishte ruajtja e paprekshmërisë seksuale të gruas dhe e shëndetit të saj. Edhe pse në këtë Kod u bë një përpjekje për një sistemim më të mirë të këtyre veprave penale, në të vërtetë sistemi i tyre ende linte për të dëshiruar. Edhe Kodi i ri Penal përshkohej nga e njëjta frymë socialiste e marksiste - leniniste dhe as në këtë kod shumë vepra penale në sferën seksuale nuk u parashikuan. U bë një hap përpara në terminologjinë juridike duke u futur koncepti i bashkëpunimit etj., por ende në të njëtin nen gjenin parashikim situata të ndryshme juridike. Risia e këtij kodi ishte futja, krahas mos arritjes së pjekurisë seksuale, e kriterit moshë që u përcaktua moshë 14 vjec si dhe e konceptit “të mitur”.

Me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri nga ai monokratik - totalitar në një sistem demokratik, pati ndryshime të shumta në të gjithë legjislacionin shqiptar. Ndryshime dhe shtesat e shumta që iu bënë edhe Kodit Penal të vitit 1977 nuk prekën veprat penale në sferën seksuale. Kështu, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 7895 dt. 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” nenet që parashikonin krimet seksuale mbetën të pandryshuara.

Hartuesit e ligjit në fjalë kanë tentuar të hartojnë një Kod penal që të ishte i zbatueshëm dhe t’i përshtatej kushteve, traditave dhe zhvillimeve demokratike të Shqipërisë. Ky Kod frymëzohej edhe nga legjislacionet e vendeve më me traditë të Evropës dhe në mënyrë të veçantë Kodit penal francez.

Kodi i ri penal ndahet në dy pjesë kryesore: në pjesën e parë që është pjesa e përgjithshme trajtohen dispozitat themelore që rregullojnë institutet e veçanta të së drejtës penale, ndërsa në pjesën e posaçme rregullohen veprat penale. Pjesa e përgjithshme, në versionin origjinar, përbëhet nga tetë krerë dhe përmban 73 dispozita kundrejt 49 dispozitave që përmbante kodi i mëparshëm. Risi përmban dhe pjesa e posaçme e këtij Kodi. Kështu renditja e veprave penale është e ndryshme në krahasim me kodin në fuqi. Është përdorur si model Kodi Penal Francez. Dënimet konkrete janë përcaktuar në harmoni me rrezikshmërinë e veprës penale dhe rezultojnë gjithashtu në harmoni midis veprave të ndryshme penale. Hartuesit e projekt Kodit theksojnë se në caktimin e dënimeve në vepra konkrete janë nisur edhe nga traditat, kushtet e vendit si dhe nga krahasimi i dënimeve të të njëjtave vepra në Kode penale të vendeve të tjera.

Krimet seksuale përmbahen në seksionin VI të këtij kodi me titull “*Krimet seksuale*”, i përfshirë në kreun II të pjesës së posaçme të K. Penal me titull “*Krimet kundër personit*”. Krimet seksuale tashmë përbëheshin nga 9 nene, nenet 100 - 108, në të cilat gjenin pasqyrim krimet e kryera ndaj sferës seksuale të femrës.

Kodi i ri Penal sjell shumë ndryshime thelbësore për krimet seksuale krahasuar me parashikimet e Kodit Penal të mëparshëm. Kështu veprat që gjejnë pasqyrim janë: *“Marrëdhëniet seksuale me të mitura”* (neni 100), *“Marrëdhëniet sesuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç”* (neni 101), *“Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura”* (neni 102), *“Marrëdhëniet seksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur”* (neni 103), *“Marrëdhëniet seksuale me kërcënim për përdorim të armës”* (neni 104), *“Marrëdhëniet seksuale duke shpërdoruar detyrën”* (neni 105), *“Marrëdhëniet seksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”* (neni 106), *“marrëdhëniet seksuale në vende publike”* (neni 107), *“Vepra të turpshme”* (neni 108).

Duhet theksuar se në këtë Kod Penal u ruajt klasifikimi i krimeve seksuale në kapitullin e krimeve kundër personit, dhe vijimësia e të njëjtit objekt të këtyre veprave penale që ishte ruajtja e paprekshmërisë seksuale të gruas, por u bë një sistemim shumë më i avancuar i këtyre veprave penale. Edhe pse në çdo nen të veçantë gjejnë parashikim lloje të ndryshme të veprave penale ndaj lirisë dhe paprekshmërisë seksuale të femrës dhe të të miturave, në të vërtetë ato linin për të dëshiruar pasi dhe në këtë kod shumë vepra penale në sferën seksuale nuk u parashikuan apo vazhduan të dënoheshin marrëdhëniet homoseksuale, kryerja të cilave dhe me konsensus përbënte vepër penale. Duhet vlerësuar edhe fakti se me këtë kod kemi gjithashtu një përmirësim të dukshëm të terminologjisë juridike.

Çfarë përbën risinë e vërtetë të këtij kodi lidhur me krimet seksuale është:

- 1) parashikimi i veçantë që ju bë çdo veprë penale duke u rritur kështu parashikimi i tyre nga në 4 në 9 nene;
- 2) parashikimi i figurave të reja të krimeve seksuale (situatave të reja) si ajo e kryerjes së marrëdhënieve seksuale duke shpërdoruar detyrën, nën kërcënimin e armës etj; si dhe
- 3) kategorizimi i ri që iu bë të miturave duke shtuar dhe të miturat nga moshë 14-18 vjeç etj.

Në lidhje me subjektin pasiv (femër) tashmë ai ndahet në katër kategori si vijon: kategoria e parë ku inkuadrohen ato femra që kanë mbushur moshën 18 vjeç dhe cilësohen si të rritura; kategoria e dytë ku inkuadrohen të miturat e moshës 14 vjeç - 18 vjeç dhe që kanë arritur pjekurinë seksuale; kategoria e tretë përfshin të miturat që nuk kanë mbushur moshën 14 vjeç dhe kategoria e katërt përfshin të miturat që kanë mbushur moshën 14 vjeç, por nuk kanë arritur pjekurinë seksuale. Kategorizimi i mësipërm ishte shumë i nevojshëm pasi nga ai varet ekzistenca e veprës penale. Kështu, për të miturat në moshën 14 - 18 vjeç dhe që kanë arritur pjekurinë seksuale për ekzistencën e veprës penale të parashikuar nga neni 101 është i nevojshëm përdorimi i dhunës.

Vepra penale e kryerjes së marrëdhënieve seksuale me kërcënim për përdorimin e armës parashikuar nga neni 104 i Kodit Penal është një figurë e re veprë penale e cila kërkon kërcënimin për përdorim aty për aty të armës.

Vepra penale e kryerjes së marrëdhënieve seksuale duke shpërdoruar detyrën parashikuar nga neni 105 i Kodit Penal, gjithashtu është një figurë e re veprë penale e cila kërkon që midis subjekteve të ketë një raport vartësie apo detyre.

Vepra penale e marrëdhënieve seksuale në gjini e parashikuar nga neni 106 i Kodit Penal ka pësuar përmirësime nga e njëjta figurë vepre penale e parashikuar në kodin e vjetër. Në të janë shtuar dhe raportet e kujdestarisë dhe birësimit. Kjo vepër penale nuk kërkon ekzistencën e dhunës, por mjafton kryerja e marrëdhënieve seksuale në vijë të drejtë apo midis vëllezërve dhe motrave etj. Kjo vepër penale është një vepër që konkurron në çdo rast me krimet e tjera seksuale.

Gjithashtu është shtuar dhe një vepër e re penale e parashikuar nga neni 107 i Kodit Penal ajo e kryerjes së marrëdhënieve seksuale në vende publike. Kjo është një kundravajtje penale dhe objekti i saj është i ndryshëm nga objekti i veprave të tjera penale të parashikuara në këtë seksion. Kjo vepër penale ka për objekt ruajtjen e marrëdhënieve juridike të vendosura për të ruajtur moralin publik dhe rregullat e moralit të shoqërisë sonë. Për këtë arsye mendoj se është bërë një sistemim i gabuar i kësaj figure vepre penale në këtë seksion.

Këto ndryshime që patën krimet seksuale me hyrjen në fuqi të Kodit Penal të vitit 1995, erdhën kryesisht si pasojë e ndryshimit të sistemeve, nevojës për një përshtatje të legjislacionit penal me atë të vendeve demokratike, me konventat ndërkombëtare dhe me një emancipim të shoqërisë dhe nevojës për të parashikuar dhe vepra penale që më parë ishin të papranueshme për moralin e shoqërisë socialiste.

Me miratimin e ligjit nr. 8733 datë 24.01.2001 dhe ligjit nr.144 datë 20.05.2013 u ndryshuan dhe u plotësuan figurat e veprave penale që parashikonin krimet seksuale ose homoseksuale. Këto ligje edhe pse kanë rol ndihmës janë aktive në luftën kundër krimeve seksuale ose homoseksuale duke parashikuar dhe dënime të rënda për këto vepra penale.

Objekt i këtyre veprave penale në radhë të parë është liria seksuale e çdo personi, qoftë ky i mitur apo i rritur, i gjinisë femërore apo mashkullore. Liria seksuale duhet kuptuar si e drejta e çdo personi për të disponuar lirinë e tij seksuale, për të pretenduar që ajo të respektohet nga të tretët si edhe si paprekshmëri e kësaj sfare kaq delikate.

Seksualiteti është një “mjet” i shprehjes së personalitetit njerëzor, është një mënyrë “komunikimi” ndërpersonale dhe krimet seksuale mund të interpretohen vetëm si një dëm që i shkaktohet personit në të drejtat e tij themelore. Legjislatori është “xheloz” në mbrojtjen e kësaj të drejte individuale që integron atë marrëdhënie të veçantë juridike që është morali publik, pra në këto vepra penale kemi një përparësi të profilit privat mbi atë publik. Deri para hyrjes në fuqi të ligjit të vitit 2001, Kodi Penal mbronte vetëm paprekshmërinë e sferës seksuale të femrës, ndërsa homoseksualiteti parashikohej si vepër penale.

Ligji nr. 8733 datë 24.01.2001 ndryshoi mënyrën e të konceptuarit të subjektit pasiv të këtyre veprave penale duke përfshirë si subjekt pasiv edhe mashkullin krahas femrës. Një risi e rëndësishme e këtij ligji, që meriton të nënvizohet, është zgjerimi i mbrojtjes që ai garanton duke përfshirë edhe marrëdhëniet seksuale midis homoseksualëve. Përmes tij sigurohet njehsimi i përgjegjësisë penale për krimet seksuale ose homoseksuale, në të cilin bazohet cilësimi si veprime të kundërligjshme me dashje, që çenojnë lirinë seksuale dhe shëndetin e femrës a të mashkullit.

Ky ligj përbëri një hap përpara dhe në përputhje me Kushtetutën e RSH-së, Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Konventën për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, për mbrojtjen e të drejtave të grave. Ky ligj padyshim mund të krahasohet edhe me kodet penale të shteteve të zhvilluara evropiane.

Ndryshimet në kodet penale evropiane përsa i përket krimeve seksuale kanë ardhur dhe si pasojë e “luftës” së gjatë që kanë bërë lëvizjet femministe dhe shoqatat për mbrojtjen e grave në këto shtete, gjë që në vendin tonë mungon. Ndryshimet në kodin tonë kryesisht bëhen si nevojë për përshtatje me legjislacionet e shteteve evropiane dhe si pasojë e ndikimit të politikës kriminale.

Me ardhjen e demokracisë, pra ndryshimin e sistemit politik, megjithëse mungojnë statistikat kriminologjike, krimet seksuale patën një rritje të madhe në vitet 1993, 1994 etj, veçanërisht deri në vitin 1997 - 1998 dhe si pasojë u bë i domosdoshëm parashikimi i figurave të më shumë veprave penale në sferën seksuale.

Kjo situatë solli fillimisht shtimin e figurave të veprave penale në Kodin Penal të vitit 1995 dhe me pas ndryshimin dhe plotësimin e këtyre veprave penale përmes ligjit nr. 8733 të vitit 2001.

Nevoja e rishikimit të dispozitave të Kodit penal u diktua nga miratimi i Kushtetutës së re, përvoja e zbatimit të ligjit 7895 në luftën kundër kriminalitetit, nga Vendimi i Gjykatës kushtetuese e cila shpallte antikushtetues dënimin me vdekje si dhe nga procesi i nënshkrimit të Protokollit të gjashtë të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe lirive themelore.

Të gjitha ndryshimet e bëra si rezultat i ligjit të mësipërm kishin si synim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personit, forcimin e rendit dhe qetësisë publike në luftë kundër kriminalitetit.

Me ligjin nr. 8733 u ndaluan si marrëdhëniet seksuale ashtu dhe ato homoseksuale me të mitur ku termi “*të mitur*” nënkupton të mitur femra dhe të mitur meshkuj. Kjo shtesë përbën një risi të domosdoshme pasi dispozita garanton në të njëjtën mënyrë fëmijën e mitur pavarësisht seksit të tij/saj. Dëmi psikologjik dhe fizik që shkaktohet tek fëmija i mitur nuk zhduket në rastin kur i mituri është i seksit mashkullor. Gjithashtu edhe neni 101 në versionin e tij origjinar ndalonte vetëm “*Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të mitura të moshës 14-18 vjeç*”.

Me shtesat e ligjit nr. 8733 ai ndalon tashmë edhe marrëdhëniet seksuale me dhunë me të mitur (meshkuj) të moshës 14 - 18 vjeç edhe ato homoseksuale me dhunë me të mitur (meshkuj dhe femra) të moshës 14 - 18 vjeç.

Objekt ndryshimi ka qenë dhe neni 102 i cili ndalon marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura. Shtohet në këtë dispozitë parashikimi i rrethanave të cilësuar si kryerja e marrëdhënies seksuale në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin duke parashikuar në këto raste dhe dënime më të rënda.

Shtohet gjithashtu neni 102/a i cili, në frymën e barazisë midis dy sekseve, ndalon marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur.

Ndërsa neni 103 i titulluar në versionin e tij origjinar “*Marrëdhënie seksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur*” pëson dy shtesa. Së pari ndalon krahas marrëdhënieve seksuale edhe ato homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur dhe së dyti parashikon dënime më të rrepta në rastin kur vepra kryhet në rrethana të cilësuar.

Neni 104 ndalon përveç marrëdhënieve seksuale edhe ato homoseksuale me kërcënim për përdorim të armës. Subjekt pasiv mund të jetë si mashkulli si femra.

Në të njëjtën frymë edhe neni 105 ndalon jo vetëm marrëdhëniet seksuale por edhe ato homoseksuale duke shpërdoruar detyrën.

Ndryshim pëson dhe neni 106 i cili dënon marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari duke konceptuar të tilla marrëdhëniet ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësimit.

Neni 107 ndalon kryerjen e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në vende publike.

Krimet seksuale pësojnë ndryshime edhe me ligjin nr. 23/2012 “*Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë"*”, të ndryshuar, por këto ndryshime lidhen vetëm me masën e dënimit në veprat penale të parashikuara në nenet 102/a dhe 108.

Së fundmi, ndryshime të rëndësishme Kodi penal ka pësuar edhe si rrjedhojë e miratimit të ligjit nr. 144/2013, datë 02.5.2013. Nevoja e ndryshimit të Kodit penal u konsiderua si thelbësore me qëllim dhënien e një përgjigjeje më të përshtatshme dhe efektive problematikave në rritje apo të reja në fushën penale. Përmes ligjit të ri këto probleme adresohen nëpërmjet një qasjeje të dyfishtë ku qasja e parë garanton forcimin e luftës ndaj kriminalitetit, duke ashpërsuar dënimet për veprat penale të rënda dhe duke parashikuar rregulla të reja, me qëllim garantimin e vuajtjes së plotë të dënimit nga personat me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

Më konkretisht mes qëllimeve të këtij ligji është trajtimi më efektiv i problematikës së dhunës në familje dhe rritja e dënimeve për ato vepra penale për të cilat është vërejtur një rritje gjatë viteve të fundit.

Kështu legjislatori ka ndërhyrë duke rritur dënimin në rastet e parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 100 ku dënimi për kryerjen e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në rrethana rënduese pëson një rritje në sensin që legjislatori fillimisht parashikonte një minimum burgimi prej pesëmbëdhjetë vitesh dhe një maksimum gjer në njëzet e pesë vjet. Me ligjin e ri maksimumi është ndërruar në minimum dhe dispozita tashmë përcakton se kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale në rrethana rënduese dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

Legjislatori ka ndërhyrë gjithashtu edhe në paragrafin e tretë “*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur*” duke rritur edhe në këtë rast dënimin. Legjislatori përcaktonte se vepra dënohej me burgim jo më pak se njëzet

vjet, ndërsa tashmë ajo dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Legjislatori ka ndërhyrë në tekstin e nenit 102 të Kodit Penal duke shtuar ndalimin e kryerjes së marrëdhënieve seksuale midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre dhe duke e dënuar me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Është shtuar një dispozitë e re që është neni 107/a i Kodit Penal i cili ndalon ushtrimin e dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, duke e dënuar me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

Gjithashtu, legjislatori rregullon dhe rastet kur vepra kryhet në rrethana rënduese si bashkëpunimi, kur kryhet kundër disa personave, kur kryhet më shumë se një herë ose kundër fëmijëve të moshës katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç. Në këto raste dënimi ashpësohet dhe subjekti aktiv dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Në rastet kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet. Dënim më i ashpër parashikohet në rastet kur kjo vepër ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit. Subjekti aktiv do të dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

Në nenin 108 të Kodit Penal, legjislatori ndalonte kryerjen e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërbëdhjetë vjeç. Me ndryshimet e ligjit nr. 144/2013 në këtë dispozitë shtohen disa paragrafë. Kështu, në kuadër të luftës së dhunës në familje, legjislatori përcakton se *“kjo vepër, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.”*.

Më tej, në kuadër të mbrojtjes së mëtejshme të të miturit përcakton se *“Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo i një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet”*.

Legjislatori shkon më tej me mbrojtjen e tij dhe me qëllim shkurajimin e çdo lloj iniciative nga ana e subjekteve aktive për të kryer krime seksuale apo vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit dënon dhe thjesht propozimin e bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale.

Gjykoj se përmes kësaj dispozite garantohet një mbrojtje ligjore maksimale e të miturve në lidhje me veprat e mësipërme.

Ndërhyrja e fundit në seksionin e krimeve seksuale lidhet me shtimin e një dispozite të re, neni 108/a i Kodit Penal, i cili ndalon kryerjen e sjelljeve me natyrë seksuale, që çenojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues. Ngacmimet seksuale përbëjnë tashmë një vepër e cila dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Në rastet kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënimi ashpësohet duke u rritur në tre deri në shtatë vjet. Ngacmimet seksuale përbëjnë një krim seksual i dënuar në një numër të lartë shtetesh të zhvilluara.

Me këtë ligj kemi një klasifikim të ri të krimeve seksuale në hap me kohën dhe pa kontradikta.

Legjislacioni penal shqiptar mbron posaçërisht lirinë seksuale dhe shëndetin e njeriut, duke dënuar rëndë përdhunimin dhe krime të tjera seksuale. Kodi penal, aktualisht, parashikon 12 figura veprash penale, si krime seksuale ose homoseksuale, të cilat konsiderohen krime kundër jetës dhe shëndetit të personit, për të cilat parashikohen dënime të rënda. Krimet seksuale dhe homoseksuale përmbahen në seksionin VI të Kodit penal, “Krimet seksuale”, i cili është një prej 10 seksioneve të kapitullit II të këtij Kodi, “Veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës”.

Krimet seksuale dhe homoseksuale janë parashikuar në të njëjtin seksion. Gjithsesi, gjenden disa dispozita të veçanta, siç është rasti i neneve 102 dhe 102/a të Kodit Penal, të cilët përkatësisht parashikojnë rastet e marrëdhënieve seksuale me dhunë me të rritura dhe rastet e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur. Ato ndryshojnë vetëm për sa u përket dënimit.

Në këndvështrimin bashkëkohor, Kodi Penal aktual paraqitet më i plotësuar në goditjen e krimeve seksuale dhe homoseksuale, në raport me të gjitha kodet apo ligjet penale të mëparshme. Të gjitha rrethanat e veçanta në të cilat mund të kryhen marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë, si dhe veprat e turpshme, klasifikohen si figura krimi më vete dhe jo si rrethana të cilësuar të kryerjes së krimit.

Marrëdhëniet seksuale me dhunë parashikohen si vepër penale më vete në: nenin 101 (Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç), nenin 102 (Marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura), 102/a (Marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur) të K. Penal dhe si rrethanë rënduese në nenin 100 (Marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale me të mitur). Më tej krimet seksuale klasifikohen marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona të pazotë për t’u mbrojtur (neni 103); marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me kërcënim për përdorim të armës (neni 104); marrëdhënie seksuale ose homoseksuale duke shpërdoruar detyrën (neni 105); marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari (neni 106); marrëdhënie seksuale në vende publike (neni 107); dhuna seksuale (neni 107/a); vepra të turpshme (neni 108) dhe ngacmimi seksual (neni 108/a).

Pothuajse të gjitha veprat e klasifikuara si më sipër përbëjnë krim dhe kryerja e çdonjërit prej tyre pasohet nga dënime të rënda. Dënimet janë më të rënda nëse veprat penale kryhen në rrethana cilësuese. Prej këtyre bëjnë përjashtim marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në vende publike pasi kjo vepër përbën një kundravajtje penale.

Këto vepra penale përbëjnë çështje të juridiksionit të gjykatave të zakonshme. Për një periudhë kohe Gjykata e Krimeve të Rënda, e krijuar në vitin 2004, ka patur

juridiksion vetëm për rastet e konsideruara mjaft të rënda, të parashikuara në nenet 100 dhe 101 të Kodit Penal, përkatësisht në rastet e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me të miturat dhe të marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur, por tanimë dhe këto vepra penale janë në juridiksionin e gjykatave të zakonshme.

Doli në pah edhe koncepti i aktit seksual. Koncepti “akt seksual” të con në mënyrë koherente në pranimin e faktit që përbëjnë marrëdhënie seksuale vetëm ato sjellje që karakterizohen nga një kontakt fizik i një pjesë cfarëdo të trupit të njërit prej partnerëve me një zonë gjenitale të partnerit tjetër (në konceptin bashkëkohor zonë gjenitale kuptohen si mamelet femërore, po ashtu dhe zona orale e anale). Vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një objektivizim efektiv i konceptit, i cili bazohet sigurisht në planin seksual të pjesëve të trupit mbi të cilat ndikon sjellja antiligjore e subjektit aktiv. U analizua gjithashtu mënyra e realizimit të veprës penale, regjimi i ushtrimit të ndjekjes penale ku u evidentua që qëllimi i ushtrimit të ndjekjes penale me ankim në disa raste është ai që të ruajë moralin dhe nderin e personit të dëmtuar, por në fakt në mënyrë indirekte mbron bashkë me nderin e të dëmtuarit dhe dhunuesit; dhe në një farë mënyre i jep atyre “licensën” për të përdhunuar.

Opsioni i zgjedhur për të ushtruar ndjekjen penale mbi bazën e ankimit të të dëmtuarit është pasojë e një vlerësimi të ndryshëm që i bëhet vlerave të të mirës së tuteluar nga norma penale dhe personalitetit dhe lirisë personale të subjektit pasiv. Në këtë mënyrë i kushtohet një vëmendje më e madhe vullnetit të brendshëm të personit të dëmtuar nga vepra penale për të mos përbulluar një proces penal dhe sidoqoftë për të mos ndjekur penalisht agresorin dhe nuk sakrifikohet ky vullnet për të patur një luftë sa më efikase ndaj kriminalitetit. Këtu është e nevojshme një ndërhyrje ndëshkuese e Shtetit që është një mjet efikas për luftën kundër kriminalitetit.

U analizua gjithashtu kryerja e krimeve seksuale në bashkëpunim e cila e analizuar në lidhje me subjektin pasiv nxjerr në pah me qartësi ngarkesën e madhe ofensive që ka. U evidentua sesi pikërisht për t’u mbrojtur specifikisht nga fakte kaq brutalë dhe në përpjekje për të “shëruar” sado pak të jetë e mundur një fenomen kaq të rëndë dhe të trishtueshëm, legjislatori ka parashikuar në pjesën më të madhe të krimeve seksuale në paragrafet e dyta të neneve kryerjen e veprave penale në bashkëpunim ku vendos dhe një sanksion më të rëndë për subjektet aktivë.

Gjatë analizës së aspekteve kriminologjike doli në pah që ekzistojnë faktorë që ndikojnë në shkaktimin e krimit të cilët edhe pse nuk janë faktorë determinues, ato janë më të favorshëm për të bërë një individ të kryejë një krim sesa faktorë të tjerë.

Këta faktorë janë: ambjenti social, një defekt fizik i autorit, një defekt mendor, pasiguria emocionale e autorit, një mjedis social që atë e rrethon si një lagje e varfër, arsimimi i dobët i tij, varfëria ekstreme, përpjekje për të kënaqur nevojën për të kryer marrëdhënie seksuale apo për të kënaqur nevojën për t’u ndjerë dominues apo sepse dikush tjetër e ka shtyrë të kryejë krimin kundrejt shpërblimit apo sepse dëshiron ta bëjë viktimën që të vuajë si dhe arsye të tjera si dhe të tjera.

I ndryshëm nga faktorët është shkaku i cili, siç u analizua në këtë punim, identifikohet kryesisht në dëshirën e autorit për të kënaqur dëshirat seksuale. U analizua gjithashtu

mënyra e kryerjes së krimit seksual dhe u arrit në përfundimin se ajo ndryshon në çdo vepër penale.

Ajo është e kushtëzuar nga faktorë të ndryshëm ku ndër të parët rradhitet inteligjenca dhe aftësitë e autorit.

Sjellja kriminale kushtëzohet edhe nga viktimja, moshja e saj, aftësia e saj për t'i bërë ballë dhunës së ushtruar nga autori. Autori vepron përmes një strategjie vetëjustifikimi të sjelljes në mënyrë që të neutralizojë senset e fajit dhe turpit nga shoqëria në nivelin e duhur për të mbajtur të paprekur vetëvlerësimin e tij. Pra ai nuk ndjehet fajtor. Doli në pah se shpesh autori është njeri psikikisht i sëmurë dhe se e vetmja metodë për të ulur numrin e krimeve seksuale është të kuptuarit e motiveve psikiatrike që qëndrojnë prapa veprës penale. Tek autori i krimit seksual mund të shfaqen shqetësime psikike të cilat njihen me emrin “parafili” apo “perversitete seksuale”. Këto e shtyjnë autorin të kryejë krimin në fjalë.

Një përfundim i rëndësishëm lidhet me faktin që shumë nga autorët e krimeve seksuale janë viktimja të krimeve me natyrë seksuale në fëmijëri.

Në lidhje me analizën e krimeve seksuale me të mitur nën moshën 14 vjeçare, fenomen i cili ka marrë përmasa shqetësuese, sidomos vitet e fundit, zgjedhja ligjore e bërë nga legjislatori përse i përket mënyrës së rregullimit të marrëdhënieve seksuale apo homoseksuale me të mitur përbën padyshim formën më të mirë të tutelës së të miturit. Kjo normë ligjore garanton pozicionin e të miturit dhe pozicionohet në mbrojtje të zhvillimit të personalitetit seksual të tij. Nëse e pranojmë këtë fakt atëherë jemi duke njohur edhe “seksualitetin” si një e drejtë dhe liri individuale e çdo subjekti.

Kryerja e marrëdhënieve seksuale me të mitur konsiderohet “tabu” për këdo dhe të miturit nuk i njihet asnjë e drejtë “për shprehjen e lirisë dhe cilësive të tij seksuale”.

Siç konfirmohet nga kërkesa e dhunës si element i nevojshëm në marrëdhëniet me të mitur të moshës 14 – 18 vjeçare, të rregulluara nga neni 101 i KP, legjislatori përcakton mbushjen e moshës 14 vjeçare si kufiri penal midis ligjshmërisë dhe paligjshmërisë në kryerjen e marrëdhënieve seksuale me apo midis të miturve.

Kjo ndodh pasi nuk mundet që ligji të ndërhyjë në mënyrë të pandërprerë në jetën dhe personalitetin seksual të të miturit. Në këtë mënyrë do të mohohet normaliteti i seksualitetit dhe do të ndërfaqej një formë traumatizimi.

Kjo formë veprë penale (marrëdhëniet seksuale me të mitur deri në moshën 14 vjeçare) paraqet një model rreziku abstrakt në sensin që gjykimi mbi ekzistencën e rrezikshmërisë formulohet *a priori* nga ana e legjislatorit. Kjo është një vepër penale që bazohet mbi një supozim absolut paprekshmërie të të miturit nën moshën 14 vjeçare. Nga kjo paprekshmëri i mituri del në momentin që mbush moshën 14 vjeçare dhe pikërisht në këtë moment ai bëhet titullar i të drejtës për lirinë seksuale.

Në një vështrim krahasues vëmë re se këto dy dispozita janë diskriminuese për shkak të orientimit seksual dhe gjinor njëkohësisht. Siç lexohet më lart, neni 102 i Kodit Penal ndëshkon “marrëdhëniet seksuale me dhunë me të rritura”. Pra bën prezumimin se vetëm gratë e rritura mund të jenë viktimja të dhunës seksuale dhe se dhunuesit e tyre mund të jenë vetëm burrat. Ndërkohë neni 102/a i Kodit Penal ndëshkon

“marrëdhëniet homoseksuale me dhunë me të rritur” duke bërë prezumimin se krimet seksuale mes personave të të njëjtit seks janë gjithmonë të kryera nga një mashkull kundër një mashkulli tjetër. Në fakt dhuna seksuale mbetet dhunë seksuale dhe ajo nuk njih orientim apo gjini.

Një dallim tjetër i pajustificuar është sanksionimi i ndryshëm.

Kështu kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë, me të rritura ose midis bashkëshortëve apo bashkëjetuesve, pa pëlqimin e njërit prej tyre, sanksionohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet, ndërkohë që kryerja e marrëdhënieve homoseksuale me dhunë me të rritur dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Në rastet kur marrëdhënia seksuale me dhunë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarës i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Ndërkohë kur bëhet fjalë për marrëdhënie homoseksuale me dhunë në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur të dëmtuarit i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, vepra dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Sanksioni mbetet i njëjtë vetëm në rastet kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e të dëmtuarit/dëmtuarës. Në këto raste dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet.

Cila është arsyeja e legjislatorit për të bërë këtë lloj diskriminimi? Mos vallë pasojat e një marrëdhëniejeje seksuale me dhunë mbi një femër janë më të rënda se pasojat e një marrëdhëniejeje homoseksuale me dhunë mbi një mashkull?

Duhet përmendur se risi e kodit penal, përbën rregullimi që i bëhet marrëdhënieve homoseksuale dhe për rrjedhojë pranimi që subjekt pasiv mund të jenë dhe meshkujt.

Do doja të nënvizoj se do të ishte interesante ideja që të dënohej penalisht dhe subjekti aktiv që nuk ushtron dhunë, por që thjesht vepron në kundërshtim me dëshirën e të dëmtuarës/it, sepse në këtë mënyrë valorizohet tema e vetëvendosjes së lirë individuale përballë çdo lloj “shtrëngimi” edhe jo të dhunshëm për të mospranuar kryerjen e akteve seksuale.

Aktiviteti seksual ka të bëjë ngushtësisht me personin dhe duhet të mbrohet si aspekt veçanërisht delikat i autonomisë individuale, që mund të sjellë një rimodulim të mbrojtjes efektivisht më garantiste të së drejtës për vetëvendosje seksuale, të tillë që kush manifeston vullnetin personal kundër kryerjes së një akti seksual ka të drejtën të mbrohet në kundërshtimin e tij pavarësisht sjelljeve personale kundrejt iniciativave të subjektit aktiv. Kjo lloj tutele është zbatuar në shtete të ndryshme veçanërisht ato me prejardhje anglosaksone.

Në lidhje me tutelën ndaj të miturit për mendimin tim legjislatori mbron jo vetëm personalitetin seksual të të miturit, por edhe vlerat e njeriut që ndodhen brenda të miturit.

I mituri instrumentalizohet dhe pse nuk mund të jetë koshient për atë që po ndodh dhe ndoshta nuk e kupton që ndaj tij po kryhen veprime të turpshme dhe ai po përdoret për kënaqësitë seksuale të subjektit aktiv dhe për këtë legjislatori nuk e kushtëzon

ekzistencën e kësaj vepre penale me pëlqimin e të miturit apo me dhunë të ushtruar ndaj tij.

Ai mbrohet pavarësisht shkallës së koshiençës dhe eksperiencës në fushën seksuale dhe duhet të vazhdohet të mbrohet dhe pse mund të ketë pjekuri të mjaftueshme seksuale, sepse veprat e turpshme mund ta cojnë në mbylljen në vetvete të të miturit si dhe në krijimin e një bote të tij të gabuar në fushën seksuale.

Në lidhje me marrëdhëniet seksuale ose homoseksuale në vende publike, parashikim i cili përmbahet në nenin 107 të Kodit Penal, në brendësi të seksionit të krimeve seksuale dua të vë në dukje se nuk jam dakort me këtë inkuadrim pasi në të vërtetë gjendemi para një figure kriminale e cila nuk ka si qëllim mbrojtjen e lirisë seksuale të subjekteve, por mbrojtjen e moralit publik.

Mendoj se kjo figurë kriminale mund të mos rregullohet në këtë seksion, por midis veprave penale që mbrojnë moralin dhe dinjitetin (seksioni VIII i kreut II)

Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke kërcënuar personin e dëmtuar për përdorim aty për aty të armës mundëj edhe të mos rregullohet nga legjislatori si figurë krimi më vete, por do të ishte e udhës që kërcënimi për përdorim arme të cilësohet si rrethanë rënduese dhe si e tillë të parashikohej dhe në dispozita të tjera të lidhura me krime të tjera seksuale.

Dhuna seksuale si figurë kriminale më vete përbën një risi për legjislacionin shqiptar. Dispozita që rregullon këtë vepër penale është shtuar përmes ligjit 144/2013, datë 2.5.2013. Sigurisht në mënyrën dhe mjetet e kryerjes së saj. Nga ana objektive krimi kryhet përmes veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër duke përdorur objekte të ndryshme.

Legjislatori nuk e specifikon natyrën e objekteve duke e zgjeruar në këtë mënyrë fushën e veprimit të dispozitës. Mendoj që miratimi i dispozitës ishte i domosdoshëm pasi në mungesë të saj sjelljet me natyrë seksuale, devijante, të cilat kryhen përmes objekteve nuk do të ishin të pa ndëshkueshme, por, sipas specifikave të rasteve konkrete, ato do të inkuadroheshin në figura të tjera të veprave penale të parashikuara nga legjislatori shqiptar si rrahje, plagosje të lehta apo të rënda dhe vrasje. Por objekti do të ishte i gabuar pasi në këto grup veprash penale legjislatori mbron jetën dhe shëndetin e subjektit pasiv, ndërsa me ndryshimet e bëra objekti kryesor është ai i mbrojtjes së sferës seksuale, por njëkohësisht dhe shëndeti e jeta e personit.

Ngacmimi seksual si vepër penale përbën një risi në legjislacionin penal shqiptar. Dispozita që ndalon ngacmimet seksuale është neni 108/a i cili mbyll edhe seksionin e krimeve seksuale. Kjo dispozitë është shtuar me ndryshimet e ligjit nr. 144/2013, datë 2.5.2013.

Në kreun e katërt u analizuar provat dhe doli në pah se krimet seksuale për shkak të natyrës së tyre si dhe mekanizmit të kryerjes në praktikë paraqesin vështirësi të mëdha në kuadër të provueshmërisë. Shpeshherë e gjithë akuza bazohet vetëm në thëniet e të dëmtuarës, në mungesë të shenjave të dhunës, në mungesë të gjurmëve biologjike. Në këtë aspekt vlerë të vecantë merr teoria e provave dhe procesi i të provuarit, të cilat përbëjnë një nga elementet thelbësore të procesit penal. Përballë nevojës për

ndëshkimin e krimit është parimi i pandëshkueshmerisë së personit që nuk e ka kryer veprën penale.

Theksohet se procesi i të provuarit është fleksibel dhe i kushtezuar nga indikatorët e figurës së veprës penale, e cila futet në kategorinë e krimeve seksuale. Kështu të ndryshëm janë indikatorët që përbëjnë elementet e “Marrëdhënies me dhunë me të rritura”, në krahasim me ata që përbëjnë “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini, ose nën kujdestari”, duke ndikuar në standartin e provës.

Në kreun e fundit u analizuan krimet seksuale në tre legjislacione, italian, francez dhe amerikan.

Edhe në Shtetet e Bashkuara, në linjë me të gjitha vendet e zhvilluara këto krimet seksuale trajtohen nga ligji dhe shoqëria si veçanërisht serioze dhe të rënda. Karakteristikë e tyre është fakti që ato dhunojnë intimitetin e individit dhe anën psikologjike të tij në një mënyrë të tillë që dëmtimet e mirëfillta fizike nuk arrinë ta bëjnë.

Vëmendja e veçantë dhe ashpërsia e legjislatorit del në pah edhe nga fakti, që në legjislacionin amerikan, sjellja seksuale kriminale kuptohet në një sens shumë të gjërë. Ajo përfshin edhe thjesht prekjet që një individ i bën një tjetri në vende intime, pjesë të trupit të këtij të fundit. Siç u evidentua në tekst Instituti Amerikan i ligjeve ka propozuar ta zgjerojë edhe më tej këtë nocion duke përfshirë prekjen e çdo pjese të trupit, të veshur ose jo, në të gjitha ato raste kur kjo prekje ka qëllime seksuale. Pavarësisht llojshmërisë së krimeve seksuale krimi më i rëndësishëm dhe më i rëndë është përdhunimi. Ky i fundit do të konsiderohet si krim i shkallës së parë apo të dytë në varësi të rrethanave të rastit konkret. Elementët e kësaj vepre penale janë tre: Actus Reus, Mens Rea dhe rrethanat materiale të kryerjes së veprës penale. Përdhunimi mund të ndodhë edhe midis dy bashkëshortëve dhe përdhunues mund të jetë edhe femra dhe viktima të jetë mashkulli.

Lëvizjet feministe në SHBA kanë përkrahur idenë se gratë nuk janë sende dhe nuk janë nën pushtetin e bashkëshortëve të tyre. Sot në 25 shtete të Amerikës marrëdhëniet seksuale me dhunë me bashkëshorten konsiderohen si një krim dhe ndoshta kjo situatë do të pranohet edhe gjatë procesit të rishikimit të Kodit penal Model.

Në legjislacionin italian krimet seksuale kanë qenë objekt i disa ndërhyrjeve legjislative. U vu në dukje se në Kodin Penal të vitit 1930 (Kodi Rocco) krimet seksuale ishin të vendosura në titullin IX “Krimet kundër moralit publik dhe zakonit të mirë”. Por nëse marrëdhënia juridike, që vihet në bazë të mbrojtjes së këtij titulli, është morali publik dhe zakoni i mirë atëherë është natyrale që të mblidhen në të njëjtin vend vepra penale shumë heterogjene midis tyre duke i lejuar ligjit në fjalë të ishte “një mbajtjes i gjerë” si për krimet seksuale ashtu dhe për ato të prostitucionit.

Nga objekti i mbrojtjes, del qartë në pah se fillimisht legjislatori italian i ka dhënë rëndësi më të madhe mbrojtjes së shoqërisë nga veprime të tilla të kundraligjshme dhe vetëm me reformën e vitit 1996, pas debateve të shumta juridike dhe parlamentare që kanë zgjatur me vite, të ndikuar dhe nga lëvizjet e shumta feministe, ai vendosi të ndryshonte jo vetëm përmbajtjen e normave juridike, por edhe vendin e tyre në Kodin

Penal duke përcaktuar si objekt kryesor të kësaj mbrojtjeje lirinë dhe sferën seksuale të individit.

Me ligjin nr.66 dt.15.02.1996 u bënë disa ndryshime thelbësore të normativës mbi krimet seksuale. Si fillim u ndryshua vendi që ato zinin në kodin penal të vitit 1930 pasi nga titulli IX “Krime kundër moralit dhe zakonisht të mirë” ato kaluan në titullin XII në “Krimet kundër personit”.

Më tej normativa është ndryshuar nga ligji nr. 38, dt 6/2/2006, ligji nr.172, dt. 1/10/2012, dekreti legjislativ nr.154, i dt. 28/12/2013 si dhe dekretit legjislativ nr.39 të dt 4/3/2014. Ndryshimet janë pritur pozitivisht edhe pse mbeten disa mëdyshje. Kështu, përse i përket krimeve seksuale ndaj të miturve, duket sikur normativa nuk merr siç duhet në konsideratë seksualitetin dhe të drejtat seksuale ndaj të miturve.

Gjithashtu duket e tepruar dhe figura e veprës penale të korrupsionit të të miturve, i parë si një formë e avancuar e eksibicionizmit. Kjo figurë veprë penale cilësohet si një naivitet i legjislatorit dhe e papërshtatshme për të mbrojtur të miturin që jeton në një botë ku në çdo moment mund të shohë imazhe dhe më të papërshtatshme që përhapen nga mjetet e ndryshme të komunikimit

Duke vijuar me krimet seksuale në të drejtën franceze, punimi nxorri në pah, mes të tjerave, sesi ka ndryshuar qëllimi i mbrojtjes juridike në këto vepra penale. Fillimisht ky qëllim identifikohet me mbrojtjen e zakoneve të mira dhe të moralit publik.

Më pas, përmes miratimit të Kodit të ri penal francez, i cili hyn në fuqi më datë 1 mars të vitit 1994 reformohet dhe qëllimi i normativës i cili identifikohet tashmë me lirinë seksuale. Në fakt, tutela franceze përqëndrohet mbi integritetin fizik dhe psikik të personit dhe seksualiteti i këtij të fundit mbetet në sfond. Ai duhet kuptuar si një përbërës i integritetit fizik.

Gjithashtu bie në sy numri i ulët i krimeve seksuale të parashikuara nga Kodi penal francez. Ato janë tre forma të abuzimit seksual: 1) abuzimi seksual në sens të ngushtë (nenet 227-25 dhe në vazhdim); 2) agresioni seksual (nenet 222-27 e në vazhdim) dhe 3) përdhunimi (nenet 222-23 dhe në vazhdim).

Në punim u kritikua mënyra e sistemimit dhe ndarja e këtyre veprave në krerët dhe seksionet përkatës të Kodit penal, pasi vepra e abuzimit seksual nuk inkadrohet me krimet e tjera seksuale, por rradhitet në sektorin e pestë i emërtuar “rreziqet ndaj të miturve”.

Abuzimi seksual në sens të ngushtë (Abuzimi seksual mbi të miturit) i referohet kryerjes së një krimi seksual, por pa përdorur dhunën, pa e detyruar viktimën, kërcënuar atë apo në mënyrë të papritur. Krimi duhet të kryhet nga një person madhor me një të mitur. Në këtë vepër penale elementi që mbron viktimën është mos marrja në konsideratë e konsensusit të viktimës. Ky fakt justifikohet me faktin që në rastin e një fëmije shumë të ri (më pak se 12, 13 vjec) konsensusi konsiderohet zakonisht si i pamundur apo i pavlefshëm.

Agresioni seksual i ndryshëm nga përdhunimi konsiston në veprime seksuale të ndryshme nga përdhunimi. Duhet nënvizuar fakti që dënohet me të njëjtat sanksione si agresioni seksual ashtu edhe tentativa për të kryer veprën penale të agresionit seksual.

Përdhunimi përkufizohet si “Çdo akt i penetrimit seksual, i çfarëdo natyre, i kryer kundër një personi duke përdorur dhunën, duke e detyruar viktimën, kërcënuar apo duke e surprizuar atë”. Përdhunimi përbën krimin seksual më të rëndë.

Në punim u evidentua orientimi i ashpër i legjislatorit francez, i cili arrin të sanksionojë këtë veprë deri me burgim të përjetshëm në të gjitha ato raste kur kryerja e veprës është shoqëruar me akte torture apo barbarizmi. Nëse krahasojmë të treja veprat penale vëmë re se abuzimi seksual në sens të ngushtë dallohet si nga agresioni seksual ashtu dhe nga përdhunimi pasi këto dy të fundit kanë një element të përbashkët që është mungesa e konsensusit të viktimës.

Një dallim tjetër që nxjerrim në pah është fakti që agresioni seksual dhe dhuna seksuale nuk janë vepra penale që lidhen në mënyrë specifike me të miturit, sic ndodh në rastin e abuzimit seksual. Në veprat penale të agresionit seksual dhe përdhunimit mosha e viktimës dhe cilësia e paraardhësit apo të mbajtësit të pushtetit përbëjnë vetëm rrethana rënduese për efekt të masës së sanksionit.

Në përfundim të kësaj analize, parë në kuadër të përgjithshëm krahasimor, arrimë në konkluzionin që, legjislacioni shqiptar mbi krimet seksuale është një legjislacion modern dhe në linjë me legjislacionet e analizuara në këtë kre.

Rekomandime.

Nga analiza e zhvilluar në këtë punim doli në pah se legjislacioni penal mbi krimet seksuale është riparë së fundmi dhe tashmë gjendemi përballë një disipline të plotë dhe në linjë me disiplina të tjera të huaja të perëndimore. Në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të kësaj disipline, përmes këtij punimi unë dëshiroj të jap disa mendime e sugjerime personale.

Së pari, përsa i përket të drejtës penale materiale gjykoj se duhet të mbrohen nga legjislatori dhe marrëdhëniet seksuale të kryera me mashtrim dhe ato kur subjekti pasiv nuk jep pëlqimin e tij. Nuk është e thënë që në cdo rast subjekti aktiv të jetë i aftë të bëjë rezistencë, sepse kjo varet nga mënyra e të përjetuarit në mënyrë thellësisht personale të ngjarjeve dhe fakteve që na ndodhin dhe cdo njeri nga ne ka mënyrën e vet të reagimit sic mund të jetë dhe mbyllja në vetvete dhe mosbërja rezistencë.

Vetë ligji penal nuk lejon zbatimin e tij me analogji dhe po të ndodhemi para faktit të tillë e vetmja gjë që mund të bëjnë organet që ushtrojnë ndjekjen penale është të vendosin mosfillimin e procedimit penal. Dhe kjo është hasur shpesh në praktikë për fakte të ndryshme, jo në sferën seksuale, ku është vendosur mosfillimi, sepse ligji nuk parashikon një figurë të tillë veprë penale.

Në lidhje me veprën penale të kryerjes së marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, duke kërcënuar personin e dëmtuar për përdorim aty për aty të armës, rekomandoj që ky krim të mos rregullohet nga autori si figurë krimi më vete, por do të ishte e udhës që kërcënimi për përdorim arme të cilësohej si rrethanë rënduese dhe si e tillë të parashikohej dhe në dispozita të tjera të lidhura me krime të tjera seksuale.

Rekomandoj gjithashtu që parashikimet e neneve 102 dhe 102/a të bashkohen në një dispozitë të vetme ku të evitohet çdo lloj diskriminimi me bazë gjinie.

Së dyti përsa i përket ligjit procedural penal mendoj se gjykimet e kësaj natyre, vecanërisht kur subjekti është i mitur, duhet të zhvillohen me dyer të mbyllura. Gjithashtu duhet të përdoren videokonferencat ku i dëmtuari/dëmtuara të ndodhen në ambiente familjare dhe të rehatshme për to, nën kujdesin e vazhdueshëm të një psikologu të specializuar në këtë fushë.

Mendoj se në cdo rast duhet të bëhet një ekspertim psikiatriko-ligjor për autorin e veprës penale si dhe një ekspertim psikologjik përsa i përket viktimës së veprës penale për të parë gjendjen e saj psikologjike dhe pasojat që ka shkaktuar vepra penale.

Nisur dhe nga eksperiencia personale, në detyrën e prokurorit, mendoj se asnjë nga veprat penale kundër sferës seksuale nuk duhet të ndiqet me ankim. Në shumë raste të dëmtuarat nga vepra penale heqin dorë për arsye nga më të ndryshmet, ku mbizotërojnë frika nga opinionin publik si edhe ndërhyrja e familjarëve për të mos e ndjekur çështjen si dhe ndërhyrja e familjarëve të autorit për ta falur atë. Për realitetin shqiptar mendoj se këto vepra penale duhet të ndiqen kryesisht. Një autor i një veprë penale të kësaj natyre, që është falur një apo dy herë do vazhdojë të kryejë vepra të kësaj natyre duke e menduar veten të padënueshëm.

Krimi seksual mund të gjenerojë simptoma të tilla si një çrregullim i vërtetë i stresit posttraumatik. Në këtë mënyrë, përvojat e vuajtura, në formën e imazheve, emocioneve, ndjenjave fizike, fjalëve, tingujve, aromave, shijeve, ankthit, mund të kthehen shpesh në mendjen e personit të abuzuar, së bashku me emocione e forta shqetësuese, të tilla si depresioni, ankthi, frika, nervozizmi, panik apo inati. Tek fëmijët kujtimet e atyre çfarë kanë ndodhur priren të përsëriten në format më të këqija të tyre dhe ndoshta të bëjnë që nesër kjo viktimë të jetë autor veprave penale.

Ndaj nuk duhet të mungojë për asnjë moment asistencë psikologjiko-psikiatrike (varet nga rëndësia e dëmit psikologjik) që në momentin që konstatohet një veprë penale e kësaj natyre dhe deri në momentin që subjekti do të konsiderohet që i ka kaluar traumat dhe problematikat e kaluara. Gjithashtu duhet të ofrohet dhe asistencë juridike falas. Kjo ndihmesë duhet të parashikohet në ligj dhe të ofrohet falas.

Shteti gjithashtu duhet të garantojë strehim të specializuar për viktimat, arsimim, punësim, pasi për realitetin shqiptar shumë herë këto viktima nuk pranohen më nga familjet dhe shoqëria, si dhe të garantojë që në këto lloj çështjesh të mos bëhet publik emri i viktimës jashtë dyerve të prokurorisë dhe gjykatës.

Në disa prokurori ka psikologë, por ato asistojnë në seanca pyetjesh, kryesisht të autorëve të veprave penale të cilët janë të mitur, dhe nuk kanë specializimet e duhura për të trajtuar viktimat e veprave penale.

Gjithashtu duhet të parashikohet dhe dëmshtëpërblimi moral, i cili duhet të rregullohet proceduralisht dhe të urdhërohet nga gjykata në momentin e dhënies së dënimit.

Rekomandoj që të ketë seksione të posacme të organeve të drejtësisë (polici gjyqësore, prokurori, gjykatë) të cilët të jenë të specializuar në këto lloj veprash penale dhe vecanërisht në lidhje me trajtimin dhe mënyrën e komunikimit, pyetjes së viktimave dhe më tej të autorëve të veprave penale. Veprat penale kundër sferës seksuale janë të një natyre krejtësisht të vecantë, të lidhura ngushtësisht me sferën psikologjike si të autorit po ashtu dhe të viktimave të këtyre veprave penale, ndaj mendoj që kërkohet specializimi i duhur për të gjithë aktorët që do merren me trajtimin, hetimin e gjykimin e këtyre çështjeve.

Së treti përsa i përket politikës penale dënimet duhet të jenë të ashpra, por gjithashtu duhet të parashikohet dhe të jepet si dënim plotësues dhe detyrimi për të ndjekur seanca me psikologë apo mjekë terapistë si gjatë kohës së burgimit po ashtu dhe pas përfundimit të tij. Nuk duhet të jepen alternativa të dënimit me burgim pa u dhënë më parë një raport nga psikologu/terapisti kurues nëse ky person është ende i rrezikshëm në kryerjen e veprave penale të të njëjtës natyrë.

Sugjeroj, që sic ndodh në shumë vende të tjera, autorët e veprave penale me natyrë seksuale të skedohen në skedarë jo publikë, dhe vazhdimisht të mbahen nën mbikqyrje nga forcat e rendit. Kuptohet kjo duhet të bëhet pa cënuar të drejtat dhe liritë themelore të personit, sepse pavarësisht faktit se ka kryer një veprë penale, ai e ka vuajtur dënimin dhe tashmë është një qytetar i lirë.

Bibliografi.

Act no. 1998 - 468 of 17 June 1998 Article 13 Official Journal of 18 June 1998. (Francë)

Act no. 2002-305 of 4 March 2002 Article 13 Official Journal of 5 March 2002. (Francë)

Act no. 94-89 of 1 February 1994 Article 15 Official Journal of 2 February 1994. (Francë)

Act no. 95-116 of 4 February 1995 Article 121 Official Journal of 5 February 1995. (Francë)

Act no. 98 - 468 of 17 June 1998 Article 13, Article 19 Official Journal of 18 June 1998. (Francë)

Act no. 98-468 of 17th June 1998 Article 18 Official Journal of 18th June 1998. (Francë)

Ambrosini G., *Le nuove norme sulla violenza sessuale*, Torino, 1997.

Anderson/Doherty, *Accounting for Rape*, London, 2008.

Antolisei F, *Manuale di diritto penale, Parte speciale - I*, edizione a cura di L. Conti, 1996.

Balbi G., *Violenza Sessuale, në Enciclopedia Giuridica, VII*, 1999.

Bandura A., *Social foundations of thought and action: A social cognitive theory*. Prentice - Hall, Englewood Cliffs, NJ, 1986.

Bashkimi Evropian, Direktiva 2011/36/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e dates 5 prill 2011 për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij.

Bertolino M., etj. *Commentario delle "Norme contro la violenza sessuale* (Legge 15 febbraio 1996, nr.66), Cedam, Padova, 1996.

Bertolino M., *I reati sessuali tra codice e riforma*, neRivista italiana di diritto e procedura penale, 1983.

Bertolino M., *La riforma dei reati di violenza sessuale*, in *Stud. Iuris*, 1996.

Bertolino M., *Liberta' sessuale e tutela penale*, Milano, 1993.

Borgogno *Il delitto di violenza sessuale*, në *I reati sessuali* nën kujdesin e F. Coppi, Torino, 2000.

Bourke J., *Stupro. Storia della violenza sessuale*, Bari, 2009.

Brahaj A., *Pedofili. Vëllimi i krimeve dhe dinamika e fenomenit*.

<http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/en/id/136/Pedofili.-Vellimi-i-krimeve-dhe-dinamika-e-fenomenit>.

Brownmiller S., *Against our will. Men, women dhe rape*. Ballantine Publishing group, 1975.

Bruzzone R., *Criminal Profiling dei child sex offenders* në (nën përkujdesjen e) Strano M., *Abusi sui minori: manuale investigativo*, Nuovo Studio Tecna, Roma 2006.

Bruzzone R., *Il profilo criminologico del pedofilo*, Artikull i botuar në numrin 3 të Revistës ALTEREGO – Maj 2007, www.accademiascienzefforensi.it

Burt, M. R. *Cultural myths and supports for rape*. Journal of Personality and Social Psychology, 1980.

Cadoppi A., *Commento all'art.3*, në A. Cadoppi, *Commentario delle norme contro la violenza sessuale e della legge contro la pedofilia*, Padova, 1999.

Cadoppi A. (nën përkujdesjen e) *La violenza sessuale a cinque anni dalla legge n.66/96. Profili giuridici e criminologici*. Padova, Cedam, 2001.

Canepa G., Lagazzi M., *I delitti sessuali*, Padova 1988.

Cappai M., *Guida alle norme contro la violenza sessuale*, 1997.

Cass. crim., 4 janvier 1985: Bull. crim. n° 10; Gaz. Pal. 1986.1.19 (viol commis par une femme).

Catanesi R., Troccoli G., *Il disturbo post-traumatico da violenza sessuale*, në Rassegna italiana di criminologia, Milano 1988.

Chaffin M., Letourneau, E., & Silovsky, J. F. *Adults, children and children who molest*. *Siecus Report*, 29(1), 2002.

Christian D., *Beyond reasonable doubt. Standard of proof and evaluation of evidence in criminal cases*, Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2009, fq. 170. Cit. prej <http://www.scandinavianlaw.se/pdf/40-7.pdf>. klikuar për herë të fundit me datë 21.05.2013.

Christopher P., *Lawful Access and Data Preservation/Retention: Present Practices, Ongoing Harm, and Future Canadian Policies*, 21 (2012) (describing the increasingly

blurred distinction between content based and non-content based data) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children)

Colli A., *La tutela della persona nella recente legge sulla violenza sessuale all'epilogo di un travagliato cammino legislativo*, në *Rivista italiana di diritto e procedura penale*, 1997.

Conso G., Grevi V., *Commentario breve al Codice di Procedura Penale. Complemento Giurisprudenziale*. Cedam, 2011.

Contieri E., *La riforma legislativa in mtema di delitti sessuali. Commento articolo per articolo*, në *Giustizia penale*, parte prima.

Coppi F., *I reati sessuali. I reati di sfruttamento dei minori e di riduzione in schiavitù per fini sessuali*. Giappichelli, 2007.

Cornish, D., & Clarke, R. *Understanding crime displacement: An application of rational choice theory*. *Criminology*, 25(4), 1987.

Cornish, D., and Clarke, R., *The Reasoning Criminal. Rational Choice Perspectives on Offending*. New York, NY: Springer - Verlag, 1986.

Council of Europe, *Guidelines of the Committee of Ministers of the Council of Europe on child-friendly justice* (17 November 2010)

Crowley, *Sexual assault*, Stamford, 1999.

Damini P., *Sulla nozione di atti sessuali ex art. 609 bis c.p.: nuova legge, vecchia giurisprudenza?*, në *Ind. Pen.*, 1988.

Deklarata e parimeve themelore të drejtësisë për viktimat e krimit dhe keqpërdorimit të pushtetit e miratuar me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara nr.40/34 të datës 29 nëntor 1985, par. 15.

Dekret legjislativ i datës 28/12/2013, nr. 154, Itali.

Dekret legjislativ i datës 4/3/2014, nr. 39, Itali.

Dekret ligj, dt. 14/8/2013, nr. 93, i konvertuar, në ligjin 15/10/2013, n. 119, Itali.

Department of Justice of Canada, *Lawful Access FAQ 4* (2005) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children) developmental perspective. Në J. E. B. Myers & L. Berliner

Department of Justice of Canada, *Lawful Access FAQ 4* (2005) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).

Diesen Ch, *Beyond reasonable doubt. Standard of proof and evaluation of evidence in criminal cases*, Stockholm Institute for Scandianvian Law 1957-2009. <http://www.scandinavianlaw.se/pdf/40-7.pdf>.

Donini M., *Art. 9, në Commentario delle norme contro la violenza sessuale*, Padova 1996.

Dr. Robin N. Haarr, *Dhuna në familje në Shqipëri, raport kombëtar mbi bazë popullatën, 2013*. raport gjenden në faqen zyrtare të INSTAT me adresë. http://www.instat.gov.al/media/225812/dhuna_ne_familje_ne_shqiperi_2013.pdf

Dr. Robin N. Haarr, *Dhuna në familje në Shqipëri, raport kombëtar mbi bazë popullatën, 2009*, UNDP. Ky raport gjenden në faqen zyrtare të UNDP me adresë: <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/Domestic%20Violence%20in%20Albania%20-%20National%20Survey.pdf>

Dragoti, E., & Kusi, S. (2007). *Violence against children in Albania: The capacities of service providers to identify, register, report and refer cases of violence against children*. Tirana, Albania: UNICEF.

Elezi I., *E drejta penale*, Tiranë 2015.

Elezi I., *Kanuni i Labërisë*, Toena, Tiranë, 2002.

EU Directive on the retention of data generated or processed in connection with the provision of publicly available electronic communication services or of public communications networks, Article 1 (Mar. 15, 2006), at <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32006L0024:en:HTML>

EU Directive on the retention of data generated or processed in connection with the provision of publicly available electronic communication services or of public communications networks, Article 1 (Mar. 15, 2006), at <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=CELEX:32006L0024:en:HTML>

European Commission Directorate General for Home Affairs, *Evidence of Potential Impacts of Options for Revising the Data Retention Directive: Current approaches to data preservation in the EU and in third countries 4* (Nov. 2012) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).

European Commission Directorate General for Home Affairs, *Evidence of Potential Impacts of Options for Revising the Data Retention Directive: Current approaches to data preservation in the EU and in third countries 4* (Nov. 2012) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).

European Commission, *Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, The EU Strategy towards the Eradication of Trafficking in Human Beings 2012-2016*.

Fiandaca G., *Buon costume. III) Moralita' pubblica e buon costume*, në *Diritto.Pen.*, në Enciclopedia giuridica, Roma, 1988.

Fiandaca G., *La rilevanza penale del "bacio" tra anatomia e cultura*, në *Foro italiano*, 1998, II.

Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF), Udhëzime për Mbrojtjen e Fëmijëve Viktima të Trafikimit (shtator 2006)

Friedman L. M., *A history of American law*, third Edition, published by Simon and Schuster, New York, 2005.

Fromuth M & Conn V. *Hidden perpetrators. Sexual molestation in a nonclinical sample of college Women. Journal of Interpersonal Violence* 12, 1997.

Frued S., *Tre saggi sulla teoria sessuale*, Boringhieri, Torino, 1905.

Garcon, *Code pénal annoté (art. 331 à 333), n°15, II*, nën përkuqdesjen e *Rousselet & Patin & Ancel*, 1956.

Gaxha A., *Gjurmët Biologjike dhe roli e rëndësia e tyre në procesin penal*, Temë Doktorature, Dhjetor 2014.

Gazzetta G., *Colpevole col consentire. Dallo stupro alla violenza sessuale nella penalistica dell'ottocento*, në *Rivista Italiana di diritto e procedura penale*, 1997, fq.424

Gjykata e Apelit Korçë, vendim nr.133, dt. 14.11.2008.

Gjykata e Apelit Korçë, vendim nr.81, dt. 06.06.2008.

Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr. 254, dt. 23.04.2009.

Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.108, dt. 15.02.2008.

Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.254, dt. 23.04.2009.

Gjykata e Apelit Tiranë, vendim nr.580, dt. 31.10.2008.

Gjykata e Apelit Vlorë, vendim nr.173, dt. 18.05.2007.

Gjykata e Kazacionit në Itali, penale, seksioni III, 23.5.2006 – 12.10.2006, n. 34128.

Gjykata e Lartë, vendim dt. 24.04.1974.

Gjykata e Lartë, vendim nr.00-2010-341 (59), dt. 29.01.2010.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, vendim nr.28, dt. 28.02.2008.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendim nr. 11- 2015 – 3901, dt. 15.08.2015.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim nr. 11-2009-3057, dt. 07.07.2009.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim nr. 11-2012-2579, dt. 04.09.2012.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim nr. 11-2012-7928, dt. 16.04.2012.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, vendim nr. 11-2013-5877, dt. 08.01.2014.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, vendim nr.261, dt. 01.12.2006.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë vendim nr.55, dt. 13.02.2008.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, vendim nr. 225, dt. 23.06.2008.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim dt. 19.01.2010.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 1581 dt. 19.11.2008.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 1856, dt. 19.12.2011.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 2011, dt. 26.12.2012.

Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 3, dt. 12.01. 2010,

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 3/2010.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 747, dt. 11.05.2010.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 821 dt. 25.04.2007.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr. 922, dt. 18.06.2010.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.1099, dt. 17.07.2008.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.136, dt. 21.09.2006.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendim nr.1581, dt. 19.11.2008.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, vendim nr.302, dt. 11.12.2002.

Gjykata evropiane e drejtësisë: Çështja *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë*, (Aplikimi nr. 23458/02), 24.03.2011.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Van Mechelen e të tjerë v. Holanda , 21363/93, 21364/93, 21427/93, e datës 23 prill 1997, par. 53. Gjithashtu Doorson v.Holanda, 20524/92, e datës 26 mars 1996, par. 70 dhe P.S. v. Gjermania, 33900/96, e datës 20 dhjetor 2001, par. 22.

Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, In re Winship, 393 U.S. 358, 364 (1970), cit. prej http://scholar.google.com/scholar_case?case=14966781063535213924&q=in+re+Winship&hl=en&as_sdt=2003, klikuar më datë 21.05.2013.

Gjykata Supreme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, In re Winship, 393 U.S. 358, 364 (1970), cit. prej http://scholar.google.com/scholar_case?case=14966781063535213924&q=in+re+Ëinship&hl=en&as_sdt=2003, klikuar më datë 21.05.2013.

Goldstein, M., Kant, H.S. and Hartman, J.J., *Pornography and Sexual Deviance*. Berkeley: University of California Press, 1974.

Goyet, *Droit Penal special*, Edicioni i tetë, Sirey, 1972.

Hamilton, C., Malby, S., & Ross, G. (2007). Analysis of the child protection system in Albania. Tirana, Albania: The Children's Legal Centre and UNICEF.

Henrik L., *Provat dhe procedimi provues*, Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012.

History of Criminal Law - Then, Now, the Future, në <http://www.crimesanddefenses.com/History.html>

Holmes R., and Holmes S., *Profiling violent criminals*, Thousands Oaks, CA, Sage, 1996.

Hysi V., *Hyrje në Kriminologji dhe Penologji*, Tiranë, 2000.

Hysi V., *International Crime Victims Survey in Tirana, Albania, 1996*, në The International Crime Victims Survey in Countries in Transition, national reports, UNICRI, Publication no.62, Romë 1998.

ILO, Vlerësimi Global i Punës së Detyruar (Gjenevë, 2012).

Intervistë mbi Krimet seksuale, një tjetër plagë e shoqërisë sonë, nga eksperti mjekoligjor Admir Sinamati <http://shendeti.com.al/krimet-seksuale-nje-tjeter-plage-e-shoqerise-sonë/>.

Jason Weinstein, Data Retention as a Tool for Investigating Internet Child Pornography and other Internet Crimes 3 (Jan. 25, 2011) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).

Kadish S. H., Schulhofer S. J., *Criminal Law and its Processes. Cases and materials*, Fifth Edition, Little, Brown and Company, Boston Toronto, London.

Kaplan M & Green A., *Incarcerated female sexual offenders: A comparison of sexual histories with eleven female nonsexual offenders*. *Sexual Abuse: A Journal of Research and Treatment* 7: 1995.

Kaplan M. and Green A., *Incarcerated female sexual offenders: A comparison of sexual histories with eleven female nonsexual offenders*. *Sexual Abuse: A Journal of Research and Treatment* 7: 1995.

Kaufman, K. L., Hilliker, D. R. and Daleiden, E. L. *Subgroup differences in the modus operandi of adolescent sexual offenders*. *Child Maltreatment*, 1, 1996.

Kerr O., *Applying the Fourth Amendment to the Internet: A General Approach*, 62 Stan. L. Rev. 1005, 1030 (2010) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children)

Këshilli i Evropës, Konventa për Veprim Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, CETS Nr 197 (Varshavë, 2005), <<http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/197.htm>>

Këshilli i Evropës, Op. Cit., Art. 10.3; UNODC, Udhëzime legjislative për Zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional dhe Protokollit në zbatim të tij (Nju Jork, 2004), f. 289.

Kodi penal francez i vitit 1810.

Kodi penal francez i vitit 1994, i ndryshuar.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendim nr.2 datë 20.06.2013

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendim nr.00-2010-765, datë 26.05.2010.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendim nr.00-2012-1274 i Vendimit (249) datë 03.10.2012.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendim Nr.00-2010-1200 (842), datë 22.09.2010

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendim Nr.00-2010-341, datë 29.01.2010

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendim Nr.00-2012-1209 (245), datë 26.09.2012.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendim nr.00-2012-1255.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendim nr.00-2012-1255.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vendim nr.170 datë 08.10.1966.

Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendim nr 245 datë 26.09.2012.

Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, vendim nr 537 datë 28.10.2009.

Kombet e Bashkuara, Konventa e të Drejtave të Fëmijës (1989).

Kombet e Bashkuara, Konventa për Statusin e Refugjatëve, 189 UNTS 150 (Gjenevë, 28 korrik 1951)

Kombet e Bashkuara, Protokolli Shtesë për Konventën për të Drejtat e Fëmijës mbi shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë.

Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 14 dhe 15 prill 2009,CTOC/COP/ËG.4/2009/2 (21 prill 2009), <http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/Final_report_English_TIP.pdf>

Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave mbajtur në Vjenë më 27-29 janar 2010, CTOC/COP/WG.4/2010/6 (17 shkurt 2010), <http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_WG4/CTOC_COP_WG4_2010_final_report_E.pdf>

Kombet e Bashkuara, Raport për mbledhjen e Grupit të Punës për Trafikimin e Personave, Mosdënimi dhe mosndjekja penale e viktimave të trafikimit të personave, qasje administrative dhe gjyqësore për shkeljet e kryera gjatë procesit të këtij trafikimi, CTOC/COP/ËG.4/2010/4 (9 dhjetor 2009), para. 10, <http://www.unodc.org/documents/treaties/organized_crime/2010_CTOC_COP_ËG4/ËG4_2010_4_E.pdf>,

Komiteti i Ministrave të shteteve anëtare në Këshillin e Evropës, Rekomandimi (2005)9 mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë, e datës 20 prill 2005, neni II(2).

Konventa e Këshillit të Evropës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”, e ratifikuar nga shteti ynë me ligjin nr.9265 datë 29.07.2004.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe Protokolli II i saj “*Mbi parandalimin, pengimin, dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*”.

Kröber, H.L., Sexualstraftäter – Klinisches Erscheinungsbild. Në Kröber H.L., Dölling D., Leygraf, N., Sass H. (Hrsg.), *Kriminologie und forensische Psychiatrie*, Band 4, Steinkopff Verlag, Darmstadt, 2009.

Lanning, K.V. *Child Molesters: a behavioral analysis*, National Center for Missing and Exploited Children (1992).

Lara Dh., *Koment mbi Kodin e Procedurës Penale*, pjesa e parë, Morava, Tiranë, 2010.

Larguier, *Droit penal special*, 12.ed., Paris, 2002.

Larose et Forcel, *Traité théorique et pratique du droit pénal français*, t. IV, n° 452, 1891.

Ligj nr. 10071 dt. 09.02.2009, www.qpz.gov.al

Ligj nr. 94, dt. 15.7.2009, Itali.

Ligj nr.8733, dt. 24.1.2001, www.qpz.gov.al

Ligji nr. 2005 -1549, dt. 12.12.2005, Francë.

Ligji nr. 172, dt. 1.10.2012, Itali.

Ligji nr. 2003 – 239, dt. 18.03.2003, Francë.

Ligji nr. 2006 – 399, dt. 4.04.2006, Francë.

Ligji nr. 239, dt. 18.03.2003, www.qpz.gov.al

Ligji nr. 38, dt. 6.2.2006, Itali.

Ligji nr. 8175, dt. 23.12.1996, www.qpz.gov.al

Ligji nr. 9110, “*Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Krimeve të Rënda*”, www.qpz.gov.al

Ligji nr. 98 – 468, dt. 17 qershor 1998, Francë.

Ligji nr. 98 – 468,dt. 17.06.1998, www.qpz.gov.al

Ligji nr.1549,dt. 12.12.2005, www.qpz.gov.al

Ligji nr.2007 – 297, dt. 5.03.2007, Francë.

Ligji nr.23, dt. 1.3.2012, www.qpz.gov.al.

Ligji nr.297,dt. 5.03.2007, www.qpz.gov.al

Ligji nr.399, dt. 4.06.2006, www.qpz.gov.al

Ligji nr.8175, dt.23.12.1996, Fletore Zyrtare nr.29, dt.7 Janar 1997, fq.965.

Ligori H., *Provat dhe procedimi provues*, Leksion, Shkolla e Magjistraturës, viti akademik 2011-2012

Macri F., *Verso un nuovo diritto penale sessuale. Diritto vivente, diritto comparato e prospettive di riforme della disciplina dei reati sessuali in Italia*, Firenze University Press, Firenze.

Malamuth M., *Rape proclivity among males*, në *Journal of social issues*, volume 57, no. 4, 1981.

Malmström C., Member of the European Commission responsible for Home Affairs, Taking on the Data Retention Directive, SPEECH/10/723 European Commission conference in Brussels (Dec. 3, 2010), at http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-10-723_en.htm

Malmström C., Member of the European Commission responsible for Home Affairs, Taking on the Data Retention Directive, SPEECH/10/723 European Commission conference in Brussels (Dec. 3, 2010), at http://europa.eu/rapid/press-release_SPEECH-10-723_en.htm

Mantovani F, *Diritto penale. I delitti contro la liberta'e l'intangibilita' sessuale, Appendice ai delitti contro la persona*, 1998.

Marcelo F. Aebi, Galma Akdeniz, Gordon Barclay, Claudia Campistol, Stefano Caneppele, Beata Gruszczyńska, Stefan Harrendorf, Markku Heiskanen, Vasilika Hysi, Jörg-Martin Jehle, Anniina Jokinen, Annie Kensey, Martin Killias, Chris G. Lewis, Ernesto Savona, Paul Smit, Rannveig Þórisdóttir: *European Sourcebook of Crime and Criminal Justice Statistics 2014*, Fifth edition, HEUNI, 2014.

Marini G., *Delitti contro la persona*, II, Torino, 1997..

Marshall, W. L., Jones, R., Ward, T., Johnston, P., and Barbaree, H. E. *Treatment outcome with sex offenders. Clinical Psychology Review*, 1991.

Marshall, W.L., *The Use of Explicit Sexual Stimuli by Rapists, Child Molesters and Nonoffender Males*. *Journal of Sex Research*. Vol. 25 No. 2, 1988.

Martinson, F. M. *Sexual development in infancy and childhood*, në G. Ryan, S. Lane (Eds.), *Juvenile Sexual Offending: Causes, Consequences, and Correction*. San Francisco: Jossey-Bass, 1997.

Mathews R, Hunter J. & Vuz J. *Juvenile female sexual offenders: Clinical characteristics and treatment issues*. *Sexual Abuse: A Journal of Research and Treatment* 9: 1997.

Mazza B., *La libertà personale quale elemento centrale delle nuove norme sulla violenza sessuale: prime osservazioni*, në *Rivista penale*.1996.

Mazzacuva N., *Violenza sessuale*, në *Diritto penale. Lineamenti di parte speciale* nën kujdesin e AA.VV., 1998.

Mens Rea and Rape: Shoul no Mean Yes in the yes of the law, published by Australian National University, 1989.

Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2011, www.drejtësia.gov.al

Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2011, www.drejtësia.gov.al

Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2012, www.drejtësia.gov.al

Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2013, www.drejtësia.gov.al

Ministria e Drejtësisë, Vjetari statistikor 2014, www.drejtësia.gov.al

Model Penal Code: *Sexual Assault and Related Offenses Tentative Draft No. 1* (April 30, 2014) http://jpp.whs.mil/Public/docs/03_Topic-Areas/02-Article_120/20140807/03_ProposedRevision_MPC213_Excerpt_201405.pdf dhe <https://www.ali.org/projects/show/sexual-assault-and-related-offenses/>

Moffetti R. C., *La testimonianza fragile nel processo penale: verso la policromatica valutazione delle dichiarazioni del minore*, në *La giustizia penale*, 2013.

Molan M., Bloy D., Lanser D., *Modern Criminal Law*, fifth edition, Cavendish publishing, USA, 2003.

Montecchi F., *Le varie forme di abuso sessuale*, në *I abusi all'infanzia. Dalla ricerca all'intervento clinico*, La nuova Italia scientifica, Roma, 1994.

Mulliri, *La legge sulla violenza sessuale. Analisi del testo, primi raffronti e considerazioni critiche*, në *Cassazione penale*, 1996.

Murphy P., *Murphy për provën*, Oxford University Press, 2005, përktheu Erjon Shehi, UET Press, 2010.

Nikolić-Ristanović, V., & Dokmanović, M., *International Standards on Domestic Violence and Their Implementation in Western Balkans*, Belgrade, HOM, 2006.

Ogloff J. RP, Cutajar M. C., Mann E. and Mullen P., *Child sexual abuse and subsequent offending and victimisation: A 45 year follow-up study, Trends & issues in crime and criminal justice*, No. 440 June 2012, Australia.

Opinioni i Këshilli Konsultativ të Gjyqtarëve Europeanë nr. 12 (2009) *Për marrëdhëniet e gjyqtarëve dhe prokurorëve në një shoqëri demokratike*.

Ordinance No. 2000 - 916 of 19 September 2000 Article 3 Official Journal of 22 September. (Francë)

OSCE Ministerial Council, Decision No. 1 Enhancing the OSCE's Efforts to Combat Trafficking in Human Beings, MC(8).DEC/1 (Vienna, 28 November 2000), para. 9; OSCE Ministerial Council, Ministerial Declaration On Combating All Forms of Human Trafficking, MC.DOC/1/11/Corr.1 (Vilnius, 7 December 2011). Vendime të Këshillit Ministerial të OSBE-së.

OSCE Ministerial Council, Declaration on Trafficking in Human Beings, MC(10). JOUR/2 (Porto, 7 December 2002), Annex 2, Section II, para.6 (Këshilli Ministerial i OSBE-së, Deklarata për Trafikimin e Qenieve Njerëzore).

Padovani T., *Violenza carnale e tutela della liberta*, në *Rivista italiana di diritto e Procedura penale*, 1989.

Pajardi D, *Oltre a sorvegliare e punire*, collana di: *Prospettive di psicologia giuridica*, 2008, Giuffrè Editore.

Parsons Ch., *Lawful Access and Data Preservation/Retention: Present Practices, Ongoing Harm, and Future Canadian Policies*, 21 (2012) (describing the increasingly blurred distinction between content based and non-content based data) (on file with the International Centre for Missing & Exploited Children).

Paul H. Robinson P. H., dhe Dubber M. D, *The American Model Penal Code: A Brief Overview*, *New Criminal Law Review*, Vol. 10, 2007, fq. 319 ose http://papers.ssrn.com/sol3/papers.cfm?abstract_id=661165

Pavoncello Sabatini L., *Violenza Carnale*, në Enciclopedia Giuridica, Roma, 1994.

Peters J. J. & Roether H. A. *Success and failure of sex offenders*. Philadelphia. American Association for the advancement of science, 1971.

Proietti G., *Lo stupratore*, në Riv. Sess, Cic. N. 28, www.psicolinea.it

Proulx, J., Ouimet, M. and Lachaine, N. *Criminologie de l'acte et pédophilie. Revue Internationale de Criminologie et de Police Technique*, 1995.

Qendra për Shanse të Barabarta dhe Luftë kundër Racizmit, Trafikimit dhe kontrabandimit të qenieve njerëzore (Belgjikë) në lidhje me vendimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit të Gent (Belgjikë), 31 maj 2007.

Qendra Studimore Innocenti e UNICEF, *Child Trafficking in the Nordic Countries: Rethinking strategies and national responses*. Technical report (May 2012)

Relacion i Këshillit të Ministrave për Projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, bashkalidhur Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 175, datë 20.03.2013.

Relacion i Komisionit të Ligjeve, Kuvendi i Shqipërisë mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, Arkiv i Parlamentit Shqiptar.

Relacioni “për projektin e Kodit të ri penal të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, drejtuar Kryesisë së Kuvendit. Arkivi i Parlamentit Shqiptar, nr.896, datë 02.06.1994.

Report from the European Commission to the Council and the European Parliament: Evaluation report on the Data Retention Directive (Directive 2006/24/EC) 22 (Apr. 18, 2011), at <http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2011:0225:FIN:en:PD> *Freport*. Grant No. 90-CA-1469. U.S. Department of Health.

Report from the European Commission to the Council and the European Parliament: Evaluation report on the Data Retention Directive (Directive 2006/24/EC) 22 (Apr.

18, 2011), at
<http://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/LexUriServ.do?uri=COM:2011:0225:FIN:en:PDF>

Romano F., *La violenza sessuale: luci e ombre nella normativa vigente e nelle prospettive di riforma*, në *Giur. mer.*, 1991.

Rossi P., *Traité de Droit pénal*, vol. III, Paris, 1829.

Roth N., *Factors in the Motivation of Sexual Offenders*, *Journal of Criminal Law and Criminology*, Volumi 42, Numri 5 janar – shkurt, Neni 5, Winter 1952.

Ryan, G. *Phenomenology : a developmental-contextual view*, në G. Ryan, S. Lane (Eds.), *Juvenile Sexual Offending: Causes, Consequences, and Correction* (pp.122-135). San Francisco: Jossey-Bass, 1997.

Sahiti E., *Argumentimi në procedurën penale*, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, Botim i dytë i plotësuar dhe i ndryshuar, Prishtinë 2006, fq.180, 181.

Sanford H. Kadish, Stephen J. Schulhofer, *Criminal Law and its Processes.Cases and materials*, Fifth Edition, Little, Brown and Company, Boston Toronto, London.

Schonke A., Schroder H., *Strafgesetzbuch Kommentar*, XXII ediz.’, Munchen, 1985.

Sebba L., *The victim’s role in the penal process: A theoretical orientation*. *The American Journal of Comparative Law* 1982; 30(2): 217-240.

Shtjefën Gj.,– *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Prishtinë 1972.

Shulevitz J.,: *Regulating sex*, *New York Times magazine*,
<http://www.nytimes.com/2015/06/28/opinion/sunday/judith-shulevitz-regulating-sex.html>

Silbert, M.H. and Pines, A.M. *Pornography and Sexual Abuse of Women.Sex Roles*.Vol. 10, 1984.

Simoni S., *Trajtimi i Viktimave të trafikimit si deshmitarë gjatë procesit gjyqësor, mundësitë ligjore për kompensimin e viktimave të trafikimit dhe nevoja për ndryshime ligjore. Probleme të hasura në praktikën gjyqësore*, shkrim në botimin e Shkollës së Magjistraturës “*Kuadri ligjor mbi trafikimin e qënieve njerëzore në Shqipëri dhe sfidat e hasura në praktikën gjyqësore*”, shkurt 2013, fq 77.

Squillaci G. F, *I reati sessuali*, <http://www.nuovefrontierediritto.it/i-reati-sessuali/>

Symons D., *The evolution of human sexuality*, Oxford University Press, 1979.

Tabarelli de Fatis S., *Sulla rilevanza penale del bacio come atto di libidine prima e dopo la riforma dei reati sessuali*, në *Rivista italiana di diritto e procedura penale*, Milano 1997.

Tedeschi T. J., Felson R. B., Violence, Aggression, and Coercive Actions *Hardcover*, në *Journal of contemporary criminal justice*, Volume 12, no.3, 1996

Tekst i shkruar i proçesverbalit të mbledhjes së Komisionit për çështjet ligjore, administratën publike dhe të drejtat e njeriut, datë 03.04.2013, ora 09.20. Arkivi i Kuvendit të Shqipërisë.

The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985).

UNICEF, *Udhëzues referencë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Viktima të Trafikimit në Evropë* (Gjenevë, 2006).

Vendim i GJK, Nr.13, Dt.Aktit: 29.05.1997, datë e miratimit 29.05.1997, Fletore Zyrtare Nr.7, Faqe 171.

Vendim i Gjykatës së Lartë franceze: Cass. crim., 4 janvier 1985: Bull. crim. n° 10; Gaz. Pal. 1986.1.19. (Francë)

Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.291, datë 15.03.2007.

Vendim i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr.876, datë 21.12.2005.

Vendim Kuadër të Këshillit Evropian 2002/629/JHA (5 prill 2011)

Venditto M., *La regolamentazione degli atti sessuali alla luce della legge 15 febbraio 1996, n. 66*, në *Rassegna italiana di crim.* 1997.

Weinstein J., *Data Retention as a Tool for Investigating Internet Child Pornography and other Internet Crimes 3* (Jan. 25, 2011) (on file ëith the International Centre for Missing & Exploited Children).

Witt, P. H., Delrusso, J., Oppenheim, J., and Ferguson.G., *Sex offender risk assessment and the law.* *Journal of Psychiatry and Law*, 1996.

Abstrakt.

Punimi "Krimet seksuale" kërkon të bëjë një analizë sa më të plotë të krimeve seksuale në Shqipëri. Në Shqipëri, krimet seksuale, tradicionalisht, janë konsideruar çënime tepër të rënda dhe të papajtueshme me nderin, moralin dhe respektin ndaj gruas. Legjislacioni penal shqiptar mbron posaçërisht lirinë seksuale dhe shëndetin e njeriut, duke dënuar rëndë përdhunimin dhe krime të tjera seksuale. Analizën me rregullimin e krimeve seksuale në të drejtën zakonore, vijon me rregullimet në Kodin Penal të Mbretit Zog (1930), me rregullimet në "Kodin Penal të Republikës Popullore të Shqipërisë" (1952), rregullimet në Kodin Penal të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (1977). Më pas vijon një vështrim të përgjithshëm mbi krimet seksuale sipas kodit penal të vitit 1995 të ndryshuar me ligjin nr. 8733 datë 24.01.2001 dhe me ligjin nr. 144 datë 02.5.2013. Kodi penal, aktualisht, parashikon disa figura veprash penale, si krime seksuale ose homoseksuale, të cilat konsiderohen krime kundër jetës dhe shëndetit të personit, për të cilat parashikohen dënime të rënda. Krimet seksuale dhe homoseksuale përmbahen në seksionin VI të Kodit penal, "Krimet seksuale", i cili është një prej 10 seksioneve të kapitullit II të këtij Kodi, "Veprat penale kundër personit, krimet kundër jetës". Më tej analizohen figurat e ndryshme të krimeve seksuale të rregulluara nga legjislatori shqiptar në Seksionin e Krimeve Seksuale në Kodin Penal, nga neni 100 deri në nenin 108 të tij. Analiza bazohet jo vetëm mbi tekstin e dispozitave dhe doktrinën në fushë, por edhe mbi vendime të ndryshme gjyqësore. Objekt analize është dhestandarti i provës në krimet seksuale, pozita e viktimës në procesin penal si dhe ndihma juridike. Analiza kryhet duke patur parasysh faktin që krimet seksuale për shkak të natyrës së tyre si dhe mekanizmit të kryerjes në praktikë paraqesin veshitirësi të mëdha në kuadër të provueshmërisë. Analizohen gjithashtu dhe krimet seksuale në legjislacionin italian, francez dhe amerikan.

Fusha e studimit: E drejtë penale

Fjalë kyçe: krim seksual, liri seksuale, akt seksual, krim homoseksual, standart prove.

Abstract.

The PhD research on "Sexual crimes" aims to do a complete analysis of sexual crimes in Albania. Sexual crimes in Albania have been considered traditionally as very serious crimes incompatible with honour, morality and respect for women. Albanian criminal legislation specifically protects the sexual freedom and human health, condemning in a severe way rape and other sexual crimes. The analysis starts with the regulation of sexual crimes under customary law, continues with regulation in the Penal Code of King Zog (1930), and in the Penal Code of the Popular Republic of Albania (1952), regulation in the Penal Code of the Popular Socialist Republic of Albania (1977). The analysis continues with the regulation of sexual crimes in the Albanian penal Code of year 1995, changed by law no. 8733 dated 24.01.2001 and law no. 144 dated 02.5.2013. The Criminal Code currently provides some offenses as sexual or homosexual crimes which are considered crimes against life and health, and for them legislator provides severe penalties. Sexual and homosexual offenses are contained in section VI of Penal Code, intitled "Sexual Crimes", which is one of the 10 sections of Chapter II of this Code intitled "Penal crimes against persons, against life". Are analyzed all sexual crimes regulated by the Albanian legislator in Sexual Crimes Section in Penal Code, from article 100 to article 108. The analysis is based not only on the text of the provisions and doctrine in the field but also on the jurisprudence. The analysis will focus also on the standard of evidence in sexual crimes, the position of the victims in criminal proceedings and also on legal aid. This analysis is carried out taking into account the fact that sexual crimes, because of their nature and the performing mechanism, present difficulties in order with proving process. This work analyzes also sexual crimes in the Italian, French and American legislation.

Field of study: Penal law

Keywords: sexual crime, sexual freedom, sexual offense, homosexual offense, standard of evidence.